# RAPORT AUDITIMI
# MBI
# (Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë)
# në

## "BASHKIA GRAMSH"

**Tiranë 2023**

# PËRMBAJTJA


I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE........................................................Error! Bookmark not defined.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit ........................................................4

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve ........................................................11

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit........................................................13

II. HYRJA........................................................14

1. Objektivat e auditimit........................................................14

2. Qëllimi i auditimit........................................................14

3. Identifikimi i çështjes........................................................15

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese........................................................15

5. Përgjegjësitë e audituesve........................................................15

6. Kriteret e vlerësimit........................................................16

7. Standardet e auditimit........................................................16

8. Metodologjia e auditimit ........................................................17

9. Dokumentimi i auditimit........................................................18

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT........................................................18

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Gramsh........................................................19

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit........................................................19

1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm. ........................................................19

2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2022.........................................................32

3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.........................................................78

4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve. ........................................................96

4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. ........................................................127

5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. të Bashkisë Gramsh ........................................................135

6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore. 149

7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme ........................................................154

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME ........................................................170

V. ANEKSET........................................................190

## Lista e shkurtimeve

| | |
|---|---|
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MFK | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli |
| NA | Nëpunës Autorizues |
| NZ | Nëpunës Zbatues |
| GSM | Grupi i Menaxhimit Strategjik |
| NJAB | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| AB | Auditi i Brendshëm |
| MAB | Manuali i Auditimit të Brendshëm |
| FZHR | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve |
| AQT | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara |
| UMF | Udhëzim i Ministrisë së Financave |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak |
| ASHK | Agjencia Shtetërore e Kadastrës |
| NJA | Njësi Administrative |
| SHA | Shoqëri Anonime |
| NJP | Njësia e Prokurimit |
| BOE | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë |
| OE | Operator Ekonomik |
| KVO | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave |
| ISSAI | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| INTOSAI | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit |
| IFAC | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve |
| IPSAS | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik |

**1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Gramsh si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, zbatimi i kontratave të punimeve në investimet publike, administrimi i aseteve, shfrytëzimi për veprimtari ekonomike i fondit pyjor si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Gramsh 11 akt konstatime dhe 1 akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit si dhe mbi Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Gramsh të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-së. Gjithashtu, në ambientet e KLSH-së më datë 17.07.2023 ishte caktuar për tu zhvilluar takimi përfundimtarë me përfaqësuesit e Bashkisë Gramsh, takim i cili nuk u zhvillua pasi subjekti me emailin e datës 17,07.2023 nuk e pa të arsyeshme zhvillimin e këtij takimi, pai më shkresën nr. 2090/9 datë 07.07.2023 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 205/6 datë 12.07.2023 ka paraqitur observacionet e Projektraportit të auditimit.

**2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve**

| Nr. | Përmbledhje e gjetjeve | Rëndësia | Rekomandimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)” Bashkia Gramsh, me vlerë 95,993,329.20 lekë me TVSH, fituar nga BOE “B.” SHPK & “G.” SHPK, rezultuan punë të pa kryera për zërin e punimeve: “Zëri: 6 (3.25/a) Gërmim Kasonete”, në vlerën **154,581 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. .... prot., datë 04.06.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gramsh dhe BOE “B.” SHPK & “G.” SHPK | E lartë | Bashkia Gramsh të arkëtojë vlerën prej **154,581 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve BOE “B.” SHPK & “G.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. .... prot., datë 04.06.2021 me objekt “Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)” Bashkia Gramsh. |
| 2 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Sistemim asfaltim rruga “Llapushaj” Bashkia Gramsh, me vlerë 96,995,778 lekë me TVSH, fituar nga BOE “V.” SHPK & “E.” SHPK & “L.” SHPK, rezultuan punë të pa kryera për zërin e punimeve: “Zëri: 6 (3.25/a) Gërmim Kasonete”, në vlerën **267,528 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. ..... prot., datë 19.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gramsh dhe BOE “V.” SHPK & “E.” SHPK & “L.” SHPK. | E lartë | Bashkia Gramsh të arkëtojë vlerën prej **267,528 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve BOE “V.” SHPK & “E.” SHPK & “L.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. ..... prot., datë 19.05.2021 me objekt “Sistemim asfaltim rruga “Llapushaj” Bashkia Gramsh. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Sistemim - asfaltim lagjia “Ish Reparti Ushtarak” Bashkia Gramsh, me vlerë 22,979,260 lekë me TVSH, fituar nga BOE “F.” SHPK & “S.” SHPK, rezultuan punë të pa kryera për zërat e punimeve: “Zëri 5(3.182/a) F.V Rërë nën dhe mbi tubacione HDPE 2*10 cm” dhe “Zëri 5 (3.620) Shtresë pllaka trotuari betoni h=6 cm”, në vlerën **264,970 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. ..... prot., datë 28.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gramsh dhe BOE “F.” SHPK & “S.” SHPK. | E lartë | Bashkia Gramsh të arkëtojë vlerën prej **264,970 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve BOE “F.” SHPK & “S.” SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. ..... prot., datë 28.05.2021 me objekt “Sistemim asfaltim lagjia “Ish reparti Ushtarak” Bashkia Gramsh. |
| 4 | Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se Leja e ndërtimit miratuar me vendim Nr. 542/5, datë 17/03/2022 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh me zhvillues “K.” SH.P.K me NIPT J......S me “Objekt banimi dhe shërbimi 3 kate dhe 5 kate me 1 kat parkim nëntokë, në qytetin e Gramshit është llogaritura më pak taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerë 184,311 lekë, konkretisht;<br>Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë (parkimi): 1100 $m^2$ * 5% * 43,000 lekë/m2 *0.7 = 1,655,500 lekë; sipërfaqe shërbimi: 885 $m^2$ * 5% * 43,000 lekë/m2 * 1.5 = 2,854,125 lekë; sipërfaqe banimi: 3460 m2 * 4% * 43,000 lekë/m2 = 5,951,200 lekë; sipërfaqe totale e ndërtimit 4345 $m^{2.}$<br>**Vlera që duhet të paguante = 10,460,825 lekë.**<br>Sipas autorizimit për pagesë të llogaritur nga përgjegjësja e financës znj K. X. dhe firmosur nga Kryetari i Bashkisë z. K. T. dhe e paguar nga firma K. SH.P.K është **9,276,514 lekë** Pra konstatohet një diference e dukshme në vlerën prej **1,184,311 lekë** *( 10,460,825 lekë - 9,276,514 lekë = 1,184,311 lekë*) e papaguar nga subjekti K. SH.P.K për shkak të keq llogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të taksës së Ndikimit në Infrastrukture. Diferenca prej **1,184,311 lekë** e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Gramsh.<br>Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “*Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015*”, Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, aneksi nr. 2 i VKM nr. 132 datë 07.03.2018 dhe sipas Vendimit te Këshillit Bashkiak nr. 96 datë | E lartë | Kryetari i Bashkisë Gramsh të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **1,184,311 lekë,** nga subjekti K. SH.P.K, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukture. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | 30/12/2019 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020" e në vijim. | | |
| 5 | Nga auditimi rezultoi se në 2 raste në miratimi e lejes së ndërtimit nuk hartuar dhe nënshkruar një Akt-marrëveshje me subjektet zhvilluese për kalimin në favor të Bashkisë Gramsh 3% (tre përqind) e sipërfaqes takuese të banimit në godinat respektivisht;<br>1. Miratimi i lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 06 , datë 02/09/2021 me subjektin zhvillues "Z. E. A. L., Znj J. F. L." dhe Bashkia Gramsh nuk kanë hartuar dhe nënshkruar një Akt-marrëveshje bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social', përcaktohet se 3% (tre përqind) e sipërfaqes takuese të banimit në godinat, objekt i aplikimit të lejes së ndërtimit Nr. 06 , datë 02/09/2021 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh është sipërfaqja prej 63 m2-, e llogaritur nga sipërfaqja totale e banimit prej 2100 m2, (2100 m2 * 3% = 63 m2) të cilat duhet të kishin kaluar në favor të Bashkisë Gramsh.<br>2. Miratimi i lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 542/5, datë 17/03/2022 me subjektin zhvillues "K." SH.P.K me NIPT J......S dhe Bashkia Gramsh nuk kanë hartuar dhe nënshkruar një Akt-marrëveshje bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social', përcaktohet se 3% (tre përqind) e sipërfaqes takuese të banimit në godinat, objekt i aplikimit të lejes së ndërtimit Nr. 542/5, datë 17/03/2022 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh është sipërfaqja prej 103.8 m2-, e llogaritur nga sipërfaqja totale e banimit prej 3460 m2, (3460 m2 * 3% = 103.8 m2) të cilat duhet të kishin kaluar në favor të Bashkisë Gramsh.<br>*Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 "Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015", nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social'.* | E lartë | Drejtorin e Planidikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë të gjitha masat e nevojshme për lidhjen e një Akt-marrëveshjeve me subjektet zhvillues "Z. E. A. L., Znj J. F. L." dhe me subjektin zhvillues "K." SH.P.K me NIPT J......S, për kalimin në favor të sipërfaqes prej 166.8 m2 banim në favor të Bashkisë Gramsh sipas pjesëve takuese së sipërcituar. |
| 6 | Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:<br>**1-**Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II", me vlerë të fondit limit 81,666,555 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE "B." & "G.", me ofertë | E lartë | Titullari i AK Bashkia Gramsh, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **79,994,441** lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.<br>**2-** Në procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtim linje ujësjellësi fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit Lagja Kocaj e Fshat Gramsh", me vlerë të fondit limit 19,166,638 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021", është shpallur fitues BOE V." Sh.P.K dhe G. shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 18,982,653 lekë pa TVSh , i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.<br>3- Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni sistemimi, Fshatit Pishaj", Bashkia Gramsh, me vlerë të fondit limit 8,331,823 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "G." SH.P.K. & "V. me ofertë 8,242,210 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.<br>**4-** Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje dru zjarri dhe pellet për vitin shkollor 2002-2023", Bashkia Gramsh, me vlerë të fondit limit 9,062,750 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A. S." P.F, me ofertë 9,051,200 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.<br>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 "*Anulimi i një procedure* prokurimi", pika nr.1, germa (ç), neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1, neni 53 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3 dhe pika 5, neni 55, "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*", pika 1**,** germa (a) dhe Ligji Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92, pika 3 *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4.1* | | |
| 7 | Nga Bashkia Gramsh me urdhrin nr. 254 datë 26/11/2021 është ngritur komisioni për verifikimin dhe vlerësimin të gjendjes tekniko financiare të automjeteve të Bashkisë Gramsh. Me shkresën 3817/1 prot datë 20/09/2022 është përgatitur relacioni mbi vlerësimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve në pronësi të Bashkisë Gramsh, ku janë evidentuar 27 mjete të dëmtuara me kosto historike 36,550,319 lekë dhe vlerë neto 4,359,312 lekë sipas procesverbaleve përkatëse. Me vendimit nr. 76 datë 30.09.2022 "Për miratimin e raportit të vlerësimit të aktiveve për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimi të Bashkisë Gramsh për vitin 2022", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut, është miratuar procesi i vlerësimit të aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit sipas procesverbaleve të mbajtura për vitin 2022 për 27 mjete në vlerën historike 36,660,319 lekë. Nga | E lartë | Drejtoria e Financës (sektori i kontabilitetit), të marrë masa që vlera e 27 mjeteve të transportit prej 36,660,319 lekë të pa shitura me procedurë ankandi, por të zbritur padrejtësisht nga aktivet, të kryhet veprimi kontabël për regjistrimin e tyre në kontabilitet, duke i ngarkuar përsëri për vlerën e tyre deri në përfundim të procesit të shitjes. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | auditimi rezulton se Drejtoria e Financës ka hequr nga bilanci mjetet e nxjerra jashtë përdorimit me vlerë historike 36,660,319 lekë, pa përfunduar me pare i gjithë procesi i shitjes me procedurë ankandi. Për këto mjete, nëpunësi zbatues nuk ka ndjekur procesin dhe nuk ka bërë veprimet e duhura përmbyllëse, pasi ka hequr përfundimisht nga kontabiliteti aktivet e mësipërme në vlerën 36,660,319 lekë, duke i çregjistruar nga llogaria 215 "Mjete transporti", duke mos bërë regjistrimin e aktiveve, si të pa përdorshme, në llogarinë përkatëse në kontabilitet, duke humbur kështu gjurmën e auditimit.<br>*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 3 -Përkufizime, pika 1,2, neni 7 - Dokumenti kontabël, neni 11 – Qëllimi i pasqyrave financiare, neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve; UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar". Nenin 109 dhe 110 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 12-Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues, dhe udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007. Kriteri: Neni 109 dhe 110 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 12-Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues, dhe udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007.* | | |
| 8 | Nga të dhënat e siguruara nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës 2021-2022, në territorin e Bashkisë Gramsh, kanë ushtruar aktivitet në fushën e energjetikës 4 subjekte, për të cilat *Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit* Bashkia Gramsh nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj), sipas tabelës vijuese. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin kullosor", pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe | E lartë | Drejtorisë së shërbimit Pyjor të kërkojë informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me qëllim evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.<br>Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor”. | | |
| 9 | Struktura e Inspektoratit së Mbrojtjes se Territorit Vendor të Bashkisë Gramsh (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me Vendim të Titullarit nr.15, datë 18.02.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njësive vartëse të saj, për vitin 2022”, ku struktura e IMTV është e përbërë nga 2 punonjës, nga të cilët 1 kryeinspektor dhe 1 inspektor. Emërimi i 1 (një) k/Inspektori dhe 1 inspektori në strukturën e IMT është në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”.<br>Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) Bashkia Gramsh për periudhën objekt auditimi janë vendosur 6 gjoba në vlerën 1,650,000 lekë + 630,000 lekë (kamatëvonesa për 3 gjoba), duke arritur në total në shumën prej **2,280,000 lekë** nga të cilat është arkëtuar vlera **183,333 lekë.** Përveç gjobave të vendosura gjatë vitit 2022 dhe që nuk janë paguar, IMTV ka edhe gjoba të tjera të vendosura më herët që nuk janë arkëtuar dhe janë në proces gjyqësor. Përkatësisht, gjoba të vendosura para vitit 2022, në total janë 10 për vlerën prej 4,610,000 lekë + 1,560,000 lekë (kamatëvonesa). Është paguar vlera prej 900,000 lekë dhe janë në proces gjyqësor 4 gjoba me vlerë 610,000 lekë. **Të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV në progresiv janë **në vlerën totale 5,806,667 lekë.**<br>Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridik nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh në progresiv në vlerën prej **5,806,667 lekë.** Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV” i ndryshuar,shfuqizuar, IMT Bashkia Gramsh, ka marrë 6 vendime për prishje objektesh pa leje, vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara. | E lartë | Inspektorati i Mbrojtës Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Gramsh, të kërkojë në Gjykatë, shndërrimin e vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe arkëtimi i vlerës **5,806,667 lekë** e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Në këto raste rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje, por nuk është marrë asnjë masë tjetër nga ana e IMT Bashkia Gramsh për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 " "Për inspektimin e ndërtimit" ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV" ndryshuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010, nr.10 323, datë 23.9.2010; nr. 23/2013, datë 14.2.2013; nr. 183/2014, datë 24.12.2014) Neni 10 Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar (shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014) Neni 20 Shfuqizime (ndryshuarme ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014). | | |
| 10 | Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Gramsh në datën 31.12.2022 janë në vlerën **66,577 mijë lekë**, *nga e cila:* subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore **në vlerë 28,247 mijë lekë** për 542 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë **38,330 mijë lekë** për 13,495 abonent., ***vlerë kjo e cila përbën detyrim të pa arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Gramsh***. Rezulton se vetëm në vitin 2022 borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale 16,332 mijë lekë, i përbërë nga 11,367 mijë lekë dhe 5,064 mijë lekë nga taksapaguesit familjarë. Bashkia Gramsh nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. DTTV për vitin 2022 nuk ka dërguar në Drejtorinë e Financës informacion lidhur me debitorët progresiv. | E lartë | Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Gramsh, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **66,577 mijë lekë**, *si më poshtë vijon*:<br>*a-T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.<br>*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit*, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).<br>*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar*, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.<br>*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet*, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.<br>e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Gramsh për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.<br>f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve |
| 11 | Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, për vitin 2022 ASHK ka dërguar informacion në Bashkinë Gramsh për 79 qytetarë që kanë kryer legalizimet e banesave të tyre. Bashkia ka llogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë për secilin nga qytetarët duke dërguar edhe njoftimet përkatëse. Vlera totale e detyrimit është 1,597,688 lekë. Kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë 75 qytetarë në vlerën 1,590,247 lekë dhe nuk ka paguar taksën 4 qytetar në vlerën 71,441 lekë duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 71,441 lekë.** *Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7.* | E lartë | Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **71,441 lekë** ndaj **4** personave. |

## 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

**Opinioni i auditimit:**

**<u>I.Opinion mbi pasqyrat financiare për vitin 2022:</u>**

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar pasqyrat financiare (PF) të Bashkisë Gramsh, për vitin 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"*Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kundërt për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Gramsh, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2022, të shprehura në bazën për opinion".*

**<u>Baza për opinionin e modifikuar (kualifikuar)</u>**:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit (kap III/2.2) ku jepen përshkrimi i çështjeve për opinionin e kundërt për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidencat e auditimit që kemi siguruar, janë të e mjaftueshme dhe të përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe bazë për dhënien e opinionit tonë të kundërt (ISA-700/ISSAI-1700).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga

audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 është 9,719 mijë lekë.

**Përshkrimi i çështjeve:**
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:
- Në gjendjen e llog. 468 "*Debitorë të ndryshëm*" nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore për 13,495 subjekte familjare dhe biznesi në vlerën **66,577 mijë lekë**, *nga e cila:* subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 28,247 mijë lekë për 542 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 38,330 mijë lekë për 13,495 abonent, për taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 71,441 lekë, subjektet që ushtrojnë aktivitet të pajisur me autorizim/ licencë të lëshuar në vlerën 4,800,000 lekë, të akumuluara në fund të vitit ushtrimor 2022, vlerë e cila nuk është kontabilizuar.
- Për vitin 2022 Drejtoria e Financës ka shkarkuar nga bilanci mjetet e nxjerra jashtë përdorimit me vlerë historike 36,660,319 lekë pa përfunduar me pare i gjithë procesi i shitjes me procedurë ankandi çka ka sjell një nënvlerësim të llogarisë 215 në fund të vitit 2022.
- Nga auditimi ka rezultuar se për vitin 2022 nga bashkia janë certifikuar në total 6 prona sipas tabelës së sipërcituar. Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Gramsh në Drejtorinë rajoneve të ASHK Gramsh, por pa vlerë, të cilat nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2022.
Për vitin 2022 kemi një mbivlerësim të llogarisë 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" për 32 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 29,116,786 lekë për të cilat nuk është bërë likuidimi i garancisë.

**II. Opinioni mbi përputhshmërinë**
Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Gramsh, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar (kualifikuar) të përputhshmërisë.

**Baza për dhënien e opinionit**
- Bashkia Gramsh nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.
-Investimet nga të ardhurat e veta kanë një nivel të ulët të realizimit krahasuar me planifikimin. Për vitin 2022 investimet janë planifikuar në vlerën **181,812** mijë lekë, realizuar **91,734** mijë lekë, ose në masën 50.46 %.
-Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura. Edhe pse janë likuiduar gjatë vitit buxhetor detyrime të prapambetura, nga ana tjetër edhe gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura, duke çuar në 31.12.2022 vlerën e tyre, me burim financimi të ardhurat e veta në 13,119 mijë lekë.
-Janë konstatuar anomali në hartimin e kritereve të veçanta të DST në procedurat e prokurimit publik, pasi janë vendosur kritere të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës.
- Në 5 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit për objektet "*Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas ,Loti II", "Ndërtim linje ujësjellësi fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit Lagja Kocaj e Fshat Gramsh"," Ndertimi i Ures Kushoves", "Rikonstruksioni sistemimi , Fshatit Pishaj", "*Sistemim Asfaltim i Lagjes Dellinje" zhvilluar në periudhën 2021-2022, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik.

- Në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 413,169,591 lekë, konkretisht si vijon:
**1-**Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II", me vlerë të fondit limit 81,666,555 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE "B." & "G.", me ofertë 79,994,441 lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.
**2-** Në procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtim linje ujësjellësi fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit Lagja Kocaj e Fshat Gramsh", me vlerë të fondit limit 19,166,638 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021", është shpallur fitues BOE V." Sh.P.K dhe G. shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 18,982,653 lekë pa TVSh , i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.
3- Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni sistemimi, Fshatit Pishaj", Bashkia Gramsh, me vlerë të fondit limit 8,331,823 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "G." SH.P.K. & "V. me ofertë 8,242,210 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.
**4-** Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje dru zjarri dhe pellet për vitin shkollor 2002-2023", Bashkia Gramsh, me vlerë të fondit limit 9,062,750 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A. S." P.F, me ofertë 9,051,200 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.
- Në 2 raste me subjektet zhvillues "Z. E. A. L., Znj J. F. L." dhe me subjektin zhvillues "K." SH.P.K me NIPT J......S nuk është lidhjen e një Akt-marrëveshjeve për kalimin në favor të Bashkisë Gramsh, të sipërfaqes prej 166.8 m2 banim, bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social', përcaktohet se 3% (tre përqind).
- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2022 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej 66,577 mijë lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

**Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Gramsh*:***

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Gramsh.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kritereve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri më kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

**I. HYRJA**
Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 205/1 Prot, datë 10.03.2023, ndryshuar me shkresën nr. 205/2 Prot., datë 12.04.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 13.03.2023 deri në datën 05.05.2023, në subjektin Bashkia Gramsh u krye "Auditimi Financiar për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 dhe Auditimi i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022". Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:
1.H. I. – Përgjegjës Grupi
2.V. S. – Anëtar
3.L. B. – Anëtar
4.E. C. – Anëtar
5 S. M. – Anëtar

**Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërie.

**Marrësi:** Raporti i Auditimi i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Gramsh.

**1. Objektivat e auditimit**
Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Gramsh kishte si objektiva kryesore:
- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[1];
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

**2. Qëllimi i auditimit**
Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Gramsh është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/ shërbimeve dhe investimeve.

**3. Identifikimi i çështjes**
Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Gramsh dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

---
[1]*Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.*

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:
**1.** Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
**2.** Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
**3.** Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
**4.** Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
**5.** Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
**6.** Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
**7.** Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Gramsh, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

**6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Gramsh është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Gramsh. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-$^{së}$ nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020";
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative";
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore";

- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël";
- "VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj";
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura";
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023";
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve";
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore";
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".
- Etj.

**7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Gramsh grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :
- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik";
- ISSAI 200 "Parimet themelore të auditimit financiar".
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

**8. Metodologjia e auditimit**

*1. Kontrolli aritmetik.*

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

*2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.*

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

*3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.*

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

*4. Kontrolli i vlerësimit*.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

*5. Konfirmim nga të tretët.*

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

*6. Kontrolli sipas një treguesi*.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

*7. Intervistimi*

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Gramsh me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

*8. Raporte dhe Informacione*

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

*Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[2].

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[3].

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të

---

[2] ISSAI 1315

[3] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

**9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1.Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi në subjektin "Bashkia Gramsh", u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t'u audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave.

Bashkia Gramsh është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore".

**Profili i Bashkisë Gramsh**

Bashkia Gramsh kufizohet në veri me Bashkinë Elbasan, në lindje me Bashkinë Pogradec, në jug-lindje me Bashkinë Maliq, në jug me Bashkinë Skrapar dhe në perëndim me Bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Gramshit. Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia numëron 24,231 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 36.305 banorësh dhe densitet 49.11 banorë për km². Bashkia ka një sipërfaqe prej 739.22 km². Bashkia Gramsh përbëhet nga 10 njësi administrative, Gramsh, Pishaj, Kodovjat, Kukur, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult, Tunjë dhe ka nën administrimin e saj një qytet dhe 94 fshatra. Bashkia e Gramshit shtrihet në një territor shumë malor në Shqipërinë qendrore, ku toka bujqësore është e paktë (rreth 14% e sipërfaqes) ndërsa pjesa tjetër e territorit është zonë

pyjore ose kullotë. Qendra e bashkisë, Gramshi, u shpall qytet në vitin 1960 si një qendër e agro-industrisë dhe e industrisë ushtarake. Mundësitë për turizëm natyror në Gramsh janë të shumta, si Ujëvara e Sotirës, Uji i Ftohtë më malin e Lenies, Liqeni i Dushkut, Pishat e Grabovës, liqenet në malin e Rovjës, Shpellat në malin e Poroçanit, Kalaja e Tunjës etj.

## REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

### 2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit:**"*Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm.*** Nënpika 1 *Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë.*

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Gramsh, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.
Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

***I. Komponenti "Mjedisi i kontrollit":***

**Në lidhje me parimin 1 "**A*ngazhimin për integritet dhe vlerat etike"*
- Bashkia Gramsh ka miratuar Rregulloren e Brendshme me Vendimin nr.129, datë 30.08.2021 "Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të administratës së bashkisë Gramsh" dhe Rregulloren e Brendshme me nr. 8175, datë 27.12.2019, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në bashkinë Gramsh" dhe raportin vjetor për veprimtarinë e kryer në zbatim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike gjatë vitit 2022 për bashkinë Gramsh", dërguar me shkresën nr.prot.256/1, datë 23.01.2023 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Tiranë. Ky raport vjetor dërgohet çdo fillim viti pranë ILDKPKI-së. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e informacionit), duke iu adresuar Kryetarit të bashkisë.

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

**Në lidhje me parimin 2**"Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje".

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë tij.

- Nga drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë për Titullarin (NA). Mungojnë raportet periodike, ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" nenin 19 dhe 29, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga Bashkia është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave" Pyetësorin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm" për vitin 2022 me shkresën nr. 908/1 prot., datë 28.02.2023.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit,dhe për vitin 2022 nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

**Në lidhje me parimin 3**"Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë"

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA. Bashkia Gramsh e ka të hartuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Zhvillimit Strategjik. Në dokumentet e PBA e ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Bashkia Gramsh për periudhën objekt auditimi ka hartuar dhe ka funksionuar 1 Rregullore të Brendshme në përshtatje me strukturën organike, me Vendimin nr. 129, datë 30.08.2021 "Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të administratës së bashkisë Gramsh".

Në nenin 1, neni 2, neni 3 të rregullores së brendshme është përcaktuar mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, që nënkupton metodën shkresore dhe elektronike. Rregullorja e Brendshme i përgjigjet dhe përputhet me ndryshimet e strukturave organike.

-Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Kështu:

**- Për vitin 2022** struktura është miratuar me Vendim të Titullarit nr.15, datë 18.02.2022 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njësive vartëse të saj, për vitin 2022" të kryetarit të bashkisë me 361 punonjës në total, ku janë 26 Sektorë dhe 9 Drejtori.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përcaktuar për çdo Drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo drejtori, sektor dhe specialist. Ndërsa në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe vlerësimet për çdo 6-mujor, por jo objektivat për secilin punonjës.
- Bashkia Gramsh ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.
- Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

**Në lidhje me parimin 4** "Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave"
- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.
- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, për këtë ka një plan vjetor pranimi, të miratuar nga kryetari i bashkisë me Vendimin nr. 17, datë 25.02.2022 "Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në Shërbimin Civil, për vitin 2022". Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale sipas nenit 26 të Rregullores së Brendshme, e cila përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin,rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare, diploma e shkollës së lartë (e noterizuar), lista e notave (e noterizuar), certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.
- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Por nga Bashkia Gramsh është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

**Për vitin 2022** realizimi i trajnimeve të stafit në organizime jashtë bashkisë paraqitet 25 trajnime me 41ditë/trajnimi/9 punonjës.

.

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.
- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor Ekonomik.

**Në lidhje me parimin 5 "**Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale".

Janë kryer delegime detyrash të cilat janë bërë në bazë të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 59, pika 3 me autorizimet dhe Urdhrat përkatës:

- Urdhër i Brendshëm prot. 1137, nr. 93 datë 25.03.2021 "Për delegimin e kompetencave"

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2019 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe udhëzimit të MFE nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat

standarde për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore"Titullari i bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:
**Për vitin 2022** me Urdhër të Titullarit, nr 98 datë 11.04.2022 "Për krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe ekipeve të menaxhimit të programeve". Në këtë urdhër është ngritur GMS me 5 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë (NA) dhe 15 ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA 2022-2024.
Përbërja e GMS është si më poshtë vijon:
- K. T. (Kryetar GMS);
- A. S. (Koordinator GMS);
- A. S. (Sekretar GMS);
- Ergita Kaso (Anëtar GMS);
- A. Ç. (Anëtar GMS).

*6. Në Bashki ngrihet Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), i cili ndjek problemet që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin:*
*a) Vendos rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar*
*b) Harton Buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA),*
*c) Ndjek zbatimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut,*
*d) Përgatit raporte në përputhje me rregullat, rregulloret dhe standardet e zbatueshme ose me objektivat e specifikuara të njësisë publike".*
Referuar kësaj nga auditimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si:
-Nuk ka vendosur rregulla të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar;
-Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.
- Me shkresën nr. 917/1 datë 28.02.2022 i është dërguar Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave "Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Gramsh dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm" për vitin 2022.
Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë: Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemi i programimit te zbatimit të buxhetit; sistemi i pagesave, sistemi i prokurimeve me vlera të vogla dhe të larta; inventarët e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese; sistemi i tatim-taksave.
Në kapitullin "Vlerësimi i sistemit të MFK" janë përshkruar se sa janë arritur objektivat në fushat prioritare për bashkinë si në sektorin e shërbimeve publike, sektorin e urbanistikës dhe sektorin e tatim-taksave. Gjithashtu janë paraqitur masat e marra për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe planveprimi për të ardhmen për përmirësimin e performancës organizative dhe financiare të njësisë nga puna për arritjen e synimeve përkatëse të: Drejtorisë Ekonomike, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.
Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit. Realizimit të "gjurmës së auditimit" që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

## *II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"*

**Në lidhje me parimin 6**:Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.
**Bashkia Gramsh** në hartimin e PBA ka vendosur objektiva si në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe dëgjesa me publikun.
- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.
**Në lidhje me parimin 7**: "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave".
Në Bashkinë Gramsh nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.
Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Duke mos u ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut.
**Në lidhje me parimin 8**: "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime"
Duke mos patur një vlerësim të riskut,ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.
- Në Rregulloren e brendshme nenin 14 "Koordinatori i Riskut" është përcaktuar:
*1. Të dhëna të përgjithshme*
*1.1.Koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i Bashkisë Gramsh*
*1.2.Koordinatori i riskut mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës.*

*2. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut*
*2.1.Është përgjegjës për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të Menaxhimit të riskut.*
*2.2.Vlerëson sistemet e risqeve.*
*2.3.Bashkërendon aktivitetet lidhur me menaxhimin e riskut.*
2.4.*Harton dhe ndjek strategjinë e menaxhimit të* riskut.

**Në lidhje me parimin 9**: "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm".

Bashkia Gramsh në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

***III.** **<u>Komponenti: " Aktivitetet e Kontrollit"</u>***

**Në lidhje me parimin 10: "**Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli"

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i financës/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).
- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit.
- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.
- Në Rregulloren e Brendshme në Kreun I neni 2 "Komunikimi ndër-Sektorial lëvizja e Dokumentacionit", përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, <u>ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë</u>, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
- Për menaxhimin e aktiveve rregullat janë identifikuar në rregulloren e brendshme në detyrat e drejtorisë Ekonomike, por për menaxhimin e tyre veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve. Aktivet Afatgjata janë regjistruara ne SIFQ, pasi kjo Bashki është pilot për aplikimin direkt në programin e Qeverisë SIFQ.

**Në lidhje me parimin 11:** "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë".

- <u>Bashkia Gramsh nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet</u>

të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.
Në rregulloren e brendshme në nenin 14 pika 3 përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe ka vetëm detyra për mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe menaxhimin e programeve, nuk merret me instalimin e programeve. Gjithashtu ka përgjegjësi dhe menaxhon Serverin kryesor, duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, fireëall-et, kufizimin e ndërhyrjeve në të dhënat e IT.
**Në lidhje me parimin 12:**"Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave".
- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuara në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, por mungojnë plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut.

***IV. Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"***
**Në lidhje me parimin 13: "Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor".**
Drejtuesit në Bashkinë Gramsh kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.
Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit.
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë këshillit bashkiak si dhe në Degën e Thesarit.
- Raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit.
- Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Microsoft Excel dhe nuk ka një program specifik të vetin të kontabilitetit. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike. Gjithashtu dhe monitorimi i të ardhurave kryhet me program Microsoft Excel i cili menaxhohet nga Sektori i Tatim-Taksave.
**Në lidhje me parimin 14:** Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm
**Në lidhje me parimin 15:** Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm
Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenin 14 pika 2 "Specialist i marrëdhënieve me publikun, të drejtat dhe kompetencat" Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo muaj dhe nëpërmjet analizave të herë pas hershme sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.
Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet përveç komunikimit verbal e shkresor kryhet nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Nga Bashkia Gramsh kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të dokumentuara ne procesverbale si dhe te ngarkuara në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh.
***V. Komponenti: "Monitorimi"***

**Në lidhje me parimin 16:** "Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme"

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit.
- Në Bashkinë Gramsh mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.
Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm, vetëm për vitin 2021.
**Në lidhje me parimin 17:** "Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë"
- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.
**Konkluzion:**Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:
*"Mjedisi i kontrollit"*
Njësia vendore ka hartuar rregulloren e brendshme, ku janë përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat e secilit punonjës. Janë përcaktuar rregulla për rekrutimin e punonjëseve, por nuk u konstatuan rregulla të shkruara për veprimet që kryhen nga punonjësi dhe strukturat përgjegjëse. Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.
Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
- Nuk është evidentuar puna e anëtarëve GMS, duke u dokumentuar takimet dhe mbledhjet të për hartimin e planit strategjik dhe PBA.
- Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.
Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.
Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, pasi nuk ka programe trajnimi për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional.
**"Menaxhimi i Riskut"**
Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në Bashkinë Gramsh nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.

Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Duke mos u ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

-Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

**"Aktivitetet e Kontrollit"**

- Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).
- Bashkia Gramsh nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara për ruajtjen e aktiveve.

**"Informimi dhe komunikimi"**

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet përveç komunikimit verbal e shkresor kryhet nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale.

**"Monitorimi"**

Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Në Bashkinë Gramsh mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit. Titullari i këtij institucioni për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi, Z. K. T., Kryetar i Bashkisë Gramsh, nëpunës autorizues dhe Z. A. S., Drejtor i Financës, nëpunës zbatues.*

**Titulli i gjetjes 1:** *Zbatim jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.*

**Situata:** Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

- Nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA.
- Në informacionin e sjellë nga Burimet Njerëzore për vitin 2022 realizimi i trajnimeve të stafit në organizime jashtë bashkisë paraqitet 25 trajnime me 41ditë/trajnimi/9 punonjës.
- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.
- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).
- Bashkia Gramsh nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK- së dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, pikën 5.3.
- Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në mos zbatim të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publike”.
- Në mbështetje të Ligjit nr. 10296 dt 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 27, në zbatim të Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publike” pika 2/2,4, nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Gramsh nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.
- Në Bashkinë Gramsh, drejtoria e financave përdor programin excel. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave dhe kjo kryhet nga drejtoria e financave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.
- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm.
- Bashkia Gramsh nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.
**<u>Kriteri:</u>** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar.
Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016
**<u>Ndikimi:</u>** Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm.
Mosndjekjen e trajnimeve cenon cilësinë e zhvillimit profesional të punonjësve.
**<u>Shkaku:</u>** Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor për MFK.
**<u>Rëndësia:</u>** E mesme
**<u>Rekomandimi:</u>** Bashkia Gramsh me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:
- Të hartojë planin e trajnimeve;
- Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;

- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik";
- Të miratojë "Strategjinë e Menaxhimit të Riskut";

### *1.2. Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.*

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në bashkinë Gramsh është organizuar dhe ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist auditimi. Kjo strukturë ka pasur vetëm 2 punonjës si inspektorë auditi të brendshëm në strukturë, në kundërshtim me kërkesa e ligjit nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik", neni 11 dhe të VKM nr. 83 datë 03/02/2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", për "*Miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*" pika 3 -*Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1⁄3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.*

Struktura e Auditit të Brendshëm në bashkinë Gramsh për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Emër Mbiemër | Funksioni | Arsimi | Vjetërsi Audit | Çertifikatë si auditues |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | L. P. | Përgj.auditimit | Financë master shkenc. | 11 vjet | 2017 |
| 2 | S. M. | Spec.auditimi | Financë master shkenc. | 3 vjet e 6 muaj | 2021 |
| 3 | J. M. | Spec.auditimi | Adm, biznes | 1 vit, larguar më 28.02.2022 | jo |

Për vitin 2022 është miratuar plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2022-2024 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe me shkresën nr. 4276 datë 14.10.2022 është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

**Për vitin 2022 janë planifikuar këto auditime si më poshtë vijon:**
1.Zbatimi i rekomandimeve të lëna
2.Sektori i Burimeve Njerëzore
3.Njësia Administrative Sult
4.Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Komunale
5.Sektori për Koordinimin dhe Integrimin Evropian, Ndihmës së huaj dhe Turizmit
6.Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (detyrimet e prapambetura)

**Nga auditimi i dosjeve të vitit 2022 konstatuam :**

***Dosje auditimi:**

**1. Sektori i Burimeve Njerëzore .**
*Njoftim për fillimin e angazhimit: Nr. 2103/1 prot, datë 25.05.2022 .
*Program Auditimi: Nr. 2103/2 prot., datë 01.06.2022.

*Periudha e auditimit: 01.01.2021 deri 31.12.2021
*Auditët: L. P. dhe S. M.
*Periudha e angazhimit: 01.06.2022-30.06.2022
*Lloji i auditimit : Përputhshmërie .
*Raporti final: nr. 2103/4 prot., datë 29/06/2022
*Numri i rekomandimeve: 6 (gjashtë) të dhëna dhe 6 (gjashtë) të pranuara

**2. Sektori i Koordinimit e Integrimit Evropian, Ndihmës së Huaj dhe Turizmit .**
*Njoftim për fillimin e angazhimit: nr. 2977/1 prot., datë 28.07.2022.
*Program Auditimi: nr. 2977/2 prot., datë 03/08/2022.
*Periudha e auditimit: 01.01.2021 deri 31.12.2021
*Auditët: L. P. dhe S. M.
*Periudha e angazhimit 03.08.2022 - 03.09.2022
*Lloji i auditimit : Kombinuar .
*Raporti final: nr. 2977/4 prot., datë 02/09/2022
*Numri i rekomandimeve: 3 (tre) të dhëna dhe 3 (tre) të pranuara

**3. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Komunale.**
*Njoftim për fillimin e angazhimit nr. 1438/1 prot., datë 06.04. 2022.
*Program Auditimi: nr. 1438/2 prot., datë 11.04.2022.
*Periudha e auditimit: 01.01.2021 deri 31.12.2021
*Auditët: L. P. dhe S. M.
*Periudha e angazhimit.**:** 11.04.2022 - 11.05.2022
*Lloji i auditimit : Kombinuar .
*Raporti final: nr. 1438/5 prot., datë 11.05.2022
*Numri i rekomandimeve: 5 (pesë) të dhëna dhe 5 (pesë) të pranuara

**4. Njësia Administrative Sult.**
*Njoftim për fillimin e angazhimit nr. 809/1 prot., datë 22.02.2022.
*Program Auditimi: nr. 809/2 prot., datë 01.03.2022
*Periudha e auditimit: 01.01.2021 deri 31.12.2021
*Auditët : S. M. dhe J. M.
*Periudha e angazhimit **:** 01.03.2022 - 01.04.2022
*Lloji i auditimit : Përputhshmërie .
*Raporti final: nr. 809/5 prot., datë 31.03.2022
*Numri i rekomandimeve: 7 (shtatë) të dhëna dhe 7 (shtatë) të pranuara

**5. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.**
*Njoftim për fillimin e angazhimit nr. 4492/1 prot., datë 04.11.2022.
*Program Auditimi: nr. 4492/2 prot., datë 07.11.2022
*Periudha e auditimit: 01.01.2022 - 31.10.2022
*Auditët : S. M. dhe L. P.
*Periudha e angazhimit **:** 07.11.2022 – 16.12.2022
*Lloji i auditimit : Financiar.
*Raporti final: nr. 4492/4 prot., datë 26.12.2022
*Numri i rekomandimeve: 5 (pesë) të dhëna

**6. Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në njësitë e audituara**
1. Programi i auditimit nr. 59 prot., datë 07.01.2022
2. Pasqyra përmbledhëse
3. Raporti i auditimit nr. 1144 prot., datë 17.03.2022

**Konkluzion.**

➢ Komiteti i Auditit të Brendshëm: Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 13 "Komitetit të Auditimit të Brendshëm", i cili përcakton se "Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm":

a) Duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
b) Duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
c) Duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
d) Duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
e) Duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;
f) Duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.
Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

➢ Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

➢ Nga shqyrtimi i dosjeve të auditimeve të periudhës 01.01.2022-31.12.2022 u konstatua se në mungesë të strukturës, nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10.

➢ Nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi, Z. K. T., Kryetar i Bashkisë Gramsh, znj. L. P. përgjegjëse sektori në Njësinë e Auditit të Brendshëm si dhe znj. S. M. me detyrë audituese dhe z. J. M. me detyrë auditues (larguar në datën 28.02.2022).*

| |
|---|
| *Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 1784 prot., datë 19.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 205/4 prot., datë 24.05.2023, nga znj. L. P., znj. S. M. dhe z. J. M., në cilësinë e punonjësve të auditit të brendshëm, ku janë shprehur komentet si më poshtë:* |

**Pretendimi i subjektit:**
Përsa i përket krijimit të komitetit të auditimit, bazuar në ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm", neni 13 pika 3 si dhe me VKM nr. 160, datë 02.03.2016 mbi krijimin e komitetit të auditimit.
Për çdo auditim shihet dhe lihen rekomandimet e para ndërsa përsa i përket prokurimeve publike dhe lejet e ndërtimit janë të audituara nga ana juaj (Kontrolli i Lartë i Shtetit) çdo vit, si dhe nga ana jonë janë audituar por jo në brendësi si rezultat i mungesës së stafit (inxhinier).
Siç edhe jeni shprehur edhe ju se ka mungesë stafi, Kontrolli i cilësisë nuk është bërë i plotë.
**Qëndrimi i Grupit të auditimit**:
Përsa i përket krijimit të komitetit të auditimit, kjo është kompetencë e titullarit të institucionit, bazuar edhe në VKM nr. 160 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike", së cilës ju i jeni referuar, dhe është në varësi të tij ngritja e këtij komiteti.
Mungesa e auditimit të procedurave të prokurimit dhe lejeve të ndërtimit është përsa i përket periudhës së auditimit të ushtruar nga ana jonë.
E njëjta gjë edhe për kontrollin e cilësisë, pasi struktura e auditit të brendshëm në bashkinë Gramsh nuk është e plotë.
Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e tjera të bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

**Titulli i Gjetjes :** *Mungesë e strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm*
**Situata:** Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2022 e përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist auditimi. Kjo strukturë ka pasur vetëm 2 punonjës si inspektorë auditi të brendshëm në strukturë, në kundërshtim me kërkesa e ligjit nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik", neni 11 dhe të VKM nr. 83 datë 03/02/2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", për "*Miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*" pika 3.
Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 13 "Komitetit të Auditimit të Brendshëm".
Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
**Kriteri:** Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",
Manuali i Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik". Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik".
**Ndikimi:** Mungesa e ngritjes së strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm nuk sjell një veprimtari të pavarur që jep siguri objektive dhe këshillim për të përmirësuar performancën e institucionit.
**Shkaku:** Mos ngritje të Njësisë së Auditit të Brendshëm.
**Rëndësia:** E mesme.

**<u>Rekomandimi:</u>** Bashkia Gramsh të marrë masa për plotësimin e strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm, dhe të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

## 2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

***2.1.*** *Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;*

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Me Urdhrin nr. 99, datë 11.04.2021, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022- 2024.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2022- 2024 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 127 datë 30.12.2021, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Elbasan: me shkresën nr.1453/ date 10.01.2022.

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

*a-PBA 2022-2024 miratuar respektivisht me VKB nr. 53 , datë 02/04/2021 me VKB nr 94, datë 29/06/2021.*

Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2022-2024 janë përcaktuar “Përshkrimi i çdo programi”; “Politikat e programit”; “Qëllimi Politikës së programit”; “Objektivat e politikës së programit”.

| PBA | Urdhëratë GMS | | Urdhëratë EMP | | VKB | | | Nr. | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Datë | Nr. | Datë | Objekti | Nr. | Datë | Programe | shënime |
| 2020-2022 | 99 | 11.04.2021 | 98 | 11.04.2021 | miratim kalendari | - | - | 16 | |
| | | | | | miratim tavaneve të shpenzimeve | 53 | 30.04.2021 | 16 | në afat |
| | | | | | miratimi i tabelave të PBA | 94 | 29.06.2021 | 16 | në afat |

*Burimi: Drejtoria e Financës*

Miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2022-2024 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 94, datë 29.06.2021, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 127 datë 30.12.2021, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Gramsh për vitet 2022-2024”, jo më vonë se 31 Janar, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 127 datë 30/12/2021, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Elbasan me shkresën nr.1453 date 10.01.2022.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 132,321,000 lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 223,687,722 lekë, transferta specifike ka vlerën 160,059,000 lekë.
Në total të ardhurat kanë vlerën 516,067,722 .lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 516,067,722 lekë.
Gjatë vitit 2022, Bashkia Gramsh me VKB nr 29, datë 28.02.2022 ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetorë 2021). Këto ndryshime paraqiten si vijon:
Janë alokuar fondet e trashëguara nga viti 2021, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 94,038,064 lekë;
Janë alokuar fonde shtesë transferte specifike për arsimit parashkollor nga ministria e linjes, për efekt të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si efekt rritjes së pagës minimale në vlerën 1,649,825 lekë;
Janë aokuar fonde për lilkujdimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 5,000,002 lekë.
Janë alokuar fonde për përballimin e krizës së rritjeve të cmimeve në vlerën 1,839,600 lekë .

**Buxhetit i miratuar për vitin 2022 është 1,078,704 (000) lekë**.me burime financimi si me poshte:
1- Të ardhurat e veta 226,359 (000) lekë (21%) të totalit të burimeve
2- Transfertë e pakushtëzuar 223,688 (000) lekë (20.7%) të totalit
3- Transfertë specifike 628,657 (000)lekë (58.3%) të totalit
Të marra së bashku trasfertat nga qeveria qëndrore janë 852,345 (000) lekë dhe zënë 79% të totalit të burimeve financiare.
Buxheti i miratuar është dërguar në Degën e Thesarit brenda afatit ligjor .
Më të detajuar burimet dhe shpenzimet e planifikuara paraqiten në tabelën si vijon:

***në mijë lekë***

| Nr. | Emërtimi | *Plani i vitit2022 ne leke* | |
|---|---|---|---|
| | | **Ardhurat** | **Shpenzimet** |
| 1 | Të ardhura të trashëguara viti 2021/2022 | 94,038 | 0 |
| 2 | Plani i të ardhurave viti 2022 | 132,321 | 0 |
| 3 | Trashëguar nga transferta viti 2022 | 468,... | 0 |
| 4 | Transfertë e pakushtëzuar viti 2022 | 223,688 | 0 |
| 5 | Transfertë e specifike viti 2022 | 160,059 | 0 |
| | | 0 | 0 |
| 1 | Paga (600) | 0 | 213,293 |
| 2 | Sigurime shoqërore (601) | 0 | 35,886 |
| 3 | Shpenzime operative (602) | 0 | 145,030 |
| 4 | Transferta (603+604+605+606+609) | 0 | 474,228 |
| 5 | Investime (230 +231) nga buxheti i Bashkisë | 0 | 91,734 |
| | **Totali i buxhetit** | **1,078,704** | **960,171** |

*Burimi: Drejtoria e financës*

Në formë tabele paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2022 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

***në mijë lekë***

| | Emërtimi | Buxheti Faktik 2021 | Faza e I PBA 2022 | Faza e II PBA 2022 | Projekt Buxhet 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 210,452 | 212,880 | 212,880 | 209,144 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 34,875 | 35,662 | 35,662 | 35,961 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 124,930 | 115,533 | 115,533 | 171,392 |
| 604 | TransfertaKorente të brendshme | 11,934 | 1,177 | 1,177 | 15,600 |
| 606 | Trans perBuxh. Fam. & Individ | 466,410 | 459,785 | 459,785 | 8,435 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **I** | **Shpenzime Korrente** | **848,601** | **825,037** | **825,037** | **440,532** |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | 19,740 | 151,041 | 151,041 | 7,325 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 289,393 | | | 170,738 |
| | **Shp. Kapitale me financim te brendshem** | **309,133** | **151,041** | **151,041** | **178,063** |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | 0 | 0 | 0 | |
| | **Shpenzime Kapitale me financim te huaj** | **0** | **0** | **0** | |
| **II** | **Shpenzime Kapitale** | **309,134** | **151,041** | **151,041** | |
| **III** | **Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **I+II +III Totali I Shpenzimeve** | | **1,157,734** | **976,078** | **976,078** | **618595** |

*Burimi: Drejtoria e financës*

Gjatë vitit 2022 është bërë Analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujore, Raportet e monitorimit janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak,dhe janë dërguar në ministrin e financave brenda afateve ligjire.

Ky raportim monotorimi për vitin 2022 është miratuar në Këshillin Bashkiak dhe është derguar në Ministrin e Financave. Konkretishte është hartuar raporti i monitorimit dhe i performances për vitin 2022 dhe është dërguar në ministrin e Financave me shkresë nr.907/1, date 28/02/2023. Në mënyrë të përmbledhur planifikimi i të ardhurave për vitin 2022 paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2.1 bashkëlidhur raportit të auditimit.

***2.2.*** *Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.*

<u>*-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive*</u>:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e më poshtme:

***në mijë lekë***

| Nr. | Emërtimi | Plan përfundim 2022 | Sipas PBA 2022-2024 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Shpenzime për pagat (600+601) ardhur e grantipakkush e spec) | ...,049 | ...,542 | -439 |
| 2 | Shpenzime (602.604.609) (ardhura e grantipakushtez e specif) | 183,994 | 576,495 | -392,501 |
| 3 | Investime Bashkia (nga te ardhura e grantipakushtez) | 178,063 | 151,041 | 27,022 |
| 4 | Investime nga FZHSH | | | |
| | **Total I planit fillestar** | **610,106** | **976,078** | |
| | **Shtesat nga Pushteti Qendror** | | | |
| 5 | Investime grant i kushtëzuar | | | |
| 6 | Shpenzime për pagat (600+601) | -2,311 | | |
| 7 | Shpenzime (602.604.609) | 10,800 | | |
| | *Grant i kushtëzuar (230-231)* | | | |
| | **Gjithsej** | **618,595** | **976,078** | **-357,483** |

*Burimi: Drejtoria e financës*

**Nga auditimi konstatohet se** nga krahesimi i planit përfundimtar të vitit 2022 me ate të PBA-së 2022-2024, do shikojm se ulje të planit përfundimtar në vlerën 359,483 mijë lekë respektivishtë: vlera në ulje 439 mijë lekë i perket shpenzimeve për paga; vlera në ulje 392,501 mijë lekë i perket shpenzimeve operative dhe trasfertat , ndërsa vlera në ritje 27,022 mijë lekë i përket investimeve të cilat janë rritur për shkak të shpenzimeve të shtuara për mbetjet urbane.

<u>*Lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2022 nga të ardhurat e veta dhe granti.*</u>

***Në mijë lekë***

| *Nr* | *Emërtimi i investimit* | *Nr dhe data e VKB* | *Vlera e miratuar në VKB* | *Vlera e realizuar e investimit (me TVSh)* |
|---|---|---|---|---|
| Lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2022 me të ardhurat e veta | | | | |
| *1* | Plani i detajuar vendor lagjia Sporti 2 | *Nr 29 date 28/02/2022* | *1,200* | *1,131* |
| 2 | Studim projektim loti I 3 rruga Skenderbegas | Nr 29 date 28/02/2022 | 2,300 | 0 |
| 3 | Plani I detajuar vendor lagjia Agjensia | Nr 29 date 28/02/2022 | 1,000 | 0 |
| 4 | Ndertim I ures ne fshatin Kushove | Nr127 date 30.12.2021 nr 73 date 30/09/2022 | 18,000 | 0 |
| 5 | Bashkefinancimet per investimet GARAZHDI MNZSH | Nr127 date 30.12.2021 | 8,000 | 291 |
| 6 | Blerje paisje e instrumenta | Nr127 date 30.12.2021 | 900 | 828 |
| 7 | Rrethimi dhe ndarja ne dyqane I tregut | Nr127 date 30.12.2021 | 5,000 | 0 |
| 8 | Blerje ndricues rrugor | Nr127 date 30.12.2021 | 2,000 | 1,800 |
| 9 | Rikonstruksioni lagji Dellinje | Nr 73 date 30/09/2022 | 2,000 | 0 |
| 10 | Sistemim asfaltimi lagjia ish Reparti Ushtarak | Nr 29 date 28/02/2022 | 831 | 831 |
| 11 | Sistemim I rruges hyrse ne varrezat e reja | Nr 29 date 28/02/2022 | 4,500 | 0 |
| 12 | Ndricimi I fshatit Trashovice | Nr 29 date 28/02/2022 | 1,800 | 1,369 |
| 13 | Ndricimi I fshatit Drize | Nr 29 date 28/02/2022 | 960 | 800 |
| 14 | Blerje materiali asfalto betoni | Nr 29 date 28/02/2022 | 2,000 | 0 |
| 15 | Prerse asfalto betoni | Nr 29 date 28/02/2022 | 400 | 358 |
| 16 | Blerje kompjutera, printer, fotokopje | Nr 29 date 28/02/2022 | 1,004 | 0 |
| 17 | Izolim I taraces se qendres kulturore te femijeve | Nr 29 date 28/02/2022 | 500 | 472 |
| 18 | Investime per mbrojtjen e tokes | Nr127 date 30.12.2021 | 1,620 | 0 |
| 19 | Pyllezime te reja | Nr127 date 30.12.2021 | 5,000 | 0 |
| 20 | Projekti ujesje. Kerpices deri ne depon Gramsh | | 2,000 | 2,000 |
| | ***Total të ardhurat e veta*** | | ***61,015*** | ***9,880*** |
| Lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2022 nga *granti* | | | | |
| *1* | Studim Projektim lagjia Pishaj | Nr 29 date 28/02/2022 | *825* | *825* |
| *2* | Studim projektim I lagjes Holtas | Nr127 date 30.12.2021 | *2,000* | *1,680* |
| *3* | Sistem Asfaltim Ish Depo e Duhanit | Nr127 date 30.12.2021 | *7,000* | *0* |
| *4* | Sistemim I rruges hyrse ne varrezat e reja | Nr127 date 30.12.2021 | *4,000* | *0* |
| *5* | Sistemim asfaltim lagjja Llapushaj | Nr127 date 30.12.2021 | *30,000* | *30,000* |
| *6* | Blerje betoniere per Komunalen | Nr127 date 30.12.2021 | *1,500* | *0* |
| *7* | Blerje kontinieri per mbetjet | Nr127 date 30.12.2021 | *2,000* | *0* |
| *8* | Rikonstruksion I lagjes Dellinj | Nr127 date 30.12.2021 | *8,000* | *0* |
| *9* | Sistemim asfaltim lagjia ish Reparti Ushtarak | Nr 29 date 28/02/2022 | *16,792* | *16,792* |
| *10* | Ndertim ujesjellsi Gramsh Fshat + fshati Kocaj | Nr 29 date 28/02/2022 | *5,660* | *5,660* |
| *11* | Ure ne perroin e Kishavices, fshati Grazhdan | Nr 29 date 28/02/2022 | *4,208* | *0* |
| *12* | Blerje motorri makinerie | Nr 29 date 28/02/2022 | *360* | *336* |
| *13* | Rikons. Sistemim asfaltim lagjia Pishaj | Nr127 date 30.12.2021 | *10,000* | *9,890* |
| *14* | Mbikqyrje + kolaudime | Nr127date 30.12.2021nr29 date 28/02/2022 | *6,300* | *2,760* |
| *15* | Rikonstruksion ura kembesore fshati Liras | Nr 29 date 28/02/2022 | *3,500* | *3,173* |
| *16* | Blerje autoboti per sektorin e MZSH | Nr 29 date 28/02/2022 | *2,677* | *0* |
| *17* | Rikons. Asfaltim I rruges Skenderbegas | Nr 29 date 28/02/2022 | *6,263* | *6,263* |
| *18* | Investime urash, kanale kulluese, tombino | Nr 29 date 28/02/2022 | *2,027* | *1,146* |
| *19* | Blerje Kamera | Nr 29 date 28/02/2022 | *936* | *936* |
| *20* | Blerje stufa, kompjutera per Arsimin | Nr127 date 30.12.2021 | *2,500* | *2,393* |
| *21* | Blerje Fonie e Kompletuar | Nr 29 date 28/02/2022 | *2,500* | *0* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ***Total nga grandi*** | | ***119,048*** | ***81,854*** |

*Burimi: Drejtoria e financës*

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.
Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" pika 100 germa "b" dhe "c" ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.
- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*".
- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.
Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.
Tabela e ndryshimeve në buxhet paraqitet në vijim:

***në mijë lekë***

| Periudha buxhetore | Buxheti Fillestar | | Ndryshime gjate viteve | | Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr/ datë | Vlera | Nr/ datë | Vlera | Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër) | | | |
| | | | | | SHTESA art. | shuma | PAKSIME art. | shuma |
| Viti 2022 | Nr.127, dt.30/12/2021 | 516,068 | Nr.29, 28.02.2022 | 94,038 | 600+601,Paga dhe sigurime. | 3436 | | |
| | | | | | 602- 609ShP. te tjera | 24559 | | |
| | | | | | 230+231 (Investime) | 66043 | | |
| | | | Nr.73, 30.09.2022 | 0 | 600+601,Paga dhe sigurime | 3034 | | |
| | | | | | 230+231 (Investime) | 5000 | 8034 | |

Burimi: Bashkia Gramsh

*Shenim: Ndryshimet e tjera në buxhetin e Bashkisë Gramsh për vitin 2022 jane kryer brenda programeve buxhetore ,midis artikujve , dhe nuk ka qene nevoja për vendim këshilli* Bashkiak kjo në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018"Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" pika 100 germa "b" dhe "c" ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, Pra shtesat dhe paksimet janë bërë me urdher te nenpunesit Autorizues dhe jane miratuar ne Degën e Thesarit Elbasan.

***2.3.** Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës Covid-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.*

Për vitin 2022 rezulton se për zbatimin e buxhetetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2022, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

***në mijë lekë***

| **Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Gramsh, për vitin 2022. Në lekë** | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Përshkrimi Shpenzimeve** | **Plani** | **Fakti** | **Realizimi ne %** | **Burimi i financimit të shpenzimit** | | | | | |
| | | | | | | **Nga Granti Qeveritar** | | | |
| | | | | **Nga të ardhurat e veta** | **% e realizimit nga të ardhurat** | **Nga transferta e pakushtëzuar** | **Nga transferta e kushtëzuar specifike** | **Nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara** | **Nga transferta e kushtëzuar për investimet** |
| Paga600 | **214,895** | **213,293** | **99.25%** | | **2,427** | **90,412** | **115,046** | **5,408** | **0** |
| Sigurime shoqërore 601 | **36,900** | **35,886** | **97.25%** | | | **15,522** | **19,460** | **904** | **0** |
| ShP. Operat602+ F. Rezervë | **171,443** | **145,030** | **84.59%** | | **70,605** | **37,409** | **36,966** | **50** | **0** |
| Subvencion Ujësjellësi, etj. 603 | **0** | **0** | **-** | | | **0** | **0** | **0** | **0** |
| K. Q Emergj Civile 604 | **15,601** | **8,177** | **52.42%** | | **8,177** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| Nd/Ekonom invalid 606 | **458,053** | **452,127** | **98.70%** | | **1,940** | **2,920** | **3,514** | **443,753** | **0** |
| Mjete ne ruajtje 466 | **0** | **12,996** | **-** | | | **0** | **0** | **12,996** | **0** |
| Investime 230-231 | **181,812** | **91,734** | **50.46%** | | **7,880** | **67,944** | **13,910** | **0** | **2,000** |
| Shpenzime 605 | **0** | **0** | **-** | | | **0** | **0** | **0** | **0** |
| Interesa kredia 166 | **0** | **0** | **-** | | | **0** | **0** | **0** | **0** |
| Takse pulle 466 | **0** | **928** | **-** | | | **0** | **0** | **928** | **0** |
| **Totali** | **1,078,704** | **960,171** | **89.01%** | | **91,029** | **214,207** | **188,896** | **464,039** | **2,000** |

***Burimi: Bashkia Gramsh***

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën **1,078,704 mijë lekë** i barabarte me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën **1,078,704 mijë lekë.**

**P**lanifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **1,078,704 mijë lekë**, ndërsa realizimi **960,171 mijë lekë**, ose në masën 89.01%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **214,895 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **213,293 mijë lekë**, ose në masën 99.25%, ndërsa zëri sigurime shoqërore ëshët realizuar në masën 97.25%.
Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **171,443 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **145,030 mijë lekë**, ose në masën 84.%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **181,812 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **91,734 mijë lekë,** ose në masën 50.46 %.

**Titulli gjetjes**: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

**Situata:** Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Gramsh ka diferenca me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën **1,078,704 mijë lekë**, ndërsa realizimi **960,171 mijë lekë**, ose në masën 89%. Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara , i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **181,812 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **91,734 mijë lekë,** ose në masën 50.46 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Gramsh në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe ngarkojnë me përgjegjësi kryetaren e Bashkisë Gramsh z. K. T., si dhe z. A. S., me detyrë Drejtor i Financës.
Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022. Veprimet e mësipërme janë në perputhje me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku thuhet:
*"Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji".*
**Kriteri:** Pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
**Shkaku:**Lidhja e kontratave në fund të vitit, si dhe për vlerën e plotë të projektit dhe jo për nivelin e fondeve të buxhetuara për vitin përkatës.
**Efekti:** Mos realizim i investimeve të planifikuara.
**Rëndësia:** E Lartë.
**Rekomandimi:**
Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuara dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

***Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë***

**Konstatohet se** për vitin 2022 me VKB nr. 127 datë 30/12/2021 është miratuar buxheti i vitit 2022 ku është përcaktuar edhe fondi rezerv (fondi i veçantë) në vlerën 2,000,000 lekë. Ky fod është përdorur në vlerën 1,940,000 lekë, kryesisht për mbështetje financiare për kurim intensiv.

Konkretusht janë lëshuar 7 urdhëra ekzekutimi në zbatim të 15 VKB si në tabelën si vijon:

| Urdher ekzekutimi | | Vlera | VKB | |
|---|---|---|---|---|
| Nr | Datë | | Nr | Datë |
| 151 | 22/02/2022 | 100,000 | 137 | 27/12/2021 |
| 203 | 09/03/2022 | 500,000 | 119 | 26/11/2021 |
| | | | 12 | 28/01/2022 |
| | | | 13 | 28/01/2022 |
| | | | 14 | 28/01/2022 |
| | | | 16 | 28/01/2022 |
| | | | 123 | 26/11/2021 |
| | | | 120 | 26/11/2021 |
| 303 | 05/04/2022 | 50,000 | 112 | 25/10/2021 |
| 332 | 11/04/2022 | 170000 | 122 | 26/11/2021 |
| | | | 15 | 28/01/2022 |
| | | | 92 | 05/03/2022 |
| … | 20/06/2022 | 50000 | 43 | 29/04/2022 |
| 1006 | 21/10/2022 | 100000 | 68 | 31/08/2022 |
| 1262 | 29/12/2022 | 970000 | 77 | 30/09/2022 |
| **SHUMA** | | **1,940,000** | | |

*Burimi: Drejtoria e financës*

*2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizmit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE).*

*Në mënyrë të përmbledhur paraqitet fondet e trazhguara për vitin 2022.*

| Fondet e trashëguara në 31.12.2021 për përdorim në vitin 2022 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466) | Fondet e trashëguara në 31.12.2022 për përdorim në vitin 2023 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466) |
|---|---|
| 94,038 | 81,718 |

## Detyrimet e prapambetura viti 2022

***në mijë lekë***

| Emerimi i detyrimit të prapamb. | Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021 | Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur(vlera e paguar për kolonën 3) | Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2021) | Detyrim iprapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2022 (situata më 31.12.2022) | Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 3 | 4 | 5=3-4 | 6 | 7=5+6 |
| Shpenzime gjyqesore | 3,877 | 0 | 3,877 | 113 | 3,990 |
| Fatura te palikujduara per sherbime | 848 | 0 | 848 | 926 | 1,774 |
| Fatura te palikujduara per mallra | 24,753 | 23,900 | 853 | 960 | 1,813 |
| Fatura te palikujduara | 3,518 | 0 | 3,518 | 2,024 | 5,542 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| per investime | | | | | |
| **Totali** | **32,996** | **23,900** | **9,096** | **4,023** | **13,119** |
| Detyrime te prapambetura nga FZHR (Ministrite e linjës) | | | | | 474 |

*Burimi: Bashkia Gramsh*

Vlera e raportuar nga Bashkia Gramsh në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 është **9,208,704 lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 1141 prot., datë 15.03.2023 drguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore. Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vleren e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vleren e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon

| N.R | Emërtimi | Stoku në vlerë | Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në | Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së |
|---|---|---|---|---|
| I | **Borxhe (a+b)** | **0** | | |
| a | **Hua sfatgjatë** | **0** | | |
| a,1 | Principali | | | |
| a,2 | Interesi | | | |
| b | **Hua afatshkurtër** | **0** | | |
| b,1 | Hua | | | |
| b,2 | Overdrafte | | | |
| b,3 | Kredi të furnitorëve | **9,208,704** | | |
| II | **Detyrime (a+b+c)** | | | **0.85%** |
| a | **Shpenzime korrente** | **1,700,582** | | |
| a,1 | Mallra dhe shërbime | | | |
| a,2 | Paga dhe sigurime | | | |
| a.3 | Të tjera | 852,871 | | |
| b | **Shenzime kapitale** | **3,518,730** | | |
| b,1 | Insitucione buxhetore | | | |
| b,2 | Subjekte private | 3,518,730 | | |
| c | **Vendime gjyqësore** | **3,989,392** | | |
| c,1 | Marrëdhënie pune | | | |
| c,2 | Mallra dhe shërbime | | | |
| c,3 | Investime | | | |
| c,4 | Të tjera | 3,989,392 | | |
| **III** | **Totali (I+II)** | **9,208,704** | **1,078,703,856** | **0.85%** |

*Burimi: Bashkia Gramsh*

**Titulli i gjetjes:** *Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura.*

**<u>Situata:</u>**

Bashkia Gramsh në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 32,996 mijë lekë (nga kjo 474 mijë leke, detyrime të FSHZH), Detyrimi i Bashkise është 32,522 mijë leke.e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 7,100 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 23,900 mijë lekë, ose 297% e vlerës së planifikuar.

Po për efekte të shtimit të detyrimeve gjate vitit 2022 , kjo ulje e detyrimeve nga pagesat nuk reflektohet në gjendjen e detyrimeve në datën 31.12.2022 .

Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur (32,996-13,119), me 19,877 lekë, ose në

masën prej 60%. Në mënyrë të detajuar paraqiten në aneksin nr. 2 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.
Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likujdimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Gramsh z. K. T., si dhe z. A. S., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.
**Kriteri:** UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Udhëzimi MFE nr. 4, datë 25.01.2021 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021" si dhe neni 52 i ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
**Ndikimi**: Likuidimi jo në kohë të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë njësinë vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.
**Shkaku:** Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Gramsh dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, ku mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet rriskë për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

***6. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor***.

➢ ***Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore***

**Për vitin 2022** numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 140, datë 29.12.2021, "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022", ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas strukturës është e përbëre nga sektorë dhe në total ka 5 punonjës konkretisht: 1 Drejtor Drejtorie, 1 Përgjegjës Sektori dhe 3 inspektor për tatim taksa vendore të Bashkisë Gramsh. Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 është paraqitur si vijon:

| *Nr.* | *Emri Mbiemri* | *Funksioni Sipas Strukturës* | *Lloji i shkollës* | *Larte ose i mesëm* | *Urdhri i emërimit Nr, datë* | *Urdhri largimit Nr, datë* | *Pozicioni i punës* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *a* | *b* | *1* | *2* | *3* | *4* | *5* | *6* |
| 1 | A. J. | Drejtor i te Ardhurave dhe Taksave Vendore | Finance-Bank | Larte | Nr.364 Dt.12.12.2022 | | Drejtor |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | J. T. | Pergjegjese e te Ardhurave dhe Taksave Vendore | Finance-Kontabilitet | Larte | Nr.07 Dt.10.01.2023 | | Pergjegjes |
| 3 | E. M. | Specialist | Administrim Biznes | Larte | Nr.214 Dt.29.09.2021 | | Specialit |
| 4 | F. B. | Specialist | Ekonomi dhe e Drejta | Larte | Nr.139 Dt.19.06.2019 | | Specialit |
| 5 | J. H. | Specialist | Veterinari | Larte | Nr.01 Dt.06.01.2014 | | Inspektor Tregu |

**Burimi:** *Bashkia Gramsh*

**Titulli gjetjes:** *Mangësitë e konstatuara në plotësimin e strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

**Situata:**Konstatohet se: struktura e DAV Bashkia Gramsh ka probleme dhe nuk është në funksion të realizmit e të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DAV Bashkia Gramsh, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor), për 13,495 subjekte familiar dhe biznesi në vlerën **66,577 mijë lekë**, *nga e cila:* subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 28,247 mijë lekë për 542 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 38,330 mijë lekë për 13,495 abonent. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vete dhe afate të përcaktuara. *Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar dhe në Kreun XI- "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar", nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 168/1 prot datë 29.04.2022. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi nëpunsin Autorizues si dhe Drejtoresha e Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore e Informimin me Publikun.*

**Kriteri:**Në përputhje me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar dhe në Kreun XI- "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar",* nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e stafit dhe mos përshtatja e strukturës më natyrën e menaxhimit të të ardhurave, çojnë në mos realizim të të ardhurave dhe mungesë të tyre në buxheti e Bashkisë Gramsh.

**Shkaku:** Mos njohja e kuadrit ligjorë për ,menaxhimit e të ardhurave nga instancat drejtues Bashkia Gramsh.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**Kryetari i Bashkisë Gramsh në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Gramsh me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

➢ ***Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve***

**Për vitin 2022:** Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 96 datë 30.12.2019 me ndryshime, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan. Nga të dhënat e **pasqyrës aneks nr. 2** më poshtë, shihet se për vitin 2022 planifikimi i të ardhurave është në vlerën. **130,245 mijë lekë** dhe realizuar në fakt në vlerën **81,868 mijë lekë**. Në mënyrë të

detajuar planifikimi dhe realizimi i të ardhurave paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Tejkalimet dhe mosrealizimet janë argumentuar si më poshtë:
**Konstatohen se** niveli i realizimit të disa taksave dhe tarifave ka ndikuar në nivelin e realizimit të të ardhurave për vitin 2022 në Bashkisë Gramsh si për shembull:
-Taksa e ndërtesës ka një mos realizim prej 476 mijë lekë, si rezultat të numrit të familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, me status invalid apo pensionist të cilët përjashtohen nga taksa e ndërtesës;
-Taksa e tokës ka një mos realizim prej 706 mijë lekë dhe truallit prej 138 mijë lekë, si rezultat i largimit të banorëve nga fshatrat;
-Taksa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit kanë një mos realizim 1,398 mijë lekë, kjo nga ardhur si rezultat i largimit të familjeve dhe bizneseve debitor.
-Vështirësi haset në vjeljen e taksës së tokës bujqësore ndaj fermerëve për shkak të mos organizimit të duhur të punës për vjeljen e taksës. Kjo sjell të ardhura të munguara nga viti në vit në buxhetin e bashkisë.

- ***Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:***

**Titulli gjetjes:** *Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin mbi aktivitetin e Agjentëve Tatimorë.*
**Situata:**Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta. Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore,në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Elbasan, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Gramsh dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Elbasan.
Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Gramsh Sh.A., është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit dhe referuar akt marveshjes me nr. 4311 repertori dhe nr. 2332 koleksioni datë 12.10.2022 është nënshkruar kontrata e bashkëpunimit me Ujësjellës-Kanalizime Elbasan Sh.A. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.
- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korespondencë me Ministrinë e Financave.
- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithëshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 7 “*Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit*” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, neni 15 “*Parapagimi*”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “*Për taksat Kombëtare*”.
Konstatojmë se sipas DTV Bashkia Gramsh, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Elbasan, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Gramsh është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur

dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Gramsh duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

**Kriteri:**Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 7 "*Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit*" dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 15 "*Parapagimi*", si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 "*Për taksat Kombëtare*".

**Ndikimi/Efekti:** Mos njohja e situatës, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Gramsh

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimin dhe mos zbatimit të kuadrit ligjorë.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandimi:**Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Gramsh, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e Agjentëve Tatimore me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

- ***Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:***

**Titulli i gjetjes** *Mbi administrimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Gramsh.*

**Situata:** Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Gramsh kryhet në programin Excel. DTTV nuk kryen regjistrim manual të të dhënave (nuk ka regjistra fizik) çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Gramsh i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelare dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV duke rezultuar në gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike të kompjuterave me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV. Gjithashtu, administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7. "Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë".

Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Gramsh:

*Tabela nr.2: Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Gramsh viti 2021 dhe 2022*

| Nr | Lloji Biznesit | Viti | Gjendja Në fillim | Regjistrime Reja | Mbyllur Aktivit | Gjendja në fund të Vitit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Biznesi Vogël | 2021 | 478 | 12 | 9 | 481 |
| | | 2022 | 481 | 2 | 12 | 471 |
| 2 | Biznesi Madh | 2021 | 72 | 2 | 4 | 70 |
| | | 2022 | 70 | 1 | 0 | 71 |
| (1+2) | Gjithsej | 2021 | 550 | 14 | 13 | 551 |
| | | 2022 | 551 | 3 | 12 | 542 |

*Burimi: Bashkia Gramsh*

**Kriteri:** Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7.

**Ndikimi:** Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV.
**Shkaku:** Mos angazhim i nivelit drejtues për të vendosur në objektivat e bashkisë krijimin e një sistemi për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.
**Rëndësia:** E mesme
**Rekomandim:** Bashkia Gramsh të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

**Titulli gjetjes:** *Konstatohet se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Gramsh, nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi), dhe për të gjithë subjektet.*

**Situata:**Sipas të dhënave për strukturën organike të Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Gramsh, konstatohet se nuk ka një të ngritur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifat vendore).
Referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori, detyrimet për taksat e tarifat vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet si vijon:
- ***Detyrimet e familjarëve:***
- *Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve*

Tarifa e pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të bashkisë.
Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.
Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gramsh nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Edhe pse është është nënshkruar akt marëveshje me shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Gramsh ShA dhe bazuar në pikën (ii) , neni 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, ka të drejtën dhe detyrimin e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk ka realizuar përfshirjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat vendore.
- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese*

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore.
Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.
Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.
Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.
Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familiar në vlerën **38,330,244 lekë.** Vlerë e cila përbën Detyrim të pa arkëtuar për buxhetin e bashkisë Gramsh, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familiar deri në datën 31.12.2022. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i

ndryshuar, Kreut XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", të ndryshuar.
Në **Pasqyrën Aneks 4** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifat vendore të ndara sipas Njësive administrative si vijon:

| Nr. debitorëve | Emërtim i njësive | Gjendja fund 31.12.2021 | Pakësime 2022 | Shtesa gjatë vitit 2022 | Gjendja në fund vitit 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| 7020100 | Taksa e tokës bujqësore | 19,339,941 | 1,524,243 | 3,014,367 | 20,830,065 |
| 7035014 | Taksa pastrimi, gjelbrimi, ndriçimi, ndërtesë, truall | 15,794,072 | 343,707 | 2,049,814 | 17,500,179 |
| 13495 | Totali familjare | 35,134,013 | 1,867,950 | 5,064,181 | 38,330,244 |

**Burimi:** Bashkia Gramsh

➢ ***Taksa e tokës:***

Për vitin 2022 taksa mbi tokën bujqësore është realizuar në nivelin 83% (planifikuar 4,250 mijë lekë dhe realizuar 3,544 mijë lekë). Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore rezulton se Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 23 , pika 1 *"Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetë deklarimet të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka",* dhe të VKB-ve për vitin 2022 dhe është e ndarë në 7 kategori që kanë nivele të ndryshme takse për ha/vit. Sipas Aneksit 3 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", Bashkia Gramsh klasifikohet në nivelin e dytë ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën më poshtë:

| **Nr** | **Njesia Administrative** | **Toke bujq. gjithsej** | **Nr. Fam. Qe kanmar AMTP** | **Siperfsqia e tokesndar ne faket Ligji 7501** | **Kategoria e tokës ndar sipas ligjit 7501/ në hektar** | | | | | **Sipërfaqa e ndar sipas kategorive** | **Siperfaqia e tokes se pandar** | **Sip. e tokesdhene me qira** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ha ne 1991 | | | III | IV | V | VI | VII | | | |
| 1 | Pishaj | 1971 | 1668 | 1217 | | 268 | 1000 | 444 | 259 | 1217 | 754 | |
| 2 | Kodovjat | 1449 | 1097 | 880 | | | 622 | 410 | 417 | 880 | 569 | 52.678 |
| 3 | Skenderbegas | 1344 | 682 | 908 | | 201 | 425 | 514 | 204 | 908 | 436 | 3.238 |
| 4 | Sult | 886 | 437 | 487 | | | 92 | 259 | 535 | 487 | 399 | 14.445 |
| 5 | Kushove | 730 | 478 | 446 | | | 213 | 330 | 187 | 446 | 284 | 9.84 |
| 6 | Lenie | 750 | 691 | 301 | | | | | 750 | 301 | 449 | 5.585 |
| 7 | Tunje | 1360 | 779 | 924 | | | | 942 | 418 | 924 | 436 | |
| 8 | Kukur | 1162 | 1192 | 589 | | | | | 1162 | 589 | 573 | 5.67 |
| 9 | Poroçan | 686 | 597 | 354 | | | | | 686 | 354 | 332 | |
| | **Shuma** | **5784.87** | **10338** | **6106** | **0** | **469** | **2352** | **2899** | **4618** | **6106** | **4232** | **90.5** |
| **Çmimi sipas VKB** | | | | | **1100** | **1000** | **900** | **800** | **700** | | | |
| **8,137,600** | | | | | | **469,000** | **2,116,800** | **2,319,200** | **3,232,600** | | | |

Burimi: *Bashkia Gramsh*

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelat e mësipërme, rezulton se nga Drejtoria e Bujqësisë disponohen të dhëna për **6106** ha tokë të dhënë me AMTP në vlerën e pritshme të arkëtimeve në vlerën **8,137,600 lekë**, ndërsa planifikimi i bërë nga DTTV është në vlerën e pritshme të arkëtimeve **4,250,000 lekë**. Diferenca në vlerën **3,887,600 lekë** nuk është e regjistruar nga DTTV për llogaritjen e taksës së tokës e cila përbën e ardhur e munguar për Bashkinë Gramsh. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave

vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 2. VKB nr. 96, datë 30.12.2019 i ndryshuar“Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Gramsh për vitin 2022”. *Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z.* A. J. *me detyrë Përgjegjës Sektori në DTTV.*

➢ ***<u>Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore.</u>***

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetrore në vlerën **28,247,308 lekë, vlerë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për për buxhetin e Bashkisë Gramsh.**

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

| Nr. debitorëve | Emërtim i njësive | Gjendja fund 31.12.2021 | Pakësime 2022 | Shtesa gjatë vitit 2022 | Gjendja në fund vitit 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| 419 | BIZNESE | 551 | 12 | 3 | 542 |
| 7020200 | Takse Ndërtesë | 1,196,173 | 99,646 | 313,226 | 1,409,753 |
| 7035009 | Takse Tabele +Reklame | 50,672 | 240 | 25,600 | 76,032 |
| 7035014 | Tarife Pastrimi | 875,875 | 38,500 | 585,000 | 1,422,375 |
| 7035023 | Tarife Ndriçimi | 123,250 | 10,000 | 96,500 | 209,750 |
| 7035013 | Tarife gjelbërim | 123,250 | 10,000 | 96,000 | 209,250 |
| 7035025 | Takse Trualli | 110,718 | 13,278 | 50,400 | 147,840 |
| 7035026 | Tarife për shkarkimin e ujërave të përdorura | 133,500 | 16,000 | 68,000 | 185,500 |
| 7035012 | Taksa e përkohshme për inf. Arsimore | 14,422,833 | 10,000 | 10,069,000 | 24,481,833 |
| 7035002 | Hapësirë Publike | 12,680 | 12,680 | - | - |
| 7111007 | Parkim | 43,575 | 2,700 | 34,100 | 74,975 |
| 7035046 | Linja ajrore | | | 30,000 | 30,000 |
| | Totali biznese | 17,092,526 | 213,044 | 11,367,826 | 28,247,308 |

**Burimi:** *Bashkia Gramsh*

Sa me sipër ariet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Gramsh, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, “*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve*”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

> “*Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar neni 9 “*Të drejtat dhe përgjegjësitë*” pika 1.3., ku përcaktohet se:

> “*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b)vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.*”

Neni 35, "*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*", me ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

**Kriteri:**Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – *"Çregjistrimi i subjekteve tatimore"* dhe Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar,* të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*[4].
**Ndikimi/Efekti:**Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2022 ka një vlerë afërsisht sa plani vjetore i të ardhurave të Bashkisë Gramsh.
**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.
**Rëndësia: i lartë**
**Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Gramsh, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **66,577 mijë lekë**, *si më poshtë vijon*:
*a-T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit*, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar,* Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet*, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Gramsh, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

- ***Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:***

**Titulli i gjetjes:** *Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve)*
**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, për vitin 2022 ASHK ka dërguar informacion në Bashkinë Gramsh për 79 qytetarë që kanë kryer legalizimet e banesave të tyre. Bashkia ka llogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë për secilin nga qytetarët duke dërguar edhe njoftimet përkatëse. Vlera totale e detyrimit është 1,597,688 lekë. Kanë paguar taksën e ndikimit

[4] Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithëse mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

në infrastrukturë 75 qytetarë në vlerën 1,590,247 lekë dhe nuk ka paguar taksën 4 qytetar në vlerën 71,441 lekë duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 71,441 lekë.** si vijon:

| Nr. | Emër | Atësi | Mbiemër | Prot BASHKI | Data | Sip. totale e ndërtimit ($m^2$) | Vlera e taksës (lekë) | Paguar | Pa paguar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A. | D. | Ç. | | 2022 | 237.8 | 38,441 | | Po |
| 2 | A. | Z. | M. | | 2022 | 96.9 | 15,664 | | Po |
| 3 | S. | Q. | L. | | 2022 | 18.6 | 3,006 | | Po |
| 4 | M. | A. | K. | | 2022 | 88.6 | 14,330 | | Po |
| **TOTALI** | | | | | | | **71,441** | | |

Burimi: *Bashkia Gramsh*

**<u>Kriteri:</u>** Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7.

**<u>Ndikimi:</u>** Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV.

**<u>Shkaku:</u>** Mos angazhim i nivelit drejtues për të vendosur në objektivat e bashkisë krijimin e një sistemi për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

**<u>Rëndësia:</u>** E mesme

**<u>Rekomandim:</u>** Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **71,441 lekë** ndaj **4** personave.

- ***<u>Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:</u>***

**<u>Titulli gjetjes:</u>** *Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me Licencë të bashkisë dhe papaguar tarifën në zbatim të VKM nr. 344, datë 19.04.2017.*

**<u>Situata:</u>**Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", pika2/9 "*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera*".

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Gramsh për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 6 subjekte të paraqitura në tabelën në vijim.

*Tabela nr. 6: Subjektet që ushtrojnë aktivitet në shitjen e lëndëve djegëse me pakicë*

| Nr | Subjekti | NIPT | Vendndodhja | Autorizimi | Rinovim i autorizimit | Detyrimi për autorizimin | Pagesat e kryera | Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | "K." | J......C | Pishaj-Gramsh | 04.07.2017-03.07.2022 | 01.08.2022-31.07.2027 | 1,000,000 | 200,000 | 800,000 |
| 2 | "K." | J......C | Holta - Gramsh | 09.09.2021- 08.09.2022 | 18.11.2022-17.11.2027 | 1,000,000 | 200,000 | 800,000 |
| 3 | "S." | J......Ë | Pishaj -Gramsh | 24.10.2017-23.10.2022 | 02.12.2022- 01.12.2027 | 1,000,000 | 200,000 | 800,000 |
| 4 | "S." | J......Ë | Koçaj- Gramsh | 11.12.2020-10.12.2025 | | 1,000,000 | 600,000 | 400,000 |
| 5 | "G." | M......M | Gramsh | Pa autorizim | | 1,000,000 | | 1,000,000 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | "B." | L.......I | Pishaj -Gramsh | Pa autorizim | | 1,000,000 | | 1,000,000 |
| | | | | | | | **1200000** | **4,800,000** |

*Burimi: Bashkia Gramsh*

***Në lidhje me auditimin e pagesave të kryera sipas autorizimeve të lëshyar nga Bashkia Gramsh dhe sipas lishencës të mara nga subjektet për ushtrimin e aktivitetit.***

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se subjektet e pajisura me autorizim 1 vjecar ka berë likuidimin e detyrimeve sipa autorizimit. Referuar lishensave përkatse subjektet janë debitorë në vlerën 2,800,000 lekë vlerë e cila konsiderohet e ardhr e munguar për buxhetin e bashkisë Gramsh. *Gjithashtu* nga auditimi rezulton se, në Bashkinë Gramsh ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizim/licencë për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë 2 subjekte, përkatësisht subjekti "G." dhe subjekti "B.", në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht:

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4 "*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*", neni 15 *"...Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji…",* neni 20-Autorizimet pika 2, "*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11*[5]*, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje*";
- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3 "*Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore*".

Ushtrimi i aktivitetit i pa pajisur me autorizim/licencë të lëshuar nga bashkia ka sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 4,800,000 lekë.**

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, Znj. L. Z. me detyrë Drejtore e Shërbimeve të Sipërmarrjes (KP).*

**Kriteri:** Në kundërshtim me nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. e VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Mos ndjekja e procedurës për dhënien e Liçensë së tregtimit të karburanteve, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Gramsh me vlerë **4,800,000 lekë.**

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimin dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitet pa dokumentacion të rregullt.

---

[5]Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 11-Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë".

**<u>Rëndësia:</u> E lartë**
**<u>Rekomandimi:</u>**Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Gramsh, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **4,800,000 lekë** ndajë **6** subjekteve, sipas pasqyrës së sipërcituar.

➢ ***<u>Mbi pagesën e detyrimeve vendore nga subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh.</u>***

**<u>Titulli i gjetjes</u>** *Mbi pagesën e detyrimeve vendore nga subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh.*
**<u>Situata:</u>** Lidhur me subjektet që janë shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duke fituar të drejtën të kryejnë punime në territorin e Bashkisë Gramsh grupi i auditimit auditoi dokumentacionin mbi pagesën e detyrimeve të këtyre subjekteve për taksat dhe tarifat vendore për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.
Për periudhën nën auditim janë identifikuar 3 operatorë ekonomikë që kanë fituar të drejtën për të kryer punime të ndryshme në territorin e Bashkisë Gramsh, dhe nuk kanë paguar detyrimet vendore sikurse paraqitet në tabelën në vijim.

*Subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh 2022 dhe rezultojnë debitorë për taksat dhe tarifat vendore.*
*Burimi i të dhënave: Bashkia Gramsh, përpunoi grupi i auditimit*

Nga auditimi rezultoi se, janë 3 operatorë ekonomik që nuk kanë paguar detyrimet vendore që lindin ndaj Bashkisë Gramsh për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën 77,583 lekë**.
Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore nuk ka dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre për periudhën e kontratës.
Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik të listuar në tabelën e mësipërme

| Nr | Subjekti | NIPTI | Vl.kont. (pa tvsh) | Afati kontrates | Lloji i taksave dhe tarifave vendore | | | | | Paguar | Debitor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Tarife pastrimi | Tarife ndricimi | Tarife gjelb. | Tarife Ujra te perd. | Arsim | | |
| 1 | R. | K......M | 3,689,182 | 30 dite | 8,333 | 1,667 | 1,667 | 416 | 167 | | 12,250 |
| 2 | A. | K.......I | 3,446,860 | 90 dite | 24,999 | 5,001 | 5,001 | 1,... | 501 | | 36,750 |
| 3 | V. | J........S | 16,940,764 | 70 dite | 19,444 | 3,889 | 3,889 | 972 | 389 | | 28,583 |
| | **Total** | | | | **52,776** | **10,557** | **10,557** | **2,636** | **1,057** | | **77,583** |

është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 12, pika 6 *"Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë bashkisë ose komunës përkatëse. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje"*, VKB nr. 96 datë 30.12.2019 "*Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore*" në Bashkinë Gramsh.
**<u>Kriteri:</u>** Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë", i ndryshuar, neni 43 pika 1/1.
Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar pika 40.1, 43.1.1.

VKB nr. 96 datë 30.12.2019 "Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore" në Bashkinë Gramsh.
**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën **77,583 lekë**.
**Shkaku:** Mos ndjekja e hapave ligjore për subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh për pagesën e taksave dhe tarifave vendore.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandim:** Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.

*Për periudhën objekt auditimi dhe shkeljet e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi punonjësit e mëposhtëm:*
- z. A. J. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore
- z. O. L. me pozicion Specialist për inspektimin, kontrollin tatimor në terren
- z. A. N. me detyrë ish/Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore nga data 20.09.2021 deri më 24.06.2022
- Znj. L. Z. me detyrë Drejtore e Shërbimeve të Sipërmarrjes (KP).
- z. J. H. me detyrë Inspektor i taksave të tregjeve (N/C)
- z. F. B. me detyrë Inspektor për taksat e biznesit (N/C).
- Znj. E. M. me detyrë Specialiste për taksat familjare (N/*C).*

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", neni 42 "*Administrimi i mjeteve monetare*", pika 2, ku përcaktohet se:

"*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.*"

*Auditim mbi shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për dhënien me qira të aseteve të Bashkisë apo Njësisë Administrative. Lidhja e kontratave. Arkëtimi i të ardhurave nga qiraja dhe përdorimi i tyre.*

**Titulli i Gjetjes:** *Keqadministrimi i të ardhurave nga kontratat e qiradhënies së pasurive të paluajtshme.*

**Situata:**
Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Gramsh u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e bashkisë të dhëna me qira. Në këtë aspekt u auditua vetëm zbatimi i kushteve të kontratave lidhur me pagesat në afat të detyrimeve të qirasë vjetore për sipërfaqen e marrë me qira dhe jo kushtet e hartimit të kontratave. Nga auditimi i kontratave të qiradhënies u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Gramsh, përllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj si vijon:
Rezultoi se në territorin e bashkisë Gramsh janë pajisur me kontrat 22 Shoqëri Koncesionare të cilat kanë lidhur kontrat me bashkinë ndër vite. sipas tabelës vijuese;

| Nr. | Ekonomia pyjore/kullosore | Shoqëria/Subjekti | Aktiviteti | Akti miratimit (Nr. datë) | Sipërfaqja e dhënë në përdorim | | Kohëzgjatja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ha | km | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Poroçan | **Subjekti "B + S." shpk** | Ndërtim dhe operim **Hec-Tervoli** | Kontratë e datë 11.02.2008 | 2.14 | 0 | 35 vjet |
| **2** | Holtë-Lukovë,Poroçan | **Shoqëria "G. " shpk** | Ndërtim dhe operim **Hec-Pisha** | Kontratë Nr..... prot, datë 05.04.2017 | 0.3126 | 1.55 | 10 vjet |
| **3** | Galigat-Strorë | **Shoqëria "S." shpk** | Ndërtim dhe operim **Hec-Pashtresh 1 dhe 2** | Kontratë Nr.... prot, datë 12.06.2017 | 0.1521 | 9.088 | 10 vjet |
| **4** | Vidhan-Skëndërbegas | **Shoqëria "O." shpk** | Ndërtim dhe operim **Hec-Kebela** | Kontratë Nr.... prot, datë 12.06.2017 dhe Aneks-Kontratë Nr....prot, datë 10.06.2019 | 0.132 | 1.33 | 10 vjet |
| **5** | Vidhan-Skëndërbegas | **Shoqëria "C." shpk** | Ndërtim dhe operim **Hec-Bletëz** | Kontratë Nr.... prot, datë 12.06.2017 | 0.137 | 2.135 | 10 vjet |
| | Vidhan-Skëndërbegas | **Shoqëria "D." shpk** | Ndërtim dhe operim **Hec-Dobrenjë-Tomorricë** | Kontratë Nr.... prot, datë 17.08.2017 | 0.0132 | 3.24 | 10 vjet |
| **7** | Vidhan-Skëndërbegas, Jançë-Kërpicë | **Shoqëria "E." sha** | Ndërtim dhe operim **Hec-Mivas** | Kontratë Nr....prot, datë 18.10.2017 dhe Aneks-Kontratës Nr....prot, datë 26.10.2018 | 0.175 | 15.021 | 10 vjet |
| **8** | Poroçan | **Shoqëria "I."shpk** | Ndërtim **Hec-Kamiçan** | Kontratë Nr.... prot, datë 12.10.2017 | 0.0239 | 1.955 | 10 vjet |
| **9** | Galigat-Strorë, Poroçan | **Shoqëria "E." shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Strori / E.** | Kontratë Nr...prot, datë 26.10.2017 | 0.0389 | 4.05 | 10 vjet |
| **10** | Suhagorë-Mali i Grabovës | **Shoqëria "G." shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Babuni** | Kontratë Nr.... prot, datë 07.11.2017 | 0.17 | 3.049 | 10 vjet |
| **11** | Suhagorë-Mali i Grabovës | **Shoqëria O." shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Shenepremte** | Kontratë Nr.... prot, datë 07.11.2017 | 0.2454 | 4.661 | 10 vjet |
| **12** | Poroçan | **Subjekti "K. P." shpk** | Ndërtim e operim **Hec-ve Kabash dhe Poroçan** | Kontratë Nr.... prot, datë 05.10.2018 | 0.804 | 12.23 | 10 vjet |
| **13** | Holtë-Lukovë, Poroçan, Gramsh-Vinë | **Subjekti "E." shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Liseci** | Kontratë Nr.... prot, datë 29.03.2018 | 0.0338 | 2.5395 | 10 vjet |
| **14** | Holtë-Lukovë | **Subjekti "D" shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Shiroku** | Kontratë Nr.... prot, datë 29.03.2018 | 0.0045 | 6.6447 | 10 vjet |
| **15** | Dushku i Bulçarit,Mashan-Rashtan,Gramsh-Vinë | **Subjekti "D." Shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Yldon 1** | Kontratë Nr.... prot, datë 22.10.2019 | 0.0176 | 3.338 | 10 vjet |
| **16** | Dushku i Bulçarit | **Subjekti "D." Shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Yldon 2** | Kontratë Nr.... prot, datë 22.10.2019 | 0.0068 | 2.5015 | 10 vjet |
| **17** | Dushku i Bulçarit,Sojnik-Kukur | **Subjekti "D." Shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Yldon 3** | Kontratë Nr.... prot, datë 22.10.2019 | 0.0052 | 1.697 | 10 vjet |
| **18** | Dushku i Bulçarit, Suhagorë Mali i Grabovës | **Shoqëria "G." shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Grabova 1** | Kontratë nr.... prot,datë 20.01.2020 | 0.0056 | 8.4255 | 10 vjet |
| **19** | Jançë-Kërpicë,Vidh | **Shoqëria "E." shpk** | Ndërtim e operim **Hec-** | Kontratë nr... prot,datë | 0 | 0.5226 | 10 vjet |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | an-Skenderbegas, Lubinjë-Tunjë | | **Blineta** | 29.01.2020 | | | |
| **20** | Dushku i Bulçarit, Suhagorë - Mali i Grabovës | **Shoqëria "H." shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Grabova 2** | Kontrata nr.... prot,datë 30.01.2020 | 0.0124 | 7.756 | 10 vjet |
| **21** | Holtë-Lukovë,Poroçan | **Subjekti " E." shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Olben** | Kontrata nr.... prot, datë 13.02.2020 | 0.0008 | 1.838 | 10 vjet |
| **22** | Poroçan,Galigat-Strorë | **Shoqëria "A." shpk** | Ndërtim e operim **Hec-Kotorri** | Kontrata nr.... prot,datë 07.07.2021 | 0 | 0.2773 | 10 vjet |

Burimi: AKBN dhe Bashkia Gramsh

**Nga auditimi i 10 kontratave të nënshkruara nga bashkia me shoqëritë koncesionare rezulton si më poshtë:**

**1. E. Sh.P.K . Për periudhën 2017 dhe 2022, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**

- Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr..... prot, datë 26.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **E. Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. N. G. me afat 10 vite (26.10.2017 -25.10.2027), rezultoi se referuar nenit 4 të kontratës nr. .... prot, datë 26.10.2017 Bashkia Gramsh ka bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik si vijon:

**I. Përllogaritjet e Bashkisë Gramsh sipas raportit teknik:**

l. Shkurre 1.4 km x 190,000 lekë/ha/vit= 266,000 lekë/vit ((hapje kanali, shtrirje tubacioni)
2.Shkurre 1.1 km x 145,000 lekë/ha/vit = 159,500 lekë/vit (linjë elektrike)
3.1nproduktive, 0.0389 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 5,563 lekë/vit (ngritje godine dhe vepra e marrje)
4.1nproduktive 1 km x 150,000 lekë/km/vit = 150,000 lekë/vit (hapje kanali , shtrirje tubacioni)
**Shuma nr. l: 600,313** (Gjashtëqind mijë e treqind e trembëdhjetë) lekë/vit.

Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:

Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës **22,000 lekë**, e përbërë nga ;

1. Vlera e druve të zjarrit 30 m$^3$ x 500 lekë/m3 =15,000 lekë
2. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore 3,000 lekë
3. Vlera e faunës 4,000 lekë

**Shuma nr.2: 22,000** (Njëzetë e dy mijë ) lekë.

- Pagesa për vitin e parë është 600,313 lekë + 22,000 lekë = 622,313 lekë
(Gjashtëqind e njëzetë e dy mijë e treqind e trembëdhjetë) lekë.
- Për vitet në vazhdim pagesa do të jetë 165,063 (Njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e tre) lekë/vit.

**<u>II.Përllogaritjet e grupit të auditimit:</u>**

Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr..... prot, datë 26.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **E. Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. N. G. me afat 10 vitë (26.10.2017 -25.10.2027) është konstatuar se Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte **600,313 lekë/vit** (Gjashtëqind mijë e treqind e trembëdhjetë) dhe jo 165,063 lekë/vit. (Njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e tre), si vijon:

l. Shkurre 1.4 km x 190,000 lekë/ha/vit= 266,000 lekë/vit ((hapje kanali, shtrirje tubacioni)

2.Shkurre 1.1 km x 145,000 lekë/ha/vit = 159,500 lekë/vit (linjë elektrike)
3.1nproduktive, 0.0389 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 5,563 lekë/vit (ngritje godine dhe vepra e marrje)
4.1nproduktive 1 km x 150,000 lekë/km/vit = 150,000 lekë/vit (hapje kanali , shtrirje tubacioni)
**Shuma nr. l: 600,313** (Gjashtëqind mijë e treqind e trembëdhjetë) lekë/vit.
Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:
Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës **22,000 lekë**, e përbërë nga ;

4. Vlera e druve të zjarrit 30 $m^3$ x 500 lekë/m3 =15,000 lekë
5. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore 3,000 lekë
6. Vlera e faunës 4,000 lekë

**Shuma nr.2: 22,000** (Njëzetë e dy mijë ) lekë.

- Pagesa për vitin e parë është 600,313 lekë + 22,000 lekë = 622,313 lekë (Gjashtëqind e njëzetë e dy mijë e treqind e trembëdhjetë) lekë.
- Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte **600,313 lekë/vit** (Gjashtëqind mijë e treqind e trembëdhjetë)

Rezulton se periudha 26.10.2018-25.10.2022, subjekti **E. Sh.P.K** ka paguar detyrimet në vlerën 660,252 lekë ku në fakt duhet të paguante 1,741,000 lekë. Diferenca **1,080,748 lekë (**1,741,000 lekë - 660,252 lekë = 1,080,748 lekë**)** për periudhën 26.10.2018-25.10.2022 përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa me sipër përllogaritja e kontratës së qirasë nr..... prot, datë 26.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **E. Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. N. G. me afat 10 vite (26.10.2017 -25.10.2027) është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

**2. "I." Sh.P.K . Për periudhën 2017 dhe 2022, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**
- Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr..... prot, datë 12.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " "I." **Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. P. K. me afat 10 vite (12.10.2017 -11.10.2027), rezultoi se referuar nenit 4 të kontratës nr. .... prot, datë 12.10.2017 Bashkia Gramsh ka bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik si vijon:

**I. Përllogaritjet e Bashkisë Gramsh sipas raportit teknik:**
1. Inprodukiive, 0.0239 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 3,418 lekë/vit
2.Inproduklive 1.955 km x 145,000 lekë/km/vit = 283,475 leke/vit (hapje kanali dhe shtrirje tubacioni)
**Totali nr. l : 286,893 lekë** (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë/vit.

Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:
Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 7,000 lekë, e përbërë nga ;
1. Kullotja 2,000 lekë
2. Vlera e faunës 5,000 lekë
**Totali nr.2: 7,000** (shtatë mije) lekë.
- Pagesa për vitin e parë dhe të dytë është 293,893 (dyqindë e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqindë e nëntëdhjetë e tre) për vitin e parë dhe të dytë të ndërtimit të Hidrocentralit Kamiçan).
- Për vitet në vazhdim do të jetë 3,418 (tremijë e katërqindë e tetëmbëdhjetë) lekë/vit.
l

**II.Përllogaritjet e grupit të auditimit:**
Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. .... prot, datë 12.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria "I." **Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. P. K. me afat 10 vite (12.10.2017 -11.10.2027), është konstatuar se Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte **286,893 lekë/vit** (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) dhe jo 3,418 lekë/vit. ((tremijë e katërqindë e tetëmbëdhjetë)., si vijon:
1. Inprodukiive, 0.0239 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 3,418 lekë/vit
2.Inproduklive 1.955 km x 145,000 lekë/km/vit = 283,475 leke/vit (hapje kanali dhe shtrirje tubacioni)
**Totali nr. l : 286,893 lekë** (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë/vit

Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:
Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 7,000 lekë, e përbërë nga ;
3. Kullotja 2,000 lekë
4. Vlera e faunës 5,000 lekë
**Totali nr.2: 7,000** (shtatë mije) lekë.
- Pagesa për vitin e parë është në vlerën 293,893 (Dyqindë e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqindë e nëntëdhjetë e tre), të ndërtimit të Hidrocentralit Kamiçan).
- Për vitet e dytë dhe në vazhdim duhet të ishte **286,893** lekë/vit (Dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre)

Rezulton se periudha 12.10.2018-11.10.2022, subjekti I." **Sh.P.K** ka paguar detyrimet në vlerën **297,311 lekë** ku në fakt duhet të paguante 1**,147,572 lekë**. Diferenca **850,261 lekë (**1,147,572 lekë - **297,311** lekë = **850,261** lekë**)** për periudhën 12.10.2018-21.10.2022 përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa me sipër përllogaritja e kontratës së qirasë nr. .... prot, datë 12.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " "I." **Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. P. K. me afat 10 vite (12.10.2017 -11.10.2027), është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet"; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën "a" të

pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

**3. O. Sh.P.K . Për periudhën 2017 dhe 2022, i shtrijnë efektet i kontrata, si më poshtë vijon:**
- Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr.... prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria "O." **Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. M. O. me afat 10 vite (07.11.2017 -06.11.2027), rezultoi se referuar nenit 4 të kontratës nr. .... prot, datë 07.11.2017 Bashkia Gramsh ka bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik si vijon:

**I. Përllogaritjet e Bashkisë Gramsh sipas raportit teknik:**

1. Cungishte 0.08 ha x 176,000 lekë/ha/vit =14,080 lekë/vit (vepër marrje dhe baten presioni)
2. Cungishte 0.894 km x 176,000 lekë/km/vit =157,344 lekë/vil (rruge e përkohshme, hapje kanali, shtrirje tubacioni)

3.Kullotë 0.122 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 21,472 lekë/vit (godine e hec, vepër marrje)
4.Kullotë 3.057 km x 176,0001ekë/km/vit =538,032 lekë/vit (rruge e përkohshme, hapje kanali, shtrirje tnbacioni)
5.1nproduklive, 0.035 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 5005 lekë/vit (ngritje godine dhe vepra e marrje)
6.1nproduktive 0.71 km x 145,000 lekë/km/vit =102,950 lekë/vit (rëngë e përkohshme, hapje kanali, shtrirje tubacioni)
7.1nproduktive 0.0084 ha x 143,0001ekë/ha/vit =1201 lekë/vit (sipërfaqe për vendosje shtyllash elektrike)
**Shuma: 840,084** (Tetëqindë e dyzetë mije e tetëdhjetë e katër) lekë/vit.
Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:
b) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 36,350 lekë, e përbërë nga :
l. Vlera e të zjarrit 30 x 500 = 15,000 lekë
2.Hera e prodhimeve te dyta pyjore 10,000 lekë
3.Kullotja 5,3501ekë
4.Hera e 6,000 lekë
**Shuma: 36,350** (Tridhjetë e gjashtë mijë e treqindë e pesëdhjetë) lekë.
▪ Pagesa për vitin e parë dhe të dytë të ndërtimimit të Hec-Shenepremte është 840,084 lekë + 36350 lekë = 876,434 ( Tetëqindë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqindë e tridhjetë e katër) lekë/vit.
• Për vitet në vazhdim do të jetë 41,758 (Dyzetë e një mijë e shtatëqindë e pesëdhjetë e tetë) lekë/vit.

**<u>II.Përllogaritjet e grupit të auditimit:</u>**
Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr.... prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria **"O." Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. M. O. me afat 10 vite (07.11.2017 -06.11.2027) është konstatuar se pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte **840,084 lekë/vit** (Tetëqindë e dyzetë mije e tetëdhjetë e katër) dhe jo 41,758 lekë/vit. (Dyzetë e një mijë e shtatëqindë e pesëdhjetë e tetë), si vijon:
3. Cungishte 0.08 ha x 176,000 lekë/ha/vit =14,080 lekë/vit (vepër marrje dhe baten presioni)
4. Cungishte 0.894 km x 176,000 lekë/km/vit =157,344 lekë/vil (rruge e përkohshme, hapje kanali, shtrirje tubacioni)

3.Kullotë 0.122 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 21,472 lekë/vit (godine e hec, vepër marrje)
4.Kullotë 3.057 km x 176,0001ekë/km/vit =538,032 lekë/vit (rruge e përkohshme, hapje kanali, shtrirje tnbacioni)
5.1nproduklive, 0.035 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 5,005 lekë/vit (ngritje godine dhe vepra e marrje)
6.1nproduktive 0.71 km x 145,000 lekë/km/vit =102,950 lekë/vit (rëngë e përkohshme, hapje kanali, shtrirje tubacioni)
7.1nproduktive 0.0084 ha x 143,0001ekë/ha/vit =1201 lekë/vit (sipërfaqe për vendosje shtyllash elektrike)
**Shuma: 840,084** (Tetëqindë e dyzetë mije e tetëdhjetë e katër) lekë/vit.
Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:
b) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 36,350 lekë, e përbërë nga :
l. Vlera e të zjarrit 30 x 500 = 15,000 lekë
5.Hera e prodhimeve te dyta pyjore 10,000 lekë
6.Kullotja 5,3501ekë
7.Hera e 6,000 lekë
**Shuma: 36,350** (Tridhjetë e gjashtë mijë e treqindë e pesëdhjetë) lekë.
▪ Pagesa për vitin e parë të ndërtimimit të Hec-Shenepremte është 840,084 lekë + 36350 lekë = 876,434 ( Tetëqindë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqindë e tridhjetë e katër) lekë/vit.
• Pagesa për vitin e dytë dhe në vazhdim duhet të ishte **840,084** (Tetëqindë e dyzetë mije e tetëdhjetë e katër) lekë/vit

Rezulton se periudha 07.11.20117-06.11.2023, subjekti **"O." Sh.P.K** nuk ka paguar detyrimet sipas kontratës. Diferenca **4,236,770 lekë (**876,434 + 840,084 +840,084 +840,084 +840,084 =**4,236,770 lekë)**, përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa me sipër përllogaritja e kontratës së qirasë nr.... prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria **"O." Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. M. O. me afat 10 vite (07.11.2017 -06.11.2027) është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

**4. G. Sh.P.K . Për periudhën 2017 dhe 2022, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**
- Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr..... prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **G. Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. N. G. me afat 10 vite (07.11.2017 -06.11.2027), rezultoi se referuar nenit 4 të kontratës nr. .... prot, datë 07.11.2017 Bashkia Gramsh ka bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik si vijon:

**I. Përllogaritjet e Bashkisë Gramsh sipas raportit teknik:**

a) Kullote 0.09 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 15,840 lekë/vit (vepër marrje, bazën presioni)

b) Kullotë 0.819 km x 176,000 lekë/km/vit = 144,144 lekë/vit (hapje rrugë, hapje kanali, shtrirje tubacioni)

c). Inproduktive, 0.08 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 11,440 lekë/yit (mgritje godine dhe vepra e marrjes)

d) Inproduktive 2.23 km x 145,000 lekë/hn/vit =323,350 lekë/vit (hapje rrugë, hapje kanali, shtrirje tubacioni)

**Shuma : 494,774 (Katerqind e nentedhjete e kater mije e shatateqinde e shtatedhjete e kater) lekë/vit.**

Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si rnë poshtë:

VIerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 10,000 lekë, e përbërë nga ;

1. VIera e prodhimeve të dyta pyjore 4,000 lekë
2. Kullotja 1,000 1ekè
3. VIera efaunes 5,000

**Shuma : 10,000 (Dhjetë mijë) lekë/vit**

- Pagesa për vitin e parë te dytë të tretë dhe të katërt është 494,774 lekë + 10000 lekë = 504,774 (Pesëqinde e katermije e shtateqinde e shtatedhjete e kater) lek/vit.
- Për vitet në vazhdim pagesa do të jetë 27,280 (Njëzetë e shtatë mijë e dyqindë e tetëdhjetë) lekë/vit.

**<u>II.Përllogaritjet e grupit të auditimit:</u>**

Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr..... prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria "**G.” Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. N. G. me afat 10 vite (07.11.2017 -06.11.2027) është konstatuar se Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte **494,774 lekë/vit** (Katerqind e nëntëdhjetë e katër mije e shatatëqindë e shtatëdhjetë e katër) dhe jo **27,280 lekë/vit.** (Njëzetë e shtatë mijë e dyqindë e tetëdhjetë), si vijon:

b) Kullote 0.09 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 15,840 lekë/vit (vepër marrje, bazën presioni)

b) Kullotë 0.819 km x 176,000 lekë/km/vit = 144,144 lekë/vit (hapje rrugë, hapje kanali, shtrirje tubacioni)

c). Inproduktive, 0.08 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 11,440 lekë/yit (mgritje godine dhe vepra e marrjes)

e) Inproduktive 2.23 km x 145,000 lekë/hn/vit =323,350 lekë/vit (hapje rrugë, hapje kanali, shtrirje tubacioni)

**Shuma : 494,774 (Katerqind e nentedhjete e kater mije e shatateqinde e shtatedhjete e kater) lekë/vit.**

Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si rnë poshtë:

VIerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 10,000 lekë, e përbërë nga ;

4. VIera e prodhimeve të dyta pyjore 4,000 lekë
5. Kullotja 1,000 1ekè
6. VIera efaunes 5,000

**Shuma : 10,000 (Dhjetë mijë) lekë/vit**

- Pagesa për vitin e parë duhet të ishte 494,774 lekë + 10000 lekë = 504,774 (Pesëqinde e katermije e shtateqinde e shtatedhjete e kater) lek/vit.

• Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte 494,774 **lekë/vit** (Katërqind e nëntedhjetë e katër mijë e shatatëqindë e shtatëdhjetë e katër)
Rezulton se periudha 07.11.20117-06.11.2023, subjekti "**G." Sh.P.K** nuk ka paguar detyrimet sipas kontratës. Diferenca **2,483,870 lekë (**504,774 + 494,774 +494,774 + 494,774 + 494,774 = **2,483,870 lekë)**, përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa me sipër përllogaritja e kontratës së qirasë nr..... prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria "**G." Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. N. G. me afat 10 vite (07.11.2017 -06.11.2027) është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet"; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën "a" të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

**5. HEC-i K. Sh.P.K . Për periudhën 2018 dhe 2022, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**
- Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr.... prot, datë 05.10.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **HEC-i K. " Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori znj. L. D. me afat 10 vite (05.10.2018 -04.10.2028), rezultoi se referuar nenit 4 të kontratës nr. ... prot, datë 05.10.2018 Bashkia Gramsh ka bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik si vijon:
**I. Përllogaritjet e Bashkisë Gramsh sipas raportit teknik:**
l. Pyll 1.55 km x 175,000 lekë/km/vit = 271,250 lekë/vit (shtrirje linje tensioni dhe vendosje shtyllash)
2.Pyll 1.38 km x 145,000 lekë/km/vit = 200,100 lekë/vit (shtrirje linje tensioni dhe vendosje shtyllash)
3.Djerrë 0.8 km x 110,000 leke/km/vit = 88000 lekë/vit (shtrirje linje tensioni dhe vendosje shtyllash)
4.Kullotë 0.82 km x 145,000 lekë/km/vir = 118900 lekë/vit (shtrirje linje tensioni dhe vendosje shtyllash)
5.Inproduktive 0.58 km x 110,000 lekë/km/vit = 63,800 lekë/vit (shtrirje linje tensioni dhe vendosje shtyllash)
6.Pyll 0.35 km x 70,000 lekë/km/vit = 24,500 lekë/vit (ndërtim e përdorim rruge )
7.Pyll 0.25 km x 35000 lekë/km/vit = 8,750 lekë/vit (ndërtim e përdorim rruge )
8.Inproduktive 6 km x 150,000 lekë/hm/vit = 900,000 lekë/vit (rruge e përkohshme, hapje kanali, shtrirje tubacioni)
9.Kullotë 0.05 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 8,800 lekë/vit (ngritje godine e hec-it, vepër marrje)
10.Pyll 0.095 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 16,720 lekë/vit (ngritje godine e hec-it, vepra e marrje dhe vend grumbullimet e materialeve të ndryshme)
11. Pyll 0.124 ha x 192,000 leke/ha/vit = 23,808 lekë/vit ( vend grumbullimet e materialeve të ndryshme)

12. Djerrë 0.2 ha x 156,000 lekë/ha/vit = 31,200 lekë/vit (vend grumbullimet e materialeve të ndryshme).
Shuma: 1,755,828 (Një milion e shtatëqindë e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzetë e tetë) lekë/vit.
Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:
Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës **32,000 lekë**, e përbërë nga ;
1.Vlera e druve të zjarrit 10 $m^3$ x 500 lekë/m3 = 5,000 lekë
2.Vlera e prodhimeve të dyta pyjore 10,000 lekë
3.Kullotja 7,000 lekë
4.Vlera e faunës 10,000 lekë
**Shuma nr.2: 32,000** (Tridhjetë e dy mijë) lekë.

- Pagesa për vitin e parë të ndërtimit dhe operimit të Hec-ve K. është 1,755,828 lekë + 32,000 lekë 1,787,828 (Një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzetë e tetë) lekë/vit.
- Për vitet në vazhdim do ti jetë 665,496 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë/vit.

**II.Përllogaritjet e grupit të auditimit:**
Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr.... prot, datë 05.10.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **HEC-i K. " Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori znj. L. D. me afat 10 vite (05.10.2018 -04.10.2028) është konstatuar se Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte 1,755,828 **lekë/vit** (Një milion e shtatëqindë e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzetë e tetë) lekë/vit dhe jo 665,496 lekë/vit (Gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë), si vijon:
l. Pyll 1.55 km x 175,000 lekë/km/vit = 271,250 lekë/vit (shtrirje linje tensioni dhe vendosje shtyllash)
2.Pyll 1.38 km x 145,000 lekë/km/vit = 200,100 lekë/vit (shtrirje linje tensioni dhe vendosje shtyllash)
3.Djerrë 0.8 km x 110,000 leke/km/vit = 88000 lekë/vit (shtrirje linje tensioni dhe vendosje shtyllash)
4.Kullotë 0.82 km x 145,000 lekë/km/vir = 118900 lekë/vit (shtrirje linje tensioni dhe vendosje shtyllash)
5.Inproduktive 0.58 km x 110,000 lekë/km/vit = 63,800 lekë/vit (shtrirje linje tensioni dhe vendosje shtyllash)
8.Pyll 0.35 km x 70,000 lekë/km/vit = 24,500 lekë/vit (ndërtim e përdorim rruge )
9.Pyll 0.25 km x 35000 lekë/km/vit = 8,750 lekë/vit (ndërtim e përdorim rruge )
8.Inproduktive 6 km x 150,000 lekë/hm/vit = 900,000 lekë/vit (rruge e përkohshme, hapje kanali, shtrirje tubacioni)
9.Kullotë 0.05 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 8,800 lekë/vit (ngritje godine e hec-it, vepër marrje)
10.Pyll 0.095 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 16,720 lekë/vit (ngritje godine e hec-it, vepra e marrje dhe vend grumbullimet e materialeve të ndryshme)
11. Pyll 0.124 ha x 192,000 leke/ha/vit = 23,808 lekë/vit ( vend grumbullimet e materialeve të ndryshme)
12. Djerrë 0.2 ha x 156,000 lekë/ha/vit = 31,200 lekë/vit (vend grumbullimet e materialeve të ndryshme).
Shuma: 1,755,828 (Një milion e shtatëqindë e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzetë e tetë) lekë/vit.

Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:
Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës **32,000 lekë**, e përbërë nga ;
5.Vlera e druve të zjarrit 10 $m^3$ x 500 lekë/m3 = 5,000 lekë
6.Vlera e prodhimeve të dyta pyjore 10,000 lekë
7.Kullotja 7,000 lekë
8.Vlera e faunës 10,000 lekë
**Shuma nr.2: 32,000** (Tridhjetë e dy mijë) lekë.

- Pagesa për vitin e parë të ndërtimit dhe operimit të Hec-ve Kabash e Porogan është 1,755,828 lekë + 32,000 lekë 1,787,828 (Një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzetë e tetë) lekë/vit.
- Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte **1,755,828 lekë/vit** (Një milion e shtatëqindë e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzetë e tetë).

Rezulton se periudha 05.10.2018 -04.10.2028, subjekti **HEC-i K. P. Sh.P.K** ka paguar detyrimet në vlerën 7,128,557 lekë ku në fakt duhet të paguante 8,811,140 lekë. Diferenca **1,682,583 lekë (**8,811,140 lekë - 7,128,557 lekë = **1,682,583** lekë**)** për periudhën 05.10.2018-04.10.2022 përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa me sipër përllogaritja e kontratës së qirasë nr.... prot, datë 05.10.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **HEC-i K." Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori znj. L. D. me afat 10 vite (05.10.2018 -04.10.2028) është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet"; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën "a" të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

**6. D Sh.P.K . Për periudhën 2018 dhe 2022, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**
- Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. ... prot, datë 29.03.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria "**D" Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. E. D. me afat 10 vite (29.03.2018 -28.03.2028), rezultoi se referuar nenit 4 të kontratës nr. nr. ... prot, datë 29.03.2018 Bashkia Gramsh ka bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik si vijon:

**I. Përllogaritjet e Bashkisë Gramsh sipas raportit teknik:**
I. Pyll 4.51308 km x 220,000 leke/km/vit = 992,877.6 leke/vit (hapje rruge dhe shtrirje tubacionesh, ndërtim kanalesh)
2.Kullotë 0.1135 km x 176,000 lekë/km/vit = 19,976 lekë/vit (hapje rruge dhe shtrirje tubacionesh, ndërtim kanalesh )
3.Djerre 1.10322 km x 145,000 leke/km/vit = 159,966.9 lekë/vit (hapje rruge dhe shtrirje tubacionesh, ndërtim kanalesh)
4.1nproduktive 0.06493 km x 145,000 lekë/km/vit = 9,414.85 lekë/vit (hapje rruge dhe shtrirje tubacionesh,ndertim kanalesh )
5. Inproduktive 0.85 km x 25,000 lekë/km/vit =21,250 lekë/vit (ndërtim rruge për përdorim )

6. Inproduktive 0.0045 ha x 143,000 lekë/ha/vit= 643.5 lekë/vit(bazament shtyllash tensionit)
**Shuma: 1,204,128.85** (Një milion e dyqindë e katër mijë e njëqindë e njëzetë e tetë pikë tetëdhjetë e pesë)lekë/vit
Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e Cila paguhet vetëm njëherë vitin e pare si më poshtë:
b) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 145,800 lekë, e përbërë nga :
1. Vlera e lëndës së punimit 15 m3 x 3,500 lekë/m3 = 52,500 lekë
2. Vlera e lëndës së punimit 3 m3 x 2,500 lekë/m3 = 7,500 lekë
3. Vlera e druve te zjarrit 7 m3 x 200 lekë/m3 = 1,400 1ekë
4. Vlera e lendës se punimit 15 "13 x 3100 lekë/m3 = 46,500 lekë
5. Vlera e lëndës së punimit 2 m3 x 1,700 1ekë/m3 = 3,400 1ekë
6. Vlera e druve te zjarrit 45m3x5001ekë/m3 = 22500 1ekë
7. Vlera e prodhimeve dyta pyjore 5000 lekë
8. Kullotja 2,000 lekë
9. Vlera e faunës 5,000 lekë

**Shuma: 145,800** (Njëqindë e dyzetë e pesë mijë e tetëqindë) lekë.

- Për vitin e parë të ndërtimit dhe operimit të Hec-it Shiroku është 1,204,128.85 lekë + 145,800 lekë = 1,349,928.85 Iekë për vitin e parë (Një milion e treqindë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqindë e njëzetë e telëpikë telëdhjetë e pesë) lekë.
- Përvitin e dytë të ndërtimit dhe operimit të Hec-it Shiroku është 1,204,128.5 lekë (Një milion e dyqindë e katër mijë e njëqindë e njëzetë e tetë pikë tetëdhjetë e pesë).

Shuma TOTALE : 1,349,928.85 lekë + 1,204,128.5 lekë = 2,554,057.35 lekë.

- Pagesa do të bëhet me këste vjetore nga viti i parë deri në afatin 10 vjeçar të kontratës në shumën 255,405.735 (Dyqindë e pesëdhjetë e pesëmijë e katërqind e pesë pikë shtatëqindë e tridhjetë e pesë) lekë/vit.

**<u>II.Përllogaritjet e grupit të auditimit:</u>**

Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. ... prot, datë 29.03.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria "**D" Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. E. D. me afat 10 vite (29.03.2018 -28.03.2028) është konstatuar se Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte 1,204,128 **lekë/vit** (**85** (Një milion e dyqindë e katër mijë e njëqindë e njëzetë e tetë)lekë/vit dhe jo 225,405 lekë/vit. (Dyqindë e pesëdhjetë e pesëmijë e katërqind e pesë), si vijon:
I. Pyll 4.51308 km x 220,000 leke/km/vit = 992,877.6 leke/vit (hapje rruge dhe shtrirje tubacionesh, ndërtim kanalesh)
2.Kullotë 0.1135 km x 176,000 lekë/km/vit = 19,976 lekë/vit (hapje rruge dhe shtrirje tubacionesh, ndërtim kanalesh )
3.Djerre 1.10322 km x 145,000 leke/km/vit = 159,966.9 lekë/vit (hapje rruge dhe shtrirje tubacionesh, ndërtim kanalesh)
4.1nproduktive 0.06493 km x 145,000 lekë/km/vit = 9,414.85 lekë/vit (hapje rruge dhe shtrirje tubacionesh,ndertim kanalesh )
5. Inproduktive 0.85 km x 25,000 lekë/km/vit =21,250 lekë/vit (ndërtim rruge për përdorim )
6. Inproduktive 0.0045 ha x 143,000 lekë/ha/vit= 643.5 lekë/vit(bazament shtyllash tensionit)
**Shuma: 1,204,128.85** (Një milion e dyqindë e katër mijë e njëqindë e njëzetë e tetë pikë tetëdhjetë e pesë)lekë/vit.
Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e Cila paguhet vetëm njëherë vitin e pare si më poshtë:
b) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 145,800 lekë, e përbërë nga :

1. Vlera e lëndës së punimit   15 m3 x 3,500 lekë/m3 = 52,500 lekë
5. Vlera e lëndës së punimit   3 m3 x 2,500 lekë/m3 = 7,500 lekë
6. Vlera e druve te zjarrit   7 m3 x 200 lekë/m3 = 1,400 1ekë
7. Vlera e lendës se punimit   15 "13 x 3100 lekë/m3 = 46,500 lekë
5. Vlera e lëndës së punimit   2 m3 x 1,700 1ekë/m3 = 3,400 1ekë
10. Vlera e druve te zjarrit   45m3x5001ekë/m3 = 22500 1ekë
11. Vlera e prodhimeve dyta pyjore   5000 lekë
12. Kullotja   2,000 lekë
13. Vlera e faunës   5,000 lekë

**Shuma: 145,800** (Njëqindë e dyzetë e pesë mijë e tetëqindë) lekë.

- Për vitin e parë të ndërtimit dhe operimit të Hec-it Shiroku është 1,204,128.85 lekë + 145,800 lekë = 1,349,928.85 lekë për vitin e parë (Një milion e treqindë e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqindë e njëzetë e tetë pikë tetëdhjetë e pesë) lekë.
- Për vitin e dytë dhe në vijim të ndërtimit dhe operimit të Hec-it Shiroku është 1,204,128.5 lekë (Një milion e dyqindë e katër mijë e njëqindë e njëzetë e tetë pikë tetëdhjetë e pesë).

**(**504,774 + 494,774 +494,774 + 494,774 + 494,774 = **2,483,870 lekë)**, përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Rezulton se periudha 29.03.2018-28.03.2023, subjekti "**D" Sh.P.K** nuk ka paguar detyrimet sipas kontratës. Diferenca **6,166,443 lekë (**1,349,929 + 1,204,129 +1,204,129 + 1,204,129 + 1,204,129 = **6,166,443 lekë)**, përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa me sipër përllogaritja e kontratës së qirasë qirasë nr. ... prot, datë 29.03.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria "**D" Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. E. D. me afat 10 vite (29.03.2018 -28.03.2028) është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet"; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën "a" të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

**7. S. Sh.P.K . Për periudhën 2017 dhe 2022, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**

- Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr.... prot, datë 12.06.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **S." Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. T. K. me afat 10 vite (12.06.2017 -11.06.2027), rezultoi se referuar nenit 4 të kontratës nr. ... prot, datë 12.06.2017 Bashkia Gramsh ka bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik si vijon:

**I. Përllogaritjet e Bashkisë Gramsh sipas raportit teknik:**

Shkurre 0.0223 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 3,924.8 lekë/vit
Kullote 0.0338 ha x 176,000 lekë/km/vit = 5,948.8 lekë/vit
Inproduktive 0.096 ha x 143,000 lekë/km/vit = 13,728 lekë/vit
Inproduktive 9,088 km x 150,000 lekë/km/vit = 1,363,200 lekë/vit
Total. 1,386,801.6 ( Një milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e një pikë gjashtë) lekë/vit

Kësaj vlere i shtohet dhe vlera e materialit drusor që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë Vitin e parë si më poshtë:
a) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 16,600 lekë, e përbërë nga :
2.Vlera e faunës 5,000 lekë
3.Vlera e prodhimeve të dyta pyjore 1,500 lekë
4.Kullotja 100 lekë
TOTALI : 16,600 (Gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.
Pagesa për vitin e parë është 1,403,401.6 ( Një milion e katërqind e tre mijë e katërqind e një pikë gjashtë) lekë. Për vitet në vazhdim do të jetë 23,601.6 (Njëzetë e tre mijë e gjashtëqind e një pikë gjashtë) lekë/vit.

**<u>II.Përllogaritjet e grupit të auditimit:</u>**

Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr.... prot, datë 12.06.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **S.” Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. T. K. me afat 10 vite (12.06.2017 -11.06.2027) është konstatuar se Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte **6**. 1,386,801.6 ( Një milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e një pikë gjashtë) lekë/vit dhe jo 23,601.6 (Njëzetë e tre mijë e gjashtëqind e një pikë gjashtë) lekë/vit, si vijon:
Shkurre 0.0223 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 3,924.8 lekë/vit
Kullote 0.0338 ha x 176,000 lekë/km/vit = 5,948.8 lekë/vit
Inproduktive 0.096 ha x 143,000 lekë/km/vit = 13,728 lekë/vit
Inproduktive 9,088 km x 150,000 lekë/km/vit = 1,363,200 lekë/vit
Total. 1,386,801.6 ( Një milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e një pikë gjashtë) lekë/vit
Kësaj vlere i shtohet dhe vlera e materialit drusor që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:
b) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 16,600 lekë, e përbërë nga :
5.Vlera e faunës 5,000 lekë
6.Vlera e prodhimeve të dyta pyjore 1,500 lekë
7.Kullotja 100 lekë
TOTALI : 16,600 (Gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.

Pagesa për vitin e parë është. 1,386,801.6 lekë + 16,600 lekë = 1,403,401.6 ( Një milion e katërqind e tre mijë e katërqind e një pikë gjashtë) lekë.
Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte 1,386,801.6 lekë/vit ( Një milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e një pikë gjashtë)
Rezulton se periudha 12.06.2017-11.06.2023, subjekti "**S.” Sh.P.K** nuk ka paguar detyrimet sipas kontratës. Diferenca 6,950,606 lekë **(**1,403,402 + 1,386,801 + 1,386,801 + 1,386,801 + 1,386,801= **6,950,606 lekë)**, përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa me sipër përllogaritja e kontratës së qirasë nr.... prot, datë 12.06.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **S.” Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. T. K. me afat 10 vite (12.06.2017 -11.06.2027) është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të

pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

**8. E. Sh.a . Për periudhën 2017 dhe 2022, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**
- Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. .... prot, datë 18.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **E.” Sh.a** përfaqësuar nga administratori z. M. H. me afat 10 vite (18.10.2017 -17.10.2027), rezultoi se referuar nenit 4 të kontratës nr. .... prot, datë 18.10.2017 Bashkia Gramsh ka bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik si vijon:

**I. Përllogaritjet e Bashkisë Gramsh sipas raportit teknik:**

I. Trungishte 0.15 ha x 210,000 lekë/ha/vit =31,500 lekë/vit (sheshi i depozitimit)
2.Inproduktive 0.025 ha x 143,000 lekë/ha/vit =3,575 lekë/vit (godina e Hec-it)
3.Trungishte 0.006 ha x 210,000 lekë/ha/vit =1,260 lekë/vit (vendosje shtyllash)
4.Shkurre 0.0034 ha x 176,000 lekë/ha/vit =... lekë/vit (vendosje shtyllash)
5. Inproduktive 0.003 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 429 lekë/vit (vendosje shtyllash)
6. Trungishte 0.401 km x 240,000 lekë/km/vit=96,240 lekë/vit (hapje kanali, shtrirje tubacioni)
7. Shkure 0.088 km x 190,000 lekë/km/vit =16,720 lekë/vit (hapje kanali, shtrirje tubacioni)
8.1nproduktive 2.673 km X 150,000 1ekë/km/vit=400,950 lekë/vit(hapje kanali, shtrirje tubaeioni)
9.Trungishte 0.455 km x70,000 1ekë/km/vit = 31,850 lekë/vit (hapje rruge për shtyllat e tensionit)
10.Shkurre 0.250km x 35,000 lekë/km/vit = 8,750 lekë/vit (hapje rruge për shtyllat e tensionit)
11.1nproduktive0.300 km x 25,000 1ekë/km/vit =7,500 1ekë/vit (hapje rruge për shtyllat e tensionit)

**Totali nr.l : 599,372** (Pesëqindë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqindë e shtatëdhjetë e dy) lekë/vit.

Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e Cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:

Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 56,500 lekë, e përbërë nga ;

1. VIera e lëndës së punimit 10 m3x 3500 lekë/m3 = 35000 lekë
2. VIera e lëndës së punimit 3 m3 x 2500 lekë/m3 = 7,500 lekë
3. Vlera e druve të zjarrit 10 $m^3$ x 500 lekë/m3 = 5,000 lekë
4. Vlera e druve të zjarrit 5 $rn^3$ x 200 lekë/m3 = 1000 lekë
5. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore, 2,000 lekë
6. Kullotja, 2,000 lekë
7. Vlera e faunes, 4,000 lekë

**Totali nr.2**: 56,500 (Pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqindë) lekë.

- Pagesa për vitin e parë 599,372 lekë + 56,500 lekë = 655,872 ( gjashtëqindë e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqindë e shtatëdhjetë e dy) lekë.
- Për vitet në vazhdim do të jetë 85,462 (Tetëdhjetë e pesë mijë e katërqindë e gjashtë dhjetë e dy) lekë/vit.

**<u>II.Përllogaritjet e grupit të auditimit:</u>**

Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. .... prot, datë 18.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **E.” Sh.a** përfaqësuar nga administratori z. M. H. me afat 10 vite (18.10.2017 -17.10.2027) është konstatuar se Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte **599,372 lekë/vit** (Pesëqindë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqindë e

shtatëdhjetë e dy) dhe jo 85,462 lekë/vit(Tetëdhjetë e pesë mijë e katërqindë e gjashtë dhjetë e dy), si vijon:
I. Trungishte 0.15 ha x 210,000 lekë/ha/vit =31,500 lekë/vit (sheshi i depozitimit)
2.Inproduktive 0.025 ha x 143,000 lekë/ha/vit =3,575 lekë/vit (godina e Hec-it)
3.Trungishte 0.006 ha x 210,000 lekë/ha/vit =1,260 lekë/vit (vendosje shtyllash)
4.Shkurre 0.0034 ha x 176,000 lekë/ha/vit =... lekë/vit (vendosje shtyllash)
5. Inproduktive 0.003 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 429 lekë/vit (vendosje shtyllash)
6. Trungishte 0.401 km x 240,000 lekë/km/vit=96,240 lekë/vit (hapje kanali, shtrirje tubacioni)
7. Shkure 0.088 km x 190,000 lekë/km/vit =16,720 lekë/vit (hapje kanali, shtrirje tubacioni)
8.1nproduktive 2.673 km X 150,000 1ekë/km/vit=400,950 lekë/vit(hapje kanali, shtrirje tubaeioni)
9.Trungishte 0.455 km x70,000 1ekë/km/vit = 31,850 lekë/vit (hapje rruge për shtyllat e tensionit)
10.Shkurre 0.250km x 35,000 lekë/km/vit = 8,750 lekë/vit (hapje rruge për shtyllat e tensionit)
11.1nproduktive0.300 km x 25,000 1ekë/km/vit =7,500 1ekë/vit (hapje rruge për shtyllat e tensionit)
**Totali nr.l : 599,372** (Peseqindë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqindë e shtatëdhjetë e dy) lekë/vit.
Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e Cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:
Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 56,500 lekë, e përbërë nga ;
1. VIera e lëndës së punimit 10 m3x 3500 lekë/m3 = 35000 lekë
2. VIera e lëndës së punimit 3 m3 x 2500 lekë/m3 = 7,500 lekë
3. Vlera e druve të zjarrit 10 $m^3$ x 500 lekë/m3 = 5,000 lekë
4. Vlera e druve të zjarrit 5 $rn^3$ x 200 lekë/m3 = 1000 lekë
5. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore, 2,000 lekë
6. Kullotja, 2,000 lekë
7. Vlera e faunes, 4,000 lekë
**Totali nr.2**: 56,500 (Pesëdhjetë e gjashtë mijë e peseqindë) lekë.

- Pagesa për vitin e parë 599,372 lekë + 56,500 lekë = 655,872 ( gjashtëqindë e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqindë e shtatëdhjetë e dy) lekë.

Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte 599,372 **lekë/vit** (Peseqindë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqindë e shtatëdhjetë e dy).

- Rezulton se periudha 18.10.2017-17.10.2022, subjekti **E. Sh.a** ka paguar detyrimet në vlerën 449,515 lekë ku në fakt duhet të paguante 2,915,917 lekë. Diferenca **2,466,402 lekë (**2,915,917 lekë - 449,515 lekë = **2,466,402 lekë)** për periudhën 18.10.2017-17.10.2022 përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa me sipër përllogaritja e kontratës së qirasë nr. .... prot, datë 18.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **E.” Sh.a** përfaqësuar nga administratori z. M. H. me afat 10 vite (18.10.2017 -17.10.2027) është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë

04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

**9. E. Sh.P.K . Për periudhën 2018 dhe 2022, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**

- Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. ... prot, datë 29.03.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **E.” Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. S. P. me afat 10 vite (29.03.2018 -28.03.2028), rezultoi se referuar nenit 4 të kontratës nr. ... prot, datë 29.03.2018 Bashkia Gramsh ka bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik si vijon:

**I. Përllogaritjet e Bashkisë Gramsh sipas raportit teknik:**

I. Pyll 0.115 km x 70,000 lekë/km/vit = 8,050 lekë/vit (ndërtim e përdorim rruge për linjën e tensionit)

2. Pyll 0.44246 km x 220,000 lekë/km/vit = 97,341.2 lekë/vit (shtrirje tubacionesh dhe ndërtim kanalesh)

3. Pyll 0.35 km x 35,000 lekë/km/vit 12,250 leke/vit (ndërtim e përdorim rruge për linjën e tensionit)

5.Pyll 0. 008125 ha x 210,000 lekë/ha/vit = 1,706.25 lekë/vit (bazament shtyllash të tensionit)

6.Pyll 0.01 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 1,760 lekë/vit (bazament shtyllash të tensionit)

7.Inproduktive 1.23201 km x 145,000 lekë/km/vit = 178,641.45 leke/vit (shtrirje tubacionesh dhe ndërtim kanalesh )

8,Kullotë 0. 01 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 1,760 lekë/vit (bazament shtyllash të tensionit)

9.Kullotë O. 04 km x 35,000 lekë/km/vit 14,000 lekë/vit (ndërtim e përdorim rruge për linjën e tensionit)

10. Djerrë 0.00125 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 178.75 lekë/vit (bazament shtyllash tensionit)

I1. Inproduktive 0.004375 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 625.625 lekë (bazament shtyllash të tensionit)

**Shuma: 316,313.275** (Treqindë e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqindë e trembëdhjetë pikë dyqindë e shtatëdhjetë e pesë) lekë/vit.

Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor,faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e Cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:

b) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 35,700 lekë, e përbërë nga :

l. Hera e lëndës së punimit 5 m3x 3,100 lekë/m3 = 15,500 lekë

2. Hera e lëndës së punimit 1 m3x 1,7001ekë/m3 = 1,700 1ekë

3. Hera e druve të zjarrit 15 m3 x 500 lekë/m3 = 7,500 lekë

4. Hera e prodhimeve të dyta pyjore 5,000 lekë

5. Kullotja 1,000 lekë

6. Hera e faunës 5,000 lekë

**Shuma: 35,700** (Tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind) lekë.

- Pagesa për vitin e parë të ndërtimit dhe operimit të Hec-it Liseci është 316,313.275 lekë + 35,700 lekë = 352,013.275 (Treqindë e pesëdhjetë e dymijë e irembëshjetë pikë dyqindë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.
- Pagesa për e dytë të ndërtimit dhe operimit të HeC-it Liseci është 316,313.275 (Treqindë e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqindë e trembëdhjetë pikë dyqindë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.
- Për vitet në vathdim do tëjetë 32,280.625 lekë (Tridhjete e dymijë e dyqindë e njëzetë e tetë pikë giashtëqindë e njëzetë e pesë) lekë/vit.

**II.Përllogaritjet e grupit të auditimit:**

Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. ... prot, datë 29.03.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **E.” Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. S. P. me afat 10 vite (29.03.2018 -28.03.2028) është konstatuar se Pagesa për vitin e dytë dhe në vijim duhet të ishte **316,313.275 lekë/vit** (Treqindë e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqindë e trembëdhjetë pikë dyqindë e shtatëdhjetë e pesë) dhe jo 32,280.625 lekë (Tridhjete e dymijë e dyqindë e njëzetë e tetë pikë giashtëqindë e njëzetë e pesë), si vijon:

I. Pyll 0.115 km x 70,000 lekë/km/vit = 8,050 lekë/vit (ndërtim e përdorim rruge për linjën e tensionit)

2. Pyll 0.44246 km x 220,000 lekë/km/vit = 97,341.2 lekë/vit (shtrirje tubacionesh dhe ndërtim kanalesh)

3. Pyll 0.35 km x 35,000 lekë/km/vit 12,250 leke/vit (ndërtim e përdorim rruge për linjën e tensionit)

5.Pyll 0. 008125 ha x 210,000 lekë/ha/vit = 1,706.25 lekë/vit (bazament shtyllash të tensionit)

6.Pyll 0.01 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 1,760 lekë/vit (bazament shtyllash të tensionit)

7.Inproduktive 1.23201 km x 145,000 lekë/km/vit = 178,641.45 leke/vit (shtrirje tubacionesh dhe ndërtim kanalesh )

8,Kullotë 0. 01 ha x 176,000 lekë/ha/vit = 1,760 lekë/vit (bazament shtyllash të tensionit)

9.Kullotë O. 04 km x 35,000 lekë/km/vit 14,000 lekë/vit (ndërtim e përdorim rruge për linjën e tensionit)

10. Djerrë 0.00125 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 178.75 lekë/vit (bazament shtyllash tensionit)

I1. Inproduktive 0.004375 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 625.625 lekë (bazament shtyllash të tensionit)

**Shuma: 316,313.275** (Treqindë e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqindë e trembëdhjetë pikë dyqindë e shtatëdhjetë e pesë) lekë/vit.

Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e Cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:

b) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 35,700 lekë, e përbërë nga :

l. Hera e lëndës së punimit 5 m3x 3,100 lekë/m3 = 15,500 lekë

2. Hera e lëndës së punimit 1 m3x 1,7001ekë/m3 = 1,700 1ekë

7. Hera e druve të zjarrit 15 m3 x 500 lekë/m3 = 7,500 lekë

8. Hera e prodhimeve të dyta pyjore 5,000 lekë

9. Kullotja 1,000 lekë

10. Hera e faunës 5,000 lekë

**Shuma: 35,700** (Tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind) lekë.

- Pagesa për vitin e parë të ndërtimit dhe operimit të Hec-it Liseci është 316,313.275 lekë + 35,700 lekë = 352,013.275 (Treqindë e pesëdhjetë e dymijë e irembëshjetë pikë dyqindë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.
- Pagesa për e dytë dhe në vazhdim të ndërtimit dhe operimit të HEC-it Liseci duhet të ishte 316,313.275 (Treqindë e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqindë e trembëdhjetë pikë dyqindë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

Rezulton se periudha 29.03.2018-28.03.2023, subjekti **E. Sh.P.K** nuk ka paguar detyrimet sipas kontratës. Diferenca **1,617,266 lekë (**352,012 + 316,313 + 316,313 + 316,313 + 316,313 = **1,617,266 lekë)**, përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa me sipër përllogaritja e kontratës së qirasë nr. ... prot, datë 29.03.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " **E.” Sh.P.K** përfaqësuar nga

administratori z. S. P. me afat 10 vite (29.03.2018 -28.03.2028) është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet"; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën "a" të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.
*Sa më sipër mbajnë përgjegjësi znj. L. D. me detyrë ish/ Kryetare e Bashkisë; z. F. L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së shërbimit Pyjor, Bujqësisë, mbrojtjes së Konsumatorit; z. B. C. me detyre Përgjegjës në Drejtorin e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit.*

**10. E. Sh.P.K . Për periudhën 2020 dhe 2022, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:**
- Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. ... prot, datë 13.02.2020 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh z. K. T. dhe qiramarrësi shoqëria "**E." Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. O. A. me afat 10 vite (13.02.2020 -12.02.2030), rezultoi se referuar nenit 4 të kontratës nr. ... prot, datë 13.02.2020, Bashkia Gramsh ka bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik si vijon:
**I. Përllogaritjet e Bashkisë Gramsh sipas raportit teknik:**
1/1. Bimësi pyjore/djerr 0.0004 ha x 143,000 lekë/ha/vit = 57.2 leke/vit, (Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj).
1/2. Bimësi pyjore/djerr 0.096 km x 145,000 lekë/km/vit = 13,920 lekë/vit, (Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, nafte, gazi, tensioni elektrik etj).
1/3. Bimësi pyjore/djerr 0.096 ha x 30,000 lekë/km/vit 2,880 lekë/vit, (Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues).
2/1 . Inproduktive 0.0004 ha x 143,000 lekë/km/vit = 57.2 lekë/vit, (Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje te tensionit, aerogjeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj).
2/2. Inproduktive 1.742 km x 145,000 lekë/km/vit 252,590 lekë/vit, (Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, gazi, tensioni elektrik etj).

2/3. Inproduktive 1.742 km x 25,000 lekë/km/ vit – 43,550 lekë/vit, (Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues).
**Shuma: 313054.4 lekë/vit** (Treqind e trembëdhjetë mijë e pesëdhjetë e katër pik katër) lekë/vit.
Kësaj vlerë i shtohet dhe vlera e materialit drusor, faunës dhe florës që rezulton nga matjet e kryera, e cila paguhet vetëm njëherë vitin e parë si më poshtë:
1. Vlera e lëndë punimi , trungishte (mes+ trashë) 2 m3 x 3,100 lekë/m3 = 6.200 lekë
2. Vlera e lëndë punimi , trungishte (hollë) 2 m3 x 1,700 lekë/m3 = 3,400 lekë
3. Vlera e druve të zjarrit ( të fortë) 10 $m^3$ x 500 lekë/m3 =5,000 lekë
4. Vlera e prodhimeve të pyjeve = 10,000 lekë
5. Kullotja = 1,500 lekë

**Shuma nr.2: 26,100** (Njëzetë e gjashtë mijë e njëqindë) lekë.

- Pagesa për vitin e parë të ndërtimit dhe Operimit të Hec Olben është 26,100 lekë + 313,054.4 lekë = 339,154.4 lekë për vitin e parë (treqindë e tridhjetë e nëntë mijë e njëqindë e pesëdhjetë e katër pik katër) lekë/vit.

Pagesa për vitin e dytë të ndërtimit dhe operimit të Hec Olben është 313,054.4 (Treqind e trembëdhjetë mijë e pesëdhjetë e katër pik katër) lekë/vit.

Për vitet në vazhdim nga Hec Olben do të jetë pagesa në shumën 46,544.4 (dyzetë e gjashtë mijë e peseqind e dyzetë e katër pik katër ) lekë/vit.

**<u>Grupit i auditimit:</u>**

Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. ... prot, datë 13.02.2020 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh z. K. T. dhe qiramarrësi shoqëria "**E.” Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. O. A. me afat 10 vite (13.02.2020 -12.02.2030) është konstatuar se Pagesa për vitin tretë dhe në vijim duhet të ishte 313,054.4 (Treqind e trembëdhjetë mijë e pesëdhjetë e katër pik katër) lekë/vit dhe jo 46,544.4 (dyzetë e gjashtë mijë e peseqind e dyzetë e katër pik katër ) lekë/vit.

Rezulton se periudha 13.02.2020-12.02.2023, subjekti **E. Sh.P.K** nuk ka paguar detyrimet sipas kontratës. Diferenca **965,263 lekë (**339,154 + 313,054 + 313,054 = **965,263 lekë)**, përfaqëson diferencën nga keqllogaritja e kontratës dhe nga mosarkëtimi i detyrimeve sipas kontratës në favor të buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa me sipër përllogaritja e kontratës së qirasë nr. ... prot, datë 13.02.2020 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh z. K. T. dhe qiramarrësi shoqëria "**E.” Sh.P.K** përfaqësuar nga administratori z. O. A. me afat 10 vite (13.02.2020 -12.02.2030) është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

*Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. K. T. me detyrë Kryetare e Bashkisë; z. F. L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së shërbimit Pyjor, Bujqësisë, mbrojtjes së Konsumatorit; z. B. C. me detyre Përgjegjës në Drejtorin e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit.*

**<u>Kriteri:</u>**

Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

**<u>Ndikimi/efekti:</u>** Keqadministrimi i sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor.

**<u>Shkaku:</u>** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**<u>Rëndësia:</u>** I Lartë.

**<u>Rekomandimi:</u>** Kryetari i Bashkisë Gramsh të analizojë sitatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e

ligjore për rishikimin e kontratave të lidhura nga Drejtoria e Pyjeve në respektim të Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 1784 prot., datë 19.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 205/4 prot., datë 24.05.2023, nga z. F. L. dhe z. B. C. në cilësinë e drejtorit dhe përgjegjësit të të drejtoris së pyjeve observacion i cili është ridërguar me shkresën nr. 2090/9 datë 07.07.2023, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 205/6 datë 12.07.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

l. Shoqëria "E." shpk me administrator ligjor z N. G. ka lidhur kontratën me nr. .... port, datë 26.10.2017 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor (dhe killlosor publik" me Bashkinë Gramsh për ndërtimin (dhe operimin e HEC-Strori me afat 10-vjeçar (05.10.2018 deri 04.10.2028) (dhe ka kryer pagesat sipas kushteve të kontratës së mësipërme.

Në lidhje me vlerën financiare të kontratës ajo është e llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064,datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006" "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" ku për vitin e parë është e llogaritur në shumën 622313 lekë (tarifa për dhënien në përdorim të fondit/pyjor dhe kullosor dhe plus vlera e materialit drusor, florës dhe faunës) ndërsa për vitet në vazhdim të kontratës pagesa është në vlerën 165,0631ekë (ndërsa shuma 266,000 lekë + 150000 lekë+ 19250 lekë= 435250 lekë për hapje kanali dhe shtrirje tubacionit nën sipërfaqe ) është hequr pasi hapja e kanalit dhe shtrirja e tubacionit nën sipërfaqe (1,5-2 m)do të bëhet vetëm për vitin e parë të punimeve kjo sipas grafikut të punimeve (pasi tubacioni mbulohet dhe rehabilitohet sipërfaqja ku është shtrirë ky tubacion), pra për vitet në vazhdim është bërë pagesa e kontratës në shumën (600313 lekë — 435250 lekë)=165063 lekë.

2. Shoqëria "I.” shpk me administrator ligjor z. P. K. ka lidhur kontratën me nr. .... port, datë 12.10.2017 ”Për dhënien në përdorim të fonolit pyjor dhe kullosor publik” me Bashkinë Gramsh për ndërtimin dhe operimin e HEC-Kamięani me afat 10-vjecar (12.10.2017 deri 11.10.2027) dhe ka kryer pagesat sipas kushteve të kontratës së mësipërme.

Në lidhje me vlerën financiare të kontratës ajo është e llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064,datë 22.12.2010 ”Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006” ”Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” ku për vitin e parë dhe të dytë është e Llogaritur në shumën 293893 lekë (tarifa për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor dhe plus vlera e materialit drusor, florës dhe faunës) ndërsa për vitet në vazhdim të kontratës pagesa është në vlerën 34181ekë, ndërsa shuma 283475 lekë për hapje kanali dhe shtrirje tubacionit nën sipërfaqe) është hequr pasi hapja e kanalit dhe shtrirja e tubacionit nën sipërfaqe (1,5-2 m) do të bëheshe për vitin e parë dhe të dytë të punimeve kjo sipas grafikut të punimeve (pasi tubacioni mbulohet dhe rehabilitohet sipërfaqa ku është shtrirë ky tubacion) dhe për vitet në vazhdim është bërë pagesa e kontratës.

3. Shoqëria "O.” shpk me administrator ligjor z. M. O. ka lidhur kontratën me nr. ... port, datë 07.11.2017 ”Për dhënien në përdorim të fonolit pyjor dhe kullosor publik” me Bashkinë Gramsh

për ndërtimin dhe operimin e HEC-Shenepremte me afat 10-vjecar (07.11.2017 deri 06.11.2027) dhe nuk ka kryer pagesat sipas kushteve të kontratës se mësipërme.
Në lidhje me vlerën financiare të kontratës ajo është e llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064,datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006" "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" ku për vitin e parë e Llogaritur në shumën 876,434 lekë (tarifa për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor dhe plus vlera e materialit drusor, florës dhe faunës) dhe për vitin e dytë është e Llogaritur në shumën 840,084 lekë( ndërsa për vitet në vazhdim të kontratës pagesa është në vënë 41,7581ekë, (ndërsa shuma 157,344 lekë + 538,032 lekë + 102,950 lekë = 798,326 lekë për hapje kanali dhe shtrirje tubacionit nën sipërfaqje ) është hequr pasi hapja e kanalit dhe shtrirja e tubacionit nën sipërfaqja (1,5-2 m) do të bëheshe për vitin e parë dhe të dytë të punimeve kjo sipas grafikut të punimeve (pasi tubacioni mbulohet dhe rehabilitohet sipërfaqe ku është shtrirë ky tubacion)dhe për vitet në vazhdim nuk është bërë pagesa e kontratës për arësye se në kontratën e lidhur midis palëve Neni 3 të tij pagesa fillon nga marrja e lejes së ndërtimit dhe fillimin e punimeve në ndërtimin dhe operimin e Hec Shenepremte.
4. Shoqëria "G. " shpk me administrator z. F. G. ka lidhur kontratën me nr. .... port, datë 07.11.2017 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor (dhe kullosor publik" me Bashkinë Gramsh për ndërtimin (dhe operimin e HEC-Babuni me afat IO-vjeçar (07.11.2017 deri 06.11.2027) (dhe nuk ka kryer pagesat sipas kushteve të kontratës së mësipërme.
Në lidhje me vlerën financiare të kontratës ajo është e llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006” "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” ku për vitin e parë e Llogaritur në shumën 504774 lekë (tarifa për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor dhe plus vlera e materialit drusor, florës dhe faunës) dhe për vitin e dytë të tretë dhe të katërt është e Llogaritur në shumën 494774 lekë ( ndërsa për vitet në vazhdim të kontratës pagesa është në vlerën 272801ekë, (ndërsa shuma '144144 lekë + 323350 lekë z: 467494 lekë për hapje kanali dhe shtrirje tubacionit nën sipërfaqje ) është hequr pasi hapja e kanalit dhe shtrirja e tubacionit nën sipërfaqja (1,5-2 m) do të bëheshe për vitin e parë dhe të dytë të punimeve kjo sipas grafikut të punimeve (pasi tubacioni mbulohet dhe rehabilitohet sipërfaqe ku është shtrirë ky tubacion)dhe për vitet në vazhdim nuk është bërë pagesa e kontratës për arësye se në kontratën e lidhur midis palëve Neni 3 të tij pagesa fillon nga marrja e lejes së ndërtimit dhe fillimin e punimeve në ndërtimin dhe operimin e Hec-Babuni.
5. Shoqëria "K.” shpk me administrator ligjor znj.L. D. ka lidhur kontratën me nr. ... port, datë 05.10.2018 ”Për dhënien në përdorim të fonolit pyjor dhe kullosor publik” me Bashkinë Gramsh për ndërtimin dhe operimin e HEC-ve Kabash dhe Porocan me afat 10-vjecar (05.10.2018 deri 04.10.2028) dhe ka kryer pagesat sipas kushteve të kontratës së mësipërme.
Në lidhje me vlerën financiare të kontratës ajo është e Llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 ”Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006” ”Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” ku për vitin e parë e Llogaritur në shumën 17878281ekë (tarifa për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor dhe plus vlera e materialit drusor, florës dhe faunës) ndërsa për vitet në vazhdim të kontratës pagesa është në vlerën 6654961ekë, (ndërsa shumat 88000 lekë + 24500 lekë + 8750 leke +900000 lekë + 16720 leke + 23808 leke + 31200 leke -1092978 lekë për hapje kanali dhe shtrirje tubacionit nën sipërfaqje ) është hequr pasi hapja e kanalit dhe shtrirja e tubacionit nën sipërfaqje (l , 5-2 m) do

të bëheshe për vitet në vazhdim të punimeve kjo sipas grafikut të punimeve (pasi tubacioni mbulohet dhe rehabilitohet sipërfaqa ku është shtrirë ky tubacion)dhe për vitet në vazhdim është bërë pagesa e kontratës.

6. Shoqëria "D.)" slipk me administrator ligjor z. E. D. ka lidhur kontratën me nr. ... port, datë 29.03.2018 "Për dhënien në përdorim të fenolit pyjor dhe kullosor publik" me Bashkinë Gramsh për ndërtimin (dhe operimin e HEC-Shirok11 me afat 10-vjeçar (05.10.2018 deri 04.10.2028) (dhe ka kryer pagesat sipas kushteve të kontratës së mësipërme.

Në lidhje me vlerën financiare të kontratës ajo është e Llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006" "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" ku për vitin e parë e Llogaritur në shumën 1349928.851ekë (tarifa për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor dhe plus vlera e materialit drusor, florës dhe faunës) ndërsapër vitin e dytë e Llogaritur në shumën 1...28.5 lekë dhe pagesa e kontratës do të bëhet me këste është në vlerën 255405.7351ekë, (ndërsa shumat 992877.6 lekë + 19976 lekë + 159966.9 lekë + 9414.85 lekë 1182235.35 lekë për hapje kanali clhe shtrirje tubacionit nën sipërfaqje ) është hequr pasi hapja e kanalit dhe shtrirja e tubacionit nën sipërfaqje (1,5-2 m) do të bëheshe për vitin e parë dhe të clytë të punimeve kjo sipas grafikut të punimeve (pasi tubacioni mbulohet dhe rehabilitohet sipërfaqa ku është shtrirë ky tubacion)dhe për vitet në vazhdim nuk është bërë pagesa e kontratës për arësye se në kontratën e lidhur midis palëve Neni 3 të tij pagesa fillon nga marrja e lejes së ndëltimit dhe fillimin e punimeve në ndërtimin dhe operimin e Hec-Shiroku.

7. Shoqëria "S." shpk me administrator ligjor z. T. K. ka lidhnr kontratën me nr.... port, datë 12.06.2017 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor (dhe kullosor publik" me Bashkinë Gramsh për ndërtimin (dhe operimin e HEC-ve Pashtrash 1 dhe 2 me afat 10 vjet (12.06.2017 deri 11.06.2017), ka kryer pagesat sipas kusllteve të kontratës së mësipërme.

Në lidhje me vlerën financiare të kontratës ajo është e llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006" "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" ku për vitin e parë e Llogaritur në shumën 1403401.61ekë (tarifa për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor dhe plus vlera e materialit drusor, florës dhe faunës) ndërsa për vitet në vazhdim të kontratës pagesa është në vlerën 23601.61ekë, (ndërsa shuma1363200 lekë për hapje kanali dhe shtrirje tubacionit nën sipërfaqje ) është hequr pasi hapja e kanalit dhe shtrirja e tubacionit nën sipërfaqje (1,5-2 m) do të bëheshe për vitin e parë të punimeve kjo sipas grafikut të punimeve (pasi tubacioni mbulohet dhe rehabilitohet sipërfaqa ku është shtrirë ky tubacion) dhe për vitet në vazhdim nuk është bërë pagesa e kontratës.

8. Shoqëria "E." shpk me administrator ligjor z,.M. H. ka lidhur kontratën me nr. .... port, datë 18.10.2018 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" me Bashkinë Gramsh për ndërtimin (dhe operimin e HEC-Mivas me afat 10-vjeçar (18.10.2018 deri 07.10.2028) dhe ka kryer pagesat sipas kushteve të kontratës së mësipërme.

Në lidhje me vlerën financiare të kontratës ajo është e llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006" "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" ku për vitin e parë e Llogaritur në shumën 5993721ekë (tarifa për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor dhe plus vlera e materialit drusor, florës clhe faunës) ndërsa për vitet në vazhdim të kontratës pagesa është në vlerën 854621ekë, (ndërsa shumat96240 lekë + 16720 lekë + 400950 lekë =5139101ekë për

hapje kanali dhe shtrirje tubacionit nën sipërfaqje ) është hequr pasi hapja e kanalit dhe shtrirja e tubacionit nën sipërfaqje (1,5-2 m) do të bëheshe për vitin e parë të punimeve kjo sipas grafikut të punimeve (pasi tubacioni mbulohet dhe rehabilitohet sipërfaqa ku është shtrirë ky tubacion)dhe për vitet në vazhdim është bërë pagesa e kontratës.

9. Shoqëria "E.” slipk me administrator ligjor z.S. P. ka lidhur kontratën me nr. ... port, datë 29.03.2018 ”Për dhënien llë përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” me Bashkinë Gramsh për ndërtimin dhe operimin e HEC-S. me afat 10-vjecar (29.03.2018 deri 28.03.2028) dhe nuk ka kryer pagesat sipas kushteve të kontratës së mësipërme.

Në lidhje me vlerën financiare të kontratës ajo është e llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006” "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” ku për vitin e parë e Llogaritur në shumën 352013.275 lekë (tarifa për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor dhe plus vlera e materialit drusor, florës dhe faunës) për vitin e dytë e Llogaritur në shumën 316313.275 lekë ndërsa për vitet në vazhdim të kontratës pagesa është në vlerën 32280.2751ekë, (ndërsa shumat 97341.2 lekë + 178641.45 lekë + 8050 lekë 284032.65 lekë për hapje kanali dhe shtrirje tubacionit nën sipërfaqja ) është hequr pasi hapja e kanalit dhe shtrirja e tubacionit nën sipërfaqeje (1,5-2 m) do të bëheshe për vitin e parë dhe të dytë të punimeve kjo sipas grafikut të punimeve (pasi tubacioni mbulohet dhe rehabilitohet sipërfaqja ku është shtrirë ky tubacion)dhe për vitet në vazhdim nuk është bërë pagesa e kontratës për arësye se në kontratën e lidhur midis palëve Neni 3 të tij pagesa fillon nga marrja e lejes së ndërtimit dhe fillimin e punimeve në ndërtimin dhe operimin e Hec-Lisec.

10. Shoqëria "E.” slipk me administrator ligjor z„ O. A. ka lidhur kontratën me nr.... port, datë 13.02.2020 ”Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” me Bashkinë Gramsh për ndërtimin dhe operimin e HEC Olben me afat 10-vjeçar (13.02.2020 deri 12.02.2030) dhe nuk ka kryer pagesat sipas kushteve të kontratës të mësipërme.

Në lidhje me vlerën financiare të kontratës ajo është e llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.391, datë 21.06.2006" "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" ku për vitin e parë e llogaritur në shumën 339154.41ekë (tarifa për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor dhe plus vlera e materialit drusor, florës dhe faunës) për vitin e dytë e llogaritur në shumën 313054.4 lekë ndërsa për vitet në vazhdim të kontratës pagesa është në vlerën 46544.41ekë, (ndërsa shumat 13920 lekë + 252590 lekë = 266510 lekë për hapje kanali dhe shtrirje tubacionit nën sipërfaqje ) është hequr pasi hapja e kanalit dhe shtrirja e tubacionit nën sipërfaqje (1,5-2 m) do të bëheshe për vitin e parë dhe të dytë të punimeve kjo sipas grafikut të punimeve (pasi tubacioni mbulohet dhe rehabilitohet sipërfaqa ku është shtrirë ky tubacion)dhe për vitet në vazhdim nuk është bërë pagesa e kontratës për arësye se në kontratën e lidhur midis palëve Neni 3 clhe Neni 5 (pika 5.2) të tij, pagesa fillon nga marrja e lejes së ndërtimit dhe fillimin e punimeve në ndërtimin dhe operimin e Hec-Olben.

Sa më sipër kontratat lidhja e kontratës midis palëve është bërë në zbatim të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” i ndryshuar, nenit 19 të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor” i ndryshuar, si dhe të nenit 801 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, ”Për kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit,

he aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkive" i ndryshuar të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM-në nr. 391, datë 21.06.2006" "Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.01, datë 9.06.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".
*Lidhur me kontratat për të cilat është parashikuar që pagesa e kontratës do të bëhet pas marrjes së lejes së ndëltimit, nga ana e bashkisë Gramsh do të hartohet amendament i kontratës për ndryshimin e Nenit 3 dhe Nenit 5 (pika 5.2) të tyre, si dhe do ti dërgohet subjekteve njoftimi i vlerësimit për pagesën e vlerës së qirasë që nga moment i lidhjes së kontratave respektive.*
**Qëndrimi i grupit të auditimit.**
Sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj nuk do të merren në konsideratë pasi:
**Së pari** Lidhja e kontratës midis palëve është bërë në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.
**Së dyti** Referuar materialit të sipërcituar të kontratave (pika 5) është bërë ulja e kontratës pa u mbështetur në dokumente justifikues. Çka do të thotë bashkia duhet të marri në dorëzim sipërfaqet e rehabilituara me procesverbalet përkatëse si dhe dokumentet e tjera mbështetës pastaj të bëhet ulja e vlerës sipas pikës 7 dhe 9 të aneksit nr. 6 e udhëzimit nr. Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik;
**Së treti** Referuar nenit 3 të kontratave të lidhura midis palëve bie në kundërshtim me pikën 20 të Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik ku citohet: “*Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitet pasardhëse”.*

- ***Subjektet që ushtrojnë aktivitet në Fond Pyjor dhe kullosor të cilët janë pajisur me leje nga ministria, por nuk kanë nënshkruar kontrat me Bashkinë Gramsh.***

***Titulli i gjetjes:*** *Bashkia Gramsh nuk ka vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi.*

**Situata:**
Grupi i auditimit bëri kërkesë për kontratat e qirave të fondit pyjor/kullosor lidhur me subjekte të cilat ushtrojnë aktivitetin në sektorin e burimeve minerare në Bashkinë Gramsh dhe NJA.
Nga të dhënat e siguruara nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Qendrës Kombëtare të Biznesit,

rezulton se përgjatë periudhës 2021-2022, në territorin e Bashkisë Gramsh, kanë ushtruar aktivitet në në fushën e energjitikës 4 subjekte, për të cilat *Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit* Bashkia Gramsh nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj), sipas tabelës vijuese. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin kullosor", pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 "Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor"

| Nr. | Qarku | HEC-i | Shoqeria Koncesionare | Nr I Heceve | Forma e kontrates |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Elbasan, Berat | Lenie, Çorovodë | "E." sh.p.k | 2 | BOT |
| 71 | Elbasan | Sotire 1, Sotire 2 | H.shpk | 2 | BOT |
| 86 | Elbasan | **Kaskada Devoll:** Moglice, Kokelit, Banje | "D." ShA | 3 | BOT |
| 171 | Elbasan | Kukur 3, Kukur 4 | K. | 2 | BOT |

Burimi: Faqe zyrtare e AKBN

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

*z. F. L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit; z. B. C. me detyre Përgjegjës në Drejtorin e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit*

**Kriteri:**

Nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin kullosor", pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 "Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor".

**Impakti:** Nuk jep siguri të mjaftueshme për përmbushjen dhe zbatimin e ligjit për funksionin dhe detyrat që ka.

**Shkaku:** Nga neglizhenca dhe nga mos këmbëngulja në zbatimin e ligjit, për mos mbledhjen dhe arkëtimin e kësaj tarife.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Drejtorisë së shërbimit Pyjor t'i kërkojë informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me qëllim evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

**3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet.**

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese "Aparati i Bashkisë Gramsh" për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Elbasan si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Gramsh për vitin 2022 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Bashkia Gramsh pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Elbasan për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr. 1292 prot.datë 29.03.2023 konfirmuar nga Dega e Thesarit Elbasan me shkresën nr. 70 prot datë 29.03.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Gramsh dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:
- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel".
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, permban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financaiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.
Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.**
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

**Totali i Aktivit** për vitin 2021 është në vlerën **3,067,669,554 lekë** dhe për vitin 2022 është **2,654,837,069 lekë** , i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari, sipas Aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**A. AKTIVE AFATSHKURTRA.**

**Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”** në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 135,837,799 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 114,261,352 lekë**,** të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “ Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte” .

- ***Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”*** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 135,837,799 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 114,261,352 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, por nuk rakordon me rubrikën analoge “Tepricën e likujditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr.3 “Pasqyrë e flukseve monetare viti 2022” të paraqitur në tabelën sipas aneksit nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- ***Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”*** sipas bilancit në mbyllje të në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën **114,261,352** lekë, e cila rakordon me gjendjen në rubrikën analoge “Tepricën e likujditeteve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën **114,261,352** lekë në Formatin nr.3 “Pasqyrë e flukseve monetare viti 2022” në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues”** të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **40,461,352 lekë** dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **40,768,606 lekë**, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej **307,254 lekë** rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive: si vijon:

| Emertimi | Gjendja në SIFQ | Shtesa 2022 | Pakësime 2022 | Gjendja më 31.12.2022 |
|---|---|---|---|---|
| 3110100 Materiale të para (Pjesë këmbimi) | - | 11,534,441 | 11,247,161 | 287,280 |
| 3120100 Materiale të përgjithshme zyre | 3,548,422 | 18,146,729 | 14,489,836 | 7,205,315 |
| 3121100 Materiale speciale (Ushqime ) | 6,852 | 3,754,443 | 3,684,010 | 77,285 |
| 3122100 Lënde djegëse të ngjashme | 4,565,232 | 24,684,660 | 25,761,518 | 3,488,374 |
| 3210100 Objekte inventari | - | - | - | - |
| 3272100 Objekte inventari | 32,323,676 | 1,052,700 | 3,683,195 | 29,693,182 |
| 3500100 Mallra | 17,170 | - | - | 17,170 |
| **Totali** | **40,461,352** | **59,172,973** | **58,865,720** | **40,768,606** |

***Burimi:*** *Drejtoria e financës*

- ***Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”*** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 8,120,506 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 11,058,254 lekë, me një diferencë në ritje për vitin ushtrimor prej 2,937,748 lekë, e cila përfaqëson shtesat e gjendjes së mallrave në fund të vitit 2022 e analizuar

- ***Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”*** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 32,323,676 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 29,693,182 lekë me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 2,630,494 lekë, e cila përfaqëson nxjerrjen jashtë përdorimit të inventarit te imët për vitin 2022, e analizuar si me sipër.

**Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme”** paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 71,715,470 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 86,...,069 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar

me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i mos kryerjes se pagesave ndaj kreditoreve të ndryshëm në lidhje me investimet dhe shërbimet e ndryshme.

***- Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm",*** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 51,285,998 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 49,561,257 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një ulje prej 1,724,741 lekë e cila vjenë si rezultat i pagesës së debitorve të qirave, etj. Analiza e gjendjes së llog. 468"Debitorë të ndryshëm "dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në forëm tabele në aneksin nr. 3 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**Titulli gjetjes:** Mos kontabilizimi i vlerës debitore të subjekteve private dhe familiar, për mos pagimin e taksave dhe tarifave vendore në vlerën prej 66,577 mijë lekë.

**Situata:** Nga analiza e llog. 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore për 13,495 subjekte familiar dhe biznesi në vlerën **66,577 mijë lekë**, *nga e cila:* subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 28,247 mijë lekë për 542 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 38,330 mijë lekë për 13,495 abonent, për taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 71,441 lekë, subjektet që ushtrojnë aktivitet të pajisur me autorizim/ licencë të lëshuar në vlerën 4,800,000 lekë, të akumuluara në fund të vitit ushtrimor 2022, vlerë e cila nuk është kontabilizuar.
**Kriteri:** Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22**.**
**Ndikimi:** Mos funksionimi i këtyre llogarive sipas parimeve kontabël të pranuara, përbën risk lidhur me saktësinë e aktiveve të bilancit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat e lindura të konstatuara, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.
**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.
**Rëndësia**: E lartë
**Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog.468 "debitorë të ndryshëm", në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

***-Gjendja e llogarisë* 4342 "Operacione me shtetin, të drejta"** (debitorë) më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 36,686,812 lekë. Nga analiza e llogarisë **4342** "Operacione me shtetin, të drejta**"** për vitin 2022 është e analizuar si vijon:

| NR. | EMERTIMI | Gjendje 31.12.2022 e llog 4342 |
|---|---|---|
| 1 | Paga Personeli llogaria 42 | 16,511,255 |
| 2 | Tatim page tatim në burim llogaria 431 | 1,197,928 |
| 3 | Sigurimet Shoqërore llogaria 435 | 5,152,330 |
| 4 | Sigurime Shëndetësore llogaria 436 | 706,196 |
| 5 | Furnitorëllogaria.401-408 | 13,119,103 |
| | **Shuma** | 36,686,812 |

Nga analiza e llogarisë 4342 **"Operacione me shtetin, të drejta" dhe vlerës të pasqyruara në 5 (pesë) llogarive pasive,** pra në vitin 2022 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e

pasqyrave të pozicionit financiar, në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

## II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

**Auditimi i aktiveve afatgjata materiale**

***Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale***, janë që të sigurohemi se:
Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

***2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve***:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

***3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:***

**a.** Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave te UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 5 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

**b.** Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 **“Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,757,943,278 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,399,774,285 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto

historike)”paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,399,774,285 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

**Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale”** që përbëhet nga**:**

**- Gjendja e llogarisë 202 *“Studime dhe kërkime”*** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën prej 28,715,741 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,091,757 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 13,091,757 lekë, ku diferenca në ulje prej 15,623,984 lekë i përket lëvizjeve të aktiveve si dhe vlerës së amortizimit .Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon:

| Nr | Viti I krjimit ose blerjes projektit | Emertimi Projektit | sasia | Vlera Fillestare | Shtesa vjetore 2022 | Totali Amortiz | Vlera e Mbetur |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2015 | Projekti Shkolles Kabash | 1 | 160,000 | - | 90,456 | 69,544 |
| 2 | 2015 | Projekti Shkolles Lleshaj | 1 | 160,000 | - | 90,456 | 69,544 |
| 3 | 2018 | Projekti rruges Sotire | 1 | 5,352,000 | - | 2,558,223 | 2,793,777 |
| 4 | 2018 | Projekti Rruges Lubinje | 1 | 1,536,000 | - | 734,198 | 801,802 |
| 5 | 2018 | Projekti rruges Q.Duzhes - Tunje | 1 | 1,950,000 | - | 932,088 | 1,017,912 |
| 6 | 2018 | Projekti ne toskollare | 1 | 2,154,000 | - | 1,029,599 | 1,124,401 |
| 7 | 2019 | Projekti rruges Bulçar - Lenie | 1 | 4,644,000 | - | 2,219,803 | 2,424,197 |
| 8 | 2022 | Projekt Lagja "Pishaj" | 1 | | 825,000 | 123,750 | 701,250 |
| 9 | 2022 | Projekt Ujesjellist Kerpic | 1 | | 2,000,000 | 300,000 | 1,700,000 |
| 10 | 2022 | Projekt rikonst.L."Holta" | 1 | | 1,680,000 | 252,000 | 1,428,000 |
| 11 | 2022 | Projekt rikonst.L."Sporit nr.2" | 1 | | 1,130,976 | 169,646 | 961,330 |
| | | | | 15,956,000 | 5,635,976 | 8,500,218 | 13,091,758 |

***Burimi: Drejtoria e financës***

Referuar tabelës vlera prej 13,091,757 lekë i përket 11 Studime dhe projektime. Vlerat e tjera te studimeve dhe projektimeve ne vitet e mëpareshme kane kaluar në vlerat e objekteve në vitin 2022.

*U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2021*.

**Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale”** paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 2,399,774,285 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,399,774,285 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- ***Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”*** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 50,742,734 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në të njëjtën vlerë prej 50,742,734 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuara sipas vlerës kontabël.

***Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”*** paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 11,217,186 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 11,217,186 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuara sipas vlerës kontabël si vijon:

| Nr | Emertimi Projektit | sasia | Vlera Fillestare | Vlera Mbetur | Totali Amortiz | Vlera e Mbetur |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Njesia Adminitrative Pishaj | 1 | 4,428,960 | 4,428,960 | - | 4,428,960 |
| 2 | Njesia Adminitrative Kodovjat | 1 | 3,665,572 | 3,665,572 | - | 3,665,572 |
| 3 | Njesia Administrative Kukur | 1 | 480,000 | 480,000 | - | 480,000 |
| 4 | Njesia Administrative Tunje | 1 | 479,120 | 479,120 | - | 479,120 |
| 5 | Njesia Administrative Sult | 1 | 479,900 | 479,900 | - | 479,900 |
| 6 | Njesia Administrative Skenderbegas | 1 | 394,800 | 394,800 | - | 394,800 |
| 7 | Njesia Administrative Poroçan | | 479,000 | 479,000 | - | 479,000 |
| 9 | Njesia Administrative Lenie | | 399,834 | 399,834 | - | 399,834 |
| 10 | Shtuar nga Studime Projektime Nj.A.Sult | | 410,000 | 410,000 | - | 410,000 |
| | | | 11,217,186 | 11,217,186 | - | 11,217,186 |

***Burimi: Drejtoria e financës***

***- Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”*** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 597,751,493 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 602,617,781 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( vlera neto)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 597,751,493 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 602,617,781 lekë. Pra kemi ritje në vlerën 4,866,288 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në menyrë kontabël sipas aneksit nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

***- Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”*** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,012,986,954 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,649,095,869 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlerën neto)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,012,986,954 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,649,095,869 lekë. Gjatë vitit 2021 janë bërë shtesat në vlerën 748,337,568 leke, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj si dhe janë transferuar Ndermarjes së Ujsjells Kanalizimet Gramsh Sh.A vlera neto 474,506,278 lekë sipas tabelës vijuese. Amortizimi për vitin 2022 është llogaritur 709,945,140 leke. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqitet sipas aneksit nr. 5 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

***- Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”*** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,068,030 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën 7,887,588 lekë e cila është e analizuar sipas vlerës kontabël.

***- Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”*** në vlerën neto paraqite në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 36,685,433 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 31,104,909 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 86,938,009 lekë, vlera e amortizimit të akumuluar është 55,833,188 leke. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2021 deri në fund të vitit 2022 paraqitet sipas aneksit nr. 6 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**Titulli i gjetjes:** Kontabilizimi i gabuar i llogarisë 215 në mbyllje të vitit ushtrimor 2022

**<u>Situata:</u>** Me urdhërin nr. 254 datë 26/11/2021 është ngritur komisioni për verifikimin dhe vlerësimin të gjendjes tekniko financiare të automjeteve të Bashkisë Gramsh. Me shkresën 3817/1 prot datë 20/09/2022 është përgatitur relacioni mbi vlerësimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të automjeteve në pronësi të Bashkisë Gramsh ku janë evidentuar 27 mjete të dëmtuara me kosto historike 36,550,319 lekë dhe vlerë neto 4,359,312 lekë sipas procesverbaleve përkatëse. Me vendimit nr. 76 datë 30.09.2022 "Për miratimin e raportit të vlerësimit të aktiveve për nxhjerjen e tyre jashtë përdorimi të Bashkisë Gramsh për vitin 2022" konfirmuar nga prefekti është miratuar procesi i vlersimit të aktiveve për jashtë përdorimit sipas procesverbaleve të mbajtura për vitin 2022 për 27 mjete në vlerën historike 36,660,319 lekë. 327 datë 27/10/2022 për tjetërsimin, nxjerrjen nga përdorimi të automjeteve të dala jashtë përdorimit sipas VKB nr 76 datë 30.09.2022.
Sa më sipër rezulton se Drejtoria e Financës ka shkarkuar nga bilanci mjetet e nxjerra jashtë përdorimit me vlerë historike 36,660,319 lekë pa përfunduar me pare i gjithë procesi i shitjes me procedur ankandi.
Për këto mjete, nëpunësi zbatues nuk ka ndjekur procesin dhe nuk ka bërë veprimet e duhura përmbyllëse, pasi ka hequr përfundimisht nga kontabiliteti aktivet e mësipërme në vlerën 36,660,319 lekë, duke i çregjistruar nga llogaria 215 "Mjete transporti", duke mos bërë regjistrimin e aktiveve, si të pa përdorshme, në llogarinë përkatëse në kontabilitet, duke humbur kështu gjurmën e auditimit.
**<u>Kriteri:</u>** Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 3 -Përkufizime, pika 1,2, neni 7 - Dokumenti kontabël, neni 11 – Qëllimi i pasqyrave financiare, neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve; UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar". Nenin 109 dhe 110 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 12-Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues, dhe udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007. Kriteri: Neni 109 dhe 110 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 12-Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues, dhe udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007.
**<u>Ndikimi/Efekti:</u>** Deformim i vlerës së aktiveve të llogarisë 215 në pasqyrat financiare, për shkak se kjo vlerë nuk mbështetet në vlerën e inventarizimit t aktiveve.
**<u>Rëndësia:</u>** E lartë.
**<u>Rekomandimi:</u>**
Drejtoria e Financës (sektori i kontabilitetit), të marrë masa që vlera 27 mjeteve të transportit me vlerë 36,660,319 lekë të pa shitura me procedurë ankandi, por të zbritur padrejtësisht nga aktivet, të kryhet veprimi kontabël për regjistrimin e tyre në kontabilitet, duke i ngarkuar përsëri për vlerën e tyre deri në përfundim të procesit të shitjes.

***- Gjendja e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik"*** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 45,491,448 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 47,108,218 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 153,271,565 lekë. Ndërsa vlera e amortizimit e përllogaritur është në shumën 106,163,347 lekë.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)" të PF si më poshtë:

Në lekë

| Nr. Rrjeshti | Nr. Reference Llogarije | EMERTIMI | Teprica ne fillim | | | Shtesat gjate vitit | | Paksimet gjate vitit | | Teprica ne Fund | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Kosto Historike | Amortizim Akumuluar | Teprica Neto | Kosto Historike | Amortizim | Kosto Historike | Amortizim | Kosto Historike | Amortizim Akumuluar | Teprica Neto |
| a | b | c | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 1 | 20 | **I. AAGJ/JO MATERIALE** | **39,493,675** | **10,777,934** | **28,715,741** | **5,635,976** | **2,310,310** | **23,537,675** | **4,588,025** | **21,591,976** | **8,500,219** | **13,091,757** |
| 2 | 201 | Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave | | | 0 | | | | | 0 | 0 | 0 |
| 3 | 202 | Studime dhe kerkime | 39,493,675 | 10,777,934 | 28,715,741 | 5,635,976 | 2,310,310 | 23,537,675 | 4,588,025 | 21,591,976 | 8,500,219 | 13,091,757 |
| 4 | 203 | Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme | | | 0 | | | | | 0 | 0 | 0 |
| 5 | 21- 28 | **II. AAGJ/ MATERIALE** | **3,897,837,613** | **1,139,894,335** | **2,757,943,278** | **256,452,906** | **153,614,021** | **579,797,393** | **118,789,515** | **3,574,493,126** | **1,174,718,841** | **2,399,774,285** |
| 6 | 210 | Toka,troje,Terene | 50,742,734 | 0 | 50,742,734 | 0 | 0 | | 0 | 50,742,734 | 0 | 50,742,734 |
| 7 | 211 | Pyje,Kullota Plantacione | 11,217,186 | 0 | 11,217,186 | 0 | 0 | 0 | 0 | 11,217,186 | 0 | 11,217,186 |
| 8 | 212 | Ndertime e Konstruksione | 857,285,793 | 259,534,300 | 597,751,493 | 35,077,761 | 30,267,321 | 0 | 55,848 | 892,363,554 | 289,745,773 | 602,617,781 |
| 9 | 213 | Rruge,rrjete,vepra ujore | 2,698,018,686 | 685,031,732 | 2,012,986,954 | 194,569,557 | 102,932,398 | 533,547,234 | 78,018,990 | 2,359,041,009 | 709,945,140 | 1,649,095,869 |
| 10 | 214 | Instalime teknike,makineri,paisje,v | 14,382,039 | 11,314,009 | 3,068,030 | 6,943,259 | 2,062,752 | 406,317 | 345,368 | 20,918,981 | 13,031,393 | 7,887,588 |
| 11 | 215 | Mjete transporti | 116,150,560 | 79,465,127 | 36,685,433 | 7,337,856 | 8,559,070 | 36,550,319 | 32,191,009 | 86,938,097 | 55,833,188 | 31,104,909 |
| 12 | 216 | Rezerva shtetrore | | | 0 | | | | | 0 | 0 | 0 |
| 13 | 217 | Kafshe pune e prodhimi | | | 0 | | | | | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 218 | Inventar ekonomik | 150,040,615 | 104,549,167 | 45,491,448 | 12,524,473 | 9,792,480 | 9,293,523 | 8,178,300 | 153,271,565 | 106,163,347 | 47,108,218 |
| 15 | 24 | Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara | | | 0 | | | | | 0 | 0 | 0 |
| 16 | 28 | Caktime | | | 0 | | | | | 0 | 0 | 0 |
| 17 | | **T O T A L I ( I + II )** | **3,937,331,288** | **1,150,672,269** | **2,786,659,019** | **262,088,882** | **155,924,331** | **603,335,068** | **123,377,540** | **3,596,085,102** | **1,183,219,060** | **2,412,866,042** |

***Testi substancial i amortizimit***

Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”pika 36. Përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje të periudhes ushtrimore për aktiv sipas klasifikmit.

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 6 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 0 lekë dhe më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 693,000 lekë që i përket kontabilizimit të aksioneve të Sh.A Ujsjellës Kanalizime Gramsh.

- **Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:**

**Pasivet afatshkurtra.** Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **146,511,119** lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **118,790,646** lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

**- *Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”*** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,119,103 lekë. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 50 fatura të palikujduara për mallra dhe shërbime. Ky borxh është krijuar nga viti 2021 deri në dhjetor të vitit 2022 sipas bilancit, në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 7 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**- *Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”*** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 16,511,255 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2023.

**- *Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”*** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 1,197,928 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

***- Gjendja e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore"*** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 5,152,330 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

**- *Gjendja e llogarisë* 436** "*Sigurime shëndetësore*" në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 706,196 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

**- Gjendja e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*"** përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 41,799,735 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 32,542,577 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në Degën e Thesarit Elbasan në mënyrë analitike paraqitet në aneksin nr. 8 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit

<u>**Titulli gjetjes:**</u> *Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje".*

<u>**Situata:**</u>
Nga analiza e lloharise 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje", më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 41,79,735 lekë, më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 32,542,570 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme.
Nga analiza të llogarië, **konstatohet se:**
- Për vitin 2022 Drejtoria e Fnancës ka të dokumentuar ngurtësimet gjatë vitit 2022 në vlerën 32,542,570 lekë për 47 subjekte. Gjatë vitit 2022 shesta janë në vlerën 3,738,931 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 12,996,096 lekë për 7 subjekte. Sipas akt rakordimeve midis Bashkisë dhe Degës së Thesarit.
- Për 32 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 29,116,786 lekë, *sipas pasqyrës së sipërcituar*, nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, <u>nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve</u>, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet e mosveprimet në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar* Kap. III, pikat 30, 50.

| |
|---|
| *pika 30."Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme <u>kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera,</u> konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe <u>saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve.</u> Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet".*<br>*Pika 50. "Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)".* |

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

| |
|---|
| *Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.* |

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me* z. E. H. me detyrë Përgjegjës i Buxheti si dhe z. A. S. me detyrë Drejtor Finance si person i ngarkuar për ndjekjes dhe çlirimin e garancive.

**Kriteri:**
Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: *UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 Kap. III, pikat 30, 50.*
**Ndikimi/Efekti:**
Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje".
**Shkaku:**
Mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar*
**Rëndësia: E lartë**
**Rekomandimi:**
-Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**Analizë e llogarive** sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të paqyruara në Formatin nr.2 "Pasqyra e përformancës financiare" të PF të vitit 2022 paraqitet në aneksin nr. 9 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit

**Analiza e llogarive të të ardhurave** për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën **949,105,696 lekë,** si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Elbasan paraqitet më poshtë:
Gjendja e llogarisë sintetike ***70* "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 56,241,166 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
a. Gjendja e llogarisë analitike ***7002* "*Tatim mbi Biznesin e vogël*"** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 102,668 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël* , e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
b. Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 8,992,741 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
c. Gjendja e llogarisë ***7029 "Të tjera tatime mbi Pasurine"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 607,730 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

d. Gjendja e llogarisë ***7033 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 8,108,967 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.
e. Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 38,380,259 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë ***71*** **"Të ardhurat jo tatimore"** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 25,627,648 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë ***7109*** "***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia"*** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 18,018,303 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
b. Gjendja e llogarisë ***711*** "***Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare"*** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 7,413,335 lekë, e cila përfshin tarifat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

**Analiza e llogarive të shpenzimeve** në vitin 2022 , të cilat në total janë në vlerën **867,386,921** lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë ***600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"*** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën **215,884,588 lekë** lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën **215,884,588** lekë diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë ***601 'Kontribute për sigurime"*** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën **36,476,104** lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën **36,476,104** lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë ***602 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **145,029,473** lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën **145,029,473** lekë , diferenca nuk ka.

**-** Gjendja e llogarisë së fondeve ***604 "Transferime korente te brendshme"*** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **8,177,380** lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

**-** Gjendja e llogarisë së fondeve ***606 "Transferime per Buxhetet familjare e Individe"*** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **462,126,630** lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

**Per vitin 2022** totali i te ardhurave ne vlere është **949,105,696** lekë dhe totali shpenzimeve eshte **867,386,921** lekë. Diferenca e tyre në vlerën **81,718,775** lekë rakordon me gjendjen e llog.85 "Rezultatin e ushtrimit".

Gjithashtu gjendja e llogarisë ***63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën -307,254 lekë .

**B - Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Gramsh).**

***-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”***

**Për vitin 2022** numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr.140 datë 29.12.2021 Miratuar në total numri 361 . Në administratën e Bashkisë dhe njësitë e saj, punonjës me kontrate dhe sezonal 4 , punonjësit të QKB= 2 dhe Gjendjes Civile = 6 punonjës gjithsej, si dhe 7 punonjës të Qendrës me Aftësi të Kufizuar (Qendra Lule Dielli ), ku vetëm njëra prej tyre paguhet nga fondi i Bashkisë, janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 361 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Gramsh është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2021 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. A. S. deri më datë 31.12.2022 dhe nga Kryetari i Bashkisë .

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës z. A. S. dhe nga Kryetari Bashkisë z. K. T.

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Sekretari i përgjithshëm Z. A. S. , Drejtor i Arsimit dhe drejtorët përkatës të sektorëve.

**B. 2 - Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2022.**

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2022) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të hartuara nga Burimet Njerëzore dhe të nënshkruara nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryetari i Bashkisë është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Gramsh, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Gramsh, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2022) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. A. S. , nga Kryetari Bashkisë z. K. T.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës z. A. S. dhe nga Kryetari Bashkisë z. K. T..

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Sekretari i Përgjithshëm Z A. S. dhe nga Drejtoret e Sektorëve.

Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, janë bërë ndalesa edhe për debitorët të përcaktuar në Urdhrat përkatës. (Te vendosura nga Përmbarimi apo palë të tjera.)

Bashkisë Gramsh janë kryer këto ndalesa: Urdhër i brendshëm nr. 244 datë 31.08.2022 “Për ndalesa në pagë”.

Paraqitja në formë tabelë e burimit të Financimit.

Në lekë

| **Periudha** | **Plan** | **Fakt** | **%** | **Burimi i financimit** | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Trans. e Pakush.** | **Të ardhura** | **Trans. e Kushtëzuar** | **Transfertë specifike** |
| Viti 2022 | 214,894,626 | 213,293,432 | 99.25% | | | | |

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë në lekë

| Nr. | Emërtimi | VITI 2022 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Plani | Fakti | % |
| 1 | F. Pagave | 214,894,626 | 213,293,432 | 99.25 |
| 2 | F. Sig. Shoq | 36,900,069 | 35,885,623 | 97.25 |
| 3 | F. Veçantë | 11,318,223 | 11,318,223 | 100 |

*Veprimet nëpërmjet magazinës*

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara.

- Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

**Titulli gjetjes:** *Mungesa e regjistrit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Gramsh.*

**Situata:**

Për vitin 2022 struktura organizative është miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Gramsh nr. 140 datë, 29/12/20221 ku dhe është krijuar struktura e menaxhimit të aseteve me emërtimin "Sektori Juridik dhe Menaxhimit të Aseteve Vendore" Referuar VKM –së nr.28., datë, 27.01.2023 Bashkia Gramsh është në process së krijimit të komisionit në zbatim të VKM së sipërcituar pasi kërkohet dhe një person nga ASHK-ja në krijimin e komisionit. Me shkresën nr. 423 prot., date 06.02.2023 i është drejtuar ASHK-së për përcaktimin e personit përgjegjës për bashkëpunim dhe me pasë krijimin e strukturës se posaçme për vazhdimin e proçedurave sipas ligjit. Përsa i përket Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë është kryer procesi i regjistrimit të tyre, ndërsa pesa i përket Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nga AITPP-ja, nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

**Bashkia Gramsh**,

Me VKM-në Nr. 431 , datë , 11/07/2007 "Për miratimin e listës përrfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shteterore që transferohen në pronesi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh, të Qarkut Elbasan", i është miratuar lista inventarit me në total 499 prona.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 29, datë 13.07.2004, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e

Bashkisë Gramsh. Kjo listë fillon me numër rendor 1 (një) dhe mbaron me nr.rendor 499 (katerqinde e nentedhjet e nente ) dhe përbëhet me 80 (tetedhjete) fletë i ndryshuar me;

- VKM nr.1321 date 01.10.2008 Bashkisë Gramsh i janë transferuar 1 prone sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.
- VKM nr. 885,datë 03.11.2010 Bashkisë Gramsh i janë transferuar 3 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej një flet.
- VKM nr.58 date. 27.01.2016 Bashkisë Gramsh i janë transferuar 5 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej dy flet.

VKM nr.629 date. 27.10.2021 Bashkisë Gramsh i janë transferuar 5 prona sipas lista së inventarit bashklidhur, gjithsej dy flet.

Bashkia Gramsh ka kryer proçesin e regjistrimit te pasurive te transferuara ne Agjencine Shteterore te Kadastres (Zyra Vendore Gramsh), e cila eshte asistuar nga Projekti USAID per Qeverisjen Vendore .

Pergatitja e dosjeve individuale tekniko-ligjore për pronat nga Kompania Shqiptare "L." shpk Tiranë , e kontraktuar për kryerjen e këtij shërbimi. Gjithashtu është krijuar një katalog elektreonik dhe i printuar të pronave vendore, sistemi GIS i pronave vendore, një baze të dhenash elektronike që mundëson regjistrimin elekrtonik dhe gjenerimin mbi të gjitha të dhenat që lidhen me Asetet Vendore .

Në tabelat me poshte jepet një permbledhje e klasifikimit të pronave të bashkise sipas fushes se perdorimit të pronave si dhe statuesi i regjistrimit në ASHK si vijon;

| Nr | Emërtimi i Pronave | Nr.transferimit | Totali | Statuesi transferimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Objekte + Terrene ,Sportive | 59 | 59 | Në pronësi |
| 2 | Vendstrehime | 11 | 11 | Në pronësi |
| 3 | Sherbime publike dhe ndricimi | 4 | 4 | Në pronësi |
| 4 | Infrastrukture | 64 | 64 | Në pronësi |
| 5 | Troje dhe hapsira publike | 106 | 106 | Në përdorim |
| 6 | Troje te lira | 127 | 127 | Në përdorim |
| 7 | Objekte te transferuara per njesin e qeverisjes vendore | 6 | 18 | Në pronësi |
| | | Totali | 389 | |

**1.Ish Komunës Skenderbega sot Njësia Administrative Skënderbegas Bashkia Gramsh**

Me VKM nr.15, datë , 12.01.2011 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Skenderbegas, të Qarkut Elbasan ", i është miratuar lista inventarit me **903 prona në total.** Bashkia është pronare për 270 prona nga të cilat 228 prona në pronësi dhe 42 prona në përdorim.

**2.Ish Komunës Kushove sot Njësia Administrative Kushove Bashkisa Gramsh**

Me VKM nr. 44, datë, 27.01.2010 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Kushove, të Qarkut Elbasan", i është miratuar lista inventarit me **561 prona në total**. Bashkia është pronare për 234 prona nga të cilat 107 prona në pronësi dhe 127 prona në përdorim.

**3.Ish Komunës Lenie sot Njësia Administrative Lenie Bashkia Gramsh**

Me VKM nr.836, datë , 21.11.2012 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Lenie, të Qarkut Elbasan", i është miratuar lista inventarit me **702 prona në total**. Bashkia është pronare për 315 prona nga të cilat 221 prona në pronësi dhe 94 prona në përdorim.

**4.Ish Komunës Sult sot Njësia Administrative Sult Bashkia Gramsh**

Me VKM nr.507, datë , 13.07.2011 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Sult, të Qarkut Elbasan", i është miratuar lista inventarit me **490 prona në total.** Bashkia është pronare për 165 prona nga të cilat 126 prona në pronësi dhe 39 prona në përdorim.

**5.Ish Komunës Kodovjat sot Njësia Administrative Kodovjat Bashkia Gramsh**

Me VKM nr.828, datë , 21.11.2012 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Kodovjat, të Qarkut Elbasan", i është miratuar lista inventarit me **693 prona në total**. Bashkia është pronare për 256 prona nga të cilat 222 prona në pronësi dhe 34 prona në përdorim.

**6.Ish Komunës Poroçan sot Njësia Administrative Poroçan Bashkia Gramsh**

Me VKM nr.661, datë, 04.08.2010 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Poroçan, të Qarkut Elbasan", i është miratuar lista inventarit me **634 prona në total**. Bashkia është pronare për 138 prona nga të cilat 65 prona në pronësi dhe 73 prona në përdorim.

**7.Ish Komunës Pishaj sot Njësia Administrative Pishaj Bashkia Gramsh**

Me VKM nr.273, datë, 18.04.2012 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Pishaj, të Qarkut Elbasan ", i është miratuar lista inventarit me **1273 prona në total.** Bashkia është pronare për 477 prona nga të cilat 219 prona në pronësi dhe 258 prona në përdorim.

**8.Ish Komunës Tunje sot Njësia Administrative Tunje Bashkia Gramsh**

Me VKM nr.578, datë, 28 .05.2009 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Tunje, i është miratuar lista inventarit me 702 prona në total. Për kete njesi nuk është miratuar lista përfundimtare .

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 46, datë ,18.04.2017, miratoi listen e pronave qe kerkon te transferohen në pronesi ose në perdorim të Bashkisë Gramsh., Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 178 ( njeqinde e shtatedhet e tete flet ) dhe me shkresë nr. 2892 prot., datë 25.04.2017 është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme , Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, Tirane për miratimin dhe transferimin e listës përfundimtare të pronave.

**9.Ish Komunës Kukur sot Njësia Administrative Kukur Bashkia Gramsh**

Me VKM nr.410, datë, 22.04.2009 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës kukur,i është miratuar lista inventarit me 509 prona në total. Per kete njesi nuk eshte miratuar lista perfundimtare .

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 48, datë ,18.04.2017, është miratuar listen e pronave që kerkon të transferohen në pronesi ose në përdorim të Bashkise Gramsh. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 73 (shtatëdhet e tre flet) dhe me shkresë nr. 3790 prot., datë 01.06.2017 është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike,Tirane për miratimin dhe transferimin e listës përfundimtare të pronave.

**Sa më sipër rezulton se** përsa i përket pronave të Kaluara me VKM në Njësitë Administrative nuk është bërë pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Gramsh; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Elbasan, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit

ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe nuk është aplikuar në ZVRPP për regjistrimin e tyre. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*", dhe UMF-së nr. 30, datë **27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III,** pika 30 ku citohet: *"Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi te llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia."* dhe pika 35/a ku citohet: "*Dokumentet vërtetues- vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet mandate arkëtimet, mandate pagesat, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi." si dhe neni 37 i ligjit 20/2020 "*Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë" Kreu IV.

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si më poshtë:

| **Nr.** | **Bashkia/ Njesite** | **Nr. Pronave në Inventar** | **Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2021** | **Nr. Praktikave te Certifikuara 2022** | **Prona te pa Rregjistruara** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bashkia Gramsh | 398 | 1 | 5 | S ka |
| 2 | NjA.Skënderbegas | 270 | | | 270 |
| 3 | Nj.A.Kushove | 234 | | | 234 |
| 4 | Nj.A.Lenie | 315 | | | 315 |
| 5 | Nj.A.Sult | 165 | | | 165 |
| 6 | Nj.A.Kodovjat | 256 | | | 256 |
| 7 | Nj.A.Poroçan | 138 | | | 138 |
| 8 | Nj.A.Pishaj | 477 | | | 477 |
| 9 | Nj.A.Tunje | 702 | Jane në proçes | | |
| 10 | Nj.A.Kukur | 509 | Jane në proçes | | |
| | | 3066 | | | |

**<u>Kriteri:</u>**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore". *neni 37 i ligjit 20/2020 "*Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë" Kreu IV.

**<u>Ndikimi/Efekti:</u>**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

**<u>Shkaku:</u>**

Mungesa e regjistrit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Gramsh.

**<u>Rëndësia:</u> E lartë**

**Rekomandimi**

- Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet si dhe për krijimin e regjistrit të pronave, në zbatim të kërkesave të UMF .

**Titulli gjetjes:** *Mos kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale të cilat janë certifikuar në ASHK nga sektori i menaxhimit të aseteve në Bashkin Gramsh.*

**Situata:**

Nga auditimi rezultoi se, për periudhën object auditimi janë certifikuar në toal 6 prona sipas tabelës së sipërcituar. Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Gramsh në Drejtorinë rajoneve të ASHK Gramsh, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 6 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Gramsh. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. *Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu (VI) "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme" dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16)*

Në mënyrë të detajuar paraqiten pronat të cilat janë aplikuar për regjistrim në ASHK për periudhën 31.12.2022 si vijon:

**"Ish Repar Ushtarak" një praktik për vitin 2022**

| Nr | Zona kadastral | Nr Pasurise | Indeksi I harte | Nr. rregjis | Siperfaqia sipas V.K.M. | | Data e aplikimit Nr. Dt. | Vertetim ose certifikat e Hipoteke | Siperfaqia sipas Faktit | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Truall | Ndert | | | Truall | Ndert |
| 1 | 2167 | 298 | K-34-119 A | 4859 | 120 | 120 | 22.12.2021 | Hipotek | 120 | 120 |
| 2 | | 299 | K-34-119 A | | 99 | 99 | | Hipotek | 99 | 99 |
| 3 | | 300 | K-34-119 A | | 275 | 275 | | Hipotek | 275 | 275 |
| 4 | | 301 | K-34-119 A | | 9 | 9 | | Hipotek | 9 | 9 |
| 5 | | 302 | K-34-119 A | | 10900 | 10900 | | Hipotek | 10900 | 10900 |

Burimi: Bashkia Gramsh

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

*1. z A. S. me detyrë Drejtoresh e Financës për periudhën e auditimit. 01.01.2021-31.12.2022*

**Kriteri:**

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu (VI) "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme" dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16

**Ndikimi/Efekti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

**Shkaku:**

Mos rakordimi ndërmjet Sektorit të Financës dhe Sektorit të Menaxhimit të Aseteve në Bashkinë Gramsh.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi**
- Drejtoria e Financës në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 6 prona të certifikuara në ASHK Elbasan, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Gramsh.

## 4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

*4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve*.

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Cërrik". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pikësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse, në përputhje me VKM, nenin 4 “*Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik*”, pika 1. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4, pika 3.

***Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara***

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

| **Periudha ushtrimore** | **Plani investime** | **BURIMET E FINANCIMIT** | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **Grand pakushtëzuar** | **Buxhet i shtetit** | **Të ardhurat e veta** |
| Viti 2021 | 403,058 | 225,164 | 119,245 | 58,649 |
| Viti 2022 | 180,063 | 119,048 | 2,000 | 59,015 |
| **TOTALIT** | **583,121** | **344,212** | **121,245** | **117,664** |

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Gramsh *(regjistrat e parashikimit dhe realizmit)*, për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

| Viti 2021 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Lloji i procedurës** | **Nr.** | **Fondi limit pa TVSh** | **Kontrata pa TVSh** | **Fondi total i kursyer pa TVSh** | **% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit** |
| *Procedurë e hapur;* | 5 | 216,658,534 | 212,905,963 | 3,752,571 | 1.732 % |
| *Kërkesë për propozime;* | 5 | 22,216,501 | 21,710 639 | 505,862 | 2.276% |
| ***SHUMA*** | ***10*** | 238,875,035 | 234,616,602 | 4,258,433 | ***2***% |
| **Viti 2022** | | | | | |
| **Lloji i procedurës** | **Nr.** | **Fondi limit pa TVSh** | **Kontrata pa TVSh** | **Fondi total i kursyer pa TVSh** | **% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit** |
| *Procedurë e hapur;* | **4** | **81,299,999** | **66,751,727** | **14,548,272** | **17.89%** |
| *Procedure e hapur e thjeshtuar* | **15** | **65,033,871** | **61,854,609** | **3,179,262** | **4.88%** |
| ***SHUMA*** | | 146,333,870 | 128,606,336 | 17,727,534 | 12**%** |

***Burimi*** *i të dhënave: Bashkia Gramsh*

| Nr. | Objekti | Fondi limit | Operatori fitues | Shënime |
|---|---|---|---|---|
| 1 | *Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas ,Loti II* | 81,666,555 | "B." & "G." | Me shkelje |
| 2 | *Ndërtim linje ujësjellësi fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit Lagja Kocaj e Fshat Gramsh"* | 19,166,638 | BOE V." Sh.P.K dhe G. shpk | Me shkelje |
| 3 | *Ndertimi i Ures Kushoves* | 30,000,000 | "BOE 'O.' SH.P.K. & V.'SH.P.K" | Me shkelje |
| 4 | *"Blerje dru zjarri dhe pellet per vitin shkollor 2002-2023".* | 9,062,750 | OE"A. S." P.F | Me shkelje |
| 5 | *Rikonstruksioni sistemimi , Fshatit Pishaj* | 8,331,823 | G." SH.P.K. & "V."SH.P.K. | Me shkelje |
| 6 | Sistemim Asfaltim lagja Holta | 17,500,000 | BOE-"K."SH.P.K &" V." SH.P.K. | Me shkelje |
| 7 | Sistemim Asfaltim i Lagjes Dellinje | 8,333,120 | BOE "R.G." Sh.p.k. & "D." SH.P.K | Me shkelje |

**Procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2021 janë si më poshtë vijon:**

**I-Tenderi me objekt:** *"Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas ,Loti II"*, me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas ,Loti II* **– viti 2021".** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** Nr. 21, datë 08.02.2021<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:**<br>E hapur | **3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**:<br>Urdhër nr. 21, datë 08.02.2021.<br>1. E. G. Specialist IT<br>2. A. R. Specialist në fushën e Urbanistikës<br>3. E. I. Specialist në fushën e Urbanistikës | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:**<br>Urdhër Nr.27, datë 10.02.2021<br>1. .A. S. Kryetar<br>2. .A. Ç. Anëtar<br>3. .A. J. Anëtar |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>81,666,555 lekë | **6. Oferta fituese**: "B." & "G."<br>Vlera **79,994,441** lekë, me lidhje kontrate datë 04.06.2021, me afat 4 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>1,671,114 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit**:<br>15.03.2021 | **9.Burimi Financimit**: "Buxheti i Bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike:**<br>a) Pjesëmarrës në tender: 6 OE<br>b) S'kualifikuar 5 OE,<br>c) Kualifikuar 1 OE |
| **11.Ankimime për kriteret e DST**<br>**PO** | **12. Përgjigje ankesës nga AK**<br>**PO**<br>Shkresa nr. 1314/3 datë 16.04.2021<br>Shkresa nr. 1340/2 datë 16.04.2021 | **13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP**<br>Vendimi nr. 232/2021prot datë 21.05.2021 |
| **Zbatimi i Kontratës Punimeve/Sherbimeve/ Mallrave** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>.... prot., datë 04.06.2021 | **15. Vlera kontratës (me TVSH)**<br>95,993,329 lekë | **16. Afati i kontratës në ditë**<br>**4 muaj** |

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

**Preventivi**

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik i objektit është hartuar nga shoqëria "D." Shpk. Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konkretisht regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit, si dhe arkivës së prokurimeve në SPE, *rezulton se shërbimi i realizimit të projektit është prokuruar dhe nga Titullari i AK.*

Fondi limit në bazë të preventivit të hartuar nga shoqëria e mësipërme në vlerën 81,666,555 lekë pa TVSH/ 97,999,866 lekë me TVSH.

U testuan disa prej zërave të preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2017, i ndryshuar (përjashtuar zëra punimesh/mallrash për të cilët nuk ka çmim të miratuar në manualin teknik).

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve të vendosura.

**Situata 1**

**Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:**

**AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar kërkon:**

**Pika 2.2.1** - Vlera mesatare e xhiros së realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit te jete **jo më e vogël se 50 %** e vlerës se fondit limit që prokurohet – Ndërkohë që sipas shkronjës "b" të pikës 7 në nenin 26 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në rastet e prokurimeve për punë publike mbi kufirin e ulët monetar (rasti në fjalë) vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor **nuk mund të tejkalojë 50%** të vlerës limit të kontratës që prokurohet. Pra kuadri rregullator ka përcaktuar nivelin maksimal, ndërkohë AK duhet të caktojë një marzhë brenda këtij niveli.

**Për kapacitetin teknik**

**Pika 2.3.1.** AK ka kërkuar përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori Ekonomik duhet te këtë realizuar punë të ngjashme, për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më te vogël se 50 % e fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit: ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se dyfishi i fondit limit i vlerës qe prokurohet dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit. Plotësimi i njërit prej dy kushteve te sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme - Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me shkronjën "a" në pikën 6 në nenin 26 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, përcaktohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të madhe se 50% e vlerës** së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Pika 2.3.3** AK kërkon liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontratës:

N.P -1 B Punime gërmimi në tokë; N.P- 4 C Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale; N.P- 5A Punime nentokesore, ura e vepra arti; NP–7 B Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje; N.P – 12A Punime të inxhinierisë së mjedisit; N.S – 6A Sinjalistika rrugore jodriçuese; N.S - 7A Barriera dhe mbrojtje rrugore, N.S – 18A Punime topogjeodezike.

Sa më sipër punimet që përfshijnë licencat NP-7B dhe NP-12A nuk përputhen me llojin e punimeve sipas preventivit të punimeve. Është kërkuar niveli B i licencës NP -1, ndërkohë sipas preventivit, punimet që përfshijnë zërin gërmime, nr. analize 3.87/b (çmim * sasi), gjithsej arrijnë në vlerën 1,801,980 lekë, ndërkohë kategoria e licencës së kërkuar nga AK, është për punime me vlerë 21,000,000-50,000,000 lekë. Në këtë rast kategoria e kërkuar duhet të ishte NP-1A.

**Pika 2.3.4** kërkohet që ofertuesi duhet të ketë staf teknik në licencen e zbatimit të punimeve, të paktën 7 inxhinier të profileve të ndryshme dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 12 muajt e fundit - Periudha prej 12 muaj nuk është e argumentuar teknikisht nga AK, se si ndikon ajo në plotësimin e kapaciteteve teknike. -Gjithashtu kërkesa për inxhinier gjeodet është e panevojshme, pasi detyrat e këtij inxhinieri realizohen edhe nga inxhinieri gjeolog[6], si dhe kërkesa për inxhinierin e mjedisit është e panevojshme, pasi në asnjë rast nuk kemi punime që kërkojnë inxhinierin e mjedisit.

**Pika 2.3.5** AK ka kërkuar që OE të ketë: 2 Teknik ndërtimi; 2 Hidraulik;1 Mekanik; 3 Karpentier; 1 Montator; 1 Specialist Montues Tubash; 1 Specialist Ndërtimi; 1 Teknik Topograf; 6 Manovrator; 3 Shofer

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur (6 muaj) që punonjësit duhet të figurojnë në listë-pagesat e OE. Për më tepër që shërbimi i manovrimit të mjeteve të punimit edhe mund të kontraktohet me subjekte fizik/juridik, pra pa qenë e nevojshme disponimi në staf.

-Për karpentierët nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të nevojshëm për zbatimin e projektit –

-Veç sa më sipër është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektricist (Hidraulik, Teknik ndërtimi, Specialist ndërtimi, karpentier, manovrator, shofer, të kërkohet dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjësit e tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike. Në vijim të kërkesës së mësipërme, është i paargumentuar dhe i panevojshëm disponimi i dëshmisë së sigurimit teknik të manovratorëve dhe shoferëve, ndërkohë që kuadri rregullator i fushës[7] përcakton se manovratorët duhet të kenë dëshmi aftësie për përdorimin e mjeteve të caktuara, po kështu edhe shoferët, për të cilët veç lejes së drejtimit, jepet edhe certifikata e aftësimit profesional.

-Është kërkuar specialist ndërtimi dhe teknik ndërtimi, por nuk arsyetohet se cili është ndryshimi ndërmjet këtyre dy profesioneve, si dhe për më tepër referuar VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", i ndryshuar, nuk ekziston një pozicion pune me emërtimin "Specialist ndërtimi". Pra kërkesa për një specialist ndërtimi, është e pabazuar, si dhe krijon paqartësi. Në rastin e mësipërm duhet të ishte kërkuar vetëm teknik ndërtimi.

-Është kërkuar specialist për montim tubash, ndërkohë janë kërkuar edhe 2 hidraulik – Kërkesa për specialist tubash është e panevojshme. Sqarojmë se hidrauliku është personi i specializuar për kryerjen e detyrave të tilla. Referuar VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", i ndryshuar, hidrauliku/ja në banesa dhe ujësjellës merret me ndërtime, montime, instalime, riparime dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik, të sistemit të ujësjellës kanalizimeve, të sistemit të ujitjes, sistemeve të ngrohje-ftohjes, të sistemeve hidraulike të objekteve të prodhimit industrial dhe objekte të tjera që përdorin sisteme hidraulike të ngjashme. Ai/Ajo monton, instalon, riparon dhe mirëmban pajisjet dhe aksesorët për ujë, gaz, kullim, kanalizim, pajisje të sistemeve të ngrohje-ftohjes, pajisje pneumatike etj. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani të ndryshme ndërtimi, në shoqëri që kanë reparte të shërbimit hidraulik dhe të vetëpunësohet. Pra në rastin konkret mund të ishin kërkuar 2 hidraulik.

---

[6] VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", i ndryshuar, kodi i profesionit 2114.

[7] VKM nr.736, datë 1.7.2009 për disa ndryshime në VKM nr.808, datë 4.12.2003 të këshillit të ministrave "Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit" dhe Urdhër nr. 200, datë 16.5.2019 për miratimin e rregullores "për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit".

**Pika 2.3.5** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si: 1 (një) Inxhinier pjese e drejtuesve teknik te shoqërisë të pajisur me Çerifikatë për Mbrojtjen e Shëndetit dhe te Sigurisë në punë, lëshuar nga autoritete të certifikuara; 1 (një) Inxhinier pjese e drejtuesve teknik te shoqërisë Çertifikuar për Sigurimin dhe kontrollin e cilësisë ISO 9001:2015; 1 (një) Inxhinier pjese e drejtuesve teknik te shoqërisë te jetë i pajisur me Certifikate për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) lëshuar nga Ministria e Mjedisit; 1(një) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik të shoqërisë, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për *"Vlerësimi dhe dokumentacioni i vlerësimit te risqeve ne kantier", "Përgjegjës për sigurinë",* e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj; 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë "Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë; 1 (një) punonjësi "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Përmbrojtjen e mjedisit"; 1 Inxhinier pjese e stafit te shoqërisë te jetë i pajisur me certificate për parandalimin dhe mbrojtje nga zjarri.
Kërkesat e mësipërme janë të pargumentuara dhe jo në përputhje me llojin e punimeve sipas preventivit. Gjithashtu kërkesa që 1 (një) Inxhinier pjese e drejtuesve teknik te shoqërisë të pajisur me Çerifikatë për Mbrojtjen e Shëndetit dhe te Sigurisë në punë e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontraktojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.
Është e panevojshme që 1 (një) Inxhinier pjese e drejtuesve teknik te shoqërisë te jetë i pajisur me Certifikate për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) lëshuar nga Ministria e Mjedisit, pasi kemi të bëjmë me zbatim punimesh, ndërkohë vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet përpara se projekti të miratohet dhe kjo fazë është ezauruar përpara zbatimit të tij
-Në vijim sqarojmë se referuar zërave të preventivit të punimeve, nuk kemi punime që kërkojnë certifikatë për parandalimin dhe mbrojtje nga zjarri. Referuar përcaktimeve të kryera në VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", i ndryshuar, për kodin e profesionit me nr.3112 **"Teknikë të inxhinierisë civile" parashikohet se:** Teknikët e inxhinierisë civile kryejnë një tërësi detyrash teknike që kontribuojnë në fushën kërkimore të inxhinierisë së ndërtimit dhe në projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimet e objekteve të dhe strukturave të tjera të tilla si, sisteme të ujësjellësit, ura, aeroporte rrugë dhe diga. Ata mund të punësohen në kompani private dhe shtetërore që sigurojnë ndërtimin, mirëmbajtjen dhe parandalime të rreziqeve nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë të rrezikshëm.
Teknikët e inxhinierisë civile kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:
-Marrin masa për sigurimin e përmbushjes së të gjitha specifikimeve të projektit, të rregullave dhe ligjeve përkatëse, si dhe për ruajtjen e standardeve të kërkuara për materialet dhe punën e kryer;
-Inspektojnë ndërtime industriale, hotele, kinema dhe objekte të tjera për të identifikuarrreziqe të mundshme nga zjarri dhe japin udhëzime për eliminimin e tyre;
-Këshillojnë për instalimin e pajisjeve zbuluese të zjarrit dhe pajisjeve për fikjen e tij, për përdorimin e materialeve në ndërtimin e objektit dhe për mjetet e transportit që reduktojnë rrezikun nga zjarri dhe dëmet nëse ai ndodh;

**Pika 2.3.7**.Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar jo më pak se 130 punonjës për periudhën 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit shoqëruar me Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe Formularët e Deklarimit te Pagesave - Ndërkohë që numri i punonjësve për të cilët është përcaktuar edhe profesioni i tyre, është 30 punonjës, pra nG.n edhe 100 punonjës për të cilët nuk përcaktohet profesioni, ç'ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet *"Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin"*.
**Pika 2.3.10 dhe 2.3.11** kërkohet që OE ofertues duhet të ketë licencë për mbrojtjen nga zjarri (Kodi 1.2.A) dhe licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me Kodin III.2.A. "License për Ekspertizë dhe Mbrojtje në Mjedis" – Nga verifikimi i zërave të punimeve sipas preventivit nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë licencat e mësipërme dhe në këto kushte kërkesa për licencat e mësipërme nuk janë të argumentuara dhe të mbështetura ligjërisht, përkundrazi licenca me kodin 1.2.A "Shërbime ekspertize" me kodin I.2.A, të cilat mund të specifikohen në shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit, *ndërkohë* këtu jemi në zbatim punimesh dhe jo projektim. Sa i përket licencës për ekspertizë dhe mbrojtje në mjedis nuk është e nevojshme në zbatimin e punimeve, pasi shërbimet që ofrohen nëpërmjet kësaj licence janë ezauruar gjatë fazës së projektimit dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të projektit.
**Pika 2.3.15.** Kërkohen dëshmi për makineritë dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, për makineritë dhe pajisjet e mëposhtme (në pronësi ose me qera):
Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri i mjeteve që kërkohet dhe lloji i tyre, në përputhje me natyrën, sasinë dhe grafikun e punimeve.
Në vijim të pikës së mësipërme është kërkuar që, për impiantet, OE duhet të paraqesë raport-testimet për materialet si më poshtë:
- Raport-Testimin e materialeve Granil, Metoda e Testimit S SH EN 933-1:2012.
- Raport-Testimin e materialeve Rërë e Larë, Metoda e Testimit S SH EN 933-1:2012.
- Raport-Testimin për mostrën e betonit, Metoda e Testimit S SH EN 12390-1 : 3 2009.
- Raport-Testimin për ujin e betonit, Metoda e Testimit S SH EN 1008:2002.

Testimet e mësipërme duhet të janë bërë nga një Laborator i Akredituar konform S SH ISO/EN 17025:2006
Raporti i testimeve duhet të jetë sipas standarteve në fuqi bazuar në ligjin ligjin Nr. 9290, datë 07/10/2004 "Për Produktet e Ndëtimit" Raportet e testimit duhet të jenë realizuar në 6-shtë mujorin e fundit - Referuar përcaktimit të bërë në shkronjën "c" të pikës 1 dhe shkronjën "dh" në pikën 9 në Kreun III të Udhëzimit Nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, këto janë dokumente që dorëzohen gjatë zbatimit të punimeve, ku plotësohet dosja e kantierit dhe kontrollohen nga përgjegjësi/drejtuesi teknik i kantierit. Pra janë të panevojshme gjatë fazës së vlerësimit, për më tepër shtojnë kostot e pjesëmarrjes në procedurë.

*Sa më sipër për kritere të vendosura në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJHDT.*

***Situata 2***

**Vlerësimi i ofertave.**

KVO është ngritur me urdhër nr. 27 datë 10.02.2021, dhe përbëhet nga z. A. S. (kryetar), z. A. Ç. dhe z. A. J. (anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 1 datë 28.05.2021 për hapjen e tenderit, procesverbali nr.1, datë 23.03.2021 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim.
Në këtë tender kanë marrë pjesë 6 OE përkatësisht:

<u>*Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:*</u>
-Nga OE G. Sh.P.K, pjesë e BOE shpallur fitues, nuk plotësohet **pika 2.2.1** në DST, pasi në vërtetimin për xhiron e realizuar, nuk pasqyrohet edhe viti 2017, ndërkohë në DST është kërkuar që në përmbushje të pikës 2.2.1, ndër dokumente të tjera, OE duhet të dorëzojë:
Vërtetim nga dega e tatim-taksave për xhiron gjatë tre viteve të fundit (2017, 2018 dhe 2019). Konkretisht OE G. Sh.P.K ka dorëzuar vetëm për vitet 2018 dhe 2019.
-Nga OE G. Sh.P.K, pjesë e BOE shpallur fitues, nuk plotësohet **pika 2.3.1** në DST, lidhur me dorëzimin e dokumentacionit për punë të ngjashme në përputhje me % (4%) e pjesëmarrjes së tij në BOE. Konkretisht OE G. ka dorëzuar dokumentacion për kontratën e punimeve të ndërtimit me objekt "Ndërtim trotuari nga Kisha Katolike në fshatin Pishaj". Në këtë kontratë sipas formularit të vlerësimit dhe kontratës për punë publike lidhur ndërmjet kontraktorit dhe të kontraktuarit, pasqyrohet se OE G. ka qenë pjesë e BOE me V.. Në këto kushte, sipas përcaktimit të bërë në pikën e mësipërme të DST, OE G. duhet të kishte dorëzuar kontratën e bashkëpunimit me OE V., me qëllim verifikimin e % së punimeve të OE G. në këtë kontratë, si dhe vlerësimin në vijim të përmbushjes së pragut për punë të ngjashme në përputhje me % e pjesëmarrjes së tij në procedurën me objekt "Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II".
-Nuk plotësohet pika 2.3.15 në DST, sa i përket mjetit "Autobitumatrice", pasi i ka mbaruar <u>afati i vlefshmërisë së kontrollit/inspektimit të radhës</u>, ndërkohë që është detyrim ligjor për mbushësin e mallrave të rrezikshme (bitum) për kontrollin e afatit të inspektimit me qëllim që ai mos të ketë kaluar[8];
-Nuk administrohet certifikata e kualifikimit për drejtuesin e autobitumatrices[9];
-Për autobitumatricen nuk administrohet certifikata për transportin e mallrave të rrezikshëm, në këtë rast të bitumit[10].
***<u>Konkluzion.</u>***
BOE "B." sh.pk & "G." sh.p.k nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. A. S. (kryetar), z. A. Ç. dhe z. A. J. (anëtar).
**Kriteri:**
Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
**Shkaku:**
Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP dhe KVO.*
**Ndikimi/Efekti:** Mos argumentim në aplikimin e kritereve të vendosura.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

**II-Tenderi me objekt:** *"Ndërtim linje ujësjellësi fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit Lagja Kocaj e Fshat Gramsh"*, me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: **"*Ndërtim linje ujësjellsi fshati Skënderbegas* – viti 2021".** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** Nr. 87, datë 19.03.2021<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:**<br>E hapur | **3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**:<br>Urdhër nr. 87, datë 19.03.2021.<br>1. E. G. Specialist IT<br>2. .A. R. Specialist në fushën e Urbanistikës<br>3. E. I. Specialist në fushën e Urbanistikës | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:**<br>Urdhër Nr.88, datë 19.03.2021<br>1. .A. S. Kryetar |

[8] Pika 1 në nenin 48 në Ligjin nr. 118/2012 "Për transportin e mallrave të rrezikshme".
[9] Neni 35 dhe 38 në Ligjin nr. 118/2012 "Për transportin e mallrave të rrezikshme".
[10] https://ëëë.dpshtrr.al/deshmi-certifikata-licenca/transporti-i-mallrave.

| | | |
|---|---|---|
| | | 2. .A. Ç. Anëtar<br>3. .A. J. Anëtar |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>19,166,638 lekë | **6. Oferta fituese**: BOE V." Sh.P.K dhe G. shpk Vlera 18,982,653 lekë, me lidhje kontrate datë 25.05.2021, me afat 3 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>183,985 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit**:<br>26.04.2021 | **9.Burimi Financimit**: "Buxheti i Bashkisë" | **10. Operatoret Ekonomike:**<br>a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE<br>b) S'kualifikuar 0 OE,<br>c) Kualifikuar 1 OE |
| **11.Ankimime për kriteret e DST**<br>**Jo** | **12. Përgjigje ankesës nga AK** | **13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP**<br>**JO** |
| **Zbatimi i Kontratës Punimeve/Sherbimeve/ Mallrave** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>1886 prot., datë 25.05.2021 | **15. Vlera kontratës (me TVSH)** 22,779,183 lekë | **16. Afati i kontratës në ditë 3 muaj** |

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

**<u>Preventivi</u>**

Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik i objektit është hartuar nga Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Ing. Z. A. C. si dhe është i nënshkruar nga Titullari i AK. U testuan disa prej zërave të preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2017, i ndryshuar (përjashtuar zëra punimesh/mallrash për të cilët nuk ka çmim të miratuar në manualin teknik)

***<u>Situata:</u>***

**<u>Mbi përcaktimin e kritereve të veçanta të kualifikimit</u>**

***AK në lidhje me kapacitetin ekonomik-financiar kërkon:***

**Pika 2.2.1** - Xhiroja mesatare vjetore gjate tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit duhet të jetë **<u>jo më pak se 50%</u>** e vlerës limit e kontratës që prokurohet – ndërkohë që sipas shkronjës "b" të pikës 7 në nenin 26 në VKM nr.914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, në rastet e prokurimeve për punë publike mbi kufirin e ulët monetar (rasti në fjalë) vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor **<u>nuk mund të tejkalojë 50%</u>** të vlerës limit të kontratës që prokurohet, pra nuk mund të tejkalojë që do të thotë se mund të jetë sa vlera e fondit limit/më poshtë, ndërkohë përcaktohet që duhet më e madhe ose baraz me vlerën e fondit limit;

**Për kapacitetin teknik**

**Pika 2.3.1.** AK ka kërkuar përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori Ekonomik duhet të kete realizuar punë të ngjashme, për një objekt të vetëm, në një vlerë sa 50 % e fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit: ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është sa dyfishi i fondit limit i vlerës qe prokurohet dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit. <u>Plotësimi i njërit prej dy kushteve te sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme -</u> Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me shkronjën "a" në pikën 6 në nenin 26 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, përcaktohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **<u>jo më të madhe se 50% e vlerës</u>** së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Për më tepër sjellim në vëmendje rekomandimet e APP, sa i përket mospërcaktimit të vlerës fikse për marzhin e vlerës së punëve të ngjashme.
**Pika 2.3.3** AK kërkon liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontratës:
*N.P-1 Niveli A; N.P-2 Niveli A; N.P-7 Niveli B; N.S.-4 Niveli A; N.S.-6 Niveli A; N.S.-8 Niveli A; N.S.18 Niveli A*
Sa më sipër punimet që përfshijnë licencat NP-2A dhe NS-6A nuk përputhen me llojin e punimeve sipas preventivit të punimeve. Për më tepër që punimet që përfshin licenca NP-2A, ezaurohen nëpërmjet licencës NP-7. Është kërkuar niveli B i licencës NP -7, ndërkohë që e gjithë vlera e prokurimit nuk tejkalon pragun 20,000,000 lekë, për të cilën kërkohet kategoria B, e cila është për punime me vlerë 21,000,000-50,000,000 lekë. Në këtë rast kategoria e kërkuar duhet të ishte NP-7A. **Pika 2.3.3** Kërkohet që OE duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës qe do të kryhen punimet në objekt - Sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", shprehimisht: "Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. <u>*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi".*</u> Pra sa më sipër nuk jemi në kushtet kur preventivi i punimeve është mbi 30,000,000 lekë, si dhe nuk është e nevojshme deklarata e mësipërme.
**Pika 2.3.5** kërkohet që ofertuesi duhet të ketë staf teknik në licencen e zbatimit të punimeve, të paktën 5 inxhinier të profileve të ndryshme dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit - Periudha prej 3 muaj nuk është e argumentuar teknikisht nga AK, se si ndikon ajo në plotësimin e kapaciteteve teknike. Sqarojmë se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 5 vite/3 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3/5 vite)[11]. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 5 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 1 vit që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë, duke ndikuar negativisht në konkurrencën në treg. Në këtë rast bazuar edhe në shkronjën "b" të pikës 8 në nenin 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar: "*Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*", <u>mjafton vetëm vendosja e numrit dhe llojit të inxhinierëve që duhen për zbatimin e punimeve.</u> Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 1 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin,

[11] Shkronja "a" pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, dëshmohet edhe kapaciteti që OE zotëron, por nuk plotësohet afati prej 3 muajsh që të jetë i punësuar pranë këtij OE, duke sjellë që ky OE megjithëse në thelb i plotëson kapacitetet teknike, të mos konkurrojë. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

**Pika 2.3.5** AK ka kërkuar që OE të ketë: 2 Teknik Ndërtimi (vërtetuar dhe me diplome); 1 Elektricist; 1 Murator; 1 Bojaxhi; 1 Karpentier; 1 Hekurkthyes; 1 Mekanik;4 Manovrator

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi kualifikimi profesional nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi si më poshtë: 2 (dy) specialist për montim tubash; 1 (një) hidraulik; 1 (një) saldator; 1 (një) elektricist.

-Nga shqyrtimi i procesverbalit përkatës, konstatohet se nuk argumentohet periudha e vendosur (3 muaj) që punonjësit duhet të figurojnë në listë-pagesat e OE. Për më tepër që shërbimi i manovrimit të mjeteve të punimit edhe mund të kontraktohet me subjekte fizik/juridik, pra pa qenë e nevojshme disponimi në staf.

-Veç sa më sipër është e panevojshme kërkesa që për çdo punonjës, përjashtuar ata me formimin profesional Elektricist (Hidraulik, Teknik ndërtimi, karpentier, manovrator, hidraulik etj) të kërkohet dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për punonjësit e tjerë të cilët nuk do të kryejnë punime elektrike. Në vijim të kërkesës së mësipërme, është i paargumentuar dhe i panevojshëm disponimi i dëshmisë së sigurimit teknik të manovratorëve dhe shoferëve, ndërkohë që kuadri rregullator i fushës[12] përcakton se manovratorët duhet të kenë dëshmi aftësie për përdorimin e mjeteve të caktuara, po kështu edhe shoferët, për të cilët veç lejes së drejtimit, jepet edhe certifikata e aftësimit profesional.

-Janë kërkuar 2 specialist për montim tubash, ndërkohë është kërkuar edhe 1 hidraulik – Kërkesa për specialist tubash është e panevojshme. Sqarojmë se hidrauliku është personi i specializuar për kryerjen e detyrave të tilla. Referuar VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", i ndryshuar, hidrauliku/ja në banesa dhe ujësjellës merret me ndërtime, montime, instalime, riparime dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik, të sistemit të ujësjellës kanalizimeve, të sistemit të ujitjes, sistemeve të ngrohje-ftohjes, të sistemeve hidraulike të objekteve të prodhimit industrial dhe objekte të tjera që përdorin sisteme hidraulike të ngjashme. Ai/Ajo monton, instalon, riparon dhe mirëmban pajisjet dhe aksesorët për ujë, gaz, kullim, kanalizim, pajisje të sistemeve të ngrohje-ftohjes, pajisje pneumatike etj. Ai/Ajo mund të punësohet në kompani të ndryshme ndërtimi, në shoqëri që kanë reparte të shërbimit hidraulik dhe të vetëpunësohet. Pra në rastin konkret mund të ishin kërkuar 2 hidraulik.

**Pika 2.3.6** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si: 1 (një) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqërisë, duhet te jete i pajisur me certifikaten të Trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne Pune", e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, (Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili operator duhet te paraqesi këtë certifikate).

1(një) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqërisë, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për "Vlerësimi dhe dokumentacioni i vlerësimit të risqeve ne kantier" përgjegjës për

---

[12] VKM nr.736, datë 1.7.2009 për disa ndryshime në VKM nr.808, datë 4.12.2003 të këshillit të ministrave "Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit" dhe Urdhër nr. 200, datë 16.5.2019 për miratimin e rregullores "për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit".

sigurinë", e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, (Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili operator duhet te paraqesi këtë certifikate).
Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, 1(një) persona te certifikuar për "Ndihmën e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave", i cili duhet te figuroje ne listepagese minimalisht për 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit. (Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili operator duhet te paraqesi këtë certifikate).
Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(një) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet te jete detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit. *Mjeku duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë .*
Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje.
1(një) prej inxhiniereve, pjese e drejtuesve Teknik të shoqërisë duhet të jete i certifikuar si Ekspert Zjarrfikës.
Kërkesat e mësipërme janë të pargumentuara dhe jo në përputhje me llojin e punimeve sipas preventivit. Gjithashtu kërkesa që 1 (një) Inxhinier pjese e drejtuesve teknik te shoqerise të pajisur me Çerifikatë për Mbrojtjen e Shëndetit dhe te Sigurisë në punë e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontraktojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes.
-Në vijim sqarojmë se referuar zërave të preventivit të punimeve, nuk kemi punime që kërkojnë certifikatë për parandalimin dhe mbrojtje nga zjarri. Referuar përcaktimeve të kryera në VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", i ndryshuar, për kodin e profesionit me nr. 3112 **"Teknikë të inxhinierisë civile" parashikohet se:** Teknikët e inxhinierisë civile kryejnë një tërësi detyrash teknike që kontribuojnë në fushën kërkimore të inxhinierisë së ndërtimit dhe në projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimet e objekteve të dhe strukturave të tjera të tilla si, sisteme të ujësjellësit, ura, aeroporte rrugë dhe diga. Ata mund të punësohen në kompani private dhe shtetërore që sigurojnë ndërtimin, mirëmbajtjen dhe parandalime të rreziqeve nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë të rrezikshëm.
Teknikët e inxhinierisë civile kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:
-Marrin masa për sigurimin e përmbushjes së të gjitha specifikimeve të projektit, të rregullave dhe ligjeve përkatëse, si dhe për ruajtjen e standardeve të kërkuara për materialet dhe punën e kryer;
-Inspektojnë ndërtime industriale, hotele, kinema dhe objekte të tjera për të identifikuarrreziqe të mundshme nga zjarri dhe japin udhëzime për eliminimin e tyre;
-Këshillojnë për instalimin e pajisjeve zbuluese të zjarrit dhe pajisjeve për fikjen e tij, për përdorimin e materialeve në ndërtimin e objektit dhe për mjetet e transportit që reduktojnë rrezikun nga zjarri dhe dëmet nëse ai ndodh;
**Pika 2.3.10 dhe 2.3.11** kërkohet që OE ofertues duhet të ketë licencë për mbrojtjen nga zjarri (Kodi 1.2.A) dhe licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me Kodin III.2.B. "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis" – Nga verifikimi i zërave të punimeve sipas preventivit nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë licencat e mësipërme dhe në këto kushte kërkesa për licencat e mësipërme nuk janë të argumentuara dhe të mbështetura ligjërisht, përkundrazi licenca me kodin 1.2.A "Shërbime

ekspertize" me kodin I.2.A, të cilat mund të specifikohen në shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit, *ndërkohë* këtu jemi në zbatim punimesh dhe jo projektim. Sa i përket licencës për ekspertizë dhe mbrojtje në mjedis nuk është e nevojshme në zbatimin e punimeve, pasi shërbimet që ofrohen nëpërmjet kësaj licence janë ezauruar gjatë fazës së projektimit dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të projektit.
**Pika 2.3.11.** Kërkohen dëshmi për makineritë dhe paisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, për makineritë dhe paisjet e mëposhtme (në pronesi ose me qera):
Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri i mjeteve që kërkohet dhe lloji i tyre, në përputhje me natyrën, sasinë dhe grafikun e punimeve.

***Situata 2***
**Vlerësimi i ofertave.**
KVO është ngritur me urdhër nr. 88 datë 19.03.2021, dhe përbëhet nga z. A. S. (kryetar), A. C. dhe A. J. (anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 1, datë 04.05.2021 për hapjen e tenderit, procesverbali nr. 2 , datë 12.05.2021 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK për miratim.
Në këtë tender kanë marrë pjesë 1 OE përkatësisht:
BOE V. & G. " Sh.P.K me ofertë ekonomike 18,982,653 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën **183,985 lekë më pak**;

Në kushtet e mësipërme është përzgjedhur fitues BOE V. & G. " Sh.P.K, me ofertë ekonomike 18,982,653 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 183,985 lekë më pak.

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:*
-Nga OE G. Sh.P.K, pjesë e BOE shpallur fitues, nuk plotësohet **pika 2.3.1** në DST, lidhur me dorëzimin e dokumentacionit për punë të ngjashme në përputhje me % (1.5%) e pjesëmarrjes së tij në BOE. Konkretisht OE G. ka dorëzuar dokumentacion për kontratën e punimeve të ndërtimit me objekt "Ndërtim trotuari nga Kisha Katolike në fshatin Pishaj". Në këtë kontratë formulari i vlerësimit përmban anomali, pasi nuk pasqyron % e bashkëpunimit ndërmjet OE G. me V., pasi sipas formularit të vlerësimit dhe kontratës për punë publike lidhur ndërmjet kontraktorit dhe të kontraktuarit, pasqyrohet se OE G. ka qenë pjesë e BOE me V.. Në këto kushte, sipas përcaktimit të bërë në pikën e mësipërme të DST, formulari i vlerësimit duhet të pasqyronte informacion të plotë për % e bashkëpunimit, me qëllim verifikimin e % së punimeve të OE G. në këtë kontratë, si dhe vlerësimin në vijim të përmbushjes së pragut për punë të ngjashme në përputhje me % e pjesëmarrjes së tij në procedurën me objekt "Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II".
-Nuk plotësohet pika **2.3.7 e DST**, pasi nga OE G., pjesë e BOE nuk është dorëzuar licenca me kod I.2.A "Shërbime Ekspertize dhe/ose profesionale te mbrojtjes civile"/kontratë me një konsulentë të licesuar që disponojnë këtë license). Po kështu edhe për disponimin e licencës me kod III.2.B "Shërbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis".
-Nuk plotësohet pika **2.3.6 e DST**, nga OE G., për kërkesat e mëposhtme:
a.1(një) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik të shoqërisë, duhet të jete i pajisur me certifikatën të Trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Pune", e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, (Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili operator duhet të paraqësi këtë certifikate).
b.1(një) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqërisë, duhet te jete i pajisur me certifikatën të Trajnimit për "Vlerësimi dhe dokumentacioni i vlerësimit të risqeve në kantier",

”Përgjegjës për sigurinë”, e dhëne nga një organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, (Ne rastin e bashkimit të operatoreve secili operator duhet të paraqësi këtë certifikate).
c.Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, 1(një) persona të certifikuar për “Ndihmën e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave”, i cili duhet të figuroje në listepagesë minimalisht për 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. (Në rastin e bashkimit të operatoreve secili operator duhet të paraqesë këtë certifikate).

***Konkluzion.***

BOE V. & G. ” Sh.P.K nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. A. S. (kryetar), z. A. Ç. dhe z. A. J. (anëtar).

**Kriteri:**

Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP dhe KVO.*

**Ndikimi/Efekti:** Mos argumentim në aplikimin e kritereve të vendosura.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 1784 prot., datë 19.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 205/4 prot., datë 24.05.2023, nga *KVO,* i cili është ridërguar me shkresën nr. 2090/9 datë 07.07.2023, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 205/6 datë 12.07.2023 *ku* janë shprehur komentet si më poshtë:

**<u>Pretendimi i subjektit:</u>**

<u>Lidhur me vlerësimin e ofertave të kësaj procedure prokurimi:</u>

Kundërshtojmë konkluzionet tuaja për ngarkimin me përgjegjësi të KVO-së për arsyet:

Në faqen 12 të Akt Konstatimit nr.l l ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi BOE "B." shpk & "G." shpk, i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar, konkretisht:

I. Sipas konstatimit tuaj, nga OE "G." shpk, pjesë e BOE të shpallur fitues nuk plotësohet pika 2.2.1 në DST, pasi në vërtetimin për xhiron e realizuar nuk pasqyrohet edhe viti 2017 ndërkohë që në DST është kërkuar që OE duhet të dorëzojë vërtetim nga dega e tatim taksave për xhiron gjatë tre viteve të fundit (2017,2018, 2019", ndërkohë që OE "G. " shpk ka dorëzuar vetëm për vitet 2018-2019.

Sqarojmë se në DST është kërkuar në pikën 2.2. "Kapaciteti ekonomik dhe financiar"

Vlera mesatare e xhiros së realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit te jete jo më e vogël se 50 % e vlerës se fondit limit që prokurohet, Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë: Vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron gjate tre viteve të fundit ( 2017, 2018 dhe 2019) .

Neni 26 pika 7 e VKM-së Nr.914 dt 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", I ndryshuar (në fuqi kohën e zhvillimit të procedurës) parashikohet se : "Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a)kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose " kopje të deklaratave të xhiros vjetore. IV procedurat e prokurimit me vlerë nën kufîrin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. IV procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufîrin e ulët monetar, vlera e

kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 50 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet;
Në interpretim sa më lart , ligjvënësi ka kërkuar vlerën e përqindjes së xhiros vjetore ,dhe në pikën 2.2.1 është kërkuar mesatarja e përqindjes së xhiros vjetore 3 vitet e fundit në masën 50 % e vlerës se fondit limit që prokurohet, çka do të thotë që niveli 50% mund të plotësohet për një vit të vetëm, për dy Vite ose tre Vite së bashku mesatarisht. Pra kërkesa ligjore ka si njëso matëse vlerën e xhiros vjetore dhe jo periudhën.
Për plotësimin e këtij kriteri OE "G. shpk ka dorëzuar vërtetimin nr.T03716901 datë 16.03.2021 , nga përmbajtja e të cilit konstatohet se mesatarja e xhiros vjetore është (32 776 787 + 1 ... 750): 34 025 537 : 2 17 012 768 lekë. Fondi limit e procedurës ka qenë 81 666 555 lekë .
Neni 74/3 i VKM –së Nr. 914 dt 29.12.2014 Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqin jene pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje. Në bazë të marrëveshjes së baslıkëpunimit OE "G.” shpk ka marrë përsipër të kryejë 4% të punimeve objekt prokurimi ;
Sipas përllogaritjeve BOE së bashku duhet të plotësojë xhiron mestarë vjetore të tre viteve të fundit në masën FL 81 666 555 leke x50% = 40 833 277 leke, OE "G.” shpk duhet të plotësonte 40 833 277 leke -1 633 331 leke.
Pra OE " G.” shpk në bazë të nenit 26/4 të VKM nr.914 dhe pikës 2.2.1 të DST , i takon të plotësojë xhiron mestare të tre viteve të fundit 1 633 331 leke, ndërkohë që ai e ka tejkaluar këtë vlerë , pasi ka plotësuar xhiron mestare prej 17 012 768 leke.
Vlen të theksohet gjithashtu referuar Ekstraktit të QKB-së, OE "G.” shpk është krijuar si shoqëri më datë 23/10/2018, dhe rıjedhimisht nuk mund të këtë xhiro vjetore për ketë vit.
Sa më siper BOE "G.” shpk & "B.” slıpk plotëson kriterin e përcaktuar në piken 2.2.1 të DST-së , lidhur me xhiron vjetore të tre viteve të fundit në masën e 50 % e vlerës se fondit limit, madje në tejkalim të kësaj vlere.
(Bashkëngjitur vërtetimi nr. T03716901 datë 16.03.2021,Vërtetimit nr.T03743188 datë 22.03.2021, ekstrakti i QKB-së datë 09.02.2021,akt marrëveshje nr. Rep 1625, nr.kol datë 22.03.2021)
2. Sipas konstatimit tuaj , nga ana e OE "G.” shpk, pjesë e BOE të shpallur fıtues nuk plotësohet pika 2.3.1 në DST , lidhur me dorëzimin e dokumentacionit për punë të ngjashme në përputhje me përqindjen (49/0) e pjesëmarrjes së tij në 13013.
Sqarojmë se për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas Loti U” , BOE " G.” shpk & "B.” shpk kanë lidhur marrëveshjen e bashkëpunimit nr. Rep 1625, nr.kol 579 datë 22.03.2021, ku anëtari i bashkimit "G.” shpk ka marrë përsipër të kryejë 49/0 të punimeve të preventivit të paraqitur në këtë procedurë.
Për plotësimin e kriterit për punë të ngjashme në përputhje me përqindjen e marrë përsipër anëtari "G.” slıpk,ka dorëzuar Formular vlerësimi, kontratë sipërmarrje nr.2476 prot datë 09.07.2020 me objekt " Ndërtim trotuari nga kisha katolike në fshatin Pishaj” lidhur midis BOE "G.” shpk & "V.” shpk dhe Bashkisë Gramsh , akt kolaudimi datë 23.102020, certifıkatë e marrjes në dorëzim të punimeve datë 26.102020, situacionin përfundimtar si dhe faturat tatimore të shitjes.
Sa i përket plotësimit të kriterit për punë të ngjashme KVO i është referuar vlerës së përcaktuar në formularin e vlerësimit dhe në kontratën e sipërmarrjes” Ndërtim trotuari nga kisha katolike në fshatin Pishaj", konkretisht vlerës prej I I 419 138 leke me tvsh dhe 9 515 948 leke , pa tvsh. Dine duke llogaritur 4 % e punimeve të marra përsipër sipas akt marrëveshjes për procedurën "Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas Loti U”, e cila arrin vlerën 3 197 754 leke pa tvsh, KVO e ka konsideruar kriterin e përmbushur nga OE "G. " shpk.

3. Sipas konstatimit tuaj, nuk plotësohet pika 2.3.15 në DST, sa i përket mjetit "autobitumatrice", pasi ka mbaruar afati i vlefshmërisë së kontrollit/inspektimit të radhës , nuk administrohet certifikata e kualifikimit për drejtuesin e autobitumatrices, mık administrohet certifıkata për transportin e mallrave të rrezikshëm , në këtë rast të bitumit.
Sqarojmë se në kriteret e kualifikimit në piken 2.3.14 është kërkuar një Autobitumatriçe në pronësi ose me (lira. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - leja e transportit qe lëshohet nga njësia vendore dine fotot përkatëse; ndërsa për mjete te marra me qera krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te përfshijë objektin përkatës dhe duhet te jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit te punimeve deri ne përfundimin e plote te punimeve.
Për plotësimin e këtij kriteri BOE " G.” shpk & "B.” slıpk, ka dorëzuar kontratën e qirasë nı<sup>s</sup> .1586 rep, nr.558 kol datë 19.03.2021 lidhur mes "I.S.P.P” shpk dhe "B.” shpk për autobitumatricen me targa LU 3021 C, me afat deri në përfundim të pummeve për objektin "Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas Loti U" ka dorëzuar certifikatën e pronësisë ,certifikatë regjistrimi të mjetit , pasaportë nr.serial 000886, lejen e qarkullimit, siguracionin e mjetit brenda afatit të vlefshmërisë, certifikatën e kontrollit teknik brenda afatit të vlefshmërisë, raportin e kontrollit teknik të mjetit, taksat vjetore, akt zhdoganimi dhe foto e mjetit. Referuar këtij dokumentacioni KVO ka vlerësuar vetëm atë dokumentacion të kërkuar në DST, dhe nuk mund të vlerësojë apo të kërkojë dokumentacion shtesë të pakërkuar. KVO vlerëson vetëm mbi bazën e kërkesave të kualifikimit të kërkuara nga Njësia e Prokurimit, dhe në asnjë kriter të DST-së nuk është kërkuar certifikata e kualifikimit për drejtuesin e autobitumatrices, nuk është kërkuar certifikata për transportin e mallrave të rrezikshëm .
Bashkëngjitur dokumentacioni për mjetin autobitumatrice i dorëzuar në SPE.
Sa më sipër, kërkojmë nga ana Juaj, të rishikoni edhe njëherë konstatimet tuaja lidhur me vlerësimin e tenderit me objekt "Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas Loti U pasi KVO ka kryer detyrat e ngarkuara konform legiislacionit në fuqi për prokurimin publik.
2.Mbi zbatimin e procedurave ligiore në tenderin me objekt "Ndërtim linie uiësiellësi fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit Kocai e Fshat Gramsh".
Lidhur me vlerësimin e ofertave të kësai procedure prokurimi:
Kundërshtojmë konkluzionet tuaja për ngarkimin me përgjegjësi të KVO-së për arsyet:
Në faqen 18 të Akt Konstatimit nr. I l ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi dokumentat e BOE të shpallur fitues nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar,konkretisht:
l. Sipas konstatimit tuaj nga ana e OE "G." shpk, pjesë e BOE të shpallur fitues nuk plotësohet pika 2.3. l. në DST lidhur me dokumentacionin për punë të ngjashme në përputhje me e pjesëmarrjes së tij në BOE.
Sqarojmë se për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt " Ndërtim linje ujësjellësi Fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit lagjja Koçaj e Fshat Gramsh" , BOE " V." shpk & "G. " shpk kanë lidhur marrëveshjen e bashkëpunimit nr. Rep 1708, nr.kol 1284 datë 03.05.2021, ku anëtari i bashkimit "G." shpk ka marrë përsipër të kryejë 1.5% të punimeve të preventivit të paraqitur në këtë procedurë, në vlerën 283 920 lekë, pa tvsh..
Për plotësimin e kriterit për punë të ngjashme në përputhje me përqindjen e marrë përsipër anëtari "G." shpk, ka dorëzuar Formular vlerësimi, kontratë sipërmarrje nr.2476 prot datë 09.07.2020 me objekt " Ndërtim trotuari nga kisha katolike në fshatin Pishaj" lidhur midis BOE

"G." shpk & "V." shpk dhe Bashkisë Gramsh , akt kolaudimi datë 23.10.2020, certifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve datë 26.10.2020, situacionin përfundimtar si dhe faturat tatimore të shitjes.
Sa i përket plotësimit të kriterit për punë të ngjashme KVO i është referuar vlerës së përcaktuar në formularin e vlerësimit dhe në kontratën e sipërmarrjes" Ndërtim trotuari nga kisha katolike në fshatin Pishaj", konkretisht vlerës prej 11 419 138 lekë me tvsh dhe 9 515 948 lekë , pa tvsh. Dhe duke Ilogaritur 1.5 % e punimeve të marra përsipër sipas akt marrëveshjes për procedurën " " Ndërtim linje ujësjellësi Fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit lagjia Koçaj e Fshat Gramsh", e Cila arrin vlerën 283 920 lekë, pa tvsh, vlerë kjo e papërfillshme nisur nga kontrata të tjera që ky operator ekonomik ka patur me bashkinë Gramsh, KVO e ka konsideruar kriterin e përmbushur nga OE "G. " shpk.
2. Sipas konstatimit tuaj nuk plotësohet pika 2.3.7 e DST, pasi nga ana e OE "G." shpk, pjesë e BOE të shpallur fitues nuk është dorëzuar licenca me kod 1.2.A "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale te mbrojtjes civile" si dhe licenca me kod 111.2.B është dorëzuar për İng. drejtues teknik certifikata e Trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Pune", e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, certifıkata e Trajnimit për "Vlerësimi dhe dokumentacioni i vlerësimit te risqeve në kantier", "Përgjegjës për sigurinë", e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptarisë i huaj si dhe certifikata për një person të certifikuar për "Ndihmën e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave", i cili duhet te figuroje ne listë pagesë minimalisht për 3 muajt fundit nga data e zhvillimit te tenderit.
Sqarojnë se neni 74/3 VKM-së Nr.914 dt 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", I ndryshuar (në fuqi kohën e zhvillimit të procedurës) parashikon ndër të tjera se "Secili prej anëtarëve të këtu bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara ne nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje".
Këto certifikata janë dorëzuar nga anëtari me përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, konkretisht OE " V." shpk i cili ka marrë përsipër të kryejë 98.5 % të kontratës.
Nisur nga përqindja e pjesëmarrjes në BOE e atërarit "G." shpk, në masën 1.5 % , ose 283,920 leke, pa tvsh, vlerë kjo minimaliste në pjesëmarrje, ky operator ka përmbushur kërkesat ligjore sipas nenit 45 të LPP , ndërsa ato ekonomike , financiare, profesionale e teknike i ka përmbushur në raport me përqindjen e punimeve të marrë përsipër . Kërkesat e mësipërme sic ju konstatoni janë përmbushur nga anëtari " V." shpk i cili ka përqindjen 98.5 % të pjesëmarrjes. Kriteri i vendosur nga Njësia e Prokurimet që si më sipër duheshin të përmbusheshin nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë është në kapërcim të kritereve ligjore të parashikuara në nenin 74 të VKM-së Nr.914 dt 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", . ndryshuar.
Referuar preventivit të ndarjes së punimeve sipas marrëveshjes OE 'G." shpk ka marrë përsipër 1.5 % të punimeve, në vlerën 283 920, lekë pa tvsh, konkretisht vetëm zërin nr., An 3.87/a Germim dheu , seksion I detyruar kanal 1=3400 m, në sasinë 1900 $111^3$ . Ushtë e tepërt ti kërkohet një OE një numër të madh certifikatash , apo kërkesa teknike apo profesionale për punime në një vlerë të papërfillshme apo punime që nuk kërkojnë kualifikime profesionale për më tepër që në këte prokurim ky OE ka kryere si bashkim operatorësh dhe kërkesat si më sipër plotësohen nga anëtari që ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.
Bashkëngjitur, kontrata e bashkëpunonit nr. 1708 rep, nr. 1284 kol datë 03.05.2021, Preventivi i ndarjes së punimeve, licenca me kod 1.2. 4 "Shërbime Ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile" si dhe licenca me kod III.2.B "Shërbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis", certifikata e Trajnimi për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e

shëndetit në punë”, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, certifikata e Trajnimi për "Vlerësimin dhe dokuıeniacioni i vlerësimit të risqeve në kantier”, "Përgjegjës për sigurinë”, e dhëne nga një organizëm i licencuar ceriifikimi shqiptar ase i huaj si dhe certifikatë për një person iu certifikuar për "Ndihmën e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave '9, të OE " V. " shpk

Sa më sipër, kërkojmë nga ana Juaj, të rishikoni edhe njëherë konstatimet tuaja lidhur me vlerësimin e tenderit me objekt " Ndërtim linje ujësjellësi Fshati Skënderbegas si në linja e ujësjellësit lagjia Koçaj e Fshat Gramsh”, pasi KVO ka kryer detyrat e ngarkuara konform legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit.</u>**

Nga Grupi i Auditimit janë nxjerrë shkeljet konkrete të legjislacionit të Prokurimit Publik në fazën e përcaktimit të kritereve të kualifikimit nga ana e KVO, të cilave nuk i është dhënë përgjigje nëpërmjet observacionit

Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

**Procedura për prokurimet të audituara për vitin 2022 janë si me poshtë**

**I. a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndertimi i Ures Kushoves”**

| **a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *“Ndertimi i Ures Kushoves””.* | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>**2. Procedure e hapur**<br>REF-47518-10-26-2022<br>Urdhri nr.4343 prot., datë 19.10.2022 | **1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit**<br>Urdhri nr. 313 datë 19.10.2022<br>1. L. Z. Kryetar.<br>2. Ing . A. B.<br>3. E. C.. | **2 Njësia e Prokurimit**<br><br>1. L. Z..<br>2.Ing.A. B..<br>3. E. C. | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr.314 prot., datë 19.10.2022<br><br>1. X. B..<br>2 E. S.<br>3.B. A.<br>Urdher nr. 338 date 07.11.2022 Te nderyshoje perberja e komisionit te vleresimit te ofertave si vijon<br>1. X. B.<br>2. A. S.<br>3. A. C. |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>30.000.000 lekë | **5. Oferta fituese, vlera fituese:**<br>Operatori Fitues:<br>29.242.605.86 lekë pa tvsh. | | **6. Diferenca me fondin limit**<br>757.394.14 lekë pa tvsh |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data .21.11.2022 ora 10.00.........<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 112 ditë** | **8. Burimi Financimit**<br>**Buxheti i Bashkisë** | | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender<br>1.BOE‘O.’SH.P.K.&V.’SH.P.K.<br>2.BOE-“M.” Shpk &”S.”Shpk<br>**3.** BOE-“D.’SH.P.K. &’P. G’SH.P.K.<br>b) S’kualifikuar 2.BOE-“M.” Shpk &”S.”Shpk<br>**3.** BOE-“D.’SH.P.K. &’P. G’SH.P.K.<br>**4.** OE-‘B.’SH.P.K<br>c) Kualifikuar BOE‘O.’SH.P.K.&V.’SH.P.K. |
| | **11. Data e lidhjes të kontratës:**<br>**Nr. 57 prot., datë 01.09.2023** | | |

**<u>Titulli i gjetjes</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kritereve .

***<u>Situata:</u>***

**Hartimi i kritereve:**

1. Kërkesa e pikës 2.3.2 e DST e cila kërkon kategoritë e licencësave N.P-4B (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale) N.S-9A (Punime strukturore speciale)

N.S-18A (Punime topogjeodezike) janë kërkesë e paargumentuara pasi nuk ka zëra punimesh në preventiv për të kërkuar këtë kategori të licencës.

1. Kërkesa e pikës 2.3.7 e DST e cila kërkon një punësim mesatar i të paktën 40 (dyzetë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar, është kërkesë e paargumentuar.

2. Kërkesa e pikës 2.3.8 e DST për mjetet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate, janë të paargumentuara, dhe jo në përputhje me preventivin e punimeve.

Kërkesat për 2 copë Ekskavator me zinxhirë, për 2 copë Ekskavator me krahë të gjate jo me pak se 15 m, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 Ton 3 copë; Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 Ton 3 copë, nuk argumentohet teknikisht. AK nuk specifikon nevojën për këto mjete.

3. Kërkesa e pikës 2.3.9 e DST 9 cila kërkon certifikata ISO 9001:2015, ISO 14001-2015, ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kërkesat për certifikatat e cilësisë, për materialet e mësipërme, janë kërkesa të paargumentuara, të cilat nuk i shërbejnë AK. Vlera e përgjithshme e kësaj procedure është modeste dhe zërat janë minimalë për të kërkuar një numër kaq të lartë certifikatash.

**Kriteri:**

Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *anëtarët e NJP*

**Ndikimi/Efekti:** Mos argumentim në aplikimin e kritereve të vendosura.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## II. Prokurimit me objekt: *"Blerje dru zjarri dhe pellet per vitin shkollor 2002-2023".*

| **a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Blerje dru zjarri dhe pellet per vitin shkollor 2002-2023".* | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Procedure e hapur e ,e thjeshtuar"**<br>REF.-45197-10-11-2022"-Urdhri nr .3231 prot., datë 16.08.2022<br>Urdhri nr.115 date 17.11.2022<br>Anullimin edhe perseritjen e procedurave te tenderit me objekt"Blerje dru zjarri dhe pelet per vitin shkollor2022-2023"Njesia e Prokurimit te kete te njejten perberje sipas percaktimeve te Urdherit te Kryetarit Nr.232 date 16.08.2022. | **1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit**<br>Urdhri nr.167, datë 16.06.2022<br>4. H. P.<br>5. E. M.<br>6. F. H.<br>7. Ing. X. M.. | **2 Njësia e Prokurimit**<br><br>1. L. Z.<br>2.Ing. A. B.<br>3.E. C..<br>. | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr.233 prot., datë 16.08.2022.<br><br>1. .X. B.<br>2. .Ing. E. S.<br>3. .B. A.<br>Urdhri nr.115 date 17.11.2022<br>Anullimin edhe perseritjen e procedurave te tenderit me objekt"Blerje dru zjarri dhe pelet per vitin shkollor2022-2023"Njesia e Prokurimit te kete te njejten perberje sipas percaktimeve te Urdherit te Kryetarit Nr.232 date 16.08.2022<br>Komisioni i Vleresimit te Ofertave perbehet si me poshte<br>1. .X. B. |

| | | |
|---|---|---|
| | | 2. .Ing. E. S.<br>3. .B. A. |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>9.062.750 (nente milion e gjashtedhjete e dy mije e shtateqind e pesedhjete )lekë | **5. Oferta fituese, vlera fituese:**<br>Operatori Fitues:<br>9.051.200(Nente milion pesedhjete e njemije e dyqind) lekë pa tvsh. | **6. Diferenca me fondin limit 11,550(njembedhjete mije e peseqind e pesedhjete)** lekë pa tvsh |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>1.Data 24.10..2022 ora 09.00.<br>2.Data 01.12.2022 ora 8.30.<br><br>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 30 ditë per tenderin e dates 24.10.2022<br>Kohezgjatja e kontratës 15 dite per tenderine e dates 01.12.2022 | **8. Burimi Financimit**<br>Buxheti i Bashkisë. | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender, **OE"A. S."**<br>b) **S'kualifikuar** ne tenderin OE"A. S. e Data 24.10..2022 ora 09.00<br><br>c) **Kualifikuar mbas vendimit te KPP** OE"A. S." ne tenderin e Data 01.12.2022 ora 8.30. |
| 10.Ankimime<br>AK-; ka<br>Urdher nr. 342 dt.08/11/2022 "Ngritjen e Komisionit per Shqyrtimin e ankesave lidhur me vleresimin e tenderit me objekt"Blerje dru zjarrri dhe pelet per vitin shkollor 2022-2023"<br>Komisioni i vleresimit te ankesave<br>1.A. S.<br>2.A. C.<br>2.E. H.<br><br>KPP-/ka<br>Komisioni i Prokurimit Publik<br>Vendim Nr. 1113 date 15/11/2022<br>1.Te mos pranoje ankesen e operatorit ekonomik " A. S." Person Fizik per proceduren e prokurimit "Procedure e hapur , e thjeshtuar"me Nr. REF. -45197-10-11-2022me objekt "Blerje dru zjarri dhe pelet per vitin shkollor 2022-2023", me fond limit 9.062.750 leke pa Tvsh , zhvilluar ne daten 24.10.2022 nga autoriteti kontraktor , Bashkia | 11. Data e lidhjes të kontratës:<br>Nr. 5079 prot., datë 06.12.2022 | 12.Përgjigje Ankesës nga KKP:<br>Vendim i KKP<br>Nr. 1113 date 15/11/2022<br>1.Te mos pranoje ankesen e operatorit ekonomik " A. S." Person Fizik per proceduren e prokurimit "Procedure e hapur , e thjeshtuar"me Nr. REF. -45197-10-11-2022me objekt "Blerje dru zjarri dhe pelet per vitin shkollor 2022-2023", me fond limit 9.062.750 leke pa Tvsh , zhvilluar ne daten 24.10.2022 nga autoriteti kontraktor , Bashkia Gramsh.<br>2. Te shpalle absolutisht te pavlefshëm vëndimin e Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave me Nr.4594/2 prot., date 09.11.2022<br>3.Ngarkohet zyra e finances te kryeje veprimit perkatese per dedhjen ne Buxhetin Shtetit te tarifes financiare te paguar nga operatori ekonomik " A. S."Person Fizik"<br>Derguar Bashkisë Gramsh me nregj.4746 date 15/11/2022. |

| | | |
|---|---|---|
| Gramsh.<br>2. Te shpalle absolutisht te pavlefshëm vëndimin e Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave me Nr.4594/2 prot., date 09.11.2022<br>3.Ngarkohet zyra e finances te kryeje veprimit perkatese per dedhjen ne Buxhetin Shtetit te tarifes financiare te paguar nga operatori ekonomik " A. S."Person Fizik"<br>Derguar Bashkisë Gramsh me nr.4746 regj date 15/11/2022. | | |

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kritereve .
***Situata:***
Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr.2728 , datë 30.06.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.
***Në DST kërkohet***
2.1.1Plotësimi I kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 8.
2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës.
Kjo do të vërtetohet duke paraqitur vërtetim për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit lëshuar nga administrata tatimore.
2.3 Kapaciteti teknik:
2.2.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:
a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

***Ne DST kërkohet 2.2.2;*** 1 Mjet transporti vet shkarkues me vinç me kapacitet mbajtës mbi 3.5 ton; 1 Pronësi ose me qira ; 2 Mjet transporti vetëshkarkues mekapacitet mbajtës mbi 3.5 ton; 1 Pronësi ose me qira.

*Mjetet e marra me qera nga G. Shpk janë të deklaruar në një tender tjetër nga G. Shpk dhe nuk ka një dokument ligjor te perfundimitapo zgjidhjes se të kontratës dhe detyrimeve tatimore qe ky operator kishte ne tenderin e meparshem. Pavaresishte se operatori ekonomik ka marre një deklarate nga përfaqësuesi i palës supervisore se ka mabaruar punimet përsëri detyrimet kontraktuala janë në fuqi.*

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 7 persona për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.
2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë punëtorë të çertifikuar për përdorimin e mjeteve prerëse (motosharrave) në pyje dhe pajisje e veshje speciale për sigurimin në punë të jetës së punonjësve.
2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të mos ketë kryer vepër penale apo kundërvajtje administrative në fondin pyjor e kullosor kombëtar lëshuar nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë OE, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 01.12.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

| Nr | Operatori ekonomi | Oferta lekë pa TVSh | Kualifikuar/S'kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | OE"A. S." P.F. | 9,051,200 lekë pa TVSH<br>Tenderi i dates 01.12.2022 ora 8.30. | Kualifikuar |
| 2 | OE"A. S. | Tenderi i dates 24.10..2022 ora 09.00. | Skualifikuar<br>Shtojca 8 pika 6 dhe 7 është plotesuar qe OE është konsultuar ne lidhje me oferten e tij.<br>-Mjetet e marra me qera nga G. Shpk jane te deklaruar ne nje tender tjeter nga G. aktualisht e ka fituar kete tender .<br>- Nga deklarata tatimore muajin e fundit rezultojne 0 punonjes 2 prej te cileve jane punesuar pe rhere te pare ditet e fundit |

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 05.12.2022 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ishte vetëm një operator pjesëmarrës janë s'kualifikuar OE "A. S." ne tenderin e pare me date 24.10.2022, është kualifikuar OE "A. S." ne tenderin e datës 01.12.2022. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK me vendim nr.123 më datë 05.12.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE "A. S." për të cilën është lidhur kontrata datë 06.12.2022 për vlerën 9,051,200 lekë pa TVSH dhe vlera 10,861,440 lekë me TVSH, dhe me afat 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e OE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se janë paraqitur ankesa nga OE "A. S.", duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK.
Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka marrë vendimin nr.115 date 17/11/2022 me të cilin ka vendosur pezullimin e vazhdimit të procedurës dhe caktimin e një Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës të përbërë nga
1.X. B.
2.A. S.

3.A. C.
Me relacionin nr.4559/1 date 09/11/2022 Komisioni i shqyrtimit te ankesave shqyrtoi ankesën e paraqitur nga OE "A. S." Person Fizik " pasi me vendim KVO-se date 02.11.2022 operatori ekonomik është skualifikuar për arsyet:
-Shtojca 8 pika 6 dhe 7 është plotësuar qe OE është konsultuar ne lidhje me oferten e tij.
-Mjetet e marra me qera nga G. Shpk janë të deklaruar në një tender tjetër nga G. aktualisht e ka fituar ketë tender .
- Nga deklarata tatimore muajin e fundit rezultojnë 0 punonjës 2 prej të cilëve janë punësuar për here te pare ditët e fundit.
1-Lidhur me piken e pare KSHA gjykon se plotësimi jo ne formën e duhur e deklaratës vlerësohet si gabim shtypi i cili nuk cenon ne thelb ofertën , mund te korrigjohet pa prekur përmbajtjen , duke e konsideruar ketë si devijim të vogël.
2-Lidhur me piken e dyte KSHA bazuar ne "Njoftimin për përfundimin e punimeve " regjistruar me nr. 4565/1 prot date 04.11.2022 keto punime kane përfunduar ne date 01.11.2022 para daljes se mbylljes se procesit te vlerësimit te KVO-se.
Duke qene se qeradhenesi ika pasur te dyja kontratat me Autoritetin Kontraktor qe zhvillon procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, KVO kishte detyrimin , mundësinë dhe kohen te merrte informacionin lidhur me gjendjen dhe fazën e punimeve të këtyre kontratave , dhe duhej te s'kualifikonte ankuesin për këtë shkak kur punimet kane përfunduar para përfundimit te procesit te vlerësimit.
3- Lidhur me piken e trete për kriterin e kualifikimit përcaktohet qartësisht se kërkohen minimalit 7 punonjës për muajin e fundit dhe ky kriter konsiderohet i përmbushur duke deklaruar këtë në Formularin Përmbledhësë të vete deklarimit .Referuar Vërtetimit për numrin e punonjësve NR.T07161173 date 03.11.2022 bashkangjitur formularit të ankesës nga operatori ekonomik ankimues dhe liste pagesës së sigurimeve shoqërore e shëndetësorë e periudhës shtator 2022 , dorëzuar ne SPE , KSHA konstaton se ankuesi"Andres Shtepenja" për muajin shtator ka pasur te siguruar 7 punonjës , duke përmbushur kriterin e përcaktuar nga Autoriteti Kontaktor.
Sa u analizua me sipër Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave "VENDOSI"
Te pranoje ankesën e paraqitur nga ana operatorit ekonomik " A. S." person fizik , për procedurën " e hapur e thjeshtuar" me objekt "Blerje dru zjarri pelet për vitin shkollor 2022-2023 " me nr. REF -45197-10-11-2022, zhvilluar ne datën 24.10.2022, autoriteti kontraktor , Bashkia Gramsh.
Komissioni i shqyrtimin te ankesave A. S., Ing. A. C., E. H..
Me shkresen nr.4594/2 date 09.11.2022 nga Bashkia Gramsh , Njesia e Prokurimit është kthyer përgjigje ankesës se operatorit ekonomik "A. S." person fizik bazuar ne vendimin e KSHA i pranohet ankesa e paraqitur për A. S." person fizik , për procedurën " e hapur e thjeshtuar" me objekt "Blerje dru zjarri pëllet për vitin shkollor 2022-2023 " me nr. REF -45197-10-11-2022, zhvilluar ne datën 24.10.2022.
**Konstatojmë si vijon se** *Komisioni i Prokurimit Publik Vendim Nr. 1113 date 15/11/2022*
*1.Të mos pranoje ankesën e operatorit ekonomik " A. S." Person Fizik për procedurën e prokurimit "Procedure e hapur , e thjeshtuar" me Nr. REF. -45197-10-11-2022me objekt "Blerje dru zjarri dhe pëllet për vitin shkollor 2022-2023", me fond limit 9.062.750 leke pa Tvsh , zhvilluar në datën 24.10.2022 nga autoriteti kontraktor , Bashkia Gramsh.*
*2. Te shpalle absolutisht te pavlefshëm vendimin e Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave me Nr.4594/2 prot., date 09.11.2022.*
*3.Ngarkohet zyra e financës të kryeje veprimit përkatëse për derdhjen ne Buxhetin Shtetit të tarifës financiare te paguar nga operatori ekonomik " A. S." Person Fizik"*
*Dërguar Bashkisë Gramsh me nr.4746 regj date 15/11/2022*

Pra Komisioni i Prokurimit Publik ka shpallur te pavlefshem vendimin e Komisionit të Shqyrtimit te Ankesave te caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor te Bashkisë Gramsh dhe nuk ka legjitimuar ankesën e operatorit ekonomik OE"A. S.

Shpallja fitues e operatorit ekonomik A. S." Person Fizik nga KVO është bazuar ne dokumentacion jote plote te paraqitur nga operatori ekonomik sepse
1.Pavaresisht se KPP nuk ka legjitimuar autoritetin ekonomik A. S." Person Fizik
2.Automjetet e marra me qera nga autoriteti ekonomik A. S." Person Fizik bazuar ne aktmarrëveshjen me G. SHPK efektet e mëparshme te kontratës se kësaj te fundit me Bashkinë e Gramshit janë të pa zgjidhura nga palët .
neni 46"Kualifikimi i ofertuesve". pika 1, ku thuhet
Operatoret ekonomik , per te marre pjese në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur te gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.
Nenin 53 "Kualifikimi i ofertuesve" pika 1 ku thuhet:
3.Autoriteti kontraktor , në zbatim te pikës 4 te këtij neni , vlerëson oferte te vlefshme , vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjithë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit , pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 te këtij ligji.
**Sa me sipër KVO** është bazuar në shpalljen fitues të operatorit ekonomik "A. S." Person Fizik jo në dokumentacionin ligjor të parashikuar nga ligji për "Për prokurimet publike"
**Kriteri:**
Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
**Shkaku:**
Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me ***përgjegjësi:*** *KVO.*
**Ndikimi/Efekti:** Mos argumentim në aplikimin e kritereve të vendosura.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## III. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *" Rikonstruksioni sistemimi , Fshatit Pishaj"*

| **a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *" Rikonstruksioni sistemimi , Fshatit Pishaj".* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E Hapur e Thjeshtuar REF.-31147-05-30-2022<br>Urdhri nr. 1295 prot , datë 29/03/2022 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>Urdhri nr. 81 prot., datë 29/03/2022.<br><br>1. L. Z..<br>2. Ing A. B..<br>3. .E. C. | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr.80 prot., datë 29/03/2022.<br><br>1. .X. B. Kryetar<br>2. .Ing. E. S.<br>3. .B. A. |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>8.331.823 lekë | **5. Oferta fituese, vlera fituese:**<br>Operatori Fitues:<br>8,242,210 lekë pa tvsh. | **6. Diferenca me fondin limit**<br>89 613 lekë pa tvsh |
| ***7/1 Data e hapjes së tenderit:***<br>*Data 10.06.2002 ora 10:00*<br>***7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 90 ditë*** | **8. Burimi Financimit**<br>Buxheti i Bashkisë | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender, "I."SH.P.K./**OE**<br>b) G." SH.P.K. & "V."SH.P.K. **B/OE**<br>S'kualifikuar"I."SH.P.K./**OE,** |

| | | |
|---|---|---|
| | | c) Kualifikuar"G." SH.P.K. & "V."SH.P.K. **B/OE** |
| **10. Ankimime AK**-s'ka/ka**; ka APP–**s'ka/ka**; KPP**-s'ka/ka | **11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 3035 prot., datë 02.08.2022** | **12.Përgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK** |

**<u>Titulli i gjetjes</u>:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kritereve .
***<u>Situata:</u>***
***Hartimi i kritereve: 1.*** Kërkesa e pikes 2.3.4 e cila kërkon 1 Inxhinier Ndërtimi, 1 Inxhinier Mjedisi 1. 1 Inxhinier Topograf/Markshejder është kërkesë jo në përputhje me preventivin e punimeve. Nuk parashikohen punimeve konkrete për të kërkuar këtë kategori punimesh.

2. Kërkesa e pikës 2.3.5 e cila kërkon 4 punonjës hekurkthyes; 4 punonjës karpentierë; 2 punonjës manovratorë patentë manovrimi nga DPSHTRR, 2 punonjës shoferë, është kërkesë e ekzagjeruar në raport me zërat e preventiv.

I kërkohet Operatori ekonomik ofertues që duhet të ketë në listë pagesë mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë punë, diplomë, licencë, Urdhër Mjeku. Mjeku i punës ose duhet të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues ose duhet të paraqitet një kontratë për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të liçensuar sipas ligjit. kërkesa për mjek është e tepërt dhe nuk ka lidhje me përcaktimin e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM -në nr. 632, date 15.07.2015 e cila ndryshuar me VKM nr.108 , date 09.02.2021 '*Për aftësitë që duhen që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit ,personat e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë"* pika 1 , ku përcaktohet se *"pas pikës 5 , e kreut II , shtohet pika 6, me përmbajtje si me poshtë vijon;"6 punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B" në zbatim të pikës 2 , kreut II të këtij vendimi , për çdo 700 punëmarrës sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës . Ndërsa punëdhënësit grupeve "C" dhe "D" , për çdo 1500 punonjës , sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar jashtë.*

***3.*** Kërkesa e pikës *2.3.7 e DST e cila kërkon një numër mesatarisht 30 (tridhjetë) personave, për 3 (tre) muajt e fundit,* është kërkesë e ekzagjeruar në raport me zërat e preventiv.

*4.* Kërkesa e pikës ***2.3.8*** *e DST e cila kërkon 2* Kamiona (kapaciteti mbajtës minimum 10 (dhjete) ton dhe maksimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton për secilin kamion, 2. Kamiona (kapaciteti mbajtës minimum) 3.5 (tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5 (pesë) ton për secilin kamion, 1 Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5 (një pik pesë) ton dhe maksimumi 2 (dy) ton për secilin kamionçinë, janë kërkesa të ekzagjeruar dhe nuk i shërben AK. Përbën kufizim për OE.

5. Kërkesa e pikës ***2.3.8*** *e DST e cila kërkon 1.* Dumper kantieri, Fadrome (Eskavator) me goma 2 copë, Autobetoniere 2 copë, Minieskavator 2 copë, Mini Ngarkues Dheu 1 copë, Autovinc 1 copë, Eskavator me zinxhirë 1 copë, Sqarojme se ky numër mjetesh i kërkuar sa mësipërm , nuk është i argumentuar me zbërthimin dhe grafikun e punimeve

Vlerësimi i ofertave

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë nr. 2987 prot date 27.07.2022 , në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga G." SH.P.K. & "V." SH.P.K. B/OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK me vendim nr. 58 date 27.07.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "G." SH.P.K. & "V." SH.P.K. B/OE" për të cilën është lidhur kontrata datë 02.08.2022 për vlerën 8,242,210 lekë pa TVSH dhe vlera 9,890,652 lekë me TVSH, dhe me afat 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Bazuar ne kontratën e bashkëpunimit date 16.06.2022 palët kontraktuese Shoqëria "V. K. " SHPK e regjistruar si person juridik me nr. Nipti K.....L dhe Shoqëria "G."SHPK me nipt L.........L për të sanksionuar marrëveshjen për krijimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive

me qellim pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me REF -31147-05-30-2022 objekt "Rikonstruksion, sistemim i fshatit Pishaj" që zhvillohet nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Gramsh.
Palet rane dakort që përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e objektit të mësipërm të jete si me poshtë :
"G." Sh.p.k. 13.72% dhe "V." Sh.p.k. 86.28% zërat konkrete te punimeve qe do te kryeje secili nga anëtaret e këtij bashkimi do te jete sipas preventivit te ndarjes se punimeve bashkëlidhur kësaj kontrate.
Nga verifikim i dokumenntacionit të operatorit ekonomik "V. "Shpk në bilancin e vitit 2019 figuron Dumper kantieri 1 copë por nga verifikimi i dokumentacionit të "V. "Shpk nuk figuron asnjë dokument Dumper kantieri b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme
Në një kohe kur një nga kriteret e skualifikimit te OE "I." Sh.P.K.
Nga ana e AK te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të përshkruara në DST është kërkuar nga OE ofertues të disponojë në total 1 (një) Dumper Kantieri (në pronësi ose me qera) si mjete për realizimin e kontratës. Nga ana e OE "I." Sh.P.K ky kriter nuk është plotësuar pasi në dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga ky OE nuk rezulton i disponueshëm asnjë Dumper Kantieri si mjet për realizimin e kontratës.
Për sa mësipërm KVO duhet te kishte rishikuar dokumentacionin për operatorin ekonomik G." SH.P.K. & "V." SH.P.K. B/OE pasi ka përdorur kritere skualifikuese për një subjekt ekonomik ndërkohë qe për subjektin tjetër ekonomik nuk janë konsideruar skualifikuese.

**Kriteri:**

Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi Njësia e prokurimit si KVO.*

**Ndikimi/Efekti:** Mos argumentim në aplikimin e kritereve të vendosura.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## IV. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Sistemim Asfaltim lagja Holta".

| **a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *" Sistemim Asfaltim lagja Holta".* | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Procedure e hapur "**<br>"<br>REF -44325-10-04-2022<br>Urdhri nr. 3752 prot., datë 16.09.2022 | **1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit**<br>Urdhri nr. 271, datë 16.09.2022<br>1.L. Z.<br>2.Ing A. B.<br>3.E. C. | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1.L. Z.<br>2.Ing A. B.<br>3.E. C. | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr.272 prot., datë 16.09.2022<br><br>1.X. B.<br>2. Ing.E. S.<br>3. B. A.. |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>17.500.000 lekë | **5. Oferta fituese, vlera fituese:**<br>1 6 940 764 Leke Operatori Fitues:<br>lekë pa tvsh. | | **6. Diferenca me fondin limit**<br>559,236 lekë pa tvsh |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 17.10.2022 ora 10.00 | **8. Burimi Financimit**<br>Buxheti i Bashkisë. | | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender, **OE "A."Sh.p.k. "BOE-"K."SH.P.K.&"V."SH.P.K.**<br>b) S'kualifikuar **OE "A."Sh.p.k OE,**<br>c) Kualifikuar "BOE- |
| **7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 70 ditë** | | | |

| | | |
|---|---|---|
| | | "K."SH.P.K.&"V."SH.P.K.**B/OE** |
| | **11. Data e lidhjes të kontratës:**<br>**Nr. 5390 prot., datë 28.12.2022** | |

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin Urdhri nr. 271, datë 16.09.2022 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit", i përbërë nga 1.L. Z. Kryetar , Drejtor i Drejtorisë se Shërbimeve; 2.Ing A. B.. Anetar , Inspektor pranë IMT se; 3.E. C. Anëtar , Specialist pranë Sektorit te Menaxhimit Financiar.
Sipas procesverbalit të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e studimit, analizen e çmimeve teknike, grafiku i punimeve, preventivin memec, dhe preventivin e punimeve pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, nga N. SH.P.K. duke përllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezulton të jetë **17,500,000** lekë pa tvsh. Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me urdhrin nr. 271 datë 16.09.2022 "Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike", i përbërë prej, 1.L. Z.; 2.Ing A. B.. 3.E. C..
.
**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve të vendosura.
**Situata: Hartimi i kritereve:** 1.Kërkesa e pikës 3.4. e cila kërkon që OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa për tre muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm, Sqarojmë se; kërkesa për mjek është e tepërt dhe nuk ka lidhje me përcaktimin e kontratës dhe është ne kundërshtim me VKM -ne nr.632, date 15.07.2015 e cila ndryshuar me VKM nr.108 , date 09.02.2021 'Per aftësitë qe duhen qe duhet te plotësojnë pjesëmarrësit ,personat e specializuara, qe merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" pika 1 ,
ku përcaktohet se pas pikës 5 , e kreut II , shtohet pika 6, me përmbajtje si me poshtë vijon;"6 punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B" ne zbatim të pikës 2 , kreut II te këtij vendimi , për çdo 700 punëmarrës sigurojnë shërbimin mjekësor ne ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës . Ndërsa punëdhënësit grupeve "C" dhe "D" , për çdo 1500 punonjës , sigurojnë shërbimin mjekësor ne ndërmarrje nëpërmjet mjekut te punës te kontraktuar jashtë
**2. Ne DST kërkohet** Operatori ekonomik ofertues ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa për tre muajt e fundit, 1 (një) Inxhinier Elektrik, 1 (një) inxhinier i pajisur me çertifikatë për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", 1 (një) punonjës specialist qe te disponojnë certifikata e trajnimit si "Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në pune" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë ne kantier", si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë. Janë kërkesa të ekzagjeruar dhe jo në përputhje me punimet. NJP, nuk ka argumentuar nevojën për ekspertizën e këtyre inxhinierëve. Nuk ka zëra punimesh në preventiv.

3. Kërkesa e pikes 2.3.6 e cila kërkon që OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 55 (pesë dhjetë e pesë) persona. Numeri prej 55 punonjesish është i ekzagjeruar dhe nuk është argumentuar ky numer bazuar ne zberthimin e e preventivit dhe grafikun e punimeve. Ne çdo rast nisur nga data e zhvillimit te tenderit do te ishte me e pershtatshme qe te zhvendosej periudha kohore , duke perfshire muajin

e fundit te mundshem per disponimin e listpagesave , per te matur nje informacion sa me koherent ne lidhje me kete kriter.

**4. Në DST Janë kerkuar 2** Automjet transporti vetshkarkuese mbi 18 ton, 2. Kamionçine 1.5-5, 2 Kamionçine 0.5-3 ton, 2 Ekskavator me zinxhirë, 1 Ekskavator me goma, 1 Fadrome me goma, 1 Minieskavator, 1 Minifadrome të pajisur me fshesë për pastrimin e rrugës, 1. Minifadrome me goma, 1 Greider nivelues i targuar, 1 Koke tërheqëse + Rimorkjator, 1 Rrul ngjeshes 1.6-4.5 ton, 1 Rrul ngjeshës hekur-gome 6.5 ton, 1 Rrul ngjeshes 8 ton, 1 Rrul ngjeshës 12 ton, 1 Asfalto shtruese. *Sqarojme se ky numer se disponimi i mjeteve të mesiperme është i ekzagjeruar dhe nuk është argumentuar ky numer bazuar në zbërthimin e preventivit dhe grafikun e punimeve.*

***Situata 2 Vlersimi i ofertave***

***Nga kontrolli i i dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik "V. Sh.p.k. rezultoi se certifikatat*** *te sistemit te menaxhimit te cilesise ,sigurise ,mjedisit ,dhe manaxhimit te nergjise rezultoi se është pajisur me certifitat* ,ISO 9001;2015 , certifikate e sistemit te menaxhimit te cilesise ,ISO 39001;2012 sistemi i menaxhimit te sigurise se trafikut rrugor, ISO 50001;2018 ,certifikate per menaxhimin e nergjise ,certikate e sistemit per menaxhimin mjedisor, PASS 99:2012, sistemi i menaxhimit te integruar , ISO 45001;2018 certifikate e sistemit te menaxhimit e sigurisë dhe shëndetit ne pune te gjitha ***certifikatat ishin te vlefshme për kohen e zhvillimit te tenderit dhe gjate periudhës se parashikuar për zbatimin e kantatës.***

Nga verifikimi i dokumentacionit tega kontrolli i dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik "K." Sh.p.k. rezultoi se është pajisur me certifikatat ISO 9001;2015 e sistemit te menaxhimit të cilësisë ,ISO 45001;2018 për shëndetin dhe sigurinë ne pune ,ISO 14001;2015 për sistemin e menaxhimit te mjedisit ,EN ISO 39001:2012 certifikate nr.0106R2022, BS PAS 99:2012 të gjitha certifikatat ishin të vlefshme për kohen e zhvillimit të tenderit dhe gjatë periudhës së parashikuar për zbatimin e kantatës, i gjithë dokumentacioni ishin kopje të motorizuara .

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë OE "A."Sh.p.k. dhe BOE K."SH.P.K.&"V."SH.P.K. , për të cilët, referuar procesverbalit datën 17.10.2022 , KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

| Nr | Operatori ekonomi | Oferta lekë pa TVSh | Kualifikuar/S'kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | K."SH.P.K.&"V."SH.P.K.BOE | 1 6 940 764 | Kualifikuar |
| 2 | OE "A."Sh.p.k | | *Skualifikohet* |
| | | | |

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 27.12.2022 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga OE "A." Sh.p.k. "BOE-"K."SH.P.K.&"V."SH.P.K. operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar OE "A." Sh.p.k janë kualifikuar "BOE-"K." SH.P.K.&"V." SH.P.K. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 27.12.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë ""BOE-"K." SH.P.K. & "V."SH.P.K." për të cilën është lidhur kontrata datë 28.12.2022 për vlerën 1 6 940 764 lekë pa TVSH dhe vlera 20.328.917 lekë me TVSH, dhe me afat 70 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Për sa me sipër Skualifikimi i operatorit ekonomik OE "A." Sh.p.k është bazuar ne mungesën e dokumentacionit te DST, përkatësisht në pikat 2.3.4 ,2.3.5, 2.3.7 , pikën 2.3.9 . dhe kualifikimi i bashkimin e opeartoreve ekonomik "BOE-"K."SH.P.K.&"V."SH.P.K. është i drejte.

**Kriteri:**
Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.
**Shkaku:**
Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me *përgjegjësi Njësia e prokurimit.*
**Ndikimi/Efekti:** Mos argumentim në aplikimin e kritereve të vendosura.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

## V. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemim Asfaltim i Lagjes Dellinje"

| **a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Sistemim Asfaltim i Lagjes Dellinje"".* | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"Procedure e hapur , e thjeshtuar"<br>REF-47882-10-31-2022<br>Urdhri nr.4441 prot., datë 27.10.2022 | **1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit**<br>Urdhri nr.328 datë 27.10.2022<br>1. L. Z. Kryetar.<br>2. Ing . A. B.<br>3. E. C. | **2 Njësia e Prokurimit**<br><br>1. L. Z. Kryetar.<br>2 Ing . A. B.<br>3.E. C. | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr.329 prot., datë 27.10.2022<br><br>1. X. B.<br>2.Ing. E. S.<br>3.B. A.<br>Te ndryshohet komisioni i vleresimit te ofertave me Urdher nr.336 date 07.11.2022<br>1.X. B.<br>2.A. S.<br>3.A. C. |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>8 333 120 (tete milion e treqind e tre mije e njeqind e njezet ) lekë | **5. Oferta fituese, vlera fituese:**<br>Operatori Fitues:<br>8 333 120 (tete milion e treqind e tre mije e njeqind e njezet ) lekë pa tvsh. | | **6. Diferenca me fondin limit**<br>0 lekë pa tvsh |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 11.11.2022 0ra 10.00<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3(tre) muaj** | **8. Burimi Financimit**<br>Buxhei i Bashkisë | | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender,<br>**BOE "R.G." Sh.p.k.& "D."SH.P.K.**<br>b) S'kualifikuar ska<br>c) Kualifikuar BOE "R.G." Sh.p.k.& "D."SH.P.K. |
| | **11. Data e lidhjes të kontratës:**<br>**Nr. 5134 prot., datë 09.12.2022** | | |

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve të vendosura.
**Situata: Hartimi i kritereve:**

**Ne DST është kerkuar** *pika 2.3.3.*
Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale , si dhe në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave ose staf mbështëtes:
- 1 (një) Inxhinier ndërtimi
- 1(nj) Inxhinier hidroteknik

- 1(nje)Inxhinier elektrik
- 1(nje)Teknik topograf/makshajder

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë :

- 2(dy) Murator, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë";
- 1(nje) Karpantieri, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë".
- 3 (tre)Manovrator shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR*;*

**Te gjithe specialistet** e mesiperm duhet te jene te pajisur me certifikatat e kualifikimit te leshuara nga IQT apo subjekete te tjera te autorizuara dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise per periudhen e parashikur. Perpunonjesit e mesiperm te paraqitet , deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik nga IQT dhe te figurojne ne listpagesat.

**Sqarojme se ky** numer nuk është argumrntuar me zberthimin e preventivit dhe grafikun e punimeve. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 22 (njezet e dy) punonjës të siguruar, për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për muajin e kërkuar;

***Listëpagesa**t e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.*

***Kontratat me punonjesit** jane te lidhura me punonjesit jane bere para noterit me por ka edhe raste si kontrata e punes individuale midis "R.G.J "SHPK dhe punonjesve K. S. e lidhur ne vitin 2014 ,punonjesit fatjon Shahini e lidhur pa percatuar periudhen kohore .Keto kontrata duhet ti referohen ndryshimeve te pages minimale bazuar ne VKM perkatese dhe detyrimeve tatimore.*

**Ne DST është kerkuar disponimi i mjeteve te meposhtme** *ne piken 2.3.6.*

Operatori Ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

| Nr | Lloji i mjetit/pajisjes teknike | Statusi | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Eskavator me zinxhira | Në pronësi ose me qira | 2 |
| 2 | Bobcat | Në pronësi ose me qira,faturë tatimore | 1 |
| 3 | Rimorkiator | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 4 | Fadroma me goma | Në pronësi ose me qira | 2 |
| 5 | Autobetoniere | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 6 | Autobetoniere kantiere | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 7 | Makina deri ne 10ton | Në pronësi ose me qira | 2 |
| 8 | Makina deri ne 10-20ton | Në pronësi ose me qira | 2 |
| 9 | Kamiocina | Në pronësi ose me qira | 2 |
| 10 | Asfalte shtruese | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 11 | Autobitumatrice ose bitumatrice | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 12 | Grejder | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 13 | Rrul | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 14 | Nyje prodhinit inerteve | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 15 | Nyje prodhimit betonit | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 16 | Nyje prodhimit te asfaltit | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 17 | Bot uji | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 18 | Tokmak | Në pronësi ose me qira | 1 |
| 19 | Vibrator | Në pronësi ose me qira | |

***Sqarojme s****e ky numer mjetesh i kerkuar me siper nuk është argumentuar ne zberthimin e preventivit dhe grafikun dhe punimeve .*

• Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -certifikata e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
• Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -kontrata e qirasë; -certifikata e pronësisë së qiradhënësit; -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
• Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes / akt-zhdoganimi / faturë tatimore / çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e vlefshme.
• Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë për vendodhjen e mjeteve/pajisjeve të deklaruara, me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

**Ne DST është kerkuar**

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetë deklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra

në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.
Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.
2.3.7 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 9001- 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente , certifikatën e menaxhimit mjedisor ISO 14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, çertifikatën e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001-2018 ( e vlefshme) ose ekuivalente, Certifikimi i Sistemit te Menaxhimit te Përgjegjësisë Sociale SA 8000-2014 (e vlefshme) ose ekuivalente.

***"R. " SHPK është e pajisur me certifikatat ISO** 9001:2015 , ISO **14001:2015 , SA 8000:2014 ,ISO 45001:2018.***

*Të gjitha çertifikata e mësipërme janë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

***b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë vetëm BOE "R.G." Sh.p.k.& "D."SH.P.K, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 1, të datës 11.11.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

| Nr | Operatori ekonomi | Oferta lekë pa TVSh | Kualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | BOE "R.G." Sh.p.k.& "D."SH.P.K. | | Kualifikuar |

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 05.12.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka qene pjesëmarrës vetëm BOE "R.G." Sh.p.k.& "D."SH.P.K., janë kualifikuar BOE "R.G." Sh.p.k.& "D." SH.P.K. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK me vendim nr.122 date 05.12.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "BOE "R.G." Sh.p.k.& "D." SH.P.K. për të cilën është lidhur kontrata datë 09.12.2022 për vlerën lekë 8,333,120 (tete milion e treqind e tre mijë e njeqind e njezetë ) lekë pa TVSH dhe vlera 9,879,378 lekë me TVSH, dhe me afat 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

**Persa me sipër** kualifikimi i bashkimit te operatoreve BOE "R.G." Sh.p.k.& "D."SH.P.K dhe devijimet e konstatuara nuk janë substanciale qe te ndikojnë ne procedurat e shpalljes fitues te te bashkimit te operatoreve BOE "R.G." Sh.p.k.& "D."SH.P.K.

Propozimi tek Titullari i Autoriteti Kontarktor si fitues e bashkimit te operatoreve BOE "R.G." Sh.p.k.& "D."SH.P.K plotëson kriteret e DST.

**4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.**

Në zbatim të pikës 4.4/4 me objekt: "*Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të*

*lidhura me operatorët ekonomik*" të Programit të Auditimit, në Bashkinë Gramsh , nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë 01.01.2021 deri me datën 31.12.2022.
Nga grupi i auditimit, u arsyetua, për t'u audituar kontrata për punë publike, pasqyruar në tabelën nr. 1, me vlerë **179,977,806 lekë pa TVSH ose 215,973,367.2 lekë me TVSH ,** mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet publike, përputhshmërinë me projektet e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimi, zbatimi i afateve të kontratave si dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera.

**Tabela nr. 1. Kontrata zbatimi të audituara**

| Nr | Objekti | Kontraktori Sipërmarrës | Vlera e kontratës me TVSH |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| | **Viti 2021** | | |
| 1 | Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)" Bashkia Gramsh | BOE "B." SHPK & "G." SHPK | 95,993,329.2 |
| 2 | Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj" Bashkia Gramsh | BOE "V." SHPK & "E." SHPK & "L." SHPK | 96,995,778 |
| 3 | Sistemim - asfaltim lagjia "Ish Reparti Ushtarak" Bashkia Gramsh | BOE "F." SHPK & "S." SHPK | 22,984,260 |
| | **Shuma në lekë me TVSH** | | **215,973,367.2** |

**Burimi: Bashkia Gramsh , përpunuar nga grupi i auditimit.**

**Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:**

**1.** Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt "**Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)"** Bashkia Gramsh , me këto të dhëna.

| **13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II) " Gramsh.** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. .... Prot., datë 04.06.2021<br>BOE "B." SHPK & "G." SHPK | **15.Vlera e kontratës**<br>Vl e prev ofertues 95,993,329.20 lekë me TVSH | **16.Likuiduar:**<br>Sit. 1 në vlerën 19,308,448 lekë me TVSH<br>Sit. 2 në vlerën 27,107,965 lekë me TVSH<br>Sit. 3 në vlerën 43,299,882 lekë me TVSH<br>Sit përfundimtar, në vlerën 5,949,790 lekë me TVSH |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>-Vlera 95,979,232 lekë me TVSH. | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 14.06.2021<br>Përfundimi punimeve: 18.11.2021 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>40 ditë |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE "T" sh.p.k | Licenca MK.0919/11 | Kontratë me nr. 1856 prot, datë 21.05.2021 |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>"G." sh.p.k | Licenca Nr: MK.2928/6 dhe MK.2892/3 | Kontratë nr. 4403 prot, datë 22.11.2021 |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë: 10.12.2021 | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Me datë 27.12.2021 objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Gramsh. Urdhër nr. --., datë ---- është ngritur grupi me përbërje: A. Ç., E. S. *dhe A, N.*. | |

**ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:**

►**<u>Titulli i Gjetjes 1</u>:** Punime ndërtimi të pa kryera në objektin "Sistemim asfaltim rruga Skënderbeg (Loti II), Bashkia Gramsh.

**<u>Përshkrimi i Situatës</u>:**

Nga auditimi i situacioneve pjesore progresive dhe situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit,

lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se zëri "Gërmim kasonete" është pasqyruar në librezën e masave jo saktësisht në volumin 548.16 $m^3$ dhe në vlerën **154,581 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

**Zëri 6(3.25/a) Gërmim kasonete.**

Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 4090 $m^3$ gërmim dheu, me çmim 282 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 4090 $m^3$ gërmim dheu, me çmim 282 lekë. Libreza e masave, pasqyron 4090 $m^3$ gërmim kasonete, detajuar sipas piketave nga seksioni SC1 deri në seksionin SC203.

Nga auditimi i punimeve në objekt rezulton se, ky zë punë është realizuar në volumin 3,559 $m^3$ dhe jo në volumin 4090 $m^3$, sepse:

- në seksionet SC2 –SC 4, me l=40 ml, seksioni mesatar tërthor është 0.606 m2 dhe jo 1.213 m2 (volumi prej 24.26 $m^3$ rezulton i pa sistemuar saktë në librezën e masave).
- në seksionet SC33 –SC 36, me l=100 ml, seksioni mesatar tërthor është 0.647 $m^2$ dhe jo 1.295 m2 (volumi prej 64.7 $m^3$ rezulton i pa sistemuar saktë në librezën e masave).
- në seksionet SC41 –SC 50, me l=180 ml, seksioni mesatar tërthor është 0.558 m2 dhe jo 1.117 m2 (volumi prej 100.57 m3 rezulton i pa sistemuar saktë në librezën e masave).
- në seksionet SC 58 –SC 72, me l=280 ml, seksioni mesatar tërthor është 0.556 m2 dhe jo 1.112 m2 (volumi prej 155.68 m3 rezulton i pa sistemuar saktë në librezën e masave).
- në seksionet SC 165 –SC 192, me l=540 ml, seksioni mesatar tërthor është 0.613 m2 dhe jo 1.226 m2 (volumi prej 202.95 m3 rezulton i pa sistemuar saktë në librezën e masave).

Sa më sipër, diferenca prej 314 m3 është librezuar jo sipas faktit dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, në vlerën **154,581 lekë pa TVSH** [548.16$m^3$ x 282 lekë].

**Kriteri:** - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. .... prot., datë 04.06.2021 .
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1856 prot., datë 21.05.2021 .

**Ndikimi/Efekti**: Pasqyrim jo i saktësuar në librezën e masave.
**Shkaku:** Nga mos azhurnimi i saktë i objektit.
**Rëndësia**: I lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Gramsh të arkëtojë vlerën prej **154,581 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve BOE "B." SHPK & "G." SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. .... prot., datë 04.06.2021 me objekt "Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)" Bashkia Gramsh.

**Si konkluzion:**

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

**1.** Sipërmarrësit të punimeve BOE "B." SHPK & "G." SHPK i janë likuiduar tepër në vlerën **154,581 lekë pa TVSH**, për pasqyrim jo të saktë në librezën e masave, të zërit "Gërmim dheu në ndërtimin e rrugës".

**2.** Për ndërtimin projektin e zbatimit të investimit me objekt: "Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II) " nga Titullari i Bashkisë Gramsh nuk është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore, veprim ky në kundërshtim, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar. Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Gramsh.

**3**. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, nuk ka kryer oponencën teknike për projektin e zbatimit me objekt: "Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)". Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, neni 6.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

***1. Znj. D.Q.,*** *në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.*

►**<u>Titulli i Gjetjes 2</u>:** Mos realizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: "Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)" Bashkia Gramsh.

**Situata:**

Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2020 nga shoqëria "D." SH.P.K përfaqësuar nga Z. N. X. me Licencë N. 6596/4. Projekti i zbatimit është miratuar nga Bashkia Gramsh.

Për projektin e zbatimit të objektit: "Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)" nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Gramsh. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Gramsh.

**<u>Kriteri</u>:** Ligji Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6.

**<u>Ndikimi/Efekti</u>:** Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

**<u>Shkaku</u>:** Neglizhencë e Bashkisë Gramsh .

**<u>Rëndësia</u>:** E lartë

**<u>Rekomandimi:</u>** Bashkia Gramsh të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike për të gjitha ndërtimet publike me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, si dhe për objektet jo publike, sipas legjislacionit në fuqi.

►**<u>Titulli i Gjetjes 3</u>:** Mos realizim i Lejes Infrastrukturore të projektit të zbatimit me objekt: "Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)" Bashkia Gramsh.

**<u>Situata</u>:**

Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objekt: "Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)" u konstatua se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Bulqizë, nuk ka miratuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK Bashkisë Gramsh.

**<u>Kriteri</u>:** Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

**<u>Ndikimi/Efekti</u>:** Realizimi i projektit të zbatimit pa Leje Ndërtimi Infrastrukturore.

**<u>Shkaku</u>:** Neglizhencë e Bashkisë Gramsh .

**<u>Rëndësia</u>:** E lartë

**<u>Rekomandimi:</u>** Bashkia Gramsh të marrë masa që të pajisin me Leje Ndërtimi Infrastrukturore

për çdo projekt zbatimi sipas legjislacionit në fuqi.
***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
***1. Z. K. T.,*** *në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Gramsh.*

***(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të zbatimit të punimeve, janë trajtuar në akt-konstatimi Nr. 4, datë 05.05.2023 , dorëzuar me protokoll në Bashkinë Gramsh )***

**2.** Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt "**Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj"** Bashkia Gramsh , me këto të dhëna.

| **13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj" Gramsh.** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. ..... Prot., datë 19.05.2021<br>**BOE "V." SHPK & "E." SHPK & "L." SHPK** | **15.Vlera e kontratës**<br>Vl e prev ofertues 96,995,778 lekë me TVSH | **16.Likuiduar:**<br>Sit. 1 në vlerën 28,500,000 lekë me TVSH |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>-Vlera 96,995,778 lekë me TVSH. | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 19.05.2021<br>Përfundimi punimeve: 17.11.2021 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>--- |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE "F S" sh.p.k | Licenca MK.3429/1 | Kontratë me nr. 1748 prot, datë 14.05.2021 |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>"G." sh.p.k | Licenca Nr: MK.2928/6 dhe MK.2892/3 | Kontratë nr. 4402 prot, datë 22.11.2021 |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë: 14.12.2021 | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Me datë 20.12.2021 objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Gramsh. Urdhër nr. --., datë ---- është ngritur grupi me përbërje: A. Ç., E. S. *dhe A. K.*. | |

**ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:**

►**Titulli i Gjetjes 4:** Punime ndërtimi të pa kryera në objektin "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj", Bashkia Gramsh.

**Përshkrimi i Situatës:**

Nga auditimi i situacioneve pjesore progresive dhe situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se zëri "Gërmim kasonetë" është pasqyruar në librezën e masave jo saktësisht në volumin 314 $m^3$ dhe në vlerën **267,528 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:
**Nga auditimi i realizimit të zërit 6(3.25/a) Gërmim kasonete.**
Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 7,469.64 $m^3$ gërmim dheu, me çmim 852 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 7,469.64 $m^3$ gërmim dheu, me çmim 852 lekë. Libreza e masave, pasqyron 7,469.64 $m^3$ gërmim kasonete, detajuar sipas piketave.
Nga auditimi i punimeve në objekt rezulton se, ky zë punë është realizuar në volumin 7,211.43 $m^3$ dhe jo në volumin 7,469.64 $m^3$, sepse:
- në piketat nr. 47 dhe 48 me l=27 ml, seksioni tërthor është 5 m2 dhe jo 9 m2 (volumi prej 108 $m^3$ rezulton i pa sistemuar).
- në piketën nr. 59 me l=25 ml, seksioni tërthor është 8.5 $m^2$ dhe jo 16.5 $m^2$ (volumi prej 206 $m^3$ rezulton i pa sistemuar).

Sa më sipër, diferenca prej 314 m3 është librezuar jo sipas faktit dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, në vlerën **267,528 lekë pa TVSH** [314 $m^3$ x 852 lekë].
**Kriteri:** - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. ..... prot., datë 19.05.2021 .
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1748 prot., datë 14.05.2021 .
**Ndikimi/Efekti**: Pasqyrim jo i saktësuar në librezën e masave
**Shkaku:** Nga mos azhurnimi i saktë i objektit.
**Rëndësia**: **E** mesme.
**Rekomandimi:** Bashkia Gramsh të arkëtojë vlerën prej **267,528 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve BOE "V." SHPK & "E." SHPK & "L." SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. ..... prot., datë 19.05.2021 me objekt "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj" Bashkia Gramsh.
**Si konkluzion:**
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;
**1.** Sipërmarrësit të punimeve BOE "V." SHPK & "E." SHPK & "L." SHPK i janë likuiduar në vlerën **267,528 lekë pa TVSH**, për pasqyrim jo të saktë të volumit të zërit gërmim kasonete, në librezën e masave.
**2.** Për ndërtimin projektin e zbatimit të investimit me objekt: "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj" nga Titullari i Bashkisë Gramsh nuk është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore, veprim ky në kundërshtim, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar. Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Gramsh.
**3**. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, nuk ka kryer oponencën teknike për projektin e zbatimit me objekt: "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj". Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, neni 6.
***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
***1. Z. S. B.,*** *në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.*

►**Titulli i Gjetjes 5:** Mos realizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj" Bashkia Gramsh.

**Situata:**
Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2020 nga Ing. Liliana Vllamasi me Licencë N. ---. Projekti i zbatimit është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh. Relacioni teknik; specifikimet teknike, për objektin është hartuar nga "A." SHPK.
Për projektin e zbatimit të objektit: "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj" nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Gramsh. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, neni 6 dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Gramsh.
**Kriteri:** Ligji Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6.
**Ndikimi/Efekti:** Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.
**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Gramsh .
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandimi:** Bashkia Gramsh të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike për të gjitha ndërtimet publike me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, si dhe për objektet jo publike,

sipas legjislacionit në fuqi.

►**Titulli i Gjetjes 6:** Mos realizim i Lejes Infrastrukturore të projektit të zbatimit me objekt: "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj" Bashkia Gramsh.

**Situata:**
Projekti i zbatimit është hartuar në vitin 2020 nga Ing. Liliana Vllamasi me Licencë N. ---. Projekti i zbatimit është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh. Relacioni teknik; specifikimet teknike, për objektin është hartuar nga "A." SHPK.
Për ndërtimin e investimit me objekt: "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj" nga Titullari i Bashkisë Gramsh Z. K. T. nuk është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore, veprim ky në kundërshtim, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar. Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Gramsh.
**Kriteri:** Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
**Ndikimi/Efekti:** Realizimi i projektit të zbatimit pa Leje Ndërtimi Infrastrukturore.
**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Gramsh .
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandimi:** Bashkia Gramsh të marrë masa që të pajisin me Leje Ndërtimi Infrastrukturore për çdo projekt zbatimi sipas legjislacionit në fuqi.
***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
***1. Z. K. T.,*** *në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Gramsh.*

***(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të zbatimit të punimeve, janë trajtuar në akt-konstatimi Nr. 5, datë 05.05.2023 , dorëzuar me protokoll në Bashkinë Gramsh )***

**3.** Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt "**Sistemim - asfaltim lagjia "Ish Reparti Ushtarak"** Bashkia Gramsh , me këto të dhëna.

| **13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Sistemim - asfaltim lagjia "Ish Reparti Ushtarak" " Gramsh.** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. ..... Prot., datë 28.05.2021<br>BOE "F." SHPK & "S." SHPK | **15.Vlera e kontratës**<br>Vl e prev ofertues 22,979,260 lekë me TVSH | **16.Likuiduar:**<br>Sit. 1 në vlerën 5,356,200 lekë me TVSH<br>Sit. Përf. Në vlerën 16,741,907 lekë me TVSH |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>-Vlera 22,979,260 lekë me TVSH. | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 15.06.2021<br>Përfundimi punimeve: 08.10.2021 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>Po, është bërë kërkesë për shtyrje afati me datë 06.09.2021. |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE "G." sh.p.k | Licenca MK.2928/8 | Kontratë me nr. 1813 prot, datë 19.05.2021 |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>OE "D." sh.p.k | Licenca Nr: MK.1676/11 | Kontratë nr. 4401 prot, datë 22.11.2021 |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë: 29.11.2021 | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Me datë 24.12.2021 objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Gramsh.<br>Urdhër nr. --., datë ---- është ngritur grupi me përbërje: A. Ç., E. I. dhe A. K.. | |

**ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:**

►**Titulli i Gjetjes 7:** Punime ndërtimi të pa kryera në objektin "Sistemim - asfaltim lagjja "Ish Reparti Ushtarak", Bashkia Gramsh

**Situata:**

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë dhe, të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Gramsh, në vlerën **264,970 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

**PUNIME KANALIZIME UJRA SHIU**

**Zëri 5(3.182/a) F.V Rërë nën dhe mbi tubacione HDPE 2*10 cm.**

Situacioni përfundimtar, pasqyron volumin 273.7 $m^3$ rërë me çmim 280 lekë. Libreza e masave pasqyron volumin 273.7 $m^3$ rërë me çmim 280 lekë.

Në fakt nga auditimi i realizimit të këtij zëri në objekt, si dhe i projekt preventivit rezulton se ky zë pune (3.182/a) është përfshirë si nën zë pune, në analizat e zërave: 3(3.An./3t) F.V. Tuba të brinjëzuar HDPE Ø 500 mm; 4(3.An/2t) F.V. Tuba të brinjëzuar HDPE Ø 400 mm, prandaj sa më sipër zëri "Zëri 5 (3.182/a) F.V Rërë nën dhe mbi tubacione HDPE" nuk mund të paguhet dy herë, pra si zë më vete dhe, si nën zë në analizën e çmimit për zërat [3(3.An./3t); 4(3.An/2t)].

Pra, realizimi i zërit të rërës në volumin 273.7 $m^3$ rezulton i dubluar dhe duhet të zhdëmtohet nga përfituesi (zbatuesi i punimeve).

Likuidimi i volumit 273.7 $m^3$ rërë është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, në shumën **<u>76,636 lekë pa TVSH</u>** [273.7 $m^3$ x 280 lekë].

**PUNIME NË TROTUARË**

**Zëri 5 (3.620) Shtresë pllaka trotuari betoni h=6 cm.**

Situacioni përfundimtar pasqyron 785.5 $m^2$ pllaka betoni me çmim 1,500 lekë. Libreza e masave pasqyron 785.5 $m^2$ pllaka betoni, pasqyruar në mënyrë analitike.

Nga auditimi i punimeve në objekt rezulton se, paketa e trotuarit është realizuar me 4 shtresa dhe konkretisht:

- Pllaka trotuari betoni me t= 6 cm
- Shtresë zhavorri 10 cm

Ndërkohë që, po t'i referohemi VKM Nr. 629, date 15.07.201 "*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*" mbi analizën për zërin konkret me nr. Analize 3.620; është parashikuar që brenda çmimit të realizohej edhe shtresa e betonit me përbërësit e parashikuar në analizë. Rezulton se shtresa e betonit në trotuar, nuk është realizuar ndërkohë që në zërin e manualit, parashikohet shtresa e betonit.

Pra, rezulton punë e kryer për sipërfaqen 785.5 $m^2$ pllaka me çmim 1,260 lekë dhe jo 785.5 $m^2$ pllaka me çmim 1500 lekë.

Sa më sipër diferenca në çmim prej 240 lekë është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, në vlerën **<u>188,520 lekë pa TVSH</u>** [785.5 $m^2$ x 240 lekë ].

**<u>Kriteri</u>:** - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. ..... prot., datë 28.05.2021 .

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1813 prot., datë 19.05.2021 .

**<u>Ndikimi/Efekti</u>**: Si pasojë e mangësive të mësipërme, janë situacionuar volume pune të pakryera.

**<u>Shkaku:</u>** Pasqyrim jo i saktë në librezën e masave nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

**<u>Rëndësia</u>**: **E** lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Gramsh të arkëtojë vlerën prej **264,970 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve BOE "F." SHPK & "S." SHPK , për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. ..... prot., datë 28.05.2021 me objekt "Sistemim asfaltim lagjja "Ish reparti Ushtarak" Bashkia Gramsh.

**Si konkluzion:**

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

**1.** Sipërmarrësit të punimeve BOE "F." SHPK & "S." SHPK i janë likuiduar tepër në vlerën **264,970 lekë pa TVSH**, për punime të kryera jo në volumet e situacionuara, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkinë Gramsh dhe duhet të kthehet nga përfituesi, sipërmarrësi i punimeve.

**2**. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, nuk ka kryer oponencën teknike për projektin e zbatimit me objekt: "Sistemim - asfaltim lagjja "Ish Reparti Ushtarak". Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, neni 6.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

***1. Z. G. S.,*** *në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.*

►**Titulli i Gjetjes 8:** Mos realizim i Oponencës Teknike të projektit të zbatimit me objekt: "Sistemim - asfaltim lagjja "Ish Reparti Ushtarak" Bashkia Gramsh.

**Situata:**

Projekti i zbatimit për objektin: "Sistemim - asfaltim lagjja "Ish Reparti Ushtarak", është hartuar në vitin 2020 nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë AK Bashkisë Gramsh; PZ është hartuar nga Ing. A. Ç. dhe Ing. M. Ç. dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Z. K. T..

Për projektin e zbatimit të objektit: "Sistemim - asfaltim lagjja "Ish Reparti Ushtarak" nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Gramsh. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, neni 6 dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë.

**Kriteri:** Ligji Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6.

**Ndikimi/Efekti:** Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.

**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Gramsh .

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Gramsh të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike për të gjitha ndërtimet publike me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, si dhe për objektet jo publike, sipas legjislacionit në fuqi.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

***1. Z. K. T.,*** *në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Gramsh.*

***(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të zbatimit të punimeve, janë trajtuar në akt-konstatimi Nr. 6, datë 05.05.2023 , dorëzuar me protokoll në Bashkinë Gramsh )***

**5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.**

Këshilli Kombëtar i Territorit në përputhje me ligjin nr. 107/2017, datë 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Bashkia Gramsh me Vendim të Këshillit të Bashkisë me Vendim nr.15, datë 25.02.2020 ka miratuar "Planin e Përgjithshëm Vendor" dhe konfirmuar me Vendim nr.1, datë 10.06.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT-së). Ky Plan mbulon Territorin e Bashkisë Gramsh ku përfshihen pesë Njësi Administrative. Niveli i

taksës së ndikimit në infrastrukturë së bashku me tarifat që aplikohen në aplikimet që kryhen në sistemin e-leje, janë të përcaktuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, në paketën fiskale vjetore, përkatësisht:
VKB Nr. 96 datë 30/12/2019 për vitin 2020 e në vijim

**1.** Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private dhe publike;

Zyra e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Gramsh ka ushtruar funksionet dhe detyrat e saj bazuar në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 "*Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015*".
Bazuar në sa më sipër, gjatë vitit 2021 janë miratuar 3 Vendime për Leje Ndërtimi, gjatë vitit 2022 janë miratuar 4 Vendime për Leje Ndërtimi sipas sistemit të e-leje, për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m2, të cilat janë paraqitur në tabelën nr.1 si vijon:

| Viti | Emërtimi i lejes së ndërtimit | Zhvilluesi | Njësia strukturore | leje zhvillimi | Vendimi Leje ndërtimi | Sipërfaqe totale ndërtimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2021 | Objekt banimi dhe shërbimi 4kate+podrum + papafingo | H. Z. | GR_UB_A2_1/8 | | Nr.5 datë 12/08/2021 | 1650 |
| 2021 | Godine banimi 5 kate me 1 kat nëntokë | E. L. | GR_UB_A1_1/15 | Nr.05,date 10/03/2021 | Nr.06 datë 02/09/2021 | 2100 |
| 2021 | Godine shërbimi e banimi 1-3-4-5 kate mbi toke e 2 kate nëntokë | S. I. | GR_UB_A1_1/6 | Nr.1, date 04/02/2021 | Nr.10 datë 09/11/2021 | 1764 |
| 2022 | Objekt banimi dhe shërbimi 3 kate dhe 5 kate me 1 kat nëntokë | K. shpk | GR_UB_AR3_357/1 | Nr.1,date 18/01/2022 | Nr.542/5 datë 17/03/2022 | 4345 |
| 2022 | Shtese kati me strukture metalike | A. K. | GR_UB_A1_1/15 | | Nr. 1696/5 date 16.09.2022 | 573 |
| 2022 | Ndërtim objekti 3 kate | S. L. | GR_UB_IE2_354/1 | Nr.2,date 01/02/2022 | Nr.727/4 datë 13/04/2022 | 452 |
| 2022 | Objekt banimi dhe shërbimi 2 kate | M. T. | GR_UB_IE2_354/1 | Nr.13date 23/08/2021 | Nr .03 datë 31/01/2022 | 280 |

**Burimi:** Drejtoria e PZHT rakorduar me sistemin e-leje

Nga dokumentacioni i sipër cituar rezulton se për periudhën objekt auditimi Janar 2021 – Dhjetor 2022 janë miratuar gjithsej 7 leje e ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se >250 m2, të cilat u audituan 4 leje. Në mënyre të detajuar paraqiten si vijon:

**<u>VITI 2021</u>**
**1. Çështja me nr. 1686 prot. datë 05.06.2021**, sipas aplikimit në sistemin e_leje.

**Objekti:** "Godine banimi 5 kate me 1 kat nëntokë, në qytetin e Gramshit lagja "Sopoti"
**Leje Zhvillimi**: Vendim Nr.05, datë 10.03.2021 i Kryetarit të Bashkisë Gramsh me zhvillues "z. E. A. L. dhe J. F. L.", nr.pasurie 8/532, ZK 1842, në pronësi të z.E. A. L. dhe J. F. L. , me kufij V-8/255, J-8/86, L-8/69, P-8/86, sipërfaqe 405 m2 dhe adresë Rr.: "Sporti, Bashkia Gramsh, sipas paraqitjes grafike në shkallë 1:500, të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**Leje ndërtimi :** Vendim Nr. 06 , datë 02/09/2021 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh
**Me zhvillues:** "z. E. A. L. dhe J. F. L."
**Të dhëna për pasurinë:**
Pasurie 8/532, ZK 1842, në pronësi të z. E. A. L. dhe J. F. L. , me kufij V-8/255, J-8/86, L-8/69, P-8/86, sipërfaqe 405 m2 dhe adresë Rr.: "Sporti, Bashkia Gramsh, sipas paraqitjes grafike në shkallë 1:500, të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**Të dhëna mbi objektin e miratuar**
Njësia Strukturore: GR_UB_A1_1/15

| **Përcaktimet sipas.** PPV GR_UB_A1_1/15 | **Leje Zhvillimi** | **Leja e Ndërtimit** |
|---|---|---|
| Madhësia min. e parcelës Pa përcaktuar $m^2$ | Pa përcaktuar $m^2$ | 1050 m2 |
| Përdorimi i lejuar : Banim + Shërbim | Banim + Shërbim | Objekt banimi 5 kate me 1 kat parkim nëntokë |
| Sipërfaqja maksimale për ndërtim Pa përcaktuar $m^2$ | Pa përcaktuar $m^2$ | 2100 m2 |
| K.sh.t max = 55% | K.sh.t max = 40.5% | 45 % |
| Imax = 2 | Imax = 2 | 2 |
| H max = 5 kate 17 m | H max = 19.90 | 1+5 kate/ 17 m2 |

- ***<u>Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.</u>***

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 "Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar", dhe sipas Vendimit te Këshillit Bashkiak nr. 96 datë 30/12/2019 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020" e në vijim

***<u>Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave nga Enti kombëtar i banesave për vitin 2021.</u>***

***<u>Llogaritur nga subjekti</u>***

Sipërfaqe banimi+ Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë (parkimi): 2593 m2*4% * 43000 = 4,459,960 lekë.

Shqyrtimi i dosjes së aplikimit: 10 000 + 2 000*4 = 18 000 lekë .

**<u>Vlera e paguar:= 4,477,960 lekë</u>**

**<u>Situata:</u>**

Së pari: Miratimi i lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 06 , datë 02/09/2021 me subjektin zhvillues "Z. E. A. L., Znj J. F. L." dhe Bashkia Gramsh nuk kanë hartuar dhe nënshkruar një Akt-marrëveshje bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social', përcaktohet se 3% (tre përqind) e sipërfaqes takuese të banimit në godinat, objekt i aplikimit të lejes së ndërtimit Nr. 06 , datë 02/09/2021 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh është sipërfaqja prej 63 m2-, e llogaritur nga sipërfaqja totale e banimit prej 2100 m2, (2100 m2 * 3% = 63 m2) të cilat duhet të kishin kaluar në favor të Bashkisë Gramsh.

**Së dyti** Pranëvendosja e dorëzuar në miratimin për leje nuk reflekton të gjitha numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet. Mosparaqitja e të dhënave të kërkuara sipas standartëve të projektimit, lë hapësirë për shkelje të **VKM 408** datë *13.05.2015 neni 34 pika 2.*

Objekti nuk ka respektuar distancën me kufirin e pronës dhe distancën ndërmjet objekteve në tre orjentime, në jug/ lindje dhe në perëndim. Ndërsa në lidhje me distancën ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës, nuk është respektuar distanca e lejuar si me poshtë.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar me

V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “*Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015*”, nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social',

**2. Çështja me nr. 1623 prot. datë 30.04.2021**, sipas aplikimit në sistemin e_leje.
**Objekti:** " Banimi dhe shërbimi 4 kate + podrum + papafingo"
**Leje Zhvillimi**: Pa përcaktuar
**Leje ndërtimi :** Vendim Nr. 5, datë 12/08/2021 të kryetarit të Bashkisë Gramsh
**Me zhvillues:** “H. Z.”
**Të dhëna për pasuritë:**
Zona Kadastrale nr.: 1842 Nr. Pasurisë: 1842-9/457 Volumi: 23 Faqja: 89 Sipërfaqja e parcelës (m2): 380 Lloji i pronësisë: Truall Adresa: Rr. Sporti, Gramsh, Funksioni i ndërtesave ekzistuese: Shtëpi
**Të dhëna mbi objektin e miratuar**
Njësia Strukturore: GR_UB_A2_1/8

| **Përcaktimet sipas.** PPV GR_UB_A2_1/8 | **Leje Zhvillimi** | **Leja e Ndërtimit** |
|---|---|---|
| Madhësia min. e parcelës PA $m^2$ | Pa përcaktuar | 380 m2 |
| Përdorimi i lejuar : Banim + Shërbim | Pa përcaktuar | Objekt banimi 5 kate me 1 kat parkim nëntokë |
| Sipërfaqja maksimale për ndërtim. | Pa përcaktuar | 1650 m2 |
| K.sh.t max = 55% | Pa përcaktuar | 70 % |
| Imax = 2.5 | Pa përcaktuar | 4.34 |
| H max = 6 kate 20 m | Pa përcaktuar | 1+5 kate/ 18,3 m2 |

- ***Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.***

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar”, dhe sipas Vendimit te Këshillit Bashkiak nr. 96 datë 30/12/2019 “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020” e në vijim.
***Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave nga Enti kombëtar i banesave për vitin 2021.***
***Llogaritur nga subjekti***
Për sipërfaqe shërbimi : 1650 m2 * 5%* 43 000 lekë/m2 = 3,547,500 lekë.
**Vlera e paguar:= 3,547,500 lekë**

**Situata:** Pranëvendosja e dorëzuar në miratimin për leje së ndërtimit Nr. 5, datë 12/08/2021 të kryetarit të Bashkisë Gramsh nuk reflekton të gjitha numrat e kateve te objekteve me të cilat kufizohet. Mosparaqitja e të dhënave të kërkuara sipas standartëve të projektimit, lë hapësirë për shkelje të **VKM 408** datë *13.05.2015 neni 34 pika 2.*
**Distanca nga kufijtë e pronës**. Vkm 408 neni 35
Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.
Konkretisht 5k+1m=6m
Objekti nuk ka respektuar distancën me kufirin e pronës dhe distancën ndërmjet objekteve në tre orientime, në jug/ lindje dhe në perëndim.

Ndërsa në lidhje me distancën ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës, nuk është respektuar distanca e lejuar.
Sa me sipër drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të Territorit Bashkia Gramsh nuk ka miratuar lejen e zhvillimit veprime të cilat bien në kundërshtim me nenin 11 të Vkm 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar.

Intensiteti i ndërtimit 1. Intensiteti (I) përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore. 2. Intensiteti (I) ekzistues në nivel njësie strukturore është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit të kateve mbi tokë për të gjithë njësinë me shumën e sipërfaqeve të parcelave të ndërrueshme në të. Në llogaritjen e (I) për njësinë nuk përfshihen rrugët dhe hapësirat publike, përveç sa përcaktohet në legjislacionin sektorial në fuqi. 3. Intensiteti (I) për çdo njësi pa PDV, përcaktohet nga dokumenti i planifikimit dhe zbatohet në çdo parcelë të ndërrueshme brenda njësisë përkatëse, përjashtuar rrugët dhe hapësirën publike. 4. Intensiteti (I) për një zonë përcaktohet në përputhje me këtë rregullore, ligjin dhe legjislacionin e posaçëm në fuqi. 5. Intensiteti (I) si rregull matet në m2 /m2 , por për ndërtime në funksion të aktiviteteve bujqësore dhe industriale-ekonomike, (I) mund të matet edhe në m3/m2, sipas akteve ligjore të posaçme në fuqi.
1650 m2(Sip. Totale e ndërtimit mbi tokë)/ 380 m2=4.34 është më i madh së koeficienti i lejuar në PPV dhe Rregulloren e Bashkisë Gramsh, pra është shkelur kriteri i Lejes së Ndërtimit dhe konkretisht Intensiteti.

**3. Çështja me nr. 3450 prot. datë 15.09.2021**, sipas aplikimit në sistemin e_leje.

**Objekti:** "Godine shërbimi e banimi 1-3-4-5 kate mbi toke e 2 kate nëntokë, në qytetin e Gramshit lagja "Sopoti"
**Leje Zhvillimi**: Vendim Nr. 1, datë 04.02.2021 i Kryetarit të Bashkisë Gramsh me zhvillues "S. I.", nr. pasurie 8/363, ZK 1842, në pronësi të , me kufij (V- 8/476; J- 8/477 ; L- 8/145; P- 8/475), sipërfaqe 713.8 dhe adresë Gramsh, Lagja "Sporti", sipas paraqitjes grafike në shkallë 1:500 të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese që është pjesë përbërëse e këtij vendimi
**Leje ndërtimi :** Vendim Nr. 10, datë 09/11/2021 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh
**Me zhvillues:** "S. I."
**Të dhëna për pasurinë:**
Pronë private Zona Kadastrale nr.: 1842 Nr. Pasurisë: 8/363 Volumi: 19 Faqja: 73 Sipërfaqja e parcelës (m2): 713.8 Lloji i pronësisë: Truall Adresa: Gramsh, Lagjja "Sporti", Ka ndërtesa ekzistuese në këtë pasuri Funksioni i ndërtesave ekzistuese: Tjetër
**Të dhëna mbi objektin e miratuar**
Njësia Strukturore: GR_UB_A1_1/6

| **Përcaktimet sipas.** GR_UB_A1_1/6 | **Leje Zhvillimi** | **Leja e Ndërtimit** |
|---|---|---|
| Madhësia min. e parcelës: Pa përcaktuar $m^2$ | Pa përcaktuar $m^2$ | 713.8 m2 |
| Përdorimi i lejuar : Banim | Banim + Shërbim | Godinë shërbimi e banimi 1-3-4-5 kate mbi toke e 2 kate nënë tokë |
| Sipërfaqja maksimale për ndërtim: Pa përcaktuar $m^2$ | 1784.5 m2 mbi tokë | 1764.7 m2 mbi tokë dhe 1161 m2 nënë tokë |
| K.sh.t max = 65% | K.sh.t max = 65% | 59 % |
| Imax = 2.5 | Imax = 2.5 | 2.47 |
| H max = 6 kate 20 m | H max = 6 kate 20 m | 2+5 kate/ 17.4 m |

- ***<u>Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.</u>***

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 "Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar", dhe sipas Vendimit te Këshillit Bashkiak nr. 96 datë 30/12/2019 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020" e në vijim.

***Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave nga Enti kombëtar i banesave për vitin 2021.***

***Llogaritur nga subjekti***

Sipërfaqe banimi+ Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë (parkimi): 2925 m2*5% * 43000 = 6,290,255 lekë.

**Vlera e paguar:= 6,290,255 lekë**

**Situata:** Pranëvendosja e dorëzuar në miratimin për leje së ndërtimit Nr. 1, datë 04.02.2021 i Kryetarit të Bashkisë Gramsh nuk reflekton të gjitha numrat e kateve te objekteve me të cilat kufizohet. Mosparaqitja e të dhënave të kërkuara sipas standartëve të projektimit, lë hapësirë për shkelje të **VKM 408** datë *13.05.2015 neni 34 pika 2.*

**Distanca nga kufijtë e pronës**. Vkm 408 neni 35

Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.

Konkretisht 5k+1m=6m

Objekti nuk ka respektuar distancën me kufirin e pronës dhe distancën ndërmjet objekteve në tre orientime, në jug/ lindje dhe në perëndim.

Ndërsa në lidhje me distancën ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës, nuk është respektuar distanca e lejuar.

**VITI 2022**

**1. Çështja me nr. 542 prot. datë 02.07.2022**, sipas aplikimit në sistemin e_leje.

**Objekti:** "Objekt banimi dhe shërbimi 3 kate dhe 5 kate me 1 kat parkim nëntokë, në qytetin e Gramshit Lagja "Sporti"

**Leje Zhvillimi**: Vendim nr. 1 datë 18.01.2022 i Kryetarit të Bashkisë Gramsh me zhvillues "K." SH.P.K, në pasurinë me nr. pasurie 8/216, ZK 1842, në pronësi të , me kufij (V 8/616/J 8/ /L8/P8), sipërfaqe 1798 dhe adresë Gramsh, Rruga "SPORTI", sipas paraqitjes grafike në shkallë 1:500 të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**Leje ndërtimi :** Vendim Nr. 542/5, datë 17/03/2022 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh

**Me zhvillues:** "K." SH.P.K me NIPT J......S

**Të dhëna për pasurinë:**

Pasuria me nr. pasurie 8/216, ZK 1842, në pronësi të K. SH.P.K, me kufij (V 8/616/J 8/ /L8/P8), sipërfaqe 1798 dhe adresë Gramsh, Rruga "SPORTI", sipas paraqitjes grafike në shkallë 1:500 të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**Të dhëna mbi objektin e miratuar**

Njësia Strukturore: GR_UB_AR3_357/1-

| **Përcaktimet sipas.** PDV GR_UB_AR3_357/1 | **Leje Zhvillimi** | **Leja e Ndërtimit** |
|---|---|---|
| Madhësia min. e parcelës 500 $m^2$ | Pa përcaktuar | 1798 m2 |
| Përdorimi i lejuar : Banim + Shërbim | Banim + Shërbim | Objekt banimi dhe shërbimi 3 kate dhe 5 kate me 1 kat |

| | | |
|---|---|---|
| | | parkim nëntokë |
| Sipërfaqja maksimale për ndërtim : 2696 | Pa përcaktuar | 4345 m2 |
| K.sh.t max = 65% | K.sh.t max = 65% | 49.2 % |
| Imax = 2.5 | Imax = 2.5 | 2.42 |
| H max = 5 kate 17 m | H max = 5 kate | 1+5 kate/ 21.16 m2 |

- ***Mënyra e llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.***

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektin e mësipërm është bërë sipas Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 "Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar", dhe sipas Vendimit te Këshillit Bashkiak nr. 96 datë 30/12/2019 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020" e në vijim.

***Llogaritjes se kostos së ndërtimit të banesave nga Enti kombëtar i banesave për vitin 2022.***

***Llogaritur nga subjekti***

Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë (parkimi): 1100 m$^2$ * 4% * 32,331 lekë/m2 = 1,422,564 lekë
sipërfaqe shërbimi: 885 m$^2$ * 5% * 43,000 lekë/m2 = 1,902,750 lekë
sipërfaqe banimi: 3460 m2 * 4% * 43,000 lekë/m2 = 5,951,200 lekë
sipërfaqe totale e ndërtimit: 4345 m$^2$

**Vlera e paguar:= 9,276,514 leke**

***Akt-Kontrollet***

Bashkia Gramsh, sipas planimetrisë së lejes së zhvillimit miratuar nga Kryetari i bashkisë me nr. 1 datë 18.01.2022 në prezencë të Administratorit ligjorë të firmës K. SH.P.K, S. P. të drejtuesit teknik Ing. K. G., përfaqësuesve të Drejtorishë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ing. A. Ç.; ing; O. C.; ing; E. S., ka përpiluat Akt-Piketimin e Rrethimit dhe i Themeleve të objektit konkretisht:

Aksi A (Ana Lindore) 4.0 m dhe 3.2 m nga kufiri i pronës për volumin 3 kt
2.9 m dhe 3.1 m nga kufiri i pronës për volumin 5 kt
Aksi B (Ana Perëndimore) 10.6 m nga kufiri i pronës për volumin 3 kt
9.7 m dhe 11.8 m nga kufiri i pronës për volumin 5 kt
Aksi A (Ana Jugore) 4.0 m nga kufiri i pronës për volumin 3 kt
4.0 m dhe 7.0 m nga kufiri i pronës për volumin 5 kt
Aksi B (Ana Veriore) 4 m nga kufiri i pronës për volumin 3 kt
6.0 m nga kufiri i pronës për volumin 5 kt

**Situata:**

**Së pari** miratimi i lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 542/5, datë 17/03/2022 me subjektin zhvillues "K." SH.P.K me NIPT J......S dhe Bashkia Gramsh nuk kanë hartuar dhe nënshkruar një Akt-marrëveshje bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social', përcaktohet se 3% (tre përqind) e sipërfaqes takuese të banimit në godinat, objekt i aplikimit të lejes së ndërtimit Nr. 542/5, datë 17/03/2022 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh është sipërfaqja prej 103.8 m2-, e llogaritur nga sipërfaqja totale e banimit prej 3460 m2, (3460 m2 * 3% = 103.8 m2) të cilat duhet të kishin kaluar në favor të Bashkisë Gramsh.

**Së dyti** është konstatuar një diferenca prej 1,184,311 lekë nga keq llogaritja e Taksës së Ndikimit në nga Bashkisë Gramsh respektivisht:

**Vlera e llogaritur nga grupi i auditimit sipas paketës fiskale**

Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë (parkimi): 1100 m$^2$ * 5% * 43,000 lekë/m2 *0.7 = 1,655,500 lekë.
sipërfaqe shërbimi: 885 m$^2$ * 5% * 43,000 lekë/m2 * 1.5 = 2,854,125 lekë .

sipërfaqe banimi: 3460 m2 * 4% * 43,000 lekë/m2 = 5,951,200 lekë.
sipërfaqe totale e ndërtimit: 4345 $m^2$
**Vlera që duhet të paguante:= 10,460,825 lekë.**

Sipas autorizimit për pagesë të llogaritur nga përgjegjësja e financës znj K. X. dhe firmosur nga Kryetari i Bashkisë z. K. T. dhe e paguar nga firma K. SH.P.K është **9,276,514 lekë**
Pra konstatohet një diference e dukshme në vlerën prej **1,184,311 lekë** ***(* 10,460,825** *lekë - 9,276,514 lekë = 1,184,311 lekë*) e papaguar nga subjekti K. SH.P.K për shkak të keq llogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të taksës së Ndikimit në Infrastrukture. Diferenca prej **1,184,311 lekë** e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 "*Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015*", nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social', Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 "Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar", dhe sipas Vendimit te Këshillit Bashkiak nr. 96 datë 30/12/2019 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020" e në vijim.
***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi sipas funksioneve;*** *z. K. T. me detyrë Kryetar i Bashkisë z. A. Ç. me detyre Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe znj K. X. me detyrë ish/ Përgjegjëse në Drejtorin e Financës.*
**Kriteri**: ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 "*Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015*", nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social', Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 "Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar", dhe sipas Vendimit te Këshillit Bashkiak nr. 96 datë 30/12/2019 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020" e në vijim.
**Impakti:**
Mosrespektimi i rregullores së miratuar nga institucioni i cili nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke mos krijuar kushte të përshtatshme me, të drejta dhe shanse të barabarta për banim. Gjithashtu mosrespektim të ligjit dhe moszbatim të tij në nivel procedurial duke sjell parregullsi juridike në çdo akt të prodhuar nga institucioni.
**Shkaku:**
Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar.
**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Drejtorin e Planidikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi, të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugës.
**Rekomandimi:** Drejtorin e Planidikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë të gjitha masat e nevojshme për lidhjen e një Akt-marrëveshjeve me subjektet zhvillues "Z. E. A. L., Znj J. F. L."

dhe me subjektin zhvillues “K.” SH.P.K me NIPT J......S, për kalimin në favor të sipërfaqes prej 166.8 m2 banim në favor të Bashkisë Gramsh sipas pjesëve takuese së sipërcituar.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Gramsh të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **1,184,311 lekë,** nga subjekti K. SH.P.K, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastructure.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 1784 prot., datë 19.05.2023 të akt konstatimit nr. 10 datë 05.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 205/4 prot., datë 24.05.2023, nga z. A. C. *në cilësinë e drejtorit të PZHT*, i cili është ridërguar me shkresën nr. 2090/9 datë 07.07.2023, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 205/6 datë 12.07.2023 *ku janë shprehur komentet si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:**

1. Në lidhje me çështjen me nr. 1686 prot., date 05/05/2021,sipas aplikimit ne sistemin e-leje, për objekt: ' 'Godine banimi 5 kate me 1 kat nëntokë" ne Gramsh, lagjja Sporti, me leje ndërtimi nr.06,date 02/09/2021 te Kryetarit te Bashkisë Gramsh, me zhvillues , z. E. A. L. dhe J. F. L., mbi problematikat e konstatuara nga auditimi, ju sqarojme se .

Përsa i përket 3% te 2000 m$^2$ sip ndërtimore, për sip totale ndërtimi 2100 të subjektit në finalë, kjo në zbatim të ligjit 22/2018 "Për strehimin social", neni 19, me gjithë citimin e tij Bashkia Gramsh nuk mendon se është në shkelje të ligjit, pasi kjo dosje apo çështje nuk është përmbyllur përfundimisht në sistemin e —leje. Një dosje e mbyllur përfundimisht, konsiderohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si autoriteti që ngarkohet me ligj për administrimin e territorit lokal ku shtrin kompetencat, atëherë kur lëshohet Certifikata e Përdorimit. Përderisa kjo faze nuk është ezauruar, atëherë DPZHT dhe asnjë zyrtar me çfarëdo emërtimi hierarkik qofte nuk mund të behet me përgjegjësi, pasi ajo harton punën e saj, në mënyrë qe raporti privat-shtet të jete në linearitet me ligjin dhe territorin.

Zhvilluesit në finalë E. L. dhe J. L., nëpërmjet studios ligjore S., kane aplikuar ne sistemin e-leje, për ndryshim projekti gjate fazës se ndërtimit në zbatim kjo të ligjit 107/2014, neni 48 dhe VKM-se 408,date 13/05/2015 i ndryshuar, neni 17,pika 1 ,shkronja b) dhe shkronja ë).

Zhvilluesi ka të drejtën ligjore, morale dhe ekonomike të ndryshoj projektin e zhvillimit të tij, kur kjo kërkohet nga interesat ekonomike të tregut.

Si përfundim, me këto ndryshime , sipërfaqja totale e ndërtimit të banimit mbi toke nga 2100 m2 shkon në sip. totale të ndërtimit të banimit mbi toke në 1965,65 m .

Për rrjedhoje kërkojmë që ky observacion për këtë pike të merret në konsiderate, pasi është e mbështetur në ligj.

Përsa i përket pikës se dyte te problematikes se konstatuar nga grupi i punës se KLSH-se, mbi Planvendosjen, ku citohet nga ju që nuk paraqiten të dhënat e numrit te kateve të objekteve me te cilat kufizohet zhvillimi, te referuar sipas jush VKM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar neni 34, pika 2, Drejtoria e Planifikimi dhe Zhvillimit te Territorit e kundërshton me arsyetimin:

Pranëvendosja në sistemin e leje, e hartuar nga sudio S&L Studio me ane te arkitektit Adhurim Qehajaj, për zhvillimin : ' 'Godine banimi 5 kate me 1 kat nëntokë" është e pasqyruar shume e qarte,konkretisht : Lindje me objekte 2 kt dhe 1 kt

Perëndim me objekte Rruge, 2 kt. 1 kt , 1 kt

Jug me objektin me nr. pasurie 8/213, me të cilin është zbatuar rregulli i kallkanit në mbështetje te VKM-se 408,date 13/05/2015 me ndryshimet qe i janë në atë kohe.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ana juaj për distancat për këtë objekt me objektet e tjera kufizuese, kufirin e pronës dhe nga trupi i rrugës, Drejtoria e Planifikimin dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori i shqyrtimit të lejeve e kundërshton pasi konkluzionet e grupit të auditimit nuk janë të sakte, realisht ato janë:
Në këtë zhvillim kemi të bëjmë me një objekt të kombinuar 3kt dhe 5 kt. Objekti 3kt shtrihet ne veri lindje dhe distancat e objektit 3kt me kufirin e pronës në lindje është afërsisht 5 m, kurse distancat e objektit 5 kt me kufirin e pronës në lindje është 6 m.
Në përëndim objekti 5 kt është në distancë me shume se 4 m me trupin e rrugës, për rruge me gjerësi me ose pa trotuare me të vogël se 7 m, kjo në mbështetje të neni 36 te VKM-se 408,date 13/05/2015 i ndryshuar.
Në jug të objektit 5 kt, kemi të bëjmë me rregullin e kallkanit, kur dy objekte janë pa dritare, pa çarje, ato rrinë kallkan me njëra tjetrën. Objekti në fiale sipas nenit 34 te VKM 408,DATE 13/05/2015 i ndryshuar i asaj kohe detyron palët të rrinë 1 m nga kufiri i pronës për kallkanin. Objekti në fjale në jug është larguar 2.7 m nga kufiri i pronës.
Në veri të objektit 3kt me kufirin e pronës, zhvillimi është ne zbatim te ligjit dhe VKM-se 408,date 13/05/2015 i ndryshuar neni 35 ,pra ne veri distanca midis 3kt dhe kufirit te pronës është 5.7 m.
2. Në lidhje me çështjen me nr. 1623prot.,date 30/04/2021,sipas aplikimit ne sistemin e-leje, për objekt: ' 'Godine banimi dhe shërbimi 4 kate + Podrum + Papafingo" ne Gramsh me leje ndërtimi nr.5,date 12/08/2021 te Kryetarit te Bashkisë Gramsh, me zhvillues , z. H. Z., mbi problematikat e konstatuara nga auditimi, ju sqarojmë se :
Përsa i përket pikës së pare të problematikes së konstatuar nga grupi i punës se KLSH-se, mbi Planvendosjen, ku citohet nga ju qe nuk paraqiten të dhënat e numrit te kateve te objekteve me te cilat kufizohet zhvillimi, të referuar sipas jush VKM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar neni 34,pika 2, Drejtoria e Planifikimi dhe Zhvillimit te Territorit e kundërshton me arsyetimin : Pranëvendosja ne sistemin e leje, e hartuar nga studio Right Click me ane te arkitektit Enea Papa ,për zhvillimin : "Godine banimi dhe shërbimi 4 kate + Podrum + Papafingo" është e pasqyruar shume e qarte, në raport me nr. e kateve te objekteve kufizuese konkretisht : Lindje me rruge dhe ne krahun tjetër të rrugës me një pallat dhe vjen me shkallëzim në rënie të kateve, në perëndim me rruge, në veri me një objekt 2kt e cila është pasqyruar në planvendosje dhe për me tepër ka një deklarate noteriale për kallkan midis palëve e hedhur në sistem, në jug kufizimet janë prape me rruge, ku pranëvendosja është përseri e qarte, Për rrjedhoje, kërkojmë dhe ky observacion për këtë pike të meret në konsiderate, pasi është e mbështetur ne ligi.
3. Ne lidhje me çështjen me nr.3450prot.,date 15/09/2021,sipas aplikimit ne sistemin e-leje, për objekt: "Godine shërbimi e banimi 1-3-4-5 kate mbi toke +2 kate nëntokë " ne Gramsh me leje ndërtimi nr. 10 , date 09/1 1/2021 te Kryetarit te Bashkisë Gramsh, me zhvillues , z. S. I., mbi problematikat e konstatuara nga auditimi, ju sqarojmë se :
Përsa i përket pikës së parë të problematikes se konstatuar nga grupi i punës së KLSH-se, mbi Planvendosjen, ku citohet nga ju dhe nuk paraqiten të dhënat e numrit të kateve të objekteve me të cilat kufizohet zhvillimi dhe distancave të referuar sipas jush VKM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar neni 34,pika 2, Drejtoria e Planifikimi dhe Zhvillimit të Territorit e kundërshton me arsyetimin:
Pranëvendosja ne sistemin e leje, e hartuar nga studio A. shpk me ane të arkitektit z. P. K.., për zhvillimin : ' 'Godine shërbimi e banimi 1-3-4-5 kate mbi toke +2 kate nëntokë " është e pasqyruar shume e qarte, ne raport me nr. e kateve të objekteve kufizuese dhe distancat nga

kufiri i pronës dhe objekteve kufizuese, pasi këtu kemi të bëjmë me objekt të përzier, konkretisht.

Në lindje, zhvillimi për objektin 5 kt kufizohet me rruge e pasqyruar sakte dhe qarte ne planvendosje, gjithashtu po i njëjti zhvillim për objekti 4 kt (objekt i kombinuar) në lindje kufizohet me rruge ;

Në perëndim, zhvillimi sipas planvendosjes për objekt 4 kt, ka si objekt kufizues rruge dhe kjo gjë është e pasqyruar shume sakte ne planvendosje ;

Ne veri, zhvillimi sipas planvendosjes për objektet 4 kt, 3kt, 4 kt (zhvillim i kombinuar),ka si objekte kufizuese një objekt 1 kt , I objekt 2kt dhe një pallat qe është treguar në planvendosje me ane të distancës;

Ne jug, zhvillimi sipas planvendosjes për objektet 4 kt, 3kt, I kt, 5 kt, 4 kt (zhvillim i kombinuar), kufizohet me objekte 2 kat, I kt të cilat janë pasqyruar shumë qarte në planvendosje.

Për rrjedhoje, kërkojmë dhe ky observacion për këtë pike të merret në konsiderate, pasi është e mbështetur ne ligj.

Në lidhje me distancat e këtij zhvillimi "Godine shërbimi e banimi 1-3-4-5 kate mbi toke +2 kate nëntokë ”nga kufiri i pronës , nga objektet kufizuese dhe nga trupi i rrugës, Drejtoria e Planifikimi dhe Zhvillimit te Territorit e kundërshton konstatimin e grupit të auditimit me arsyetimin:

Në lindje, zhvillimi për objektin 5 kt ka ruajtur distancat me kufirin e prone në mbështetje të VKM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar, neni 35 sipas formulës (d—nr.kt +lm), pra për objektin 5 kt ne lindje zhvillimi ka ruajtur distancen 6 m nga kufiri i pronës. Për sa i përket këtij zhvillimi, për objektin 4 kt, po prape ne lindje, është ruajtur distanca ne mbështetje të VKM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar, neni 35 sipas formulës (d—nr. kt +lm),pra për objektin 4 kt ne lindje zhvillimi ka ruajtur distancën 6 m nga kufiri i pronës. Për sa i përket këtij zhvillimi, për objektin Ikt, po prape ne lindje , është ruajtur distanca ne mbështetje te VKM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar, neni 35 sipas formulës (d—nr. kt +1 m),pra për objektin 1 kt ne lindje zhvillimi ka ruajtur distancën 9.7 m nga kufiri i pronës. Këtu është ruajtur edhe distanca e zhvillimit për objektet 5kt,4 kt,l kt me trupin e rrugës, ne mbështetje te VKM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar, neni 36,pika l, shkronja c) "për gjerësi rruge, përfshire trotuaret, me të madhe se 15 (pesëmbëdhjetë) metra, distanca minimale është 4 (katër) metra' pra distanca për këto objekte te kombinuar ne këtë zhvillim te paraqitur ne planvendosje shkon nga 8.5 — 13.6 m nga trupi i rrugës dhe deri në 1-1.9 m nga aksi i rrugës.

Në perëndim, zhvillimi për objektin 4 kt ka ruajtur distancat me kufirin e prone ne mbështetje te VKM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar, neni 35 sipas formulës (d—nr. kt +1 m), pra për objektin 4 kt ne perëndim zhvillimi ka ruajtur distancën 5.1 m nga kufiri i pronës. Këtu në këtë drejtim, janë ruajtur edhe distancat e zhvillimit me trupin e rrugës, ne mbështetje te VKM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar, neni 36,pika l, shkronja b) "për gjerësi rruge, përfshire trotuaret, 7 (shtate) deri ne 15 (pesëmbëdhjetë) metra, distanca minimale është 3 (tre) metra” ,pra për objektin.

4kt,distanca nga trupi i rrugës është rreth 4 metra, kurse nga aksi i rrugës është 8.7 metra, fakt ky i paraqitur në planvendosje.

Në veri, zhvillimi për objektin 4 kt,3kt,4kt (objekt i kombinuar) ka ruajtur distancat me kufirin e prone ne mbështetje te V KM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar, sipas rregullit te kallkanit ,pasi ky zhvillim ne veri ka qëndruar kallkan në raport me kufirin e pronës. Këtu në këtë drejtim,

janë ruajtur edhe distancat e zhvillimit me objektet kufizuese me rregullin e kallkanit ku ndërtimi ne finalë është tërhequr respektivisht nga kufiri i prone 1 m. Ne lidhje me distancës e këtij zhvillimi me pallatin e paraqitur ne planvendosje në veri, distanca është ruajtur 6 m për objektin 4 kt.
Në jug, zhvillimi për objektin 4 kt,3kt,4kt,1kt,5kt,4kt (objekt i kombinuar) ka ruajtur distancat me kufirin e prone ne mbështetje te VKM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar, sipas rregullit te kallkanit pasi ky zhvillim ne jug ka qëndruar kallkan ne raport me kufirin e pronës. Theksojmë se ne Jug, ky zhvillim ka lidhur një kontrate kallkani me Bashkinë e Gramshit, pasi kjo e fundit është pronare e vetme e truallit me nr. pasurie 8/156-NI ,dhe pronare e vetme e pasurisë nr. 8/477 e objektit e ngritur mbi truallin e përmendur me sipër. Kjo kontrate mban Nr.3419 Prot., Gramsh me, 14/09/2021, e cila vjen ne zbatim te V KM-se 408,date 13.05.2015 i ndryshuar ku e lejon zhvillim në fyle të ndërtojë në kufijtë e pronës se vet. këtu në këtë drejtim, ruajtur edhe distancat e zhvillimit me objektet kufizuese në zbatim të ligjit. ( Kërkojmë që edhe kjo pike e observacionit te pranohet, pasi është e bazuar ne ligj dhe ne fakte).
4. Ne lidhje me çështjen me nr.542 prot.,date 02/07/2022,sipas aplikimit ne sistemin e-leje, për objekt: ' 'Godine banimi e shërbim 3 kate dhe 5 kate mbi tok me 1 kat parkim nëntokë ” ne lagjen Sporti, Gramsh me leje ndërtimi nr.542/5,date 17/03/2022 te Kryetarit te Bashkisë Gramsh, me zhvillues subjektin K. SHPK ,me nipt J......S, mbi problematikat e konstatuara nga auditimi, ju sqarojmë se .
Përsa i përket 3% te 2000 sip ndërtimore banimi, për sip totale ndërtimi 4345 $m^2$ të subjektit në fiale, kjo në zbatim te ligjit 22/2018 "Për strehimin social", neni 19, me gjithë citimin e tij Bashkia Gramsh nuk mendon se është ne Shkelje te ligjit, pasi kjo dosje apo çështje nuk është përmbyllur përfundimisht ne sistemin e —leje. Një dosje e mbyllur përfundimisht, konsiderohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, si autoriteti qe ngarkohet me ligj për administrimin e territorit lokal ku shtrin kompetencat, atëherë kur lëshohet Certifikata e Përdorimit. Përderisa kjo faze nuk është rezauruar, atëherë DPZHT dhe asnjë zyrtar me çfarëdo emërtimi hierarkik qofte nuk mund te behet me përgjegjësi, pasi ajo harton punën e saj, ne mënyrë qe raporti privat-shtet te jete në linearitet me ligjin dhe territorin. ( Kërkojmë qe edhe kjo pike e observacionit të pranohet, pasi është e bazuar ne ligj dhe ne fakte).
Në lidhje me llogaritjen e taksës, kjo do të korektohet në një kohe sa me të shpejte nga ana e Bashkisë se Gramshit edhe pse nuk është përgjegjësia e DPA-IT. Do ti kërkohet subjektit/ve ne fjale, qe te paraqiten dhe të derdhin detyrimin e palikujduar pranë arkës së Bashkisë ose në një nga bankat e nivelit te dyte, kjo për shkaqe teknike.

**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit</u>**

Sa mësipër observacionet e paraqitura nga z. A. Ç. nuk merren në konsiderat si vijon:
1. Në lidhje me çështjen me nr. 1686 prot., date 05/05/2021,sipas aplikimit ne sistemin e-leje, për objekt: ' 'Godine banimi 5 kate me 1 kat nëntokë" ne Gramsh, lagjja Sporti, me leje ndërtimi nr.06,date 02/09/2021 te Kryetarit te Bashkisë Gramsh, me zhvillues , z. E. A. L. dhe J. F. L. ju sqarojmë se:
**Së pari** Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit përpara miratimit të lejes duhet të kishte nënshkruar një Akt-marrëveshje bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social', përcaktohet se 3% (tre përqind) e sipërfaqes takuese të banimit në godinat, objekt i aplikimit të lejes së ndërtimit Nr. 06 , datë 02/09/2021 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh është sipërfaqja prej 63 m2-, e llogaritur nga sipërfaqja totale e banimit prej 2100 m2, (2100 m2 * 3% = 63 m2) të cilat duhet të kishin kaluar në favor të Bashkisë Gramsh pastaj të vazhdonte me miratimin e lejes së ndërtimit.

**Së dyti** Në sistemin e – leje subjekti zhvillues nuk ka aplikuar për ndryshim projekti gjate fazës se ndërtimit kjo konfirmuar dhe na fakti pasi në dosje nuk ndodhet as projekti dhe as pagesa.
**Së treti** Pranëvendosja e dorëzuar në miratimin për leje nuk reflekton të gjitha numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet. Mosparaqitja e të dhënave të kërkuara sipas standartëve të projektimit, lë hapësirë për shkelje të **VKM 408** datë *13.05.2015 neni 34 pika 2.*

2. Në lidhje me çështjen me nr. 1623prot.,date 30/04/2021,sipas aplikimit ne sistemin e-leje, për objekt: ' 'Godine banimi dhe shërbimi 4 kate + Podrum + Papafingo" ne Gramsh me leje ndërtimi nr.5,date 12/08/2021 te Kryetarit te Bashkisë Gramsh, me zhvillues , z. H. Z., mbi problematikat e konstatuara nga auditimi, ju sqarojmë se :
**Së pari intensiteti i lejuar sipas rregullores është 2.5 % ndërsa sipas lejes së ndërtimit është miratuar në 4.34 % si dhe** K.sh.t max = 55% ndërsa sipas lejes së ndërtimit është K.sh.t max = 70% çka do të thotë është shkelur kriteri i Lejes së Ndërtimit dhe konkretisht Intensiteti
3. Ne lidhje me çështjen me nr.3450prot.,date 15/09/2021,sipas aplikimit ne sistemin e-leje, për objekt: "Godine shërbimi e banimi 1-3-4-5 kate mbi toke +2 kate nëntokë ” në Gramsh me leje ndërtimi nr. 10 , date 09/11/2021 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh, me zhvillues , z. S. I., mbi problematikat e konstatuara nga auditimi, ju sqarojmë se :
Referuar arkumentimit të paraqitur prej jush janë mare distancat e largëta dhe jo të gjitha distancat sipas kufijve si vijon:
4. Ne lidhje me çështjen me nr.542 prot.,date 02/07/2022,sipas aplikimit ne sistemin e-leje, për objekt: ' 'Godine banimi e shërbim 3 kate dhe 5 kate mbi tok me 1 kat parkim nëntokë ” ne lagjen Sporti, Gramsh me leje ndërtimi nr.542/5,date 17/03/2022 te Kryetarit te Bashkisë Gramsh, me zhvillues subjektin K. SHPK, me nipt J......S, mbi problematikat e konstatuara nga auditimi, ju sqarojmë se .
**Së pari** Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit përpara miratimit të lejes duhet të kishte nënshkruar një Akt-marrëveshje bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social', përcaktohet se 3% (tre përqind) e sipërfaqes takuese të banimit në godinat, objekt i aplikimit të lejes së ndërtimit Nr. 542/5, datë 17/03/2022 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh është sipërfaqja prej 103.8 m2-, e llogaritur nga sipërfaqja totale e banimit prej 3460 m2, (3460 m2 * 3% = 103.8 m2) të cilat duhet të kishin kaluar në favor të Bashkisë Gramsh.

**<u>Leje të ndërtimit për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m2 për vitin 2021-2022</u>**

**Rezultoi se**: Bashkia Gramsh ka miratuar 23 lejet ndërtimi “Për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m2”, nga të cilat u audituan të 23-ta lejet e ndërtimi “Për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m2”. Konstatimet nga lejet e audituara për lejet e zhvillimit dhe Ndërtimit paraqiten në **Aneksin nr. 1 pika 5 bashkëlidhur raportit të auditimit.**
**-** Nga auditimi **i 7** lejet e ndërtimi “Për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m2”, drejtoria e PZHT ka njoftuar çdo aplikant për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe tarifat që shoqërojnë çdo leje ndërtimi, mbështetur në Vendimin e Këshillit Bashkiak 96 datë 30/12/2019 “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020” e në vijim Llogaritja e taksës është bërë me të dyja funksionet është kosto e ndërtimit =32,331 lekë, miratuar nga Enti i Banesave për Bashkinë Gramsh ose vlera e preventivit. Në çdo aplikim Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e ka llogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë sipas vlerës më të lartë, *në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar dhe me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e*

*territorit", i ndryshuar. Llogaritja e taksës është bërë në përputhje me vendimin e Këshillit Bashkiak.*

**6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.**

Struktura e Inspektoratit së Mbrojtjes se Territorit Vendor të Bashkisë Gramsh (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me Vendim të Titullarit nr.15, datë 18.02.2022 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njësive vartëse të saj, për vitin 2022", ku struktura e IMTV është e përbërë nga 2 punonjës, nga të cilët 1 kryeinspektor dhe 1 inspektor. Në formë tabele paraqitet si vijon:

| Nr. | Emër Mbiemër | Funksioni sipas strukturës | Lloji i arsimit/dega | Data emërimit në detyrë | Aktualisht në punë apo larguar, data |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | E. H. | Kryeinspektor | Jurist | 01.09.2021 | Në punë |
| 2 | A. B. | Inspektor | Ing. gjeotek | 01.09.2021 | Në punë |

***Burimi: Bashkia Gramsh***

Emërimi i 1 (një) k/Inspektori dhe 1 inspektori në strukturën e IMT është në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 "Për inspektimin e ndërtimit" neni 11 "Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit", ku përcaktohet se: "Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjes vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

***<u>1.Përshkrimi i situatës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022</u>***

Në ushtrimin e detyrave funksionale të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Gramsh për periudhën objekt auditimi, aktiviteti i veprimtarisë së punës në terren i cili është pasqyruar dhe dokumentuar me procesverbale konstatimi dhe për më tej me vendime pezullimi punimesh dhe vendime për prishje objekti të ndërtuar pa leje ndërtimi, në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën në vijim.

*Pasqyra e vendimeve të marra për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022*

| Nr. | Lloji i aktit | 2022 |
|---|---|---|
| 1 | PV/Akte kontrolli | |
| 2 | PV/Akte konstatimi | 6 |
| 3 | Vendime gjobe | 6 |
| 4 | Vendime pezullimi | 6 |
| 5 | Vendime prishje | 6 |
| 6 | PV ekzekutimi të prishjeve | |
| 7 | Kallëzime penale | Njëkohësisht me komisariatin |

| | | |
|---|---|---|
| 8 | Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv | 2 |
| 9 | Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT | + |
| 10 | Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori | |
| 11 | Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori | |

Burim: Bashkia Gramsh.

***<u>2. Burimi i krijimit të të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor / nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.</u>***

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Gramsh për periudhën e auditimit, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si vijon:

| Nr | Viti | Nr Subjek. | Vlera e Gjobës | Arkëtuar | | | | Debitor | % Realizim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gjoba | Kamat vonesa | Totali | Nr Pers. | | |
| 1 | 2021 | 10 | 4.610.000 | 900.000 | 1.560.000 | 900.000 | 10 | 4 | 19% |
| 2 | 31.12.2022 | 6 | 2.280.000 | 183.333 | 630.000 | 183.333 | 6 | 3 | 8% |
| | SHUMA | 16 | 6.890.000 | 1.083.333 | 2.190.000 | 1.083.333 | 16 | 7 | |

Burim: Bashkia Gramsh.

Në mënyrë të detajuar paraqiten si vijon;

| Nr. | Subjekti | Vendimi | | Arsyeja/Shkaku i gjobës | Vlera e gjobës | Situata aktuale e gjobës | | | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr | Data | | | Likuiduar | Proces gjyqësor | Pa likuiduar | Kamatë vonesa | Pa likujduar |
| 1 | A. J. | .... | 11.02.2022 | Ndërtim objekti pa leje përkatëse | 500.000 | Likujduar 1 këst 83.333 | jo | 417.000 | jo | 417.000 |
| 2 | M. L. | .... | 04.03.2022 | Ndërtim objekti pa leje përkatëse | 500.000 | Titull ekzekutiv | Titull ekzekutiv | 800.000 | 300.000 | 800.000 |
| 3 | N. B. | .... | 08.04.2022 | Ndërtim objekti pa leje përkatëse | 50.000 | Likujduar | jo | Likujduar | jo | 0 |
| 4 | K. S. | .... | 12.07.2022 | Ndërtim objekti pa leje përkatëse | 500.000 | Titull ekzekutiv | Titull ekzekutiv | 800.000 | 300.000 | 800.000 |
| 5 | E. Ç. | .... | 22.12.2022 | Ndërtim objekti pa leje përkatëse | 50.000 | Likujduar | jo | Likujduar | jo | 0 |
| 6 | B. B. | .... | 30.12.2022 | Ndërtim objekti pa leje përkatëse | 50.000 | Pa likujduar | jo | Pa likujduar | 30.000 | 80.000 |

Burimi: Bashkia Gramsh

Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) Bashkia Gramsh për periudhën objekt auditimi janë vendosur 6 gjoba në vlerën 1,650,000 lekë + 630,000 lekë (kamatëvonesa për 3 gjoba), duke arritur në total në shumën prej **2,280,000 lekë** nga të cilat është arkëtuar vlera **183,333 lekë.**
Përveç gjobave të vendosura gjatë vitit 2022 dhe që nuk janë paguar, IMTV ka edhe gjoba të tjera të vendosura më herët që nuk janë arkëtuar dhe janë në proces gjyqësor. Përkatësisht, gjoba të vendosura para vitit 2022, në total janë 10 për vlerën prej 4,610,000 lekë + 1,560,000 lekë (kamatëvonesa). Është paguar vlera prej 900,000 lekë dhe janë në proces gjyqësor 4 gjoba me vlerë 610,000 lekë. **Të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV në progresiv janë **në vlerën totale 5,806,667 lekë.**

Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridik nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh në progresiv në vlerën prej **5,806,667 lekë,** në kundërshtim me:

**a-neni 16**, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, ***përcaktohet se*: -***Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë,* ***deri në një muaj****. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.*

**-Neni 15-***(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni )(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3);*

*b*-nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”.

c-Nga Drejtoria Juridik dhe IMTV, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.

d-Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të Bashkisë Gramsh nuk ka marrë masat dhe nuk ka kërkuar në Gjykatë rivendosjen në afat të 31 vendimeve të gjobave në vlerën **5,806,667 lekë,** në kundërshtim me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile në RSH” i ndryshuar, nenet 17 dhe 55- Vënia në ekzekutim, shkronja (ç) ku përcaktohet se: *Vënia në ekzekutim e urdhrit të ekzekutimi bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kreditorit dhe nenet* 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH.

**3. Vendimet e marra nga IMT për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi.**

Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV” i ndryshuar, IMT Bashkia Gramsh, ka marrë 6 vendime për prishje objektesh pa leje (sipas tabelës së mëposhtme), vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara.

Në 6 raste (sipas tabelës së mëposhtme) rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje, por nuk është marrë asnjë masë tjetër nga ana e IMT Bashkia Gramsh për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 “ “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe konkretisht neni 10. *Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi K/Inspektorin z. E. H. si dhe inspektorin z. A. B..*

Pasqyra mbi vendimet e marra nga IMT për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi për periudhën 01/01/2022– 31/12/2022 ***si vijon:***

| *Nr.* | *Emri Subjektit (Shoqëria)* | *Lloj objektit* | *Vendimi* | |
|---|---|---|---|---|
| | | | *Nr.* | *Datë* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *1* | A. J. | *p.fizik* | 0000063 | *11.02.2022* |
| *2* | M. L. | *p.fizik* | *0000064* | *04.03.2022* |
| *3* | N. B. | *p.fizik* | *0000065* | *08.04.2022* |
| *4* | K.l S. | *p.fizik* | *0000066* | *12.07.2022* |
| *5* | E. Ç. | *p.fizik* | *0000001* | *12.12.2022* |
| *6* | B. B. | *p.fizik* | *0000068* | *20.12.2022* |

Burimi: Bashkia Gramsh

Mbi procedurat e njekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të bashkisë sipas dispozitave ligjore të nenit 81, Inspektimit, pika 3, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar.

Përsa i përket pikës së mësipërme nga ana e IMTV bashkia Gramsh, nuk na u vendos në dispozicion dokumentacion shkresor mbi bashkëpunimin midis kësaj strukture dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit.

***Konkluzion.***

Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) Bashkia Gramsh për periudhën objekt auditimi janë vendosur 6 gjoba në vlerën 1,650,000 lekë + 630,000 lekë (kamatëvonesa për 3 gjoba), duke arritur në total në shumën prej **2,280,000 lekë** nga të cilat është arkëtuar vlera **183,333 lekë.**

Përveç gjobave të vendosura gjatë vitit 2022 dhe që nuk janë paguar, IMTV ka edhe gjoba të tjera të vendosura më herët që nuk janë arkëtuar dhe janë në proces gjyqësor. Përkatësisht, gjoba të vendosura para vitit 2022, në total janë 10 për vlerën prej 4,610,000 lekë + 1,560,000 lekë (kamatëvonesa). Është paguar vlera prej 900,000 lekë dhe janë në proces gjyqësor 4 gjoba me vlerë 610,000 lekë. **Të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV në progresiv janë **në vlerën totale 5,806,667 lekë.**

Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridik nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh në progresiv në vlerën prej **5,806,667 lekë,** në kundërshtim me:

**a-neni 16**, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime, ***përcaktohet se*:** *-Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë,* ***deri në një muaj****. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.*

Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV" i ndryshuar, IMT Bashkia Gramsh, ka marrë 6 vendime për prishje objektesh pa leje (sipas tabelës së mëposhtme), vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara.

Në 6 raste (sipas tabelës së mëposhtme) rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje, por nuk është marrë asnjë masë tjetër nga ana e IMT Bashkia Gramsh për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 " "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar dhe konkretisht neni 10. *Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi K/Inspektorin z. E. H. si dhe inspektorin z. A. B..*

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
*z. E. H., me detyrë, Kryeinspektor i Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor.*
*z. A. B., me detyrë inspektor pranë Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor.*

**Titulli i Gjetjes 3:** *Mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV.*
**Situata:** Struktura e Inspektoratit së Mbrojtjes se Territorit Vendor të Bashkisë Gramsh (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me Vendim të Titullarit nr.15, datë 18.02.2022 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njësive vartëse të saj, për vitin 2022", ku struktura e IMTV është e përbërë nga 2 punonjës, nga të cilët 1 kryeinspektor dhe 1 inspektor. Emërimi i 1 (një) k/Inspektori dhe 1 inspektori në strukturën e IMT është në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 "Për inspektimin e ndërtimit" neni 11 "Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit".
Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) Bashkia Gramsh për periudhën objekt auditimi janë vendosur 6 gjoba në vlerën 1,650,000 lekë + 630,000 lekë (kamatëvonesa për 3 gjoba), duke arritur në total në shumën prej **2,280,000 lekë** nga të cilat është arkëtuar vlera **183,333 lekë.**
Përveç gjobave të vendosura gjatë vitit 2022 dhe që nuk janë paguar, IMTV ka edhe gjoba të tjera të vendosura më herët që nuk janë arkëtuar dhe janë në proces gjyqësor. Përkatësisht, gjoba të vendosura para vitit 2022, në total janë 10 për vlerën prej 4,610,000 lekë + 1,560,000 lekë (kamatëvonesa). Është paguar vlera prej 900,000 lekë dhe janë në proces gjyqësor 4 gjoba me vlerë 610,000 lekë. **Të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV në progresiv janë **në vlerën totale 5,806,667 lekë.**
Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridik nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh në progresiv në vlerën prej **5,806,667 lekë.** Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV" i ndryshuar, IMT Bashkia Gramsh, ka marrë 6 vendime për prishje objektesh pa leje, vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara.
Në këto raste rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje, por nuk është marrë asnjë masë tjetër nga ana e IMT Bashkia Gramsh për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 " "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar dhe konkretisht neni 10.
**Kriteri:** -Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar,
-Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar,
-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për disiplinimin e punimeve në ndërtim*", i ndryshuar,
-Ligji nr.10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtje Administrative", përkatësisht: neni 22- vendim për kundërvajtje administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv" nenin 24- "Shndërrimi i vendimit për kundërvajtje administrative në titull ekzekutiv" dhe neni 30- " Arkëtimi i shumave të detyrimit".
-VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*";
**Impakti:** Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

**<u>Shkaku:</u>** Mos rakordimi midis Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Financës dhe Sektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit. Nga mos funksionimin i detyrave dhe kompetencat përkatëse në mos zbatimin e ligjit, për arkëtimin e kësaj tarife nga ana e Bashkisë.
**<u>Rëndësia</u>:** E lartë
**<u>Rekomandimi:</u>** Inspektorati i Mbrojtës Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Gramsh, të kërkojë në Gjykatë, shndërrimin e vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 "Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv" dhe neni 30 "Arkëtimi i shumave të detyrimeve" të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe arkëtimi i vlerës **5,806,667 lekë** e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh.

**7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme**

**7.1.** Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.
**7.2.** Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.
**7.3.** Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**Titulli i gjetjes**: *Bashkia Gramsh është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*
**<u>Situata:</u>**
Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit", Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. *376/7prot., datë. 22.07.2022* i ka dërguar Bashkinë Gramsh **Vendimin 116, datë 21.07.2022**, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

*<u>**a .** Për përmirësimin e gjendjes janë</u> rekomanduar 13 **masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 13 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa, zbatuar pjesërisht 2 masa dhe janë në proces zbatimi 2 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative.*

***b.2.** <u>Për shpenzime në kundërshtim me principet e **3 E-të është**</u> rekomanduar që të arkëtohet vlera **67,860,312 lekë.** Nga verifiimi rezulton se nga vlera e rekomanduar është arkëtuar vlera 4,088,052 lekë është në process zbatimi vlera 63,663,960 lekë dhe nuk është arkëruar vlera 108,300 lekë për 2 rekomandime.*

**DREJTIMET E AUDITIMIT:**
**1.<u>Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit</u>".**

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Gramsh rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr.376/7 datë. 22.07.2022, ndërsa nga Bashkia Gramsh për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 2950/2 Prot. datë 11.08.2022. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda 20 ditësh, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Gramsh është hartuar Plan veprimi për zbatimin e

rekomandimeve me shkresën nr.3022 Prot datë 01.08.2022 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

***Zbatuar***

**2. <u>Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit</u>**

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Gramsh, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 376/7 datë.22.07.2022 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 22.03.2023**.**
Afati 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit të KLSH janë shkelur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika <u>2, ku përcaktohet se</u>: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, pasi referuar programit të auditimit nr. **205/1 Prot, datë 10.03.2023 mbi "**Auditimit financiar dhe përputhshmërisë" të miratuar nga Kryetari i KLSH u bë verifikimi i zbatimit të detyrave në subjekt.

<u>3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".</u>

**<u>Titulli i gjetjes</u>** *Mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.*

**<u>Situata:</u>**Nga verifikimi rezulton se Bashkia Gramsh ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. nr. 2950/2 Prot. datë 11.08.2022, **dhe ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm ku <u>përcaktohet se:</u> 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe <u>raporton rregullisht në këshillin e njësisë.</u>
**<u>Kriteri:</u>** Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50, pika 5.
**<u>Ndikimi:</u>** Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Gramsh të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.
**<u>Shkaku:</u>** Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Gramsh me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.
**<u>Rëndësia:</u>** E mesme
**<u>Rekomandim:</u>** Bashkia Gramsh të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

**<u>4. Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.</u>**

**A. MASA ORGANIZATIVE:**

**Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Gramsh 13 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 13 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa dhe zbatuar pjeswrisht 2 masa, në proces zbatimi 2 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

*Mjedisi i kontrollit:* Në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë nuk është ngritur asnjë komision nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është larguar apo marrjen me procesverbal sintetik të dosjeve dhe punës të personelit që kanë filluar ushtrimin e detyrës. Nuk është hartuar "*Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*", nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA, si dhe nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-së në fushën e Menaxhimit të Riskut, mbi MFK-në për GMS. Burimet Njerëzore kanë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera për periudhën e auditimit. Në vitin 2021 kanë kryer trajnime 18 punonjës të bashkisë. Nuk ka plan-veprime vjetore për arritjen e objektivave, qëllimeve të politikave afatmesme (PBA) që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

*Menaxhimi i riskut:* Bashkia Gramsh e ka përgatitur po nuk ka miratuar "**Strategjinë e Riskut**" për vitin 2021. Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" neni 27, me Udhëzimin nr.16 dt.20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publike*" pika 2/2,4.

*Aktivet e kontrollit:* Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" neni 13 dhe si rrjedhojë, nuk ka takime të dokumentuara midis Komitetit të Auditimit dhe drejtuesve të NJAB-së".

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Gramsh të merren masa për të rritur njohuritë mbi Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit si dhe për zbatimin e të gjithë komponentëve të saj. Burimet njerëzore të kenë një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve dhe një data bazë me emrat e punonjësve, të ngrihen komisione nga titullari mbi inventarizimin e dosjeve në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë, të miratohet Strategjia e Riskut për vitin 2021, të zhvillohen mbledhje të dokumentuara të GMS-së si dhe të ngrihet Komiteti i Auditimit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*1.2. Nga verifikimi rezultoi se:* Burimet njerëzore kanë një data bazë në lidhje me trajnimet të cilat i zhvillojnë pranë Shkollës Shqipëtare të Administratës Publike, aktualisht është i vetmi institucion ku punonjësit dhe nëpunësit civil të bashkisë Gramsh ndjekin trajnimet. ASPA çdo fillim viti publikon kalendarin e trajnimeve dhe ju vihet në dispozicion bashkisë ku cdo punonjës zgjedh dhe ndjek trajnimin që i nevojitet. Në bazë të nevojave që punonjësit kanë për trajnime nga ana e burimeve njereëzore është hartuar plani vjetor i trajnimeve. Janë kryer trajnime për punonjësit e finanvës për menaxhimin financiar të kontrollit (MFK dhe GMS). Gjithashtu Burimet Njerëzore kanë miratuar Planin e Pranimeve për vitin 2022 me Vendmin nr.17, datë 25.02.2022 "Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në Shërbimin Civil, për vitin 2022" të kryetarit të bashkisë, me 19 pozicione vakante nga të cilat janë zhvilluar proçedurat për 11 pozicione pune.

***Zbatuar pjeswrisht***

**2. Gjetje nga auditimi:**Njësia e Auditit të Brendshëm nuk mbulon me auditim të gjitha fushat/sistemet e njësisë publike duke mos i dhënë prioritet fushave/sistemeve të përzgjedhura, sipas nivelit të riskut, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm*", Strategjinë e auditimit të brendshëm, bazuar në tre klasifikimet e mëposhtme, duhet të konsiderojë një frekuencë auditimi si vijon:
i - Fusha me risk të lartë – e këshillueshme një herë në vit;
ii - Fusha me risk të mesëm – e këshillueshme një herë në dy- tre vite;
iii - Fusha me risk të ulët – e këshillueshme jo më shumë se pesë vite.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**2.1. Rekomandim:** Njësia e Auditit të Brendshëm të hartojë program pune për auditimin e fushave më me risk në veprimtarinë e institucionit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*2.2. Nga verifikimi rezultoi se:Është hartuar plani strategjik dhe vjetor për drejtoritë dhe njësitë vartëse të Bashkisë Gramsh , nga ana e sektorit të Auditit të Brendshëm për vitin 2022 në bazë të nivelit të riskut , miratuar dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm , me shkresë nr.prot.3392/2 datë 13/10/2021 .*

***Zbatuar pjesërisht***

**3. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi u konstatua se në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 80 datë 28.12.2020, "*Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2021*"është planifikuar fondi rezervë në shumën 2,000,000 lekë. Ky fond është përdorur për ndihma dhe shpërblime ndaj qytetarëve të ndryshëm të Bashkisë Gramsh, të cilët kanë paraqitur kërkesa për ndihmë dhe mbështetje. Përkatësisht gjatë vitit 2021 Këshilli Bashkiak ka miratuar 32 vendime me objekt dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për probleme të ndryshme të cilat arrijnë vlerën totale 2,000,000 lekë. Nga Drejtoria e Financës të Bashkisë Gramsh janë likuiduar gjatë vitit 2021 gjithsej 29 vendime, të miratuara nga Këshilli Bashkiak Gramsh në vlerën totale 1,775,000 lekë. Veprimet e mësipërme të marra nga KB Gramsh janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar neni 6, ligjin nr. 137/2020 datë 16.11.2020 "*Për buxhetin e vitit 2021*", Aneksi nr. 2, Udhëzimin nr. 4 datë 25.01.2021 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021*", pika 108.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Gramsh nëpëmjet strukturave përkatëse të marrë masat që për çdo kërkesë të paraqitur për ndihmë dhe mbështetje financiare pranë bashkisë, të bëhen verifikimet e duhura dhe të plotësohet dokumentacioni që argumenton nevojën dhe pamundësinë financiare të qytetarëve përpara se dosja të dërgohet për miratim në Këshillin Bashkiak. Drejtoria e Financës të ndërpresë likuidimin e praktikave që nuk kanë dokumentacionin e plotë dhe të duhur, si dhe gjatë përdorimit të fondit rezervë të vlerësojë nevojën reale për përdorimin e tij me qëllim që të mos ketë efekte negative në buxhetin e bashkisë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*3.1.1. Nga verifikimi rezultoi se:* Në zbatim te rekomandimeve nga KLSH për çdo kërkesë të paraqitur për mbështetje financiare është verifikuar paraprakisht dokumentacioni që argumenton nevojën dhe pamundësinë financiare dhe pas verifikimit janë dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak. Gjatë vitit 2022 konkretisht janë lëshuar 7 urdhëra ekzekutimi në zbatim të 15 VKB në vlerën 1,970,000 lekë trajtuar me hollsisht në akt konstatimin e buxhetit.

***Zbatuar***

**<u>3.2 Rekomandim:</u>** Këshilli Bashkiak Gramsh të ndërpresë marrjen e vendimeve me efekte financiare në buxhetin e bashkisë në rastet kur kërkesa për ndihmë dhe mbështetje financiare nuk shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e duhur. Këshilli Bashkiak përpara marrjes së vendimeve për ndihmë dhe mbështetje financiare ndaj qytetarëve në nevojë, të shtyrtojë me korrektësi dokumentacionin e dosjeve dhe në rastet kur dokumentacioni nuk është i plotë dhe i besueshëm të kthejë praktikat në strukturat përkatëse të bashkisë për plotësim.
*<u>3.2.1. Nga verifikimi rezultoi se</u>:,* Në zbatim të rekomandimeve nga KLSH çdo kërkesë të paraqitur për miratim në KB ka qënë e plotësuar me dokumentacioni që argumenton nevojën dhe pamundësinë financiare sipas 7 urdhëra ekzekutimi në zbatim të 15 VKB në vlerën 1,970,000 lekë trajtuar me hollsisht në akt konstatimin e buxhetit.

***Zbatuar***

**4.Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi u konstatua mos realizim në treguesit e buxhetit, veçanërisht për sa i përket të ardhurave vendore, mos realizim i cili ka krijuar detyrime të pa likuiduara të prapambetura ndaj të tretave, duke paraqitur një risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, sepse buxheti i vitit ushtrimor do të përdoret jo për të financuar nevojat reale, por për të likuiduar detyrime të prapambetura për investimet, mallrat e shërbimet, apo dëmshpërblim nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku gjendje progresive e detyrimeve në vite është si më poshtë:
-Detyrime për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2021 në vlerë 32,995,914 lekë.
Vlera 32,995,914 lekëështë e trashëguar sipas periudhave si në vijim:
-mbartur nga vitet 2010-2015, vlera 10,372,922 lekë;
-krijuar në vitet 2016-2018, vlera 2,139,549 lekë dhe vlera 2,641,476 lekë detyrim nga FZHR;
-krijuar gjatë viti 2021, vlera 19,901,314 lekë;
Veprime në mospërputhje me nenin 50, neni 52, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 56, ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", pika 62, UMFE nr. 2 datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*"; UMF nr. 5 datë 27.12.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", UMFE nr. 4 datë 25.01.2021 "*Për buxhetin e vitit 2021*", pikat 115-125 "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>4.1 Rekomandim:</u>** Bashkia Gramsh, Drejtoria e Financës, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material mbi gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën **32,995,914 lekë**, të analizojë situatën dhe të ndërpresë krijimin e detyrimeve të prapambetura duke nxjerrë përgjegjësitë e të marrë masa për të mos patur angazhime të reja buxhetore pa fonde në dispozicion.
*<u>4.2. Nga verifikimi rezultoi se</u>:, Në zbatim të rekomandimeve nga KLSH është informuar këshilli bashkiak me materialin mbi gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, dhe ka ndërpresë krijimin e detyrimeve të prapambetura, konkretisht nga vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021 në velrën 32,995,914 lekë janë likujduar detyrimet në vlerën 23,899,960 lekë dhe janë shtuar detyrime të reja në vlërën 4,023,149 lekë prej të cilave 112,750 lekë nga sistemimi i rakordimit të detyrimeve mbi proceset gjyqësose dhe 3,910,399 lekë për faturat e periudhës së fundvitit tëperiudhës 2022 (detyrime të cilat janë likujduar gjate periudhes aktuale 2023)*
*Vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 rezulton në vlerën 13,119,103 lekë.*
*Vlera 13,119,103 lekëështë e trashëguar sipas periudhave si në vijim:*

*-mbartur nga vitet 2010-2015, vlera 6,091,774 lekë; prej të cilave 3,989,392 lekë për vendime gjyqësore dhe 2,102,382 lekë për fatura të palikujduara.*
*-krijuar në vitet 2019 për ivesime nga ministria e linjës, vlera 475,454 lekë dhe vlera 2,641,476 lekë detyrim nga FZHR;*
*-krijuar gjatë viti 2022, vlera 3,910,399 lekë.*
*Nga detyrimet e mbartura nga faturat e palikujduara për periudhës 2010-2015 një pjesë e konsiderueshme e tyre janë të pa plotësuara me dokumentacionin e plotë të procedurës së prokurimit dhe është e pamundur likujdimi i tyre.*

***Zbatuar***

**5. Gjetje nga auditimi:** Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë në Bashkinë Gramsh kryhet në programin Excel. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk kryen regjistrim manual të të dhënave dhe çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Gramsh i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Administrimi i taksave dhe tarifave vendore është detyrim i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*" i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7, "*Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**5.1 Rekomandim:** Bashkia Gramsh të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

***Qershor 2023***

*5.2. Nga verifikimi rezultoi se: ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar*

***Pa zbatuar***

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi krijimin e të ardhurave nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë Gramsh u konstatua se, janë dhënë me qira asete për të cilat nuk janë lidhur kontratat përkatëse në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. Përkatësisht, janë 8 subjekte/qytetarë që përdorin pasuri të bashkisë pa lidhur një kontratë qiraje, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 "*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", e ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1 Rekomandimi:** Sektori Juridik dhe i Aseteve të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me subjektet/personat që kanë në përdorim objekte/prona/sipërfaqe në pronësi të Bashkisë Gramsh.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*6.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Kryetari i Bashkise ka ngritur Urdherin Nr.217 date 01.08.2022 "Për marrjen e masave organizative dhe zhdemtim nisur nga Raporti përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit "Mbi auditimin Financiar" të ushtruar në Bashkinë Gramsh për periudhën 01.01.2021-31.12.2021", për marrjen e masave për akt-konstatimin nr. 5 datë 13.05.2022. Janë zbatuar pikat si me poshte vijon:*
*Pika 8 e urdherit Nr.217 date 01.08.2022, jane bërë njoftimet për të lidhur kontratat e qirasë për debitoret, bashkëlidhur gjenden fotokopje të njoftimeve;*

*Pika 11 e urdhërit të Kryetarit, sipas të cilit është përllogaritur kostoja për kryerjen e regjistrimit të pasurive në NJA Pishaj, duke njoftuar me shkresë Drejtorinë e Finances dhe Buxhetit, për vleren totale (bashkëlidhur fotokopje shkresen).*
*Pika 15. Jane marre masat për të lidhur kontratat e qirase për 22 subjekte qiramarrëse, nga të cilat janë lidhur gjithsej 18 kontrata deri më sot, kanë mbeteur edhe 4 subjekte pa ju lidhur kontrata (bashkelidhur lista).*
*Janë mbledhur të ardhurat nga debitoret për vitin janar-dhjetor 2022 gjithsej në vlerën prej 5,904,062 (pesë milion e nëntëqind e katër mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë. Diferenca për tu mbledhur është 7,911,*120 - 5 904 062 = 2,007,058 (dy milion e shtatë mijë e pesëdhjetë e tetë) lekë.

***Në proces zbatimi***

**7.Gjetje nga auditimi:** Në gjendjen e llog. 468 "*Debitorë të ndryshëm*" nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore familjare në vlerën 15,794,072 lekë, për taksa dhe tarifa e bizneseve në vlerën 18,951,699 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 108,300 lekë, taksat e tokës bujqësore në vlerën 19,339,941 lekë, subjektet që ushtrojnë aktivitet të pajisur me autorizim/ licencë të lëshuar në vlerën 2,000,000 lekë, mos pagesa të kontratave të qirave në vlerën 1,422,665 lekë (*nga diferenca midis vitit 2020 në vlerën 6,488,455 lekë (vlerë e kontabilizuar) dhe vitit 2021 progresive 7,911,120 lekë*), nga operatorët ekonomik që nuk kanë paguar detyrimet vendore që lindin ndaj bashkisë Gramsh për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki në vlerën 2,750,000 lekë në total 60,366,677 lekë të akumuluara në fund të vitit ushtrimor 2021, vlerë e cila nuk është kontabilizuar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>7.1 Rekomandimi:</u>** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog.468 "debitorë të ndryshëm", në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

***Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022***

*<u>7.2. Nga verifikimi rezultoi se</u>: Nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiarer të vitit 2022 debitorët për taksat dhe tarifat, procedurë e cila do të kryhet në një moment të dytë, kur të jenë azhornuar saktë dhe në mënyrë të plotë debitorët për taksat dhe tarifat të subjekteve familjare dhe ekonomikë.*

***Pa zbatuar***

**8.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Gramsh, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 05.01.2021 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime SHA Gramsh e cila është shoqëri aksionere me objekt aktiviteti "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij"*. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Gramsh në "*Ujësjellës Kanalizime Gramsh*" SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 "*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*" në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 "*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*" me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale*" pika 55, 56, 57 si dhe me

Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 "*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të "*Ujësjellës Kanalizime Gramsh*" SHA, me vlerë kontabël 178,620,750 lekë në debi të llogarisë 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

***Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022***

*8.2. Nga verifikimi rezultoi se*: Në pasqyrat financiare të vitit 2022 janë pasqyruar në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022, më konkretisht në llogarinë "26"Pjesëmarrje në kapitalet e veta, konkretisht në shoqërinë "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a" ku Bashkia Gramsh zotëron 4.13 % të kapitalit në vlerën 413,000 lekë dhe shoqëria "E.E" ku Bashkia Gramsh zotëron 8 % të kapitalit në vlerën 280,000 lekë.

***Zbatuar***

**9.Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi ka rezultuar se, përveç objekteve të inventarit të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 919,245,713 lekë (vlerë e kontabilizuar), ka objekte të njësive administrative të cilat nuk janë pajisur me titull pronësie dhe nuk janë kontabilizuar, konkretisht për llog 210 "*Toka troje terrene*", llog. 211 "*Pyje plantacione*", llog. 212 "*Ndërtesa e konstruksione*". Për rrjedhojë ka rezultuar se pasuritë e paluajtshme nuk janë kontabilizuar në aktivet afatgjata materiale, me qenë se nuk janë pajisur me një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor),në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 510, datë 10.06.2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial*", Kreu VI "*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandim:** Bashkia Gramsh duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

***Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022***

*9.2. Nga verifikimi rezultoi se: ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.*

***Pa zbatuar***

**10.Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Gramsh dhe për Njësitë Administrative. Në kolonën shënime nga komisioni nuk ka vlerësime të aktiveve të veçanta për gjendje jashtë përdorimi. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2021. Nuk është kryer inventarizimi i magazinës së institucionit në bazë të urdhrave të Titullarit për ngritjen e komisionit "*Për kryerjen e procesit të inventarizimit*". Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e titullarit nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues të institucionit, veprime në

kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivit, apo mallrave e materialeve. Komisioni i inventarizimit nuk ka bërë një vlerë totale me listë të bashkëngjitur, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj, sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në varësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës Brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimi i gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse ekzistojnë apo jo diferenca. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>10.1 Rekomandim:</u>** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh, komisionet e ngarkuara sipas urdhrave të Titullarit, të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit.

***Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022***

*<u>10.2. Nga verifikimi rezultoi se</u>: Në zbatim të* Urdhërit Nr. 348 datë 15/12/2020 dhe Nr.243 dt.08.11.2021 "Për inventarizimin e të gjitha aseteve, inventarit ekonomik, paisjeve, inventarit të imët dhe të gjithë bazës materiale të Bashkise" komisionet e ngritura për kryerjen e inventarizimt filluan proçedurat e inventarizimit dhe vlerësimit tekniko fizike të invetarit të imët, inventarit ekonomik dhe paisjeve në pronësi të Bashkisë e mbi bazën e të dhënave nga kontabiliteti për vitin e vënies në punë dhe kohën e përdorimit.

Në përfundim të procesit Komisionet e invetarizimit dhe vlërsimit hartuan listën e materialeve për nxjerrje jashtë përdorimit ku janë specifikuar emërtimi i materialeve, njësia matëse, cmimi për cdo artikull, sasia, vlera dhe shkaku që kërkohet të dalë jashtë përdorimit, të firmosura nga komisionet sipas grupeve dhe llojit, dhe janë miratuar për tu nxjerrë jashtë përdorimi me V.K.B Nr. 91 datë 31.10.2022 "për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të zyrave të bashkisë dhe istitucioneve vartëse të saj.

Në zbatim të këtij vendimi është ngritur komisioni i asgjësimit me Urdhër të Kryetarit Nr. 360 datë 07/12/2022 "Për krijimin e komisionit për asgjesimin e mallrave të dëmtuara si rezultat amortizimit të tyre, të ndodhura në magazinat e bashkisë dhe institucioneve vartëse të saj dhe në njësitë administrative" komision i cili ka ndjekur procedurat e asgjësimit ne zbatim tëUdhëzimit të Ministrisë së Financave dhe ekonomisë Nr .30 dt 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik " Kreu IV i tij.

Edhe për vitin 2022 është kryer inventarizimi i aktiveve nga komisionet e ngritura në zbatim të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr 359 date 07/12/2022 dhe janë hartuar procesvernbalet lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka.

***Zbatuar***

**11. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi rezulton se, raporti përfundimtar i auditimit të fundit dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Gramsh me shkresën nr. 867/20 datë 05.01.2022. Nga Bashkia Gramsh kanë filluar të merren disa masa lidhur me zbatimin e rekomandimeve por duhet të merren ende masa të tjera si dhe duhet të bëhet ndjekja intensive e masave të marra, si vijon:

- Janë lidhur 10 kontrata për asetet e dhëna me qira me personat që kishin në përdorim asetet e bashkisë mbeten ende për t'u lidhur edhe 5 kontrata qiraje.
- Janë njoftuar për të shlyer detyrimin OE "Z." Shpk me shkresën nr. 324 Prot, datë 26.01.2022 për shumën 1,329,268 lekë dhe OE "M." Shpk, me shkresën nr. 325 Prot, datë 26.01.2022 për shumën 215,538 lekë.
- Janë marrë masa për të paguar detyrimet nga kontratat e qirave, përkatësisht për 22 subjekte me vlerë të detyrimit 6,591,955 lekë kanë paguar detyrime të pjesshme ose të plota 15 subjekte me vlerë totale 597,675 lekë dhe mbeten ende për t'u arkëtuar **5,949,280 lekë**.

**-** Nuk kanë paguar detyrimet në vlerën **61,340 lekë** 3 operatorë “B.” Shpk, në vlerën 21,000 lekë, “Z.” Shpk në vlerën 20,170 lekë, dhe “B.” Shpk në vlerën 20,170 lekë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 61-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandim:** Bashkia Gramsh të marrë masat si dhe të vijoj me ndjekjen e masave që ka marrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH si vijon:

- Të lidhë kontratat e qirasë me personat që kanë në përdorim asetet e bashkisë;
- Të ndjekë të gjitha hapat ligjor për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve nga OE “Z.” për shumën 1,329,268 lekë dhe OE “M.” Shpk, për shumën 215,538 lekë;
- Të marrë masa për të paguar detyrimet nga kontratat e qirave, me vlerë totale **5,949,280 lekë;**
- Të ndjekë të gjitha hapat ligjor për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve në vlerën **61,340 lekë** nga operatorët “B.” Shpk, në vlerën 21,000 lekë, “Z.” Shpk në vlerën 20,170 lekë, dhe “B.” Shpk në vlerën 20,170 lekë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*11.2. Nga verifikimi rezultoi se:*

*-Janë marre masat për të lidhur kontratat e qirase për 22 subjekte qiramarrëse, nga të cilat janë lidhur gjithsej 18 kontrata deri më sot, kanë mbeteur edhe 4 subjekte pa ju lidhur kontrata trajtuar sa më sipër.*

*- Për periudhen janar –dhjetor viti 2021 jane arketuar të detyrime të mbartura në vlerën 1,221,065 leke duke mbetur pa u arkëtuar vlera 4,728,215 lekë .*

*-Sqarim: Subjekti “B.” Shpk ka likujduar detyrimin prej 20,498 lekë në muajin gusht 2022 sipas faturës bankare, ndërsa për sa i perket subjektit “B.” Shpk, në vlerën 21,000 lekë, dhe “Z.” Shpk në vlerën 20,170 lekë nuk i kane paguar detyrimet.*

***Në proces***

**12.Gjetje nga auditimi**: Bashkia Gramshka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 867/20, datë 05.01.2022, por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, neni 50, pika 5. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 61-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandim:** Bashkia Gramsh të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*12.2. Nga verifikimi rezultoi se:* Në zabatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresë Nr. 376/3 datë.07.06.2022 është nxjerrë Urdhëri i brendshm i Kryetarit të Bashkisë nr, 217 datë 01/08/2022 “Për marrjen e masave organizative dhe zhdëmtimi nisur nga Raporti Përfundimtar i Kontrollit të Lartë të Shtetit “Mbi Auditimin Financiar”, të ushtruar në Bashkinë Gramsh për periudhën janar 2021 – 31 dhjetor 2021. Urdhër në të cilin janë pëcaktuar masat që duhen marrë, personat përgjegjës dhe afatet e plotësimit për çdo rekomandim specifik, në lidhje Raportin e Auditimit informimi i këshillit bashkiak është bërë periodikisht sipas punës se secilit sektor dhe janë reflektuar në Buxhet.

***Zbatuar***

**C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, për vitin 2021 nuk ka paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë z. X. D. në vlerën **108,300 lekë** duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh. Veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 95/2018 "*Për disa ndryshime dhe shtesanë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksavevendore*", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës sëmbledhjes dhe administrimittë të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizim*", pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit të Auditimit).*

**<u>1.1 Rekomandim:</u>** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga z. X. D. në vlerën **108,300lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Gramsh të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*<u>1.2. Nga verifikimi rezultoi se</u>:, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi deri me 05.05.2025 nuk është arkëtuar vlera e sipërcituar.*

***Pa zbatuar***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave rezulton se, 22 qiramarrës nuk kanë zbatuar kushtet e kontratave të qirasë duke mos paguar detyrimin për vitin 2021 në vlerën totale prej **7,911,120 lekë** që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh.Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kushteve të kontratave të qirasë përkatësisht me nenin 3 "*Pagesa dhe regjimi i saj*".
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>2.1 Rekomandim:</u>** Sektori Juridik dhe i Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masat dhe të ndjekin të gjitha hapat ligjorë që 22 qiramarrësit që nuk kanë zbatuar kushtet e kontratës së qirasë të paguajë detyrimet përkatëse secili që në vlerën totale janë **7,911,120 lekë.** Gjithashtu, në vijimësiSektori Juridik dhe i Aseteve të ndjekë me përpikmërizbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*<u>2.2. Nga verifikimi rezultoi se</u>:, Kryetari i Bashkise ka ngritur Urdherin Nr.217 date 01.08.2022 "Për marrjen e masave organizative dhe zhdemtim nisur nga Raporti përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit "Mbi auditimin Financiar" të ushtruar në Bashkinë Gramsh për periudhën 01.01.2021-31.12.2021", për marrjen e masave për akt-konstatimin nr. 5 datë 13.05.2022. Janë zbatuar pikat si me poshte vijon:*
*Pika 8 e urdherit Nr.217 date 01.08.2022, jane bërë njoftimet për të lidhur kontratat e qirasë për debitoret, bashkëlidhur gjenden fotokopje të njoftimeve;*
*Pika 11 e urdhërit të Kryetarit, sipas të cilit është përllogaritur kostoja për kryerjen e regjistrimit të pasurive në NJA Pishaj, duke njoftuar me shkresë Drejtorinë e Finances dhe Buxhetit, për vleren totale (bashkëlidhur fotokopje shkresen).*
*Pika 15. Jane marre masat për të lidhur kontratat e qirase për 22 subjekte qiramarrëse, nga të cilat janë lidhur gjithsej 18 kontrata deri më sot, kanë mbeteur edhe 4 subjekte pa ju lidhur kontrata (bashkelidhur lista).*

*Janë mbledhur të ardhurat nga debitoret për vitin janar-dhjetor 2022 gjithsej në vlerën prej 5,904,062 (pesë milion e nëntëqind e katër mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë. Diferenca për tu mbledhur është 7,911*,120 - 5 904 062 = 2,007,058 (dy milion e shtatë mijë e pesëdhjetë e tetë) lekë.

***Në proces zbatimi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Gramsh në datën 31.12.2021 janë në vlerën **54,085,792 lekë** nga të cilat vlera prej 18,951,699 lekë i përket 62 subjekteve private, vlera prej 15,794,072 lekë i përket kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe vlera prej 19,339,941 lekë është detyrimi për taksën e tokës bujqësore, duke sjellë **të ardhura të munguara** në buxhetin e Bashkisë Gramsh.
Në vitin 2021, borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale **16,363,890** lekë, i përbërë nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën 11,022,712 lekë, taksat dhe tarifat familjare në shumën 2,807,774 lekë dhe taksa e tokës bujqësore në shumën2,533,404 lekë. Rezulton se, Bashkia Gramsh nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1 Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Gramsh, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **54,085,792 lekë**, *si më poshtë vijon*:
*a-T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit*, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar,* Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet,* nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e-Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Gramsh, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*3.2. Nga verifikimi rezultoi se:*, Drejtoria e të Ardhurave dhe Taksave Vendore me shkresen nr. Prot 4279, date 14.10.2022, ka bere edhe njoftimet për subjektet debiotere. Në përfundim të procesit kanë paguar detyrimet e prapambetura si vijon;

1. Subjekte tregtare: 9 subjekte me vlere 213,044 lekë
2. Familje: 141 familje me vlere 343,707 lekë
3. Taksa e tokës bujqësore: 1,524,243 lekë.

Më hollsisht gjendja debitore është trajtuar në Akt konstatimin e të ardhurave nr. 8 datë 05.05.2023 mbajtur në Bashkinë Gramsh.

***Në proces zbatimi***

**4. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Gramsh ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizim/licencë për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë 2 subjekte, përkatësisht subjekti "G." dhe subjekti "B.", në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre*", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre*", të ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20-Autorizimet pika 2, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 2,000,000 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1 Rekomandim:** Drejtoria e Shërbimeve dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa që subjektet "G." dhe "B.", që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 1,000,000 lekë secili ndaj Bashkisë Gramsh.

***Menjëherë***

*4.2. Nga verifikimi rezultoi se:,* Drejtoria e Shërbimeve dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore iu ka dërguar këtyre subjekteve menjëhere njoftimet ,Nr.2884 Prot.,datë 20.07.2022 dhe Nr.2885 Prot.,datë 20.07.2022 me lëndë "Për pajisjen me liçensë për tregtim me pakicë të karburanteve për konsumatorë fundorë". Subjekti "G." SHPK ka paraqitur kërkesën datë 29.03.2023 për pajisjen me liçensë për tregtimin me pakicë të karburanteve për konsumatorë fundorë" dhe aktualisht jemi në fazë përgatitje dokumentacioni.
Përsa i përket subjektit "B.",vazhdon të mbetet debitor pranë bashkisë Gramsh.

***Në proces zbatimi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Gramsh janë 4 operatorë ekonomik që nuk kanë paguar detyrimet vendore që lindin ndaj bashkisë për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 203,500 lekë**. Drejtoria Juridike nuk ka dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre sipas përcaktimeve të paketës fiskale. Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik është në kundërshtim me përcaktimet e ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 43 pika 1/1, Udhëzimit të MF nr. 24, datë 02.09.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar pika 40.1, 43.1.1 dhe VKB nr. 96 datë 30.12.2019"*Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore*" në Bashkinë Gramsh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**5.1 Rekomandim:** Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*5.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar*

***Pa zbatuar***

**6. Gjetje nga auditimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Gramsh për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 ka vendosur 10 masa administrative "*Dënim me gjobë*", me vlerë totale

3,500,000 lekë.Për gjobat e vendosura në vitin 2021, janë paguar në mënyrë vullnetare 3 gjoba në vlerën totale 600,000 lekë, janë në proces gjyqësor 3 gjoba në vlerën 2,000,000 lekë dhe nuk janë marrë masa për arkëtimin e 4 gjobave në vlerën 900,000 lekë. Rezulton se, për vitin 2021 **të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë **në vlerën totale 2,900,000 lekë.** Përveç gjobave të vendosura gjatë vitit 2021 dhe që nuk janë paguar, IMTV ka edhe gjoba të tjera të vendosura më herët që nuk janë arkëtuar dhe janë në proces gjyqësor. Përkatësisht, janë në proces gjyqësor 4 gjoba me vlerë 610,000 lekë dhe për një gjobë është nënshkruar marrëveshje dhe ende mbetet për t'u likuiduar vlera 41,600 lekë. Pra, gjoba të vendosura para vitit 2021 në proces gjyqësor dhe me marrëveshje të pa arkëtuara në total janë në **vlerën 651,600 lekë**. **Të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV në progresiv janë **në vlerën totale 3,551,600 lekë.** (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandim:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **3,551,600 lekë**.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

*6.2. Nga verifikimi rezultoi se:*, Në zbatim të Urdhërit Nr.09.,date 12.01.2022 "Për marrjen e masave organizative dhe zhdëmtimi nisur nga Raporti Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit "Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë", të ushtruar në Bashkinë Gramsh për periudhën 01 janar 2019-31 dhjetor 2020", në lidhje me gjetjet e Kontrollit të Lartë të Shtetit ,për shëndërrimin e dy vendimeve të kundërvajtjes me titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 "Shëndrrimi i vendimit për kundërvajtjet administrative në titull ekzekutiv" dhe neni 30 "Arkëtimi i shumave të detyrimeve të ligjit nr.10279 datë 20.05.2010 "për kundërvajtjet administrative,dhe arkëtimin e vlerës 541 600 lekë ,ju bëjmë me dije se :

Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit ka marrë menjëherë masat e duhura administrative ,i janë dërguar gjykatës administrative Durrës kërkesat për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për subjektet Sh.T. dhe H. L., si edhe i është dërguar subjektit fizik Z. G. ,njoftim për shlyerje detyrimi të gjobës .

Bashkëlidhur po ju dërgojmë :

1.Shkresën Nr.251 Prot.,datë 20.01.2022 " Njoftim për shlyerje detyrimi të gjobës" .

2.Shkresën Nr.249 Prot., datë 20.01.2022 " Kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vjeljen e gjobës Nr.1887/3 prot.,datë 04.04.2019.

3.Shkresë Nr.... Prot.,datë 20.01.2022 "Kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vjeljen e gjobës Nr.1777/7 datë 15.06.2020.

Pas procedurave të ndjekura me sipër ,IMT i është drejtuar Gjykatës Administrative Durrës për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit për debitorët e mësipërm.

***Në proces zbatimi***

## D. MASAT DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 15 germat b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, neni 59 "*Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore*", pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*,ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*", neni 37, "*Masa disiplinore*", **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Gramsh**t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të

konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

***Sipas urdhrit nr. 223 datë 05.08.2022 është ngritur Komisioni Disiplinor dhe ka bere verifikimin rast pas rasti të konstatimeve të KLSH, dhe sipas vendimeve perkatese te cituar ne tabelen ka vendosur "Ndërprerjen e ecurisë disiplinore" për 9 persona si me poshtë:***

Lista analitike e masave te rekomanduara dhe zbatuara

| **Nr** | **Emri Mbiemri** | **Pozicioni Zyrtar** | **Rekomandimi i KLSH dhe I APP** | **Masa e zbatuar** | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Shkresa apo vendimi nr data** | **Lloji i masës së zbatuar** |
| 1 | A. C. | Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit | *Mase disiplinore* | Vendimi nr.79 date 26.08.2022 | Ndreprere |
| 2 | E. H. | Kryeinspektor i IMT-se | *Mase disiplinore* | Vendimi nr.77 date 25.08.2022 | Ndreprere |
| 3 | L. P. | Pergjegjes i Auditit te Brendshem | *Mase disiplinore* | Vendimi nr.78 date 25.08.2022 | Ndreprere |
| 4 | A. J. | Drejtor i Drejtorise se te Ardhurave dhe Taksave Vendore | *Mase disiplinore* | Vendimi nr.80 date 26.08.2022 | Ndreprere |
| 5 | E. K. | Drejtori i Drejtorise Juridike, Burimeve Njerezore | *Mase disiplinore* | Vendimi nr.81 date 31.08.2022 | Ndreprere |
| 6 | A. S. | Drejtor i Drejtorise se Finaces dhe Buxhetit | *Mase disiplinore* | Vendimi nr.71 date 22.08.2022 | Ndreprere |
| 7 | E. I. | Pergjegjes i Sektorit te Emergjencave Civile | *Mase disiplinore* | Vendimi nr.72 date 22.08.2022 | Ndreprere |
| 8 | E. G. | Pergjegjes i Sektorit te IT-se | *Mase disiplinore* | Vendimi nr.773 date 22.08.2022 | Ndreprere |
| 9 | D. C. | Pergjegjes i Sektorit Juridik dhe i Aseteve Vendore | *Mase disiplinore* | Vendimi nr.74 date 22.08.2022 | Ndreprere |

## V- <u>Konkluzione dhe rekomandime</u>:

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Gramsh për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 376/7prot., datë. 22.07.2022, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre nuk është zbatuar dhe nuk rikërkohen si rekomandime të pa zbatuara pasi zbatimi i tyre pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual janë rekomandimet:

**<u>5.1 Rekomandim:</u>** Bashkia Gramsh të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

**<u>7.1 Rekomandimi:</u>** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog.468 "debitorë të ndryshëm", në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

**<u>9.1 Rekomandim:</u>** Bashkia Gramsh duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

## C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

**<u>1.1 Rekomandim:</u>** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga z. X. D. në vlerën **108,300 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Gramsh të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**<u>5.1 Rekomandim:</u>** Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.

***Rekomandim mbas verifikimt*:** Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Gramsh ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për masat e konsideruara të pa zbatuara të cilat janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë.

**<u>Kriteri</u>:**
Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15, "Të drejtat e KLSH", germa j), *ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin" me ndryshime.*

**<u>Shkaku</u>:**
Mos ndjekja e gjitha procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 108,300 lekë.

**Ndikimi/Efekti:**
Ndikon në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Gramsh.

**Rëndësia:** *E Lartë*

**<u>Rekomandim</u>:**
Kryetari i Bashkisë Gramshtë analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara si vijon;

**Për 3 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:**

**<u>5.1 Rekomandim:</u>** Bashkia Gramsh të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

**<u>7.1 Rekomandimi:</u>** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog.468 "debitorë të ndryshëm", në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

**<u>9.1 Rekomandim:</u>** Bashkia Gramsh duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**Për 2 masë të ardhura të munguara në vlerën 108,300 lekë si vijon:**

**<u>1.1 Rekomandim:</u>** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga z. X. D. në vlerën **108,300 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Gramsh të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**<u>5.1 Rekomandim:</u>** Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.

## IV GJETJE DHE REKOMANDIME

## A. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

**1 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:
- Nuk është hartuar "*Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*", për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA.
- Në informacionin e sjellë nga Burimet Njerëzore për vitin 2022 realizimi i trajnimeve të stafit në organizime jashtë bashkisë paraqitet 25 trajnime me 41ditë/trajnimi/9 punonjës.
- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.
- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).
- Bashkia Gramsh nuk ka miratuar "*Strategjinë e Menaxhimit të Riskut*", e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK- së dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike*", pikën 5.3.
- Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në mos zbatim të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016

"*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publike*".
- Në mbështetje të Ligjit nr. 10296 dt 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" neni 27, në zbatim të Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publike*" pika 2/2,4, nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Gramsh nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik".
- Në Bashkinë Gramsh, drejtoria e financave përdor programin excel. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave dhe kjo kryhet nga drejtoria e financave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.
- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm.
- Bashkia Gramsh nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1 faqe 19-32 të Raportit të Auditimit).*
**<u>1.1. Rekomandimi:</u>** Bashkia Gramsh me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:
- Të hartojë planin e trajnimeve për stafin;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik";
- Të miratojë "Strategjinë e Menaxhimit të Riskut".

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**<u>2. Gjetje nga auditimi:</u>** Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2022 e përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist auditimi. Kjo strukturë ka pasur vetëm 2 punonjës si inspektorë auditi të brendshëm në strukturë, në kundërshtim me kërkesa e ligjit nr.114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik*", neni 11 dhe të VKM nr. 83, datë 03/02/2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", për "*Miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*" pika 3. Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" neni 13 "*Komitetit të Auditimit të Brendshëm*".
Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" të Brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 19-22 të Raportit të Auditimit).*
**<u>2.2. Rekomandimi:</u>** Bashkia Gramsh të marrë masa për plotësimin e strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm dhe për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje

titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Gramsh ka diferenca me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën **1,078,704 mij**ë **lekë**, ndërsa realizimi **960,171 mijë lekë**, ose në masën 89%. Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **181,812 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **91,734 mijë lekë,** ose në masën 50.46 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Gramsh në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*".
Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*
**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuara dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**4.Gjetje nga auditimi**: Bashkia Gramsh në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 32,996 mijë lekë (nga kjo 474 mijë leke, detyrime të FSHZH), Detyrimi i Bashkisë është 32,522 mijë lekë e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 7,100 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 23,900 mijë lekë, ose 297% e vlerës së planifikuar.
Po për efekte të shtimit të detyrimeve gjate vitit 2022 , kjo ulje e detyrimeve nga pagesat nuk reflektohet në gjendjen e detyrimeve në datën 31.12.2022 .
Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur (32,996-13,119), me 19,877 lekë, ose në masën prej 60%. Në mënyrë të detajuar paraqiten në aneksin nr. 2 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 "P*ër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për

likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Gramsh dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, ku mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet rriskë për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**5. Gjetje nga auditimi**: Në Struktuën e DAV Bashkia Gramsh ka probleme dhe nuk është në funksion të realizmit e të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DAV Bashkia Gramsh, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor), për 13,495 subjekte familjare dhe biznesi në vlerën **66,577 mijë lekë**, *nga e cila:* subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 28,247 mijë lekë për 542 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 38,330 mijë lekë për 13,495 abonent. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara. *Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar dhe në Kreun XI- "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar", nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 168/1 prot datë 29.04.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Gramsh të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Gramsh me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**6. Gjetje nga auditimi**: Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta. Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Elbasan, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Gramsh dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Elbasan. Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Gramsh Sh.A., është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit dhe referuar akt marrëveshjes me nr. 4311 repertori dhe nr. 2332 koleksioni datë 12.10.2022 është nënshkruar kontrata e bashkëpunimit me Ujësjellës-Kanalizime Elbasan Sh.A. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.
- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 7 "*Të*

*drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit*" dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 15 "*Parapagimi*", si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 "*Për taksat Kombëtare*" . *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e Agjentëve Tatimore me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**7. Gjetje nga auditimi**: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Gramsh kryhet në programin Excel. DTTV nuk kryen regjistrim manual të të dhënave (nuk ka regjistra fizik) çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Gramsh i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelare dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV duke rezultuar në gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike të kompjuterave me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV. Gjithashtu, administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*" i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7. "*Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Bashkia Gramsh të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**8. Gjetje nga auditimi**: Nga të dhënat e siguruara nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me kontratat e koncesionit sipas regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës 2021-2022, në territorin e Bashkisë Gramsh, kanë ushtruar aktivitet në fushën e energjetikës 4 subjekte, për të cilat *Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit* Bashkia Gramsh nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj), sipas tabelës vijuese. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "*Për pyjet dhe shërbimin pyjo*r", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "*Për Fondin kullosor*", pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "*Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor*", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 "*Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Drejtorisë së shërbimit Pyjor të kërkojë informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me qëllim evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.
Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**9. Gjetje nga auditimi**: Nga analiza e llog. 468 "*Debitorë të ndryshëm*" nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore për 13,495 subjekte familjare dhe biznesi në vlerën **66,577 mijë lekë**, *nga e cila:* subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 28,247 mijë lekë për 542 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 38,330 mijë lekë për 13,495 abonent, për taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 71,441 lekë, subjektet që ushtrojnë aktivitet të pajisur me autorizim/ licencë të lëshuar në vlerën 4,800,000 lekë, të akumuluara në fund të vitit ushtrimor 2022, vlerë e cila nuk janë kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2022. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22**.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 78-96 të Raportit të Auditimit).*
**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog.468 "*debitorë të ndryshëm*", në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port të ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

***Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023***

**10. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Gramsh me urdhrin nr. 254 datë 26/11/2021 është ngritur komisioni për verifikimin dhe vlerësimin të gjendjes tekniko financiare të automjeteve të Bashkisë Gramsh. Me shkresën 3817/1 prot datë 20/09/2022 është përgatitur relacioni mbi vlerësimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve në pronësi të Bashkisë Gramsh, ku janë evidentuar 27 mjete të dëmtuara me kosto historike 36,550,319 lekë dhe vlerë neto 4,359,312 lekë sipas procesverbaleve përkatëse. Me vendimit nr. 76 datë 30.09.2022 "*Për miratimin e raportit të vlerësimit të aktiveve për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimi të Bashkisë Gramsh për vitin 2022*", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut, është miratuar procesi i vlerësimit të aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit sipas procesverbaleve të mbajtura për vitin 2022 për 27 mjete në vlerën historike 36,660,319 lekë. Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Financës ka hequr nga bilanci mjetet e nxjerra jashtë përdorimit me vlerë historike 36,660,319 lekë, pa përfunduar me pare i gjithë procesi i shitjes me procedurë ankandi. Për këto mjete, nëpunësi zbatues nuk ka ndjekur procesin dhe nuk ka bërë veprimet e duhura përmbyllëse, pasi ka hequr përfundimisht nga kontabiliteti aktivet e mësipërme në vlerën 36,660,319 lekë, duke i çregjistruar nga llogaria 215 "*Mjete transporti*", duke mos bërë regjistrimin e aktiveve, si të pa përdorshme, në llogarinë përkatëse në kontabilitet, duke humbur kështu gjurmën e auditimit
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",* neni 3 -Përkufizime, pika 1,2, neni 7 - Dokumenti kontabël, neni 11 – Qëllimi i pasqyrave financiare, neni 15-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve; UMF nr. 8 datë 9.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar". Nenin 109 dhe 110 të* UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* ligjin

10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 12-Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues, dhe* udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 78-96 të Raportit të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës (sektori i kontabilitetit), të marrë masa që vlera e 27 mjeteve të transportit prej 36,660,319 lekë të pa shitura me procedurë ankandi, por të zbritur padrejtësisht nga aktivet, të kryhet veprimi kontabël për regjistrimin e tyre në kontabilitet, duke i ngarkuar përsëri për vlerën e tyre deri në përfundim të procesit të shitjes.

***Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023***

**11. Gjetje nga auditimi**: Nga analiza e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjetet në ruajtje*", më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 41,79,735 lekë, më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 32,542,570 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga analiza të llogarië, konstatohet se: - Për vitin 2022 Drejtoria e Financës ka të dokumentuar ngurtësimet gjatë vitit 2022 në vlerën 32,542,570 lekë për 47 subjekte. Gjatë vitit 2022 shesta janë në vlerën 3,738,931 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 12,996,096 lekë për 7 subjekte. Sipas akt rakordimeve midis Bashkisë dhe Degës së Thesarit.- Për 32 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 29,116,786 lekë, *sipas pasqyrës së sipërcituar*, nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprimet e mosveprimet në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* i ndryshuar Kap. III, pikat 30, 50. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 78-96 të Raportit të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** -Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

***Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023***

**12. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 6 prona sipas tabelës së sipërcituar. Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Gramsh në Drejtorinë rajoneve të ASHK Gramsh, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 6 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Gramsh. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 *"Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme",* Kreu (VI) *"Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme"* dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 78-96 të Raportit të Auditimit).*

**12.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 6 pronave të certifikuara në ASHK Elbasan, por pa vlerë

respektive, si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Gramsh.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**13. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi u konstatua se në 5 procedura e prokurimi me objekt: "*Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II", "Ndërtim linje ujësjellësi fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit Lagja Kocaj e Fshat Gramsh"," Ndërtimi i Urës Kushovës", "Rikonstruksioni sistemimi, Fshatit Pishaj", "Sistemim Asfaltim i Lagjes Dellinje*" zhvilluar në periudhën 2021-2022, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme në hartimin e kritereve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për rregullat e prokurimit publik*", i ndryshuar, me pikën 4 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4.1, faqe 96-127 të Raportit të Auditimit).*

**13.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Gramsh të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:

**1-**Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II*", me vlerë të fondit limit 81,666,555 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE "B." & "G.", me ofertë **79,994,441** lekë pa TVSH, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

**2-** Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtim linje ujësjellësi fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit Lagja Kocaj e Fshat Gramsh*", me vlerë të fondit limit 19,166,638 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021", është shpallur fitues BOE V." Sh.P.K dhe G. shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 18,982,653 lekë pa TVSh , i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

3- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksioni sistemimi, Fshatit Pishaj*", Bashkia Gramsh, me vlerë të fondit limit 8,331,823 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "G." SH.P.K. & "V. me ofertë 8,242,210 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

**4-** Në procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje dru zjarri dhe pellet për vitin shkollor 2002-2023*", Bashkia Gramsh, me vlerë të fondit limit 9,062,750 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A. S." P.F, me ofertë 9,051,200 lekë pa tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 "*Anulimi i një procedure* prokurimi", pika nr.1, germa (ç), neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1, neni 53 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3 dhe pika 5, neni 55, "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*", pika 1**,** germa (a) dhe Ligji Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", neni 92, pika 3 *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4.1, faqe 96-127 të Raportit të Auditimit).*

**<u>14.1. Rekomandim: </u>** Titullari i AK Bashkia Gramsh, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**15.Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratave për punë publike, respektivisht:

- "*Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)";*
- *"Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj"";*
- *"Sistemim - asfaltim lagjja "Ish Reparti Ushtarak"*, rezultoi se, Autoriteti Kontraktor Bashkia Gramsh nuk ka kryer oponencën teknike për projektin e zbatimit për të gjitha ndërtimet publike dhe ndërtimet jopublike. Veprim ky në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, neni 6.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4.1, faqe 96-127 të Raportit të Auditimit).*

**<u>15.1. Rekomandimi</u>:** Bashkia Gramsh të marrë masa që të kryej oponencë teknike nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha ndërtimet publike, pavarësisht vlerës së tyre; për të gjitha ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; për të gjitha objektet me akses publik.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**16. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objektet: "*Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)"; "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj"*, u konstatua se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, nuk ka miratuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4.1, faqe 96-127 të Raportit të Auditimit).*

**<u>16.1. Rekomandimi</u>:** Bashkia Gramsh të marrë masa që të pajisë me Leje Ndërtimi Infrastrukturore çdo projekt zbatimi sipas legjislacionit në fuqi.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**17. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi rezultoi se në 2 raste në miratimi e lejes së ndërtimit nuk hartuar dhe nënshkruar një Akt-marrëveshje me subjektet zhvilluese për kalimin në favor të Bashkisë Gramsh 3% (tre përqind) e sipërfaqes takuese të banimit në godinat respektivisht;

1. Miratimi i lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 06 , datë 02/09/2021 me subjektin zhvillues "Z. E. A. L., Znj J. F. L." dhe Bashkia Gramsh nuk kanë hartuar dhe nënshkruar një Akt-marrëveshje bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 "*Për strehimin social"*, përcaktohet se 3% (tre përqind) e sipërfaqes takuese të banimit në godinat, objekt i aplikimit të lejes së ndërtimit Nr. 06 , datë 02/09/2021 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh është sipërfaqja prej 63 m2-, e llogaritur nga sipërfaqja totale e banimit prej 2100 m2, (2100 m2 * 3% = 63 m2) të cilat duhet të kishin kaluar në favor të Bashkisë Gramsh.
2. Miratimi i lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 542/5, datë 17/03/2022 me subjektin zhvillues "K." SH.P.K me NIPT J......S dhe Bashkia Gramsh nuk kanë hartuar dhe nënshkruar një Akt-marrëveshje bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social', përcaktohet se 3% (tre përqind) e sipërfaqes takuese të banimit në godinat, objekt i aplikimit të lejes së ndërtimit Nr. 542/5, datë 17/03/2022 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh është sipërfaqja prej 103.8 m2-, e llogaritur nga sipërfaqja totale e banimit prej 3460 m2, (3460 m2 * 3% = 103.8 m2) të cilat duhet të kishin kaluar në favor të Bashkisë Gramsh.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 *"Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015",* nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 *"Për strehimin social'. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 5, faqe 135-149 të Raportit të Auditimit).*

**17.1. Rekomandimi:** Drejtorin e Planidikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë të gjitha masat e nevojshme për lidhjen e një Akt-marrëveshjeve me subjektet zhvillues "Z. E. A. L., Znj J. F. L." dhe me subjektin zhvillues "K." SH.P.K me NIPT J......S, për kalimin e sipërfaqes prej 166.8 m2 banim në favor të Bashkisë Gramsh sipas pjesëve takuese së sipërcituar.

***Menjëherë***

**18. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në miratimin e lejeve së ndërtimit nuk janë respektuar distancën me kufirin e pronës, me trupit të rrugës, konkretisht si vijon:

1. Leja e ndërtimit miratuar me vendim Nr. 06 , datë 02/09/2021 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh, me zhvillues "z.E. A. L. dhe J. F. L.".
2. Leja e ndërtimit miratuar me vendim Nr. 5, datë 12/08/2021 të kryetarit të Bashkisë Gramsh me zhvillues "H. Z.".
3. Leja e ndërtimit miratuar me vendim Nr. 10, datë 09/11/2021 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh me zhvillues "S. I."
4. Leja e ndërtimit miratuar me vendim Nr. 542/5, datë 17/03/2022 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh me zhvillues "K." SH.P.K me NIPT J......S.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 "*Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 5, faqe 135-149 të Raportit të Auditimit).*

**18.1. Rekomandimi:** Drejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi, të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugës.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**19. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi rezultoi se në 10 raste në fondin pyjor dhe kullosor janë nënshkruar kontrata me shoqëritë koncesionare, të cilët janë në papajtueshmëri me Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor, konkretisht si vijon:

1. Kontrata e qirasë nr..... prot, datë 26.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " E. Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z. N. G. me afat 10 vite (26.10.2017 -25.10.2027).
2. Kontrata e qirasë nr. .... prot, datë 12.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " "I." Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z. P. K. me afat 10 vite (12.10.2017 -11.10.2027).
3. Kontrata e qirasë nr. ... prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria "O." Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z. M. O. me afat 10 vite (07.11.2017 -06.11.2027).
4. Kontrata e qirasë nr..... prot, datë 07.11.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " G. Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z. N. G. me afat 10 vite (07.11.2017 -06.11.2027).

5 Kontrata e qirasë nr.... prot, datë 05.10.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " HEC-i K. P." Sh.P.K përfaqësuar nga administratori znj. L. D. me afat 10 vite (05.10.2018 -04.10.2028).
6. Kontrata e qirasë nr. ... prot, datë 29.03.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria "D" Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z. E. D. me afat 10 vite (29.03.2018 -28.03.2028).
7. Kontrata e qirasë nr.... prot, datë 12.06.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " S." Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z. T. K. me afat 10 vite (12.06.2017 -11.06.2027).
8. Kontrata e qirasë nr. .... prot, datë 18.10.2017 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " E." Sh.a përfaqësuar nga administratori z. M. H. me afat 10 vite (18.10.2017 -17.10.2027).
9. Kontrata e qirasë nr. ... prot, datë 29.03.2018 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh znj. L. D. dhe qiramarrësi shoqëria " E." Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z. S. P. me afat 10 vite (29.03.2018 -28.03.2028).
10. Kontrata e qirasë nr. ... prot, datë 13.02.2020 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh z. K. T. dhe qiramarrësi shoqëria "E." Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z. O. A. me afat 10 vite (13.02.2020 -12.02.2030).
Sa më sipër miratimi i kontratave është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "*Për pyjet*"; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën "a" të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 "*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*", i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 "*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*", të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010". *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.6, faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*
**19.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Gramsh të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme duke reflektuar kërkesat e pikës 5.1 të VKM Nr. 267 datë 27.04.2023.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**20. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Gramsh, nga KLSH janë rekomanduar masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë dërguar në subjekt me shkresën nr. nr. 376/7prot., datë. 22.07.2022. Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre, si vijon:
- janë rekomanduar 13 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 13 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa, zbatuar pjesërisht 2 masa dhe janë në proces zbatimi 2 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative.
- Janë rekomanduar 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara në vlerën 67,860,312 lekë, nga e cila është arkëtuar vlera 4,088,052 lekë, është në proces zbatimi vlera 63,663,960 lekë dhe nuk është arkëtuar vlera 108,300 lekë për 2 rekomandime.
- Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Gramsh t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse, rekomandim i cili është zbatuar. Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me

ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"* neni 15, "Të drejtat e KLSH", germa j), ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin" me ndryshime. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 154-170 të Raportit të Auditimit).*
**20.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Gramsh të marrë të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi të lëna nga KLSH në raportin e auditimit të fundit, sipas shkresës nr. *376/7prot., datë. 22.07.2022*, të përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë raport auditimi, pika "Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e fundit" si vijon:

**Për 3 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:**

**5.1 Rekomandim:** Bashkia Gramsh të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.
**7.1 Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog.468 "debitorë të ndryshëm", në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

**9.1 Rekomandim:** Bashkia Gramsh duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**Për 2 masë të ardhura të munguara në vlerën 108,300 lekë si vijon:**

**1.1 Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga z. X. D. në vlerën **108,300 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Gramsh të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
**5.1 Rekomandim:** Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

## C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "K*odi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", **nga Titullari i njësisë publike,** të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,871,390 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "*Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)"* Bashkia Gramsh, me vlerë 95,993,329.20 lekë me TVSH, fituar nga BOE "B." SHPK & "G." SHPK, rezultuan punë të pa kryera për zërin e punimeve: "Zëri: 6 (3.25/a) Gërmim Kasonete", në vlerën **154,581 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. .... prot., datë 04.06.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gramsh dhe BOE "B." SHPK & "G." SHPK.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4/4.4 faqe 127-135 të Raportit të Auditimit).*

**<u>1.1. Rekomandimi</u>:** Bashkia Gramsh  të arkëtojë vlerën prej **154,581 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve BOE "B." SHPK & "G." SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. .... prot., datë 04.06.2021 me objekt "Rikonstruksioni i rrugës automobilistike Skënderbegas (Loti II)" Bashkia Gramsh.

***Menjëherë***

**2. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "*Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj*" Bashkia Gramsh, me vlerë 96,995,778 lekë me TVSH, fituar nga BOE "V." SHPK & "E." SHPK & "L." SHPK, rezultuan punë të pa kryera për zërin e punimeve: "Zëri: 6 (3.25/a) Gërmim Kasonete", në vlerën **267,528 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. ..... prot., datë 19.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gramsh dhe BOE "V." SHPK & "E." SHPK & "L." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4/4.4 faqe 127-135 të Raportit të Auditimit).*

**<u>2.1. Rekomandimi</u>:** Bashkia Gramsh  të arkëtojë vlerën prej **267,528 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve BOE "V." SHPK & "E." SHPK & "L." SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. ..... prot., datë 19.05.2021 me objekt "Sistemim asfaltim rruga "Llapushaj" Bashkia Gramsh.

***Menjëherë***

**3. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "*Sistemim - asfaltim lagjia "Ish Reparti Ushtarak*" Bashkia Gramsh, me vlerë 22,979,260 lekë me TVSH, fituar nga BOE "F." SHPK & "S." SHPK, rezultuan punë të pa kryera për zërat e punimeve: "Zëri 5(3.182/a) F.V Rërë nën dhe mbi tubacione HDPE 2*10 cm" dhe "Zëri 5 (3.620) Shtresë pllaka trotuari betoni h=6 cm", në vlerën **264,970 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. ..... prot., datë 28.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Gramsh dhe BOE "F." SHPK & "S." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4/4.4 faqe 127-135 të Raportit të Auditimit).*

**<u>3.1. Rekomandimi</u>:** Bashkia Gramsh  të arkëtojë vlerën prej **264,970 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve BOE "F." SHPK & "S." SHPK, për punime të pakryera, sipas kontratës

me nr. ..... prot., datë 28.05.2021 me objekt "Sistemim asfaltim lagjja "Ish reparti Ushtarak" Bashkia Gramsh.

***Menjëherë***

**4. Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se Leja e ndërtimit miratuar me vendim Nr. 542/5, datë 17/03/2022 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh me zhvillues "K." SH.P.K me NIPT J......S me "*Objekt banimi dhe shërbimi 3 kate dhe 5 kate me 1 kat parkim nëntokë*", në qytetin e Gramshit është llogaritura më pak taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerë 184,311 lekë, konkretisht; Sipërfaqe e ndërtimit kati nën tokë (parkimi): 1100 $m^2$ * 5% * 43,000 lekë/m2 *0.7 = 1,655,500 lekë; sipërfaqe shërbimi: 885 $m^2$ * 5% * 43,000 lekë/m2 * 1.5 = 2,854,125 lekë; sipërfaqe banimi: 3460 m2 * 4% * 43,000 lekë/m2 = 5,951,200 lekë; sipërfaqe totale e ndërtimit 4345 $m^{2.}$

**Vlera që duhet të paguante = 10,460,825 lekë.**

Sipas autorizimit për pagesë të llogaritur nga përgjegjësja e financës znj K. X. dhe firmosur nga Kryetari i Bashkisë z. K. T. dhe e paguar nga firma "K." SH.P.K është **9,276,514 lekë** Pra konstatohet një diference e dukshme në vlerën prej **1,184,311 lekë** *( 10,460,825 lekë - 9,276,514 lekë = 1,184,311 lekë*) e papaguar nga subjekti K. SH.P.K për shkak të keq llogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të taksës së Ndikimit në Infrastrukture. Diferenca prej **1,184,311 lekë** e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Gramsh.

Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 "*Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015*", Udhëzimit nr. 3, date 28.12.2016 "Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit sipas Entit Kombëtar", aneksi nr. 2 i VKM nr. 132 datë 07.03.2018 dhe sipas Vendimit te Këshillit Bashkiak nr. 96 datë 30/12/2019 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020" e në vijim *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 135-149 të Raportit të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Gramsh të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **1,184,311 lekë,** nga subjekti "K." SH.P.K, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

***Menjëherë***

## C.I. MASA PËR ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET DHE ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE TË ARDHURA TË MUNGUARA.

**1.Gjetje nga auditimi**: Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Gramsh në datën 31.12.2022 janë në vlerën **66,577 mijë lekë**, *nga e cila:* subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore **në vlerë 28,247 mijë lekë** për 542 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë **38,330 mijë lekë** për 13,495 abonent., ***vlerë kjo e cila përbën detyrim të pa arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Gramsh***. Rezulton se vetëm në vitin 2022 borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale 16,332 mijë lekë, i përbërë nga 11,367 mijë lekë dhe 5,064 mijë lekë nga taksapaguesit familjarë. Bashkia Gramsh nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. DTTV për vitin 2022 nuk ka dërguar në Drejtorinë e Financës informacion lidhur me debitorët progresiv. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*

**<u>1.1.Rekomandimi:</u>** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Gramsh, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **66,577 mijë lekë**, *si më poshtë vijon***:**
*a-T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit*, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar*, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet*, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Gramsh për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**2.Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, për vitin 2022 ASHK ka dërguar informacion në Bashkinë Gramsh për 79 qytetarë që kanë kryer legalizimet e banesave të tyre. Bashkia ka llogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë për secilin nga qytetarët duke dërguar edhe njoftimet përkatëse. Vlera totale e detyrimit është 1,597,688 lekë. Kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë 75 qytetarë në vlerën 1,590,247 lekë dhe nuk ka paguar taksën 4 qytetar në vlerën 71,441 lekë duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 71,441 lekë.** *Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*
**<u>2.1.Rekomandimi:</u>** Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **71,441 lekë** ndaj **4** personave.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi**: Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 6 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 4 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe nuk kanë paguar detyrimet në vlerë 2,800,000 lekë si dhe nuk janë pajisur me aurorizim për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë 2 subjekte, përkatësisht subjekti "G." dhe subjekti "B.", të cilët nuk kanë paguar detyrimet në vlerë 2,000,000 lekë. Nga ushtrimi i aktivitetit i pa pajisur me autorizim/licencë të lëshuar nga bashkia dhe pa paguar detyrimet për autorizim ka sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 4,800,000 lekë.** Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me nenin 35 të ligjin nr.

9632, datë 30.10.2006 *"Për Sistemin e Taksave Vendore",* i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. e VKM nr. 170, datë 25.4.2002 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre",* i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015*"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Gramsh, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **4,800,000 lekë** ndajë **6** subjekteve, sipas pasqyrës së sipërcituar.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**4.Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi u konstatua se për shkak të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik, në Bashkinë Gramsh kanë zhvilluar aktivitet edhe 3 subjekte, të cilët nuk janë evidentuar për efekt të pagesës së detyrimeve tatimore që lindin ndaj njësisë vendore. Kjo situata ka sjellë krijimin e të ardhurave të munguara në vlerën 77,583 lekë. Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore nuk ka dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre për periudhën e kontratës. Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik të listuar në tabelën e mësipërme është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 12, pika 6 *"Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë bashkisë ose komunës përkatëse. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje",* VKB nr. 96 datë 30.12.2019 "*Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore*" në Bashkinë Gramsh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-78 të Raportit të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**5.Gjetje nga auditimi:** Struktura e Inspektoratit së Mbrojtjes se Territorit Vendor të Bashkisë Gramsh (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me Vendim të Titullarit nr.15, datë 18.02.2022 "*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njësive vartëse të saj, për vitin 2022*", ku struktura e IMTV është e përbërë nga 2 punonjës, nga të cilët 1 kryeinspektor dhe 1 inspektor. Emërimi i 1 (një) k/Inspektori dhe 1 inspektori në strukturën e IMT është në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 "*Për Inspektimin e Ndërtimit*", i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 "*Për inspektimin e ndërtimit*" neni 11 "*Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit*".

Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) Bashkia Gramsh për periudhën objekt auditimi janë vendosur 6 gjoba në vlerën 1,650,000 lekë + 630,000 lekë (kamatëvonesa për 3 gjoba), duke arritur në total në shumën prej **2,280,000 lekë** nga të cilat është arkëtuar vlera **183,333 lekë.** Përveç gjobave të vendosura gjatë vitit 2022 dhe që nuk janë paguar, IMTV ka edhe gjoba të

tjera të vendosura më herët që nuk janë arkëtuar dhe janë në proces gjyqësor. Përkatësisht, gjoba të vendosura para vitit 2022, në total janë 10 për vlerën prej 4,610,000 lekë + 1,560,000 lekë (kamatëvonesa). Është paguar vlera prej 900,000 lekë dhe janë në proces gjyqësor 4 gjoba me vlerë 610,000 lekë. **Të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV në progresiv janë **në vlerën totale 5,806,667 lekë.**

Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridik nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh në progresiv në vlerën prej **5,806,667 lekë.** Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 "*Për inspektimin e ndërtimit*" i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV" ndryshuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010, nr.10 323, datë 23.9.2010; nr. 23/2013, datë 14.2.2013; nr. 183/2014, datë 24.12.2014) Neni 10 Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar (shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014) Neni 20 Shfuqizime (ndryshuarme ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014).* IMT Bashkia Gramsh, ka marrë 6 vendime për prishje objektesh pa leje, vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara. Në këto raste rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje, por nuk është marrë asnjë masë tjetër nga ana e IMT Bashkia Gramsh për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 "*Për inspektimin e ndërtimit*", i ndryshuar. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin e ndërtimit*" i ndryshuar dhe konkretisht neni 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 149-154 të Raportit të Auditimit).*

**<u>5.1.Rekomandimi:</u>** Inspektorati i Mbrojtës Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Gramsh, të kërkojë në Gjykatë, shndërrimin e vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 "*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv"* dhe neni 30 "Arkëtimi i shumave të detyrimeve" të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*" dhe arkëtimi i vlerës **5,806,667 lekë** e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

## D. MASA DISIPLINORE

### I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Gramsh, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit, si më poshtë:

**1. Z. A. J.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore
**2. Z. O. L.** me pozicion Specialist për Inspektimin, Kontrollin Tatimor në Terren
**3. Z. F. B.** me detyrë Inspektor për Taksat e Biznesit
**4. Znj. E. M.** me detyrë Specialiste për taksat familjare

**<u>Për shkeljet e konstatuara</u>**

Në mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave vendore", ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kreu XI-"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara" neni 93

“Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, me pasojë mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e detyrimit 66,577 mijë lekë.

**5. Znj. E. I.** me detyrë përgjegjëse sektori në Drejtorin e Shërbimeve me Sipërmarrje, Transporteve, Strehim dhe Emergjencave Civile.
**6. Znj. B. A.** me detyrë specialiste paga dhe shpenzime në Drejtorin e Financës dhe Buxhetit.
**7. Znj L. Z.** me detyrë drejtor drejtorie në Drejtorin e Shërbimeve me Sipërmarrje, Transporteve, Strehim dhe Emergjencave Civile.
**8. Znj. E. C.** me detyrë specialiste në Drejtorin e Financës dhe Buxhetit.
**<u>Për shkeljet e konstatuara</u>**
Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 “*Kualifikimi ofertuesve*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar; neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, neni 26 “*Kontrata për punë publike*”, pika (5); neni 61 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”, pika (2), paragrafi (2).

**9. Z. A. S.** me detyrë Sekretar i Përgjithshëm.
**10. Z. E. S.** me detyrë Specialist në Drejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
**<u>Për shkeljet e konstatuara</u>**
Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të ofertës e cila për devijime të vogla nuk plotësojnë kriteret në kërkesat kualifikuese, ndërsa duhej të ishin skualifikuar dhe KVO duhej ti kishte rekomanduar titullarit anulimin e procedurave të prokurimit, për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) “*Anulimi një procedure prokurimi*”, pika (1), germa (ç); neni (46) “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika (1); neni (53) “*Shqyrtimi ofertave*”, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*”, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe neni (66) “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika (3); neni (67) “*Klasifikimi ofertave*; neni (68) “*Raporti përmbledhës*”; Kreu (VIII) “*Kushte të përgjithshme për zbatim*”; neni (73) “*Mungesa e konkurrencës*”, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

**11. Z. A. Ç.** me detyre Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

**<u>Për shkeljet e konstatuara</u>**
Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të ofertës e cila për devijime të vogla nuk plotësojnë kriteret në kërkesat kualifikuese, ndërsa duhej të ishin skualifikuar dhe KVO duhej ti kishte rekomanduar titullarit anulimin e procedurave të prokurimit, për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) “*Anulimi një procedure prokurimi*”, pika (1), germa (ç); neni (46) “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika (1); neni (53) “*Shqyrtimi ofertave*”, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*”, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe neni (66) “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika (3); neni (67) “*Klasifikimi ofertave*; neni (68) “*Raporti përmbledhës*”; Kreu

(VIII) “*Kushte të përgjithshme për zbatim*”; neni (73) “*Mungesa e konkurrencës*”, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

- Në cilësinë e *Drejtorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit* për mos zbatim të kërkesave të ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “*Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015*” Në miratimin e lejeve të ndërtimit. (Më hollësisht trajtuar në raportin përfundimtar të auditimit).

**II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, LIGJIN 139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 e nenit 15, si dh enë pikën 1, germa (i), neni 29të ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin embrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe të nenit 82 dhe 84 të “Rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Gramsh,** që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit:

**1. Z. X. B.** me detyrë Drejtor Kabineti

**<u>Për shkeljet e konstatuara</u>**

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të ofertës e cila për devijime të vogla nuk plotësojnë kriteret në kërkesat kualifikuese, ndërsa duhej të ishin skualifikuar dhe KVO duhej ti kishte rekomanduar titullarit anulimin e procedurave të prokurimit, për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) “*Anulimi një procedure prokurimi*”, pika (1), germa (ç); neni (46) “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika (1); neni (53) “*Shqyrtimi ofertave*”, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*”, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe neni (66) “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika (3); neni (67) “*Klasifikimi ofertave*; neni (68) “*Raporti përmbledhës*”; Kreu (VIII) “*Kushte të përgjithshme për zbatim*”; neni (73) “*Mungesa e konkurrencës*”, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

**2. z. F. L.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit

**3. z. B. C.** me detyre Përgjegjës në Drejtorin e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit

**<u>Për shkeljet e konstatuara</u>**

Në hartimin e kontratave është në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010. ”.

**4. Z. E. H.** me detyrë Kryeinspektor në Drejtorin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit dhe Policisë Bashkiake.
**5. Z. A. B.** me detyrë Inspektor në Drejtorin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit dhe Policisë Bashkiake.

**<u>Për shkeljet e konstatuara</u>**
**Në** shndërrimin e vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 "Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv" dhe neni 30 "Arkëtimi i shumave të detyrimeve" të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe arkëtimi i vlerës **5,806,667 lekë** e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh.

**E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.**
Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e masës disiplinore z. A. R. Specialist në fushën e Urbanistikës në cilësinë e personit përgjegjës për hartimit e dokumenteve të tenderit në procedurat "Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas ,Loti II", dhe "Ndërtim linje ujësjellësi fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit Lagja Kocaj e Fshat Gramsh", znj K. X. me detyrë ish/ Përgjegjëse në Drejtorin e Financës si personi përgjegjës për keq llogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në lejen e ndërtimit Nr. 542/5, datë 17/03/2022 të Kryetarit të Bashkisë Gramsh.

***Shënim: Për punonjësit që kanë bërë shkelje, mangësi apo të meta më të ulta se risku, nuk rekomandojnë masë disiplinore:***

**1. Z A. S.** me detyrë Drejtor i Financës për periudhën e auditimit. 01.01.2021-31.12.2022
2. **z. E. H.** me detyrë Përgjegjës i Buxheti 01.01.2021-31.12.2022

**F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**
Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Gramsh pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**
**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.
**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**<u>Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.</u>**

# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT